



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

WE EMPOWER PEOPLE

NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMIT DHE DËNIMIT ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

*Guidë mbi jurisprudencën e Gjykatës
Europiane të të Drejtave të Njeriut*



Ndalimi i Torturës, Trajtimit dhe Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues

Guidë mbi jurisprudencën e Gjykatës
Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Redaktor

Biljana Braithwaite, Menaxhere Projekti për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE
Catharina Harby, konsulente ligjore senior, Qendra AIRE
Goran Miletic, Drejtori për Evropën, Civil Rights Defenders

Kontribuese kryesore

Ishaani Shrivastava, Barrister, Dhomat Devereux, Londër

Falenderime të veçanta për

Nuala Mole, juriste senior, Qendra AIRE
Anske Venter dhe Sanjit Nagi, Praktikantë, Qendra AIRE

Përkthyen nga origjinali

Ina Xhepa, Drejtore Ekzekutive, Qendra Europiane
Klara Kodra, Menaxhere Projekti, Qendra Europiane

© 2018 AIRE Centre

Printuar
200

Versioni origjinal i këtij botimi u përgatit në anglisht. Ai u përkthye në gjuhën boshnjake, kroate, malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase.

Dizajn
Kliker Dizajn

Printoi
Kontura

Hyrje

Forumi i Pestë mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore – synon nxitjen e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe procesin e integritetit të BE – do të fokusohet në çështjen kritike të ndalimit të torturës, ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.


Ndalimi i torturës duhet të jetë pjesë e themelit të çdo shteti, që pretendon të jetë demokratik. Pa këtë parim nuk mund të thuhet se një shoqëri mbështetet në shtetin e së drejtës. Ky ndalim është një normë *jus cogens* e linjës zakonore ndërkombëtare. Ndalimi shfaqet në shumë traktate ndërkombëtare dhe pothuajse në të gjitha sistemet ligjore vendase në mbarë botën. Në konsultim me gjyqtarët e rajonit dhe Strasburgut, janë identifikuar aspektet më të rëndësishme të nenit 3. Këto aspekte përfshijnë detyrimin pozitiv dhe procedural të shtetit për të hetuar pretendimet për trajtime të ndaluara, detyrimet thelbësore ndaj Shtetit në lidhje me trajtimin e personave të ndaluar; personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor; azilkërkuesit dhe emigrantët; si edhe fëmijët. Duke ofruar një analizë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane dhe përmbledhjet e çështjeve më të rëndësishme, shpresojmë se ky botim, së bashku me burimet e tjera që u ofrohen pjesëmarrësve në Forum do të ndihmojnë në avancimin e kuptimit të ndalimit të torturës - si në aspektin e saj substancial, ashtu edhe procedural.

Është dëshira dhe objektivi ynë që të gjithë pjesëmarrësit në përfundim të këtij eventi, të pajisur me të gjitha materialet dhe pas marrjes pjesë në diskutime, do të ndjehen më të aftë për të hulumtuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane dhe për të kapërcyer sfidat me të cilat po përballlet aktualisht zbatimi i Konventës në rajon.

Ne ju urojmë të gjithëve diskutime dhe Forum të suksesshëm.

Biljana Braithwaite

The AIRE Centre



Goran Miletić

Civil Rights Defenders



Skopje, March 2018

Përmbajtja

Hyrje	3
(1) Hyrje: ndalimet absolute	11
(2) Përkufizime: Tortura dhe trajtimi çnjerëzor, ose trajtimi a ndëshkrimi poshtërues	12
(3) Detyrimet thelbësore	15
(4) Detyrimet Procedurale	29
(5) Përfundime	33
NENI 3 Përmbledhje vendimesh	34
<i>Nuk ekziston rreziku i trajtimit çnjerëzor në shkelle të nenit 3 nëse një i huaj muxhahedin deportohet në Tunizi</i>	
VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AL HANCHI k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS	34
<i>Deportimi i një muxhahedini drejt Sirisë përbënte shkelle të nenit 3, sepse atje ekziston rreziku i keqtrajtimit – një ndalim arbitrar përpara procesit të deportimit përbënte shkelle të nenit 5</i>	
VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AL HUSIN k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS	37
<i>Dështimi i autoriteteve rumune për të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme kërkuesen nga dhuna në familje derivon në shkelle të nenit 3</i>	
VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BĂLŞAN k. RUMANISË	41
<i>Mungesa e hetimeve efektive mbi një rast keqtrajtimi e ndjekur nga një sherr ku u përfshinë të rritur dhe të mitur përbën shkelle të nenit 3</i>	
VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BEGANOVIĆ k. KROACISË	44
<i>Mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm mjekësor ose mbikëqyrja arsimore e një të mituri në një qendër të përkohshme ndalimi, përbën shkelle të nenit 3 dhe 5, ndërsa marrja në pyetje dhe proceset përbëjnë shkelle të nenit 6</i>	
VENDIMI DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BLOKHIN k. RUSISË.....	48

Përdorimi i forcës, përveç rasteve kur është domosdoshmërisht i nevojshëm, i përdorur nga autoritetet ndaj individëve që ndodhen nën kontrollin e tyre shkel nenin 3 dhe nëse ky veprim nuk deriun dëmtime serioze fizike ose mendore

VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BOUYID k. BELGIKËS54

Mbipopullimi i qelive të burgut deriun një shkelje të nenit 3 dhe zgjatja e periudhës së ndalimit për 5 vjet 8 muaj dhe 15 ditë shkel nenin 5 (3) të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BULATOVIĆ k. MALIT TË ZI.....58

Dështimi për të kryer një hetim efektiv dhe këshillimi i një të mituri pas abuzimit seksual përbënte shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN C.A.S DHE C.S k. RUMANISË.....61

Dhuna e policëve kundër demonstruesve paqësor në vendqëndrimin e tyre dhe ligjet e papërshtatshme penale për të parandaluar në mënyrë efektive dhunën e ushtruar përbënin shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN CESTARO k. ITALISË.....65

Dështimi në mbrojtjen e individëve nga dhuna me motive fetare dhe mungesa e hetimeve efektive përbën shkelje të neneve 3 dhe 9

VENDIMI I GJYKATËS PËR ÇËSHTJEN E ASAMBLESË GLDANI TË DËSHMITARËVE TË JEHOVAIT DHE TË TJERË kundër GJEORGJISË 69

Dështimi i Kroacisë në mbrojtjen e një personi me aftësi të kufizuara nga ngacmime të dhunshme të përsëritura cenon nenet 3 dhe 8 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ĐORĐEVIĆ k. KROACISË.....74

Kushtet e papërshtatshme të ndalimit dhe trajtimi mjekësor i kërkuesit uin në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN DYBEKU k. SHQIPËRISË 77

Bashkëpunimi i autoriteteve maqedonase në rrëmbimin e kërkuesit - përbën shkelje të nenit 3 të Konventës

VENDIMI DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN EL-MASRI k. ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQËDONISË..... 80

Përdorimi i teknikave të ndaluara nga neni 3 nga punonjësit e policisë

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN GÄFGEN k. GJERMANISË.....85

Individëve me aftësi të kufizuara fizike të mbajtur në paraburgim, duhet t'u plotësohen nevojat e tyre të veçanta në mënyrë adekuate me qëllim që Shteti të veprojë në përputhje me nenin 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRIMAILOVS k. LETONISË 88

Trajtim i papërshtatshëm mjekësor në shkelje të nenit 3 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRORI k. SHQIPËRISË92

Një operacion i ashpër i policisë për të arrestuar një politikan ka deriuar shkelje të neneve 3, 5 (3), 5 (5), 6, 8 dhe 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GUTSANOVI V k. BULLGARISË95

Keqtrajtimi nga policia gjatë arrestit

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN HAJNAL k. SERBISË 99

Mbajtja de facto për 23 ditë në zonën e tranzitit të azilkërkuesve ishte e paligjshme dhe largimi i tyre nga Hungaria në Serbi i ekspozoi ata para një rreziku real chain-refoulement

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ILIAS DHE AHMED k. HUNGARISË 103

Të drejtat e mbrojtura nga neni 3 janë absolute dhe nuk mund të derogohen për shkak të emergjencave publike

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN IRLANDA k. MBRETËRISË SË BASHKUAR 108

Marrja e provave me forcë përbën shkelje të të drejtave të kërkuarit në kuadër të ndalimit e trajtimit çnjerëzor e poshtërues dhe procesit të rregullt

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN JALLOH k. GJERMANSË 112

Mungesa e një hetimi efektiv mbi pretendimet për nënshtrimin ndaj torturës të një personi me origjinë etnike rome

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN JASAR k. "ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË"116

Mungesa e mbikqyrjes ose e kujdesit të specializuar për një person më aftësi të kufizuar mendore që kreu veturasje në burg – përbën shkelje të nenit 3 dhe 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KEENAN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....119

Moskryerja e një hetimi efektiv nga ana e agjentëve shtetërorë gjatë arrestimit dhe ndalimit në komisariatin e policisë dhe në paraburgim përbënte shkelje të nenit 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KRSMANOVIĆ k. SERBISË123

Kohëzgjatja e tepërt e procesve të kujdestarisë dhe dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve përbën shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE M. k. KROACISË127

Kjo çështje kishte të bënte me detyrimin pozitiv të shteteve për të ngritur dhe zbatuar me efektivitet një sistem penal që ndëshkon të gjitha format e përdhunimit

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M.C. k. BULLGARISË 131

Mungesa e hetimeve efektive ndaj sulmeve të motivuara për shkak të urrejtjes fetare

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MILANOVIĆ k. SERBISË.....134

Ndalimi për 27 ditë rresht në një hapësirë në më pak se 3 m² përbën trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN MURŠIĆ k. KROACISË.....137

Autoritetet belge nuk duhet të kishin kthyer mbrapsht azilkërkuuesin në shtetin grek

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN M.S.S. k. BELGIKËS DHE GREQISË.....141

Struktura e arsimit fillor në Irlandë në vitet 1970, dështoi në mbrojtjen e një nxënëseje nga abuzimi seksual nga mësuesi i saj duke derivuar në shkelje të neneve 3 dhe 13

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN O'KEEFFE k. IRLANDËS 149

Një vendim i rëndësishëm mbi dështimin e autoriteteve për mbrojtjen ndaj dhunës në familje përbënte shkelje të neneve 2, 3 dhe 14

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN E DHOMËS OPUZ k. TURQISË152

Dështimi i autoriteve për të marrë në konsideratë shëndetin e kërkuesit gjatë procesit të dëbimit të tij, përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës në shkelje të nenit 3

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN

MADHE PAPOSHVILI k. BELGJIKËS157

Dështimi i autoriteteve, për të përmbushur detyrimet pozitive në mbrojtje të kërkuesve nga persekutimi nga të burgosurit e tjerë, përbënte shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RODIĆ DHE 3 TË TJERËT

k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS.....161

Mos respektimi i masës së ndërmjetme bazuar në Rregullin 39, për të mos lejuar ekstradimin në SHBA përbënte shkelje të nenit 34

VENDIM PËR ÇËSHTJEN RRAPO k. SHQIPËRISË 165

Mos kryerja e hetimeve në mënyrë efektive lidhur me lëndimet e pësuar nga kërkuesi, mbarte në vetvete një nivel minimal të shkallës së ashpërisë për t'u konsideruar keqtrajtim sipas nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SINIŠTAJ DHE TË TJERËT k. MALIT TË ZI 170

Dështimi i autoriteteve kroate për hetimin e dhunës mbi motive racore ndaj viktimave, përbëjnë shkelje të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠKORJANEC k. KROACISË.....174

Sterilizimi i gruas rome në një spital publik, pa vullnetin e saj të plotë përbënte shkelje të të drejtave të njeriut sipas neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN V.C. k. SLLOVAKISË 178

Dështimi i autoriteteve për dhënien e trajtimit me terapinë e përshtatshme gjatë periudhës së ndalimit për një person të varur nga droga, përbënte një shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN WENNER k. GJERMANISË 183

Mungesa e një hetimi efektiv lidhur me pretendimet për abuzimin seksual dhe mbrojtja e viktimës nga ballafaqimi me autorin e sulmit – ishte në shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Y. k. SLLOVENISË 187

Detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur fëmijët nga veprime të personave të tretë në kuadër të nenit 3 dhe mungesa e një mjeti efektiv ankimi në bazë të nenit 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Z. DHE TË TJERËT

k. MBRETËRISË SË BASHKUAR190

(1) Hyrje: ndalimet absolute

Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut imponon një **ndalim absolut dhe të pakushtëzuar** ndaj torturës, ose trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës.

Është e vështirë të mbivlerësohet rëndësia e kësaj ndalese. Ajo është një nga normat e **vetme** *jus cogens* e së drejtës zakonore ndërkombëtare, e pranuar gjerësisht nga bashkësia ndërkombëtare, si një nga parashikimet, ndaj të cilave nuk lejohet asnjë shmangie. Ndalimi shfaqet në shumë traktate ndërkombëtare, duke përfshirë: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare; katër Konventat e Gjenevës; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës; dhe Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ndalimi gjendet në pothuajse **të gjitha** sistemet ligjore vendase në mbarë botën.

Një shtet nuk mund të kërkojë të justifikojë keqtrajtimin e ndaluar nga neni 3, parësisht nëse pretendon: se ky trajtim ndodhi si pjesë e përpjekjes për të shpëtuar jetën e të tjerëve; për arsye të sigurisë kombëtare; për parandalimin e terrorizmit; ose për parandalimin e krimit të organizuar. **Asnjë derogim** nuk lejohet gjatë luftës, ose gjatë një gjendjeje të jashtëzakonshme¹.

Është e qartë se neni 3 imponon **një detyrim negativ thelbësor** - shtetet nuk duhet të pajtohen drejtpërdrejtë në asnjë trajtim të ndaluar. Kur shqyrtohet së bashku me nenin 1 të Konventës², neni 3 imponon edhe **një detyrim pozitiv** - për të siguruar që individët brenda juridiksionit³ të një shteti të jenë të mbrojtur nga çdo trajtimi i ndaluar. Detyrimet pozitive ndaj një shteti janë⁴:

- 1 *Gäfgen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05 (i përfshirë në këtë publikim); *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93.
- 2 Neni 1, KEDNJ: "**Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut**" "Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente".
- 3 Kjo zakonisht do të kufizohet në veprimet që ndodhin dhe vendimet që merren brenda territorit të shtetit. Juridiksioni ekstra-territorial do të ushtrohet në rrethana të jashtëzakonshme, duke përfshirë: a) kur shteti kryen një veprim që prek individët jashtë territorit të tij; b) kur shteti ushtron kontroll efektiv mbi një zonë jashtë territorit të tij; c) kur kontrolli ushtrohet në territorin e Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës (do të çojë në një "vakum" në mbrojtje brenda "hapësirës ligjore" të Konventës): *Al-Skeini dhe Të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 7 korrikut 2011, nr. 55721/07; *Hassan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 16 shtatorit 2014, nr. 29750/09.
- 4 *Z dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, nr. 29392/95 (i përfshirë në

- (a) një detyrim thelbësor për të ndërmarrë **masa të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimin për të cilin shteti ka pasur ose duhet të kish pasur dijeni** (p.sh., rastet në të cilat autori i keqtrajtimit potencial është një palë e tretë dhe jo një zyrtar, që ushtron funksione publike); dhe
- (b) **një detyrim procedural për të kryer një hetim efektiv** kur situata ka të bëjë me një keqtrajtim të diskutueshëm (kryer ose nga autoritetet shtetërore ose nga individë privatë).

Si gjithmonë, Konventa duhet të garantojë, që të drejtat e parashikuara në të të jenë **praktike dhe efektive dhe jo teorike apo iluzionare**. Në kontekstin e nenit 3, një rëndësi te veçantë i jepet detyrimit për të hetuar.

(2) Përkufizime: Tortura dhe trajtimi çnjerëzor, ose trajtimi a ndëshkrimi poshtëruës

Tradicionalisht, Gjykata ka dalluar torturën nga trajtimin ose ndëshkimin çnjerëzor, ose degradues në mënyrat e mëposhtme:

- (a) Gjykata ka konsideruar se dallimi midis torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës rrjedh kryesisht nga ndryshimi në intensitetin e vuajtjeve të shkaktuara. Synimi i Konventës ishte, që me fjalën “torturë”, të bashkëngjiste një stigmë të posaçme për trajtimin çnjerëzor të qëllimshëm, i cili ka shkaktuar vuajtje shumë serioze dhe mizore⁵.
- (b) Trajtimi është konsideruar si “çnjerëzor”, sepse *inter alia* është kryer me paramendim, kryhet për një periudhë kohe të caktuar, si edhe ka shkaktuar lëndime trupore ose vuajtje intensive fizike a mendore⁶.

këtë publikim); *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 29 tetorit 1998, nr. 23452/94 (çështje kryesore në kontekst të nenit 2 me parime të zbatueshme për nenin 3); *Dorđević k. Kroacisë*, vendim i 24 korrikut 2012, nr. 41526/10 (i përfshirë në këtë publikim); *A dhe Të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shtatorit 1998, nr. 3455/05 (mbrojtja e “ndëshkimit prindëror” në rastin kur një fëmijë i rrahur nga njerku i tij çoi në shqyrtimin e faktit se shteti ka dështuar në mbrojtjen e fëmijës nga trajtimi i ndaluar) *Beganović k. Kroacisë*, vendim i 25 qershorit 2009, nr. 46423/06 (i përfshirë në këtë publikim).

5 *Iralanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 18 janarit 1978, nr. 5310/71 (i përfshirë në këtë publikim).

6 *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, nr. 34529/10 (i përfshirë në këtë publikim); *Beganović k. Kroacisë*, vendim i 25 qershorit 2009, nr. 46423/06 (i përfshirë në këtë publikim); *Jalloh k. Gjermanisë*, Vendim i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2006, nr. 54810/00 (i përfshirë në këtë publikim).

- (c) Trajtimi është konsideruar “poshtërues”, kur shkakton tek viktimat e tij ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit; nëse poshtëron ose zbeh personalitetin e një individit përpara vetë atij, ose një individ tjetër; nëse thyen rezistencën fizike ose psikologjike të personit, ose e shtyn personin të veprjë kundër vullnetit ose ndërgjegjes së tij; ose tregon mungesë respekti dhe cenon dinjitetin njerëzor⁷.

Është e rëndësishme të vërehet se **trajtimi që përfshihet në ndonjërin nga këto kategori do të derivojë një shkelje të nenit 3 të Konventës**.

Si **trajtimi fizik ashtu edhe ai mendor** mund të derivojnë një trajtim të ndaluar. Kërcënimi që një trajtim i tillë mund të ndodhë, me kusht që ai të jetë real dhe i menjëhershëm, gjithashtu mund të shkelë nenin 3⁸.

Nevojitet **një nivel minimal ashpërsie** me qëllim që trajtimi të përfshihet në fushëveprimin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi varet nga të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë këtu faktorët e mëposhtëm:⁹

- (a) kohëzgjatja e trajtimit;
- (b) efektet e tij fizike ose mendore;
- (c) gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore të viktimës;
- (d) qëllimin për të cilin është shkaktuar trajtimi dhe synimin; ose motivimin që qëndron pas tij;
- (e) konteksti, siç është gjendja e tensionuar dhe emocionale;
- (f) nëse ishte sistematik;
- (g) nëse shteti mund të kishte ndërmarrë veprime alternative për të përmbushur një qëllim legjitim (p.sh., duke arrestuar dikë).

7 *Stanev k. Bullgarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 17 janarit 2012, nr. 36760/06; *Svinarenko dhe Slyadnev k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 17 korrikut 2014, nr. 32541/08; *Labita k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 prillit 2000, nr. 26772/95; *Jalloh k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 11 Korrikut 2006, nr. 54810/00 (i përfshirë në këtë publikim); *Beganović k. Kroacisë*, vendim i 25 qershorit 2009, nr. 46423/06 (i përfshirë në këtë publikim); *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (i përfshirë në këtë publikim); *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, nr. 34529/10 (i përfshirë në këtë publikim).

8 *Gäfgen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05 (i përfshirë në këtë publikim);

9 *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 18 janarit 1978, nr. 5310/71 (i përfshirë në këtë publikim); *Gäfgen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05 (i përfshirë në këtë publikim).

Fokusi i Gjykatës është gjithnjë e më shumë në faktin nëse Shtetet respektojnë **standarde të pranueshme sjelljeje**¹⁰. Ndikimi subjektiv mbi individin dhe qëllimi i trajtimit, nuk do të jetë përcaktues, përveç rasteve përjashtimore¹¹.

Shtetet duhet të udhëhiqen nga shembuj faktikë të trajtimit, të cilat janë vlerësuar në të kaluarën se kanë shkelur nenin 3. Megjithatë, një rast i vlerësuar më parë se nuk ka pasur shkelje, **nuk** përjashton mundësinë e evidentimit të një shkeljeje në të ardhmen. Konventa është **një instrument i gjallë. Standardi gjithnjë e në rritje**, që kërkohet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut kërkon në mënyrë të pashmangshme vendosmëri më të madhe në vlerësimin e shkeljeve mbi vlerat themelore të shoqërive demokratike¹².

Gjithënjë e më shumë, Gjykata është ndikuar nga ndryshimet progresive që ndodhin në Shtetet Palë¹³. Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT)¹⁴ është një organizëm, që ka ndikuar në promovimin e një konvergjence të standardeve të trajtimeve të papranueshme në mbarë botën - në kushtet e privimit të lirisë.

Përcaktimi i fakteve është detyrë e gjykatave vendase. Ndërsa, Gjykata Evropiane nuk ka lidhje me këto gjetje. Ajo do të distancohet nga përcaktimi i kryer vetëm për arsye tepër thelbësore¹⁵. **Kualifikimi ligjor**, që do të zbatohet për këto fakte, duke përfshirë dhe pyetjen nëse faktet derivojnë ose jo shkelje, i takon Gjykatës së Strasburgut dhe jo kërkuesit¹⁶.

Barra e provës për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje duhet të shkoj në këto raste "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"¹⁷. Për të bërë këtë vlerësim, Gjykata do të shqyrtojë të gjithë materialin e paraqitur para saj, vlerësojë rëndësinë e tij, identifikojë mangësitë në të, si dhe të marrë në konsideratë rëndësinë e çdo mangësie.

10 *Fedotov k. Russia*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 tetorit 2005, nr. 5140/02.

11 *K.C. k. Slovakia*, vendim i 8 nëntorit 2011, nr. 18968/07 (i përfshirë në këtë publikim).

12 *Selmouni v France*, Vendim i Dhomës së Madhe of 28 Korrikut 1999, nr. 25803/94.

13 *M.C. k. Bullgarisë*, vendim i 4 dhjetorit 2003, nr. 39272/98 (i përfshirë në këtë publikim).

14 KPT-është themeluar në bazë të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës 1987. KPT-së i lejohet të vizitojë vendet e paraburgimit në Shtetet e Këshillit të Evropës dhe të hartojë raporte për gjetjet dhe rekomandimet për për shtetet në fjalë. Anëtarët e KPT-së janë të pavarur dhe të paanshëm.

15 *Gäffen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05 (i përfshirë në këtë publikim).

16 *Bălsan k. Rumanisë*, vendim i 23 Majit 2017, nr. 49645/09 (i përfshirë në këtë publikim).

17 *Grimailous k. Letonisë* vendim i 25 qershorit 2013, nr. 6087/03 (i përfshirë në këtë publikim). Kjo nuk do të pasqyrojë domosdoshmërisht teste të formuluar në mënyrë të ngjashme në ligjin vendas.

Aty ku është e përshtatshme Gjykata, mund të nxjerrë përfundime nga fakte dhe **ndërhyrje** të tilla, duke përcaktuar se ka pasur shkelje¹⁸. Këto janë disa shembuj nga të cilat mund të nxirren konkluzione të kundërta ndaj një shteti:

- (a) dështimi në sigurimin e dokumenteve ose dëshmitarëve të rëndësishëm;¹⁹
- (b) dështimi për t'iu përgjigjur pretendimeve të dhunës ndaj një të burgosuri;²⁰
- (c) mos lejimi i një të burgosuri të ekzaminohet nga ekspertë mjekësorë të pavarur ose nga avokati i tij.²¹

(3) Detyrimet thelbësore

(a) Trajtimi i një individi kur ndodhet nën kontrollin e autoriteteve shtetërore

Gjykata Evropiane ka trajtuar një numër tepër të madh çështjesh në lidhje me keqtrajtimin e individëve që ndodheshin nën kontrollin e autoriteteve. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, personat që gjenden në këto kushte:

- (a) sapo arrestohen ose janë të arrestuar;
- (b) merren në pyetje nga agjentë shtetërorë, prokurorë, policë ose forca të sigurisë;
- (c) të mbahen në paraburgim deri në përfundim të procesit penal;
- (d) të burgosur pasi janë dënuar;
- (e) në paraburgim për shkak të migrimin;
- (f) të mbahen të mbyllur ose nën kujdes në një institucion mjekësor²²;
- (g) mbahen në ose nën kujdesin e shtëpive të fëmijës.

Çdo përdorim i forcës fizike kundër një personi, përveç rasteve kur kjo bëhet ekstremisht e nevojshme për shkak të sjelljes së vetë personit, cenon dinjitetin e subjektit në fjalë. Në parim nëse kjo forcë arrin pragun e ashpërsisë **derivon shkelje** të nenit 3.

18 *Grimailous k. Letonisë* vendim i 25 qershorit 2013; *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 18 janarit 1978, nr. 5310/71 (i përfshirë në këtë publikim).

19 *Aydin k. Turqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe i 25 shtatorit 1997, nr. 23178/94.

20 *Karabet dhe Të Tjerët k. Ukrainës*, vendim i 17 janarit 2013, nr. 38906/07 and 52025/07.

21 *Karabet dhe Të Tjerët k. Ukrainës*, vendim i 17 janarit 2013, nr. 38906/07 and 52025/07.

22 Personat që janë nën kontrollin e shtetit për shkak të sëmundjes ose të mungesës së zotësisë juridike, dallohen nga personat që janë nën kontrollin e shtetit sepse kanë kryer një krim apo dyshohen se kanë kryer një krim. Megjithatë, në të dy rastet, shteti ka detyrime sipas nenit 3.

Kërkesat e një hetimi dhe vështrësimit të pamohueshme të luftës kundër krim-it, nuk e kufizojnë mbrojtjen që duhet dhënë në lidhje me integritetin fizik të individëve në kuadër të nenit 3²³. Koha në të cilën një person arrestohet para vlefësimin të masës së sigurisë është një periudhë gjatë së cilës rreziku i shkeljeve ndodh shpesh në nivelin më të lartë. Është në këtë fazë kur një individ rrezikon të jetë subjekt i dhunës fizike dhe të merret në pyetje. Mund t'i vendosen pranga dhe të kontrollohet fizikisht. Metodatat për kapjen dhe arrestimin e personit mund të bien ndesh me nenin 3. Neni 6 (e drejta për një proces të rregullt) do të invokohet. **Mundësia për të pasur një avokat** është jetësore për të siguruar, që shkeljet të mos ndodhin.

Çdo përdorim i forcës gjatë arrestimit duhet të jetë njëkohësisht **i domosdoshëm dhe proporcional**. Shembuj në të cilët forca mund të jetë e nevojshme përfshijnë rastet kur ekzistojnë arsye për të besuar se personi i interesuar do të rezistonte ndaj arrestimit, ose do të zhdukte, dëmtonte ose shkatërronte provat. Çdo përdorim i tillë i forcës duhet të jetë proporcional. Efekti i shkaktuar nga mënyra e arrestimit të një individit tek anëtarët e afërt të familjes, duke përfshirë edhe fëmijët e mitur (të cilët nuk janë vetë të arrestuar), është gjetur të jetë trajtim degradues dhe si rrjedhojë një shkelje e nenit 3²⁴.

Në lidhje me hetimet dhe proceset penale, ekziston **një ndalim absolut për përdorimin e çdo prove të marrë nga tortura ose trajtimi çnjerëzor ose degradues**²⁵. Pa një ndalim të tillë, të drejtat e garantuar neni 3 do të bëheshin të pabaza.

Në kontekstin e kontroleve fizike do të jenë relevant faktorët si gjinia e të kontrolluarit dhe kontrolluesit, vendi i kontrollit dhe ndërhyrja e kryer²⁶. Për vendosjen e prangave dhe kufizimeve të tjera, do të vlerësohen mënyra e ekzekutimit të masës shtrënguese, kohëzgjatja si dhe domosdoshmëria për përdorimin e kësaj mase²⁷.

Gjykata vlerëson se procesi i **mbajtjes në paraburgim e bën një individ veçanërisht të prekshëm ndaj rrezikut të keqtrajtimin**. Privimi i lirisë krijon një mundësi më të madhe për abuzime të tilla²⁸. Përsëri, mundësia për të pasur një avokat siguron një

23 *Gutsanovi k. Bullgaria*, vendim i 15 tetorit 2013, nr. 34529/10 (i përfshirë në këtë publikim); *Hajnal k. Serbia*, vendim i 19 qershorit 2012, nr. 36937/06 (i përfshirë në këtë publikim).

24 *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, nr. 34529/10 (i përfshirë në këtë publikim).

25 *Gäfgen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 Qershorit 2010, nr. 22978/05 (i përfshirë në këtë publikim); *Tomasi k. Francës*, vendim i 27 gushtit 1992, nr. 12850/87.

26 *Valašinas k. Lituaniës*, vendim i 24 korrikut 2001, nr. 44558/98.

27 *Öcalan k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 May 2005, nr. 46221/99.

28 *Hajnal k. Serbisë*, vendim i 19 qershorit 2012, nr. 36937/06 (i përfshirë në këtë publikim).

mbrojtje thelbësore. KPT-ja ka theksuar se periudha menjëherë pas arrestimit të një individi, është momenti kur rreziku i frikësimit dhe keqtrajtimit fizik është në maksimum. KPT-ja ka vërejtur një rrezik veçanërisht të lartë në komisaritet e policisë²⁹.

Dhoma e Madhe së fundmi përmbloodhi parimet e mëposhtme, të cilat janë të zbatueshme për rastet e heqjes së lirisë:³⁰

- (a) Mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masave kundër individit nuk duhet t'a nënshtrojë atë përballë stresit ose vështirësive që tejkalojnë nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim.
- (b) Duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgosjes, shëndeti dhe mirëqenia e individit duhet të sigurohen në mënyrë adekuate, ndër të tjera, kryesore është dhënia e kujdesit dhe trajtimit të duhur mjekësor.
- (c) Mungesa e një qëllimi për të poshtëruar ose për të fyer një të paraburgosur është një faktor, që duhet marrë parasysh, por nuk përjashton gjetjen e një shkeljeje.
- (d) Detyrimet sipas nenit 3 zbatohen pavarësisht nga vështirësitë financiare ose logjistike të Shtetit.

Gjykata ka theksuar rëndësinë e rolit parandalues të KPT-së gjatë monitorimit të kushteve të paraburgimit dhe të standardeve, që zhvillon në këtë drejtim. Gjykata ka përsëritur se kur vendoset për rastet në lidhje me kushtet e paraburgimit, ajo do të mbajë në vëmendje këto standarde³¹.

Faktorët që duhet të shqyrtohen gjatë vlerësimit të **kushteve të ndalimit** përfshijnë: objektet e gjumit; sanitare; kushtet e temperaturës; dritën natyrale; ushqimin dhe ujin; mundësi infektimi; ndjeshmëria ndaj sëmundjeve; disponueshmërinë e ushtrimit fizik; të drejtën për të pasur vizita; kujdesin mjekësor; dhe mbipopullimin e qelive (më pak se 3 m² për një person të paraburgosur në qeli derivon mundësi për një prezumim të fortë për shkelje). Mund shqyrtohet nëse kohëzgjatja e situatës është e shkurtër, e rastësishme dhe e parëndësishme, si edhe nëse shoqërohet me mundëinë e lirisë së lëvizjes jashtë qelisë; dhe institucioni i paraburgimit është i përshtatshëm pa rrethana të tjera rënduese³².

29 Raporti i Përgjithshëm nr. 6. 1996, paragrafi 15; 1999, Raporti i Përgjithshëm nr. 9. paragrafi 23.

30 *Muršić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit, nr. 7334/13 (i përfshirë në këtë publikim); *Wenner k. Gjermanisë*, vendim i 1 shtatorit 2016, nr. 62303/13 (i përfshirë në këtë publikim); *Bulatović k. Malit të Zi*, vendim i 22 korrikut 2014, nr. 67320/10 (i përfshirë në këtë publikim).

31 *Muršić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2016, nr. 7334/13 (i përfshirë në këtë publikim).

32 *Muršić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2016, nr. 7334/13 (i përfshirë në këtë publikim).

Do të vlerësohet **kohëzgjatja dhe efekti kumulativ i këtyre kushteve. Karakteristikat personale** të individit në fjalë do të jenë gjithashtu relevante. Individët me aftësi të kufizuara lëvizëse mund të vuajnë sidomos në hapësirat e pamjaftueshme fizike³³. Për personat e me problem të shëndetit mendor (qoftë të mbajtur në një kontekst penal ose thjesht mjekësor) vlerësimi nëse kushtet janë të mjaftueshme **duhet** të marrë parasysh dobësinë dhe aftësinë e tyre të kufizuar. Ndjenja e inferioritetit dhe e pafuqisë, e cila është tipike për personat që vuajnë nga një çrregullim i shëndetit mendor është element, që rrit nevojën e vigjilencës. Për shembull, nuk është e përshtatshme për të trajtuar të burgosurit me një gjendje psikologjike të rënduar “njësoj” si të burgosurit e tjerë.³⁴

Dhoma e izolimit në vetvete nuk është në kundërshtim me nenin 3. Megjithatë, sërish, kohëzgjatja dhe domosdoshmëria e izolimit, shëndeti i të burgosurit dhe çdo trajtim tjetër në lidhje të do të jetë i rëndësishëm. Fakti që futja në dhomën e izolimit është bërë për mbrojtjen e vetë të burgosurit nuk përbën domosdoshmërisht një faktor përjashtues për përgjegjësi.

Shteti mund të ketë përgjegjësinë për keqtrajtimin e kryer, jo vetëm nga punonjësit shtetërorë, por edhe nga të burgosurit e tjerë.³⁵ Qëllimi i detyrimit për të parandaluar sjelljen e ndaluar nga personat e tretë do të trajtohet më poshtë (seksioni 3 (d)).

Kur ngjarjet në fjalë janë tërësisht ose pjesërisht në kuadër të njohurive ekskluzive të autoriteteve shtetërore, siç është rasti për personat gjenden brenda kontrollit ose kujdestarisë shtetërore, **do të lindin dyshime të forta faktike në lidhje me dëmtimet që ndodhin gjatë ndalimit**. Barra e provës i takon Shtetin për të dhënë një arsytim të pranueshëm dhe bindës. Në mungesë të një arsytimi të tillë, Shteti mund të konsiderohet përgjegjës dhe në shkelje.³⁶

Procesverbalet janë shumë të rëndësishme, veçanërisht në të gjitha rastet kur individët mbahen nën kontrollin e shtetit. **Mbikëqyrja e detajuar, e rregullt dhe e saktë e mbajtjes së procesverbaleve**, jo vetëm që do të zvogëlojë rrezikun e rasteve të shkeljeve të nenit 3, por do të mundësojë rritjen e llogaridhënies³⁷. Kjo është mënyra

33 *Arutyunyan k. Rusisë*, vendim i 10 janarit 2012, nr. 48977/09.

34 *Dybeku k. Shqipërisë*, vendim i 18 dhjetorit 2007, nr. 41153/06.

35 *Rodić dhe Të Tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendim i 27 majit 2008, nr. 22893/05 (i përfshirë në këtë publikim).

36 *Hajnal k. Serbisë*, vendim i 19 qershorit 2012, nr. 36937/06 (i përfshirë në këtë publikim); *Tomasi k. Francës*, vendim i 27 gushtit 1992, nr. 12850/87; *Aksoy k. Turqisë*, vendim i 18 dhjetorit 1996, nr. 21987/93; *Selmouni k. Francës*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 korrikut 1999, nr. 25803/94.

37 *Salman k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2000, nr. 21986/93; *Hilal Mammadou k. Azerbaixhanit*,

më e mirë për të evidentuar kushtet në të cilat është mbajtur një individ, si edhe mundëson kryerjen e rishikimeve të rregullta. Shtetet nuk mund të mbështeten në mungesën e dëmtimeve të regjistruara për të hedhur poshtë pretendimet lidhur me trajtimin e ndaluar.³⁸ Asnjë shtet nuk mund të mbështetet në gjetje të parregullta për shkak të një hetimi të paplotë.³⁹

KPT-ja ka deklaruar se të drejtat themelore që i garantohen një personi në komisar-iatet e policisë do të përforcohen dhe puna e policëve do të lehtësohej më shumë **nëse do të ekzistonte një regjistër i vetëm dhe gjithëpërfshirës** për çdo person të ndaluar, në të cilin mund të regjistroheshin të gjitha aspektet e arresimit, veprimet e ndërmarra në lidhje me personin duke përfshirë:⁴⁰

- (a) kur individit i ishte privuar liria;
- (b) arsyet për masat e ndërmarra kundër individit;
- (c) kur individit i janë komunikuar të drejtat e tij/saj, si edhe përmbajtja e komunikimit;
- (d) çdo shenjë dëmtimi fizik ose sëmundje të shëndetit mendor;
- (e) hera e fundit që janë vizituar nga një mjek, anëtar i familjes, ose avokati;
- (f) kur individit i është ofruar ushqim ose ujë;
- (g) kur individit është marrë në pyetje;
- (h) kur individit është transferuar ose lënë i lirë.

Individët do të përpiqen për të siguruar prova lidhur me dështimet dhe mangësitë institucionale nga punonjësist e shtetit. Për këtë, Gjykata konsideron se shteteve **u kërkohet të paraqesin prova për të kundërshtuar ankesat objekt shqyrtimi**.⁴¹ Raportet e KPT-së dhe raportet e organizatave të tjera qeveritare dhe jofitimprurëse, mbi kushtet e përgjithëshme të ndalimit, përdoren shpesh për të mbështetur këto akuza.⁴²

vendim i 4 shkurtit 2016, nr. 81553/12.

38 *Dedouskiy dhe Të Tjerët k. Rusia*, vendim i 15 Maj 2008, nr. 7178/03.

39 *Virabyan k. Armenisë*, vendim i 2 tetorit 2012, nr. 40094/05 (shteti duhet të shpjegojë plagosjen e testikullit të kërkuesit si pasojë e rezistencës).

40 Raporti i Dytë i Përgjithshëm, paragrafi 40.

41 *Ogica k. Rumanisë*, vendim i 27 majit 2010, nr. 24708/03.

42 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 21 janarit 2011, nr. 30696/09 (i përfshirë në këtë publikim).

(b) Ndhima mjekësore për personat që ndodhen nën kontrollin e Shtetit

Shtetet **duhet** të mbrojnë mirëqenien fizike dhe mendore të personave, që ndodhen nën kontrollin e tyre, të cilëve u është privuar liria, qoftë kjo për shkak të proceseve penale, ose për shkak se individit është i sëmurë, ose ka probleme të shëndetit mendor. Kjo përfshin **dhënien e ndihmës së përshtatshme mjekësore**. Kur Shtetet vendosin të mbajnë një person të sëmurë rëndë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të veçantë në garantimin e kushteve, që korrespondojnë me nevojat e veçanta të atij personi.

“Përshtatshmëria” e ndihmës mjekësore është e vështirë për tu përcaktuar. Trajtimi mjekësor i ofruar në mjediset e burgut duhet të jetë në një nivel të krahasueshëm me nivelin që Shteti garanton për popullatën në tërësi. Kjo nuk do të thotë se çdo të burgosuri duhet t’i garantohet i njëjti nivel trajtimi mjekësor, që ofrohet në institucionet më të mira shëndetësore jashtë burgjeve.⁴³ Gjykata garanton fleksibilitet të mjaftueshëm në përcaktimin e standardit të kërkuar të kujdesit shëndetësor, duke e vendosur rast pas rasti. Ky standard duhet të jetë “i pajtueshëm me dinjitetin njerëzor”, por duke marrë parasysh dhe “kërkesat praktike të burgosjes”.⁴⁴

I takon Gjykatës të përcaktojë nëse Shteti ka ofruar **prova të besueshme dhe bindëse**, që tregojnë se gjendja shëndetësore e kërkuesit dhe trajtimi i duhur janë vlerësuar dhe evidentuar në mënyrë të përshtatshme dhe se kërkuesi ka marrë kujdesin të duhur mjekësor në burg.⁴⁵

Shtetet duhet të sigurojnë:⁴⁶

- (a) mbajtjen e të dhënave gjithëpërfshirëse lidhur me gjendjen shëndetësore të të ndaluarit dhe trajtimin e tij/saj gjatë qëndrimit në burg;

43 *Wenner k. Gjermanisë*, vendim i 1 shtatorit 2016, nr. 62303/13 (i përfshirë në këtë publikim *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009, nr. 25336/04 (i përfshirë në këtë publikim).

44 *Siništaj dhe Tërëti k. Malit të Zi*, vendim i 24 nëntorit 2015, nr. 1451/10 (i përfshirë në këtë publikim).

45 *Wenner k. Gjermanisë*, vendim i 1 shtatorit 2016, nr. 62303/13 (included as a summary in this publication).

46 *Siništaj dhe Tërëti k. Malit të Zi*, vendim i 24 nëntorit 2015, nr. 1451/10 (i përfshirë në këtë publikim); *Wenner k. Gjermanisë*, vendim i 1 shtatorit 2016, nr. 62303/13 (i përfshirë në këtë publikim); *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 Korrikut 2009, nr. 25336/04 (i përfshirë në këtë publikim); *Blokhin k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06 (i përfshirë në këtë publikim).

- (b) mbikëqyrja është e rregullt dhe e vazhdueshme, përfshin një strategji gjithëpërfshirëse terapeutike që synon trajtimin e përshtatshëm të problemeve shëndetësore të të burgosurit, ose parandalimin e përkeqësimit;
- (c) është siguruar kujdesi i duhur;
- (d) trajtimi mjekësor nuk i është mohuar;
- (e) nuk kërkohet miratim nga prokurori për trajtim;
- (f) diagnoza është e shpejtë dhe e saktë;
- (g) çdo trajtim korrespondon me sëmundjen me të cilën është diagnostikuar i burgosuri, siç është përcaktuar nga mjekët specialistë;
- (h) krijohen kushte të nevojshme në mënyrë që të mund të ndiqet trajtimi i përshkruar;
- (i) nëse kërkohet këshillim shtesë nga një ekspert mjekësor më i specializuar, në rast të një mendimi të ndryshëm mjekësor.

Ashtu si me kushtet e burgut, monitorimi, procesverbali dhe rishikimi janë të domosdoshëm. Mosmbajtja në mënyrën e duhur e procesverbaleve do të dëmtojë rezultatin e çdo procesi monitorimi ose mbikëqyrjeje. Për një person që për shembull, ka probleme të shëndetit mendor dhe ka rrezik të kryejë vetëvrasje, kjo mund të përbëjë shkelje në bazë të kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor.⁴⁷

Fakti që gjendja shëndetësore e një kërkuesi përkeqësohet në burg nuk mund të mjaftojë për konstatimin e një shkeljeje. Ajo që duhet të përcaktohet është nëse shteti, në kohën e duhur, **siguron gjithë kujdesin mjekësor të disponueshëm** me qëllim për të penguar avancimin e sëmundjes në fjalë.⁴⁸

Në lidhje me **ndërhyrjet e detyruara mjekësore për qëllime terapeutike**:⁴⁹

- (a) caktimi i trajtimit mjekësor pa pëlqimin e kujdestarit të personit pa zotësi për të vepruar përbën një ndërhyrje që mund të shkelë të drejtën e integritit fizik;
- (b) kur trajtimi ka për qëllim shpëtimin e jetës së individit, për shembull, dhënia e ushqimit me forcë, duhet të tregohet se është e domosdoshme nga ana mjekësore;
- (c) do të jetë relevante nëse ndërhyrja me forcë është urdhëruar dhe administruar nga mjekët, si edhe nëse personi në fjalë është vendosur nën mbikëqyrje mjekësore;

⁴⁷ *Keenan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 3 prillit 2001, nr. 27229/95 (i përfshirë në këtë publikim).

⁴⁸ *Siništaj dhe Të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 24 nëntorit 2015, nr. 1451/10 (i përfshirë në këtë publikim).

⁴⁹ *K.C. k. Sllovakisë*, vendim i 8 nëntorit 2011, nr. 18968/07 (i përfshirë në këtë publikim); *Jalloh k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2006, nr. 54810/00 (i përfshirë në këtë publikim); *Neumerzhitsky k. Ukrainës*, vendim i 5 prillit 2005, nr. 54825/00.

- (d) mënyra e administrimit nuk duhet të kalojë pragun e nivelit minimal të ashpërsisë, në veçanti, duhet të merret parasysh nëse personi ka përjetuar dhimbje ose vuajtje të rënda fizike si pasojë e ndërhyrjes;
- (e) Gjykata do të shqyrtojë nëse ndërhyrja ka pasur si rezultat përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të personit ose ka pasojë të dëmshme afatgjata;
- (f) duhet të ekzistojnë dhe respektohen garancitë procedurale për kryerjen e ndërhyrjes.

Në parim, Konventa, nuk e ndalon përdorimin e **një ndërhyrjeje mjekësore me forcë, që do të ndihmojë në hetimin e një veprë penale**. Megjithatë, çdo ndërhyrje në integritetin fizik të një personi të kryer me qëllim marrjen e provave duhet të jetë subjekt i shqyrtimit të rreptë. Faktorët e mëposhtëm kanë rëndësi të veçantë:⁵⁰

- (a) masa në të cilën ndërhyrja mjekësore me forcë ishte e nevojshme për marrjen e provave (përfshi këtu, për shembull, nëse ishin marrë në konsideratë metoda të tjera, më pak shqetësuese për marrjen e provave);
- (b) proporcionaliteti i ndërhyrjes, në lidhje me rrezikshmërinë e veprës penale të dyshuar ose të kryer;
- (c) rreziqet shëndetësore për të dyshuarin;
- (d) mënyra e kryerjes së procedurës;
- (e) dhimbjet fizike dhe vuajtjet psikologjike të shkaktuara;
- (f) shkalla e mbikëqyrjes mjekësore të ofruar;
- (g) efektet mbi shëndetin e të dyshuarit;
- (h) në të gjitha rrethanat, ndërhyrja nuk duhet të arrijë pragun minimal të ashpërsisë që do të shqyrtohej në bazë të qëllimit të nenit 3.

Kur gjendja shëndetësore e një të burgosuri kërkon kujdes të specializuar në spital, vijimi i ndalimit, qoftë edhe në spitalin e burgut, mund të përbëjë shkelje në vetvete.⁵¹ Tre elementet e mëposhtme duhen të merren parasysh:

- (a) gjendja shëndetësore;
- (b) ndihma e përshtatshme dhe kujdesi mjekësor që mund të sigurohet gjatë ndalimit; dhe
- (c) Mbajtja nën vëzhgim gjatë ekzekutimit të masës së ndalimit në funksion të gjendjes shëndetësore të kërkuesit.

⁵⁰ *Jalloh k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2006, nr. 54810/00 (i përfshirë në këtë publikim).

⁵¹ *Aleksanyan k. Rusisë*, vendimi i 22 dhjetorit 2008, nr. 46468/06.

Personat që ndalohen jo për shkak të veprave penale, por për shkak të shëndetit të tyre mendor, duhet të vendosen në **institucione të posaçme të kujdesit mjekësor**. Ata janë në pozita vulnerable dhe mund të mos jenë në gjendje për tu ankuar lidhur me trajtimin, ose të kërkojnë ndihmë. Ata mund rrezikojnë të kryejnë vetëvrasje, ose në mënyrë të pandërgjegjshme të jenë të dhunshëm. Mënyra e zbatimit, domosdoshmëria dhe kohëzgjatja e çdo kufizimi të përdorur për t'iu përgjigjur një dhune të tillë do të jetë e rëndësishme në vlerësimin nëse ka pasur shkelje. Veçanërisht në këtë kontekst, **ndëshkimi i një sjelljeje të tillë do të ndalohej**. Trajtimi duhet të jetë terapeutik.

Lidhur me fëmijët, shtetet gjithmonë duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës. Nëse shteti konsideron se fëmijës duhet t'i hiqet liria, për këtë veprim duhet të kryhet një vlerësim mjekësor i gjendjes shëndetësore të fëmijës për të përcaktuar nëse masa e propozuar është e përshtatshme.⁵²

(c) Kthimi mbrapsht, dëbimi dhe ekstradimi

Shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë kjo, mund të ngrejë diskutime për një çështje sipas nenit 3, ku **evidentohen shkaqe thelbësore për të besuar se personi në fjalë, nëse dëbohet do të përballë me një rrezik real keqtrajtimi**. Në një rast të tillë, neni 3 e ndalon dëbimin. Duke qenë se ndalimi është absolut, sjellja e kërkuarve, sado e padëshirueshme apo e rrezikshme, që mund të jetë nuk mund të merret parasysh. Të gjitha procedurat e brendshme për kërkesat për azil, refuzimet dhe apelimet duhet të aplikojnë gjithashtu standarde, që garantojnë respektimin e ndalimit në bazë të nenit 3.

Situatat në të cilat kjo mund të lindin janë:

- (a) refuzimi i hyrjes në kufi;
- (b) refuzimi i kërkesave për azil;
- (c) refuzimi i vizave;
- (d) deportimi pas dënimeve penale;
- (e) transferimi jashtë-gjyqësor i personave nga një shtet në tjetrin, me qëllim ndalimin dhe marrjen në pyetje jashtë rrjedhës së sistemit ligjor;
- (f) ekstradimi i një personi të akuzuar, ose dënuar për kryerjen e një krimi në një shtet tjetër për të qenë pjesë e procesit a dënimit penal;
- (g) dëbimet kolektive nga territori ose në kufijtë e tij mund të ngrejë çështje që mbrohen nga neni 3 dhe janë të ndaluara sipas nenit 4 të Protokollit nr. 4;

⁵² *Blokhin k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06 (i përfshirë në këtë publikim).

- (h) “kthimi mbrapsht” i personave nga një Shtet (për shembull, refuzimi nga autoritetet shtetërore i hyrjes së individëve brenda kufijve të shtetit, ose dërgimin e tyre drejt kufirit, në vend që të marrin në shqyrtim kërkesat e tyre për azil);
- (i) situata e “*chain-refoulement*”⁵³ (azilkërkuessit kthehen në një vend të tretë, nga i cili janë rikthyer sërish, ndoshta disa për disa herë radhazi dhe përballen me rrezikun e keqtrajtimet).

Parimet bazë janë si më poshtë vijon:⁵⁴

- (a) Vlerësimi i ekzistencës së një rreziku real duhet të jetë **rigoroz**. Kërkuessit duhet të paraqesin dëshmi bindëse për të demonstruar se ekzistojnë arsye thelbësore për të besuar se, nëse masa e ankimuar do të zbatohet, ata do të ishin të ekspozuar ndaj një rreziku real për t’u nënshtruar trajtimet në kundërshtim me nenin 3. Kur paraqiten këto prova, i takon shtetit të heq çdo dyshim në lidhje me to.
- (b) Gjykata do të vlerësojë të gjitha materialet e parashtruara para saj ose, nëse është e nevojshme, materialet e marra *proprio motu*. Ajo do ta bëjë këtë sidomos kur një kërkuess ose një palë e tretë ofron arsye thelbësore që hedhin dyshime mbi saktësinë e informacionit të mbështetur nga shteti.⁵⁵ Vlerësimi i shtetit duhet të jetë i përshtatshëm dhe i mbështetur në mënyrë të mjaftueshme nga materialet e brendshme, siç janë raportet kombëtare, si dhe materiale nga burime të tjera të besueshme dhe objektive siç janë shtetet e tjera kontraktuese ose jo-kontraktuese, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, dhe organizatat jofitimprurëse.
- (c) Nëse një kërkuess nuk është dëbuar ende kur Gjykata Evropiane ka marrë rastin në shqyrtim, koha respektive e vlerësimit do të jetë koha e procesit para Gjykatës Evropiane. Një vlerësim i plotë dhe *ex nunc* mund të kërkohej në rast se situata në vendin e destinacionit mund të ndryshojë gjatë kësaj kohe. Ndërsa momenti historik është me interes (pasi ajo mund të ndikojë në situatën aktuale dhe

53 Termi *refoulement* është një term që përdoret në të drejtën e azilit. Në rastin konkret ka të bëjë më refuzimin e vazhdueshëm të kërkesave për azil. (Shënim i përkthyeses).

54 *El-Masri k. Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (i përfshirë në këtë publikim); *Al-Husin k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendimi i 7 shkurtit 2012, nr. 3727/08 (i përfshirë në këtë publikim); *Al-Hanchi k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendimi i 15 nëntorit 2011, nr. 48205/09 (i përfshirë në këtë publikim); *Abdolkhani dhe Karimnia k. Turqisë*, vendimi i 22 shtatorit 2009, nr. 30471/08.

55 Sipas nenit 36 të Konventës, Gjykata mund të ftojë çdo person të interesuar, që nuk është kërkuess për të paraqitur komente me shkrim ose për të marrë pjesë në seanca dëgjimore.

zhvillimin e saj të mundshëm), janë kushtet aktuale ato që janë vendimtare. Prandaj është e nevojshme të merret parasysh informacioni, që ka dalë pas vendimit përfundimtar nga autoritetet vendase.

- (d) Nëse tashmë ka ndodhur një dëbim, ekzistenca e rrezikut duhet të vlerësohet kryesisht *ex tunc* duke u bazuar në ato fakte, që ishin të njohura, që konsiderohen të jenë të njohura, ose duhet të kenë qenë të njohura nga shteti në kohën e dëbimit. Gjykata gjithashtu do të ketë parasysh informacionin që vjen pas ekstradimit ose deportimit.

Gjykata arsyeton se notat diplomatike janë një mjet standard për shtetet që i dëbojnë/ përjashtojnë individët (shembuj të zakonshëm janë kur një individ është dënuar për akte terroriste) ose ekstradojnë individët, duke marrë garanci se në shtetin pritës nuk do t'i nënshtrohen trajtimit të ndaluar kundër këtij individi. Në çdo rast, Gjykata do të vlerësojë sigurinë e ofruar, ose duhej të ofrohej, për të përcaktuar nëse do të ketë shkelje apo jo, kur individi tashmë është dëbuar ose ekstraduar. Gjykata do të shqyrtojë nëse shteti pritës ka një histori të konsoliduar të respektimit të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, si dhe nëse ekziston një historik i respektimit të garancive të dhëna⁵⁶.

Situatat që përfshijnë **largimin e një personi të sëmurë rëndë** mund të ngrejne çështje, që mbrohen nga neni 3. Shtetet nuk janë të detyruara të lehtësojnë pabarazitë lidhur me ofrimin e kujdesit shëndetësor me shtetet pritëse. Fokusi qëndron nëse Shteti po kryen një veprim, i cili do të rezultojë në ekspozimin e një individi ndaj rrezikut të trajtimit, që ndalohet në bazë të nenit 3.

Kjo do të thotë se mund të ketë shkelje kur tregohen shkaqe thelbësore për të besuar se një person ndodhet para rrezikut të vdekjes në rast dëbimi, ose nëse nuk ndodhet para rrezikut për jetën, do të ekspozohet përballë një rreziku real të shpejtë dhe të pakthyeshëm për gjendjen e tij të mëparshme shëndetësore, duke i shkaktuar vuajtje të madhe a shkurtuar ndjeshëm jetëgjatësinë, për shkak të mungesës së trajtimit të përshtatshëm në vendin pritës, ose mungesës së qasjes ndaj një trajtimi të tillë.⁵⁷

⁵⁶ *Rrapo k. Shqipërisë*, vendimi i 25 shtatorit 2012, nr. 58555/10; *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 17 janarit 2012, nr. 8139/09; *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93.

⁵⁷ *Paposhvili k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, nr. 41738/10 (të përfshira në këtë publikim).

Parimet e mëposhtme kanë rëndësi në rastet e largimit të një personi të sëmure rëndë:⁵⁸

- (a) Përgjegjësia kryesore për zbatimin e Konventës i përket autoriteteve kombëtare, të cilëve u kërkohet të shqyrtojnë frikën e kërkuesit dhe të vlerësojnë rreziqet me të cilat ai mund të ballafaqohet. Gjykata zbaon parimin e subsidiaritetit dhe është e varur nga sistemet kombëtare. Detyrimi i autoriteteve plotësohet kryesisht përmes procedurave të përshtatshme, që lejojnë këto lloj shqyrtime.
- (b) Kërkuesit duhet të paraqesin prova bindëse që vërtetojnë se ekzistojnë shkaqe thelbësore për të besuar se ata do të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku real të trajtimit të ndaluar sipas nenit 3.
- (c) Shteti i duhet të largojë çdo dyshim të ngritur nga këto prova. Rreziku i pretenduar duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të kujdesshëm.
- (d) Shteti duhet të marrë në konsideratë pasojat e mundshme për largimin duke u bazuar në situatën e përgjithshme në shtetin pritës dhe rrethanat personale të individit.
- (e) Shteti duhet të marrë parasysh burimet e përgjithshme siç janë raportet e OBSH-së, ose organizatave jofitimprurëse.
- (f) Shteti duhet të marrë parasysh raportet mjekësore të kërkuesit.
- (g) Kur ekzistojnë dyshime serioze lidhur me ndikimin e largimit, shteti kthyes duhet të sigurojë garanci individuale, të mjaftueshme dhe të besueshme nga shteti pritës si parakusht për largimin në mënyrë, që trajtimi i përshtatshëm do të jetë i arritshëm (i prekshëm), kështu që individi nuk e gjen veten në një situatë në kundërshtim me nenin 3.
- (h) Fakti që shteti pritës është një shtet tjetër palë i Konventës dhe se kërkuesi mund të fillojë aplikimin prej atje, nuk është vendimtar. Shtetet kthyes nuk përjashtohen nga detyrimi i tyre për të parandaluar situata të tilla.

⁵⁸ *Paposhuili k. Belgium*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, nr. 41738/10 (i përfshirë në këtë publikim); *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 17 janarit 2012, nr. 8139/09.

(d) Detyrimet pozitive për të parandaluar keqtrajtimin e kryer nga individë

Në mënyrë që të kemi të bëjmë me një detyrim pozitiv në rastet kur veprimi është kryer nga një individ dhe jo nga një autoritet shtetëror, duhet të të jemi përpara rastit kur shteti **e dinte ose duhet ta kishte ditur se gjatë asaj kohe kishte një risk real dhe të menjëhershëm keqtrajtimi të një individi, ose grupi individësh nga veprime kriminale të një pale të tretë dhe se Shteti** dështoi në marrjen e mavase brenda kompetencave të tij, të cilat do ta kishin **shmangur rrezikun** sipas një vlerësimi të arsyeshëm.⁵⁹ Testi që duhet të kryhet nuk është një test i llojit “por-për”⁶⁰.

Qëllimi i detyrimeve pozitive të shtetit mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse keqtrajtimi është shkaktuar nga përfshirja e agjentëve shtetërorë, apo nga individë.⁶¹

Shteti nuk mund të garantoj përmes sistemit ligjor, që trajtimi i ndaluar të evitohet tërësisht dhe as mund të parashikoj saktësisht veprën penale, që është konsumuar. Do të konsiderohet shkelje kur sistemi ligjor vendas, veçanërisht ligji penal, nuk siguron **mbrojtje praktike dhe efektive** të të drejtave të parashkuara nga neni 3.⁶²

Kur Gjykata konstaton se niveli i ashpërsisë së dhunës së shkaktuar nga individët mund të mbrohet përmes nenit 3, ky nen kërkon zbatimin e mekanizmave adekuat të ligjit penal. Kjo duhet të mbështetet nga ligjet dhe mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e shkeljeve të këtyre dispozitave.

Gjykata herë pas here, ka pranuar edhe vulnerabilitetin e disa grupeve të caktuara të shoqërisë dhe nevojën për një përfshirje më aktive të Shtetit në mbrojtjen e tyre. Në shembujt e mëposhtëm:

(a) **Fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.** Gjykata ka përmendur se Konventa e OKB-së për të Drejtatat e Fëmijëve thekson se në mënyrë që fëmijët të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, Shtetet duhet

59 *Bälşan k. Rumansië*, vendim i 23 majit 2017, nr. 49645/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Dorđević k. Kroacisë*, vendim i 24 korrikut 2012, nr. 41526/10 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) *M. dhe M. k. Kroacisë*, vendim i 3 shtatorit 2015, nr. 10161/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *E. dhe të Tjerët k. Mbrtërisë së Bashkuar*, vendim i 26 nëntorit 2002, nr. 33218/96; *Mastromatteo k. Italisë*, Dhoma e Madhe vendim i 24 tetorit 2002, nr. 37703/97.

60 *O’Keefe k. Irlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 janarit 2014, nr. 35810/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

61 *Beganović k. Kroacisë*, vendim i 25 qershorit 2009, nr. 46423/06 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

62 *Beganović k. Kroacisë*, vendim i 25 qershorit 2009, nr. 46423/06 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

të parashikojnë një sërë masash mbrojtëse parandaluese, korrigjuese dhe dëmshpërbljuese⁶³. Këshilli i Evropës ka hartuar disa rekomandime për parashikimin dhe implementimin e strategjive kombëtare të integruara për mbrojtjen e fëmijëve.⁶⁴

- (b) **Minoritetet Fetare.**⁶⁵ Analizimi i dhunës dhe trajtimit çnjerëzor përmes jurisprudencës e cila nuk ka karakteristika të ngjashme do të thotë të mohosh natyrën specifike të akteve, që konsistojnë në shkelje të të drejtave themelore. Anëtarët e minoriteteve fetare mund të përballen me diskriminime ose me pretendime të pabazuara nga ana e policëve, që kryejnë hetimet.
- (c) **Viktimat e dhunës në familje.** Shtetet kanë detyrimin pozitiv të hartojnë dhe të zbatojnë efektivisht një sistem ligjor për të ndëshkuar të gjitha format e dhunës në familje dhe për të mbrojtur viktimat e saj⁶⁶. Gjykata do të shqyrtojë nëse autoritetet kanë marrë mjaftueshëm në konsideratë parimet që rrjedhin nga vendimet e saj për çështje të ngjashme, madje edhe kur ato kanë të bëjnë me shtetet e tjera. Në interpretimin e dispozitave të Konventës dhe fushëveprimin e detyrimeve të shtetit në raste specifike, Gjykata do të kërkojë çdo konsensus dhe vlera të përbashkëta, që dalin nga praktikata e Shteteve Evropiane dhe instrumenteve të specializuara ndërkombëtare si Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave, si dhe duke i kushtuar vëmendje evolucionit të normave dhe parimeve në të drejtën ndërkombëtare përmes zhvillimeve të tjera siç është Konventa e Belem do Para, e cila në mënyrë specifike përcakton detyrat e Shteteve në çrënjjosjen e dhunës me bazë gjinore⁶⁷.
- (d) **Azilkërkuesit dhe personat që mbahen në burgjet e imigracionit.** Shtetet nuk kanë arritur ende të marrin masa adekuate për nevojat thelbësore të azilkërkuesve, të cilët mund të jenë pa mbështetje familjare a miqësore dhe

63 *C.A.S. dhe C.S. k. Rumanië*, vendim i 20 marsit 2012, nr. 26692/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

64 *M. dhe M. k. Kroacië*, vendim i 3 shtatorit 2015, no. 10161/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *A dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shtatorit 1998, nr. 3455/05; *Bevacqua dhe S. k. Bullgarisë*, vendim i 12 qershorit 2008, nr. 71127/01.

65 *Milanovic k. Serbisë*, vendim i 14 dhjetorit 2010, nr. 44614/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

66 *M. dhe M. k. Kroacië*, vendim i 3 shtatorit 2015, nr. 10161/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *A dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shtatorit 1998, nr. 3455/05; *Bevacqua dhe S. k. Bullgarisë*, vendim i 12 qershorit 2008, nr. 71127/01; *Balışan k. Rumanisë*, vendim i 23 majit 2017, nr. 49645/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

67 *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

mund të mos kenë mundësi për të filluar punë. Zgjidhjet përkohshme për situatat e azil kërkuesve kanë rezultuar të paefektshme.⁶⁸

(4) Detyrimet Procedurale

Neni 3 parashikon një **detyrim procedural ndaj Shteteve për të hetuar në mënyrë efektive dyshimet për keqtrajtim**. Ky detyrim është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Pa të, detyrimi thelbësor për të ndaluar torturën ose trajtimin çnjerëzor ose degrados do të ishte joefektiv. Sjellja e ndaluar do të mbetej e fshehur dhe Shtetet mund të veprojnë pa u ndëshkuar⁶⁹.

Detyrimi për të hetuar nuk është një detyrim i rezultatit, por i mjeteve. Jo çdo hetim duhet domosdoshmërisht të konkludojë se pretendimet e kërkuesit për ngjarjet janë të bazuara dhe të sakta. Sidoqoftë, **hetimet duhet të çojnë në vërtetimin e fakteve** dhe nëse pretendimet vërtetojnë se janë të vërteta, në identifikimin dhe **dënimin e tyre që janë përgjegjës**.⁷⁰

Akuzat për keqtrajtim mund të lindin edhe kur ka pasur neglizhencë mjekësore. Në këto raste, detyrimi për të ngritur një sistem efektiv gjyqësor mund të quhet i plotë nëse sistemi ligjor i siguron viktimave një mjet juridik, që parashikon përgjegjësinë juridike të mjekëve për veprimet ose mosveprimet e tyre dhe dëmshpërblimin të drejtë.⁷¹

Detyrimi për të hetuar rastet e keqtrajtimit zbatohet si ndaj individëve edhe ndaj Shtetit.⁷²

68 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 janarit 2011, nr. 30696/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08; *Kaja k. Greqisë*, vendim i 27 korrikut 2006, nr. 32927/03; *Shchebet k. Rusisë*, vendim i 12 qershorit 2008, nr. 16074/07.

69 *El-Masri k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

70 *Crimailous k. Letonisë*, vendim i of 25 qershorit 2013, nr. 6087/03 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

71 *V.C. k. Sllovakisë*, vendimi i 8 nëntorit 2011, nr. 18968/07, (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), në kontekstin e nenit 2, por mund të aplikohet edhe në bazë të nenit 3.

72 *C.A.S. dhe C.S. k. Rumanisë*, vendim i 20 marsit 2012, nr. 26692/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Hetimet duhet:⁷³

- (a) të ndërmarrin përpjekje serioze për të zbuluar se çfarë i ka ndodhur individit;
- (b) të jenë të plota dhe efektive;
- (c) të mundësojnë identifikimin e autorëve;
- (d) të mundësojnë dënimin e autorëve;
- (e) të hapura për shqyrtim publik;
- (f) të kryhen menjëherë (në mënyrë që të shmangët humbja e provave) dhe pa vonesa të pa justifikuar. ⁷⁴

Hetuesit duhet të:⁷⁵

- (a) marrin në pyetje dhe dëshmi nga të gjithë individët e përfshirë, nga policët, forcat e sigurisë dhe nga zyrtët e qeverisë;
- (b) shqyrtojnë dokumentat me rëndësi për çështjen;
- (c) vlerësimi i dokumentave të tjera që ndihmojnë në zbulimin e të vërtetës dhe rrethanat e çështjes;
- (d) konstatimin e mungësive të informacioneve në dokumente;
- (e) konstatimin e fakteve kontradiktore;
- (f) kërkimi i të dhënave dhe mendimeve të ekspertëve, përfshirë evidencën mjekësore dhe forensike, që mund të nevojiten si dhe përfshirja e ekzaminimeve të hollësishme mjekësore, raporte, fotografi dhe autopsi;
- (g) zhvillimi i hetimeve pa vonesa të paarsyeshme;

të ruajnë pavarësinë dhe paanësinë në të gjitha aspektet, si dhe në raport me autoritetet shtetërore përfshirë policinë, nuk duhet të ketë prezumin ligjor se autoritetet

73 *El-Masri v. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

74 *El-Masri v. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). *M. dhe M. k. Krocisë*, vendim i 3 shtatorit 2015, nr. 10161/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

75 *El-Masri k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *M. dhe M. kundër Krocisë*, vendim i 3 shtatorit 2015, nr. 10161/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

shtetërore kanë vepruar joligjërish. Kur një agjent shteti është akuzuar për krime që përfshijnë keqtrajtim, është e rëndësishme që ai/ajo të pezullohet nga detyra gjatë hetimit dhe gjyqimit, si edhe të shkarkohet nëse dënohet⁷⁶

Viktimat e prezumuara duhet të jetë e aftë të :⁷⁷

- (a) marrin pjesë në mënyrë efektive në hetim;
- (b) kenë akses në informata lidhur me hetimin;
- (c) në rrethana të caktuara, detyrimi procedural i Shtetit mund të shtrihet në ofrimin e qasjes efektive në përfaqësimin ligjor falas;
- (d) kundërshtojnë vendimet e prokurorëve për cilësimin e trajtimit të tyre.

Autoritetet duhet të marrin parasysh situatën vulenrabël të personave dhe faktin se njerëzit, të cilët i janë nënshtruar keqtrajtimit të rëndë shpesh do të jenë më pak të gatshëm ose në gjendje të bëjnë një ankesë.⁷⁸

Kur ka dyshime se një sulm është i motivuar nga racizmi, autoritetet duhet të hetojnë pretendimin e racizmit si dhe rrethanat e sulmit. Gjatë hetimit të incidenteve të dhunshme që dyshohet se janë shkaktuar nga racizmi, Shtetet **duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e arsyeshme për të përcaktuar nëse ka pasur motive raciste** dhe për të vendosur nëse ndjenjat e urrejtjes ose paragjyqimeve të bazuara në origjinën etnike të një personi kanë luajtur rol në ngjarjet.⁷⁹ Në praktik:

- (a) detyrimi për të hetuar sjellje raciste të mundshme është një detyrim i cili rrjedh nga mjetet e përdorura - duke marrë të gjitha masat e arsyeshme, duke pasur parasysh rrethanat - jo një detyrim për të arritur një rezultat specifik.

76 *El-Masri v. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Savitskyk k. Ukrainës*, vendim i 26 korrikut 2012, nr. 38773/05 (pavarësia dhe paanshmëria e pamjaftueshme, policët e akuzuar morën deklaratat përkatëse të dëshmitarëve dhe departamenti i tyre zhvilloi hetimin); *Cestaro k. Italisë*, vendim i 7 prillit 2015, nr. 6884/11 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

77 *El-Masri v. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Jasar k. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007, nr. 69908/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Bălșan k. Rumanisë*, vendim i 23 majit 2017, nr. 49645/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Savitskyk k. Ukrainës*, vendim i 26 korrikut 2012, nr. 38773/05; *Macovei k. Rumanisë*, 21 korrik 2007.

78 *Krsmanović k. Serbis*, vendim i 19 dhjetorit 2017, nr. 19796/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

79 *Škorjanec v. Kroacis*, vendim i 28 marsit 2017, nr. 25536/14 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- (b) jo vetëm veprimet e bazuara në karakteristikat e viktimës mund të klasifikohen si krime të urrejtjes. Autorët mund të kenë motive të përziera të ndikuara nga një qëndrim i njëanshëm ndaj grupit të cilit i përket një viktimë ose për të cilën ai ose ajo mendohet se i përkasin.
- (c) i takon autoriteteve të kërkojnë një lidhje të mundshme mes qëndrimeve raciste dhe një akti dhune.
- (d) akti mund të bazohet në karakteristikat personale ose të perceptuara të viktimës ose në bazë të lidhjeve të tija shoqërore ose të supozuara me persona që kanë ose supozohet të kenë këto karakteristika.

Shtetet duhet të sigurojnë që sistemet ligjore vendase të përmbajnë struktura adekuate për të mundësuar një hetim të tillë. Praktikë administrative, pavarësisht nëse e pasqyrojnë apo jo legjislacionin e zbatueshëm, do të jenë relevante. Shtetet duhet të bëjnë pyetjet e mëposhtme:

- (a) A po bashkëpunojnë autoritetet shtetërore siç kërkohet?
- (b) A i kuptojnë ato mbrojtjet substanciale të parashikuara në nenin 3?
- (c) A është janë procedurat transparente?
- (d) A publikohen emrat e autorëve?
- (e) A ka trajnime adekuate në të gjitha fazat e hetimit, arrestimit, dënimit dhe dënimit - nga detektivët dhe punonjësit e policisë për gjyqtarët e apelit?

Dhënia e dënimeve të drejta sipas ligjit penal është shumë e rëndësishme. Dënimet e ulta për autorët mund të tregojnë mungesë efektiviteti të një hetimi dhe gjykimi, për shkak të mungesës efektit parandalues⁸⁰. Periodat e kufizuara mund të shkaktojnë shkelje procedurale.⁸¹

Neni 13 i Konventës siguron të drejtën për një **zgjidhje efektive**. Në kuadër të nenit 3, fokusi është në përmbushjen e detyrimit procedural. Pas konstatimit të shkeljes, do të jetë i nevojshme pagimi i shpërblimit të viktimës. Në qoftë se shpërblimi do të ishte i mjaftueshëm, shtetet mund thjesht të "paguajnë" torturën. Në këtë rast, neni 3 do të ishte i paefektshëm.

80 *Zontul k. Greqisë*, vendimi 17 janarit 2012, nr. 12294/07 (Një dënim 6-mujor për një roje kufitare që torturoi një azilkërkues u konsiderua joproporcional).

81 *Id.*

Kur një person i akuzuar për veprimtari kriminale është marrë në pyetje duke përdorur një metodë të ndaluar sipas nenit 3 dhe kur rezultatet e marrjes në pyetje kanë çuar në disavantazhe për të, Gjykata ka shqyrtuar nëse llojet të tjera të dëmshpërblimit janë të përshtatshme. Gjykata nuk ka përjashtuar që shteti duhet të adresojë ndikimin e vazhdueshëm të sjelljes së ndaluar dhe të adresojë pavarshmërinë e provave të fituara nga kjo sjellje.⁸²

(5) Përfundime

Ndalimi i torturës është një nga vlerat më themelore të shoqërive demokratike. Është e domosdoshme që Shtetet të përmbushin detyrat e tyre të përfshira në Konventë për të trajnuar prokurorë, oficerë policie, forca të sigurisë, avokatë, të gjithë nivelet e gjyqtarëve, stafin e burgjeve, institucionet e mirëqenies sociale, profesionistët e shëndetësisë, zyrtarët e emigracionit dhe rojet kufitare.

Detyrimet thelbësore, që ndalojnë dhe parandalojnë keqtrajtimin duhet të përmbushen nga çdo shtet i cili pretendon të respektojë dhe të mbrojë shtetin e së drejtës. Detyrimi procedural është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Pa hetime të përshtatshme, dëshmitë e shkeljeve do të mbeten të evidentuara dhe të pagjykuara. Pa identifikimin dhe dënimin e autorëve, abuzimet do të vazhdojnë.

Një përzgjedhje e përmbledhjeve të rasteve nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të vijojë për të ilustruar dhe përpunuar më tej çështjet e diskutuara në këtë hyrje.

82 *Cășgen k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim);

NENI 3 Përmbledhje vendimesh

Nuk ekziston rreziku i trajtimit çnjerëzor në shkelje të nenit 3 nëse një i huaj muxhahedin deportohet në Tunizi

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AL HANCHI k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

(Kërkesa nr. 48205/09)

15 nëntor 2011

1. Faktet kryesore

Kërkesuesi, Ammar Al Hanchi, ishte një shtetas tunizian i lindur në vitin 1965. Ai mbërriti në Bosnje dhe Hercegovinë gjatë luftës së 1992-95 dhe u bashkua me muxhahedinët: të cilët janë një lëvizje muslimane që pretendon të luftojë xhihadin, ose të kryejë një luftë të shenjtë. Përmes dokumentave të falsifikuara z. Al Hanchi arriti të merrte një letërnjoftim në vitin 1995. Në vitin 1997, ai u martua me shtetase nga Bosnja dhe Hercegovina. Çifti ka dy fëmijë, respektivisht të lindur në vitin 1998 dhe 2000.

Në prill 2009, autoritetet zbuluan se z. Al Hanchi ishte një emigrant ilegal. Në maj 2009, bazuar në raportet e shërbimeve të inteligjencës u vendos se z. Al Hanchi përbente një kërcënim për sigurinë kombëtare. Për rrjedhojë, deportimi i tij u urdhërua dhe atij iu ndalua të ri-hynte në Bosnje dhe Hercegovinë për një periudhë pesë vjeçare.

Në korrik të vitit 2009, z. Al Hanchi aplikoi për azil duke pretenduar se nëse do të kthehej në Tunizi ai do të përballej me një trajtim që vinte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Kërkesa e tij u refuzua dhe në dhjetor 2009 atij iu dha një urdhër dëbimi.

2. Vendimi i Gjykatës

Për shkak të përfshirjes së tij me muxhahedinët, z. Al Hanchi u ankua se rikthimi i tij në Tunizi do ta ekspozonte atë ndaj një trajtimi, që binte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Gjithashtu, z. Al Hanchi u ankua se ndaj tij kishte pasur cenim të të drejtave të parashikuara në nenet 5 dhe 8 të Konventës, për shkak se ai kish qëndruar në paraburgimi gjatë kohës që pritej urdhëri i dëbimit, si edhe për shkak të faktit se ky urdhër do të shpërbente familjen e tij.

Neni 3

Kur shqyrtoi pretendimet e kërkuarit në bazë të nenit 3, Gjykata iu referua gjetjeve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Raporteve të OKB-së: nga këto gjetje u identifikua se Tunizia kishte ndërmarrë hapa drejt një sistemi qeverisje demokratike. Gjykata në veçanti iu referua pjesëve të raporteve që deklarorin se: (a) të gjithë të burgosurit politikë kishin përfituar nga amnistia; (b) Shërbimi i Sigurimit të Shtetit ishte shërbërë; dhe (c) se ka pasur shkarkime dhe/ose ndjekje penale për disa zyrtarë të lartë për shkak të abuzimeve të shkuara me të drejtat e njeriut. Duke mbajtur në vëmendje këto gjetje, Gjykata vërejt se në Tunizi ishin evidentuar raste të trajtimeve në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, por ato ishin incidente sporadike. Veçanërisht pas ndryshimit të regjimit nuk kishte asnjë indicie që tregonte se islamikët synoheshin sistematikisht si një grup.

Gjithashtu, Gjykata vërejt se Tunizia kishte aderuar në Protokollin Opsional të Konventës së OKB kundër Torturës dhe Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike. Kështu, Tunizia ka pranuar ligjërisht kompetencën e Komitetit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së për të dëgjuar raste individuale, që pretendohej se kishin qenë subjekt keqtrajtimi. Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se kishte një vendosmëri të autoriteteve tuniziane për të zhdukur kulturën e dhunës dhe mosndëshkimit që kishte mbizotëruar gjatë regjimit të mëparshëm. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ekzistonte rreziku, që z. Al Hanchi do të trajtohej në kundërshtim me garancitë e nenit 3 nëse deportohej në Tunizi.

Nenet 5, 6, dhe 8

Gjykata rrëzoi ankimet e tjera të z. Al Hanchi.

Gjykata vërejt se z. Al Hanchi ishte ndaluar me qëllim të deportimit në përputhje të plotë me ligjin vendas, në kushte të përshtatshme dhe jo në bazë të një vendimi arbitrar. Për rrjedhojë nuk kishte shkelje të nenit 5 të Konventës.

Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për shkelje procedurale gjatë procesit të dëbimit, Gjykata kujtoi se vendimet në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e nenit 6, pasi nuk përfshijnë përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile.

Së fundmi, në lidhje me ankimin e z. Al Hanchi për cenim të së drejtës së garantuar nga neni 8, Gjykata vërejt se një ankim në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës përbënte në parim një mjet efektiv juridik sipas Konventës. Duke pasur

parasysh se ankimi i z. Al Hanchi ishte ende në pritje përpara kësaj gjykate dhe se Konventa nuk kërkon, që ankimet në kuadër të nenit 8 në lidhje me procese dëbimi të kenë akses në një mjet me efekt pezullues të menjëhershëm (në ndryshim me ankimet në kuadër të nenit 3) pretendimi i z. Al Hanchi ishte i parakohshëm.

Deportimi i një muxhahedini drejt Sirisë përbënte shkelje të nenit 3, sepse atje ekziston rreziku i keqtrajtimit – një ndalim arbitrar përpara procesit të deportimit përbënte shkelje të nenit 5

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AL HUSIN K. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

(Kërkesa nr. 3727/08)

7 shkurt 2012

1. Faktet kryesore

Al Husin, lindi në Siri. Ai u transferua në ish-Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë për të studiuar në vitin 1983. Në vitin 1993, kërkuesi u takua në Kroaci me një refugjate nga Bosnja dhe Hercegovina, me të cilën u martua dhe kishte tre fëmijë së bashku, të gjithë me shtetësi boshnjake që jetojnë në Bosnje dhe Hercegovinë në kohën e këtij gjykimi. Gjatë luftës së viteve 1992-1995 në Bosnje dhe Hercegovinë, z. Al Husin u bashkua me një njësi të muxhahedinëve, që synonte të mbështeste muslimanët boshnjakë në luftën e tyre ushtarake. Megjithatë, nuk është e qartë sesa kohë z. Al Husin ishte anëtar i El Mujahedin, e cila ishte një njësi e posaçme brenda forcave lokale të Ushtrisë së Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës, e përbërë kryesisht nga luftëtarë të huaj muxhahedinë. Gjithashtu, nuk është e qartë kur z. Al Husin mori shtetësinë boshnjake. Duket se kjo ndodhi ndërmjet viteve 1992 dhe 1994. Në vitin 2001 dhe 2007, autoriteti përkatës i administratës anuloi vendimin e natyralizimit të kërkuesit, duke deklaruar se ai kishte fituar shtetësinë boshnjake përmes sjelljes mashtruese, informacionit të rremë dhe fshehjes së fakteve relevante. Si rezultat, kërkuesi u bë resident i jashtëligjshëm në Bosnje dhe Hercegovinë. Z. Al Husin bëri disa kërkesa për një leje qëndrimi, të cilat të gjitha u refuzuan nga Zyra për të Huajt bazuar në raporte konfidenciale të inteligjencës, duke deklaruar se kërkuesi ishte një kërcënim për sigurinë kombëtare. Pas çdo refuzimi, atij i'u la një afat prej 15 ditësh për largim vullnetar.

Më 1 qershor 2007, z. Al Husin kërkoi azil. Ai deklaroi se ai do të konsiderohej nga autoritetet siriane si një anëtar i Vëllazërisë Muslimane të jashtëligjshme ose si një islamik. Ai pretendoi se autoritetet siriane ishin të vetëdijshme për aktivitetet e tij në Bosnje dhe Hercegovinë dhe për këtë shkak kishin marrë në pyetje babanë dhe vëllezërit e tij. Një prej vëllezërve ishte mbajtur në paraburgim për nëntë muaj, sepse ai nuk pranoi të spiunonte kërkuesin. Z. Al Husin argumentoi se duke pasur parasysh situatën politike dhe të të drejtave të njeriut në Siri, deportimi i tij do ta ekspozonte përballë rrezikut, që t'i nënshtrohej keqtrajtimit. Në këto kushte kërkuesi pretendoi se legjitimohej për të kërkuar azil, si edhe në kuadër të respektimit të jetës së tij private dhe familjare.

Më 8 gusht 2007, Zyra për të Huajt refuzoi kërkesën e azilit dhe i dha kërkuetit një periudhë 15 ditore për largim vullnetar, duke deklaruar se ai gjendej përballë një rreziku real për t'iu nënshtruar keqtrajtimeve. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata Shtetërore. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e ktheu vendimin për rishqyrtim në lidhje me kërkesën e z. Al Husin për respektimin e jetës së tij familjare. Kjo Gjykatë urdhëroi që kërkueti të mos deportohej derisa çështja të përfundonte. Kërkesa u rrëzua nga Gjykata e Shtetit dhe i'u dorëzua Zyres së të Huajve për rishqyrtim. Në vitin 2009, Zyra për të Huajt mori në shqyrtim kërkesën e tij për leje qëndrimi dhe i dha kërkuetit një afat prej 15 ditësh kohë për largim vullnetar. Ky vendim u miratua nga Ministria për Çështjet e Sigurisë dhe Gjykata e Shtetit. Kërkueti parashtroi ankesë kushtetuese kundër këtij vendimi, i cili ishte ende në pritje në kohën kur Gjykata e Strasburgut po gjykonte çështjen.

Më 6 tetor 2008, Zyra për të Huajt e vendosi z. Al Husin në një qendër emigrimi për arsye sigurie, masë e cila u la në fuqi nga Gjykata e Shtetit dhe ajo Kushtetuese. Më 1 shkurt 2011, Zyra e të Huajve lëshoi një urdhër deportimi, i cili ndalonte z. Al Husin të ri-hynte në vend për pesë vjet. Në vitin 2011, Ministria për Çështjet e Sigurisë dhe Gjykata Shtetërore e miratuan vendimin. Në vitin 2011 Gjykata e Strasburgut në zbatim të Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës mori një vendim të ndërmjetëm, përmes së cilit i kërkoi qeverisë së shtetit të paditur të mos deportonte kërkuetin. Në kohën në të cilën çështja shqyrtohej në Strasburg kërkueti ndodhej ende i ndaluar për qëllim deportimi.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueti u ankua se dëbimi i tij drejt Sirisë do ta ekspozonte atë ballë një rreziku të trajtimit në kundërshtim me nenin 3. Gjithashtu, ai kontestoi ligjshmërinë e paraburgimit të tij sipas nenit 5.

Neni 3

Qeveria argumentoi se kërkesa e z. Al Husin për azil ishte shqyrtuar me kujdes dhe ishte rrëzuar në bazë të faktit se kërkueti nuk arriti të provonte se rreziku ndaj tij ishte i vërtetë. Megjithatë, Gjykata i'u referua parashtrimin të bërë nga Human Rights Watch, i cili kishte ndërhyrë si palë e tretë në proces. Sipas këtij parashtrimi në Siri, individët e akuzuar se kanë qenë islamikë kishin qenë subjekt i gjyqimeve të padrejta dhe torturave. Gjykata ritheksoi se siç përcaktohet në të drejtën ndërkombëtare, si dhe në detyrimet e traktatit, shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve nga territori i tyre. Megjithatë, dëbimi nga shteti mund të ngrejë një çështje sipas nenit 3, kur janë provuar se ekzistojnë shkaqe thelbësore për

të besuar se nëse dëbohet, personi në fjalë do të përballet me një rrezik real për t'iu nënshtruar keqtrajtimit. Në këto raste, neni 3 nënkupton një detyrim për të mos e dëbuar personin. Për më tepër, ndalimi ndaj tortures, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues është një e drejtë absolute, sjellja e kërkuesit, sado e padëshirueshme apo e rrezikshme, nuk mund të merret parasysh.

Barra e provës i takon kërkuesit, për të vërtetuar se ka arsye të konsiderueshme për të besuar se ai do të ishte i ekspozuar ndaj një rreziku real për t'iu nënshtruar një trajtimi në kundërshtim me nenin 3. Kur këto prova sigurohen është detyrë e qeverisë të largojë çdo dyshim rreth situatës. Vlerësimi i ekzistencës së një rreziku real duhet gjithashtu të jetë rigoroz. Gjykata duhet të jetë e bindur se vlerësimi i bërë nga autoritetet ishte i përshtatshëm dhe i mbështetur mjaftueshëm në burime informacioni të brendshme, si dhe nga burime të tjera objektive.

Në rastin në fjalë, Gjykata vërejti se autoritetet e brendshme nuk kishin marrë në konsideratë mjaftueshëm natyrën e lëvizjes muxhahedine, të cilës i përkiste kërkuesi. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte dhënë një numër të konsiderueshëm intervistash për disa media arabe, pas luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, duke zbuluar përfshirjen e tij në lëvizjen muxhahedine. Kërkuesi u identifikua gabimisht si terrorist i dënuar në Raportin e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve për Terrorizmin në Bosje dhe Hercegovinë dhe u arrestua për qëllime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare. Të gjithë këta faktorë do ta bënin atë një person me interes për autoritetet siriane. Kërkuesi madje paraqiti dokumente të lëshuara nga shërbimi i sigurimit sirian nga viti 2002, duke bërë thirrje për arrestimin e tij pas hyrjes në vend.

Bazuar në situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Siri dhe situatën politike të krijuar atje prej mars 2011, Gjykata konkludoi se ekzistonte një rrezik real për kërkuesin për t'iu nënshtruar keqtrajtimit nëse deportohej në Siri. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se dëbimi i tij do të shkelte nenin 3 të Konventës.

Neni 5

Gjykata vërejti se neni 5 garanton një të drejtë themelore duke mbrojtur të gjithë individët kundër ndërhyrjes arbitrare të shtetit me të drejtën e tyre për liri. Nën-paragrafët e neni 5 (1) janë një listë shteruese e bazave të lejueshme në të cilat një person mund të privohet nga liria dhe duhet të interpretohen ngushtësisht. Neni 5 (1) (f) lejon shtetin të kontrollojë lirinë e të huajve në kontekstin e emigracionit, por kërkon që procedurat e deportimit të jenë në progres dhe të ndiqen me kujdesin e duhur. Përveç respektimit të ligjit kombëtar, heqja e lirisë duhet të jetë në përputhje me mbrojtjen e individëve nga arbitrariteti.

Gjykata vuri në dukje se procedura e deportimit kundër kërkuesit nisi më 1 shkurt 2011. Megjithatë, ai u arrestua më 6 tetor 2008. Kjo do të thoshte se periudha e parë e paraburgimit të kërkuesit nuk ishte e justifikuar sipas nenit 5 (1) (f). Gjykata argumentoi se në kohën e arrestimit të z. Al Husin autoritetet vendase mund të kishin lëshuar një urdhër deportimi kundër tij dhe pastaj t'a arrestonin atë për këtë qëllim. Qeveria nuk arriti të japë një shpjegim përse kjo procedurë nuk ishte ndjekur. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 5 (1) lidhur me periudhën e paraburgimit të kërkuesit nga data 6 tetor 2008 deri më 31 janar 2011.

Sa i përket periudhës pasuese, Gjykata vuri në dukje se një urdhër dëbimi u lëshua më 1 shkurt 2011 dhe se ankesa u trajtua brenda një muaji. Megjithëse kërkuesi kishte mbetur në paraburgim deri në kohën e shqyrtimit të çështjes në Strasburg, periudha nga 15 marsi 2011 duhet të shqyrtohet më vete pasi qeveria nuk e ka deportuar kërkuesin, në zbatim të masës së ndërmjetme dhënë nga Gjykata sipas Rregullit 39. Megjithatë, edhe në zbatimin të një mase të ndërmjetme dhënë nga Gjykata, heqja e lirisë së individit duhet të bëhet në përputhje me ligjin kombëtar, si dhe me Konventën.

Gjykata arriti në përfundimin se procedurat e deportimit, megjithëse ishin pezulluar përkohësisht, kishin qenë në progres që nga 1 shkurti i vitit 2011. Nuk kishte asnjë indikacion se autoritetet kishin vepruar në keqbesim dhe se kërkuesi ishte arrestuar në kushte të papërshtatshme ose se paraburgimi ishte arbitrar për ndonjë arsye tjetër. Prandaj, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 5 (1) lidhur me periudhën e paraburgimit pas 1 shkurtit 2011.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit një dëmshpërblim prej 3,000 euro në kuadër të dëmit jomaterial.

Dështimi i autoriteteve rumune për të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme kërkuesen nga dhuna në familje derivon në shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BĂLŞAN K. RUMANISË

(Kërkesa nr. 49645/09)

23 maj 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Angelica Camelia Bălşan, ishte një shtetase rumune e lindur më 1957 dhe jetonte në Petrosan, Rumani. Znj. Bălşan ishte martuar me N.C në vitin 1979 dhe kishte katër fëmijë me të. Kërkuesja pohoi se N.C.-ja ushtronte dhunë ndaj saj dhe fëmijëve të tyre gjatë gjithë periudhës në të cilin ata kishin qenë të martuar. Dhuna ndaj kërkueses u shtua në vitin 2007 në periudhën kur çifti po divorcohej. E njëjta situatë vazhdoi dhe në vitin pasardhës pasi divorci kishte marrë formë të prerë. Kërkuesja u dhunua nga N.C. tetë herë gjatë kësaj periudhe dhe pësoi plagosje të lehta të vërtetuara nga raportet mjekësore, që kërkonin kujdes mjekësor prej dy deri në dhjetë ditë.

Gjatë kësaj periudhe, znj. Bălşan kërkoi ndihmë përmes telefonatave të emergjencës në polici, kërkesave për urdhëra mbrojtjeje drejtuar kreut të policisë dhe padive në prokurori. Në lidhje me paditë e paraqitura u vlerësua si nga organi i akuzës gjatë fazave të hetimit t edhe nga gjykatat vendase se kërkuesja kishte provokuar dhunën në familje dhe se ngjarjet e ndodhura nuk ishin aq serjoze për të qenë objekt i ligjit penal. Për rrjedhojë, në lidhje me tre incidentet që ndodhën në vitin 2007, gjykatat vendase përfundimisht vendosën të lirojnë N.C nga akuzat e plagosjes së lehtë me dashje. Lidhur me pesë incidentet e ndodhura në vitin 2008, organi i akuzës vendosi të mos ngrite akuzë. N.C. iu dha një gjobë administrative prej 200 lei rumune (rreth 50 euro) pas secilës prej këtyre vendimeve. Gjatë fazës së hetimeve dhe proceseve gjyqësore, znj. Bălşan vazhdoi të sillte në vëmendje të autoriteteve abuzimin që N.C. bënte ndaj saj, duke i paralajmëruar se ajo kishte frikë për jetën e saj. Megjithatë asnjë masë konkrete nuk u ndërмор asnjëherë dhe kërkesat e saj për urdhër mbrojtjeje mbetën pa përgjigje.

2. Vendimi i Gjykatës

Znj. Bălşan u ankua se autoritetet rumune kishin dështuar ta mbronin atë nga dhuna e përsëritur në familje dhe nuk kishin shpallur përgjegjës N.C., pavarësisht ankesave të saj të shumta. Gjithashtu, ajo pohoi se toleranca e autoriteteve për akte të tilla

dhune e kishte bërë atë të ndihej e poshtëruar dhe e pafuqishme. Rasti është shqyrtuar në kuadër të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) marrë së bashku me nenin 3 të Konventës.

Neni 3

Gjykata pohoi se dhuna fizike të cilës i ishte nënshtruar znj. Bălșan në mënyrë të përsëritur nga N.C. dhe lëndimet e saj siç janë dokumentuar në raportet mjekësore dhe policore, ishin mjaft serioze për të arritur nivelin e kërkuar të ashpërsisë në kuadër të nenit 3 të Konventës. Për më tepër, autoritetet rumune duhet të kishin qenë të vetëdijshme për abuzimin e kërkueses, duke marrë parasysh thirrjet e saj të përsëritura për ndihmë si në polici ashtu edhe në gjykatë. Prandaj, autoritetet kishin detyrimin të ndërmerrenin të gjitha masat e arsyeshme për të vepruar në lidhje me ankesat të saj dhe për të parandaluar që dhunimi të ndodhte përsëri. Znj. Bălșan kishte vepruar në zbatim të kuadrit ligjor vendas i cili garantonte mundësinë që viktimat e dhunës në familje të ankoheshin dhe të kërkonin mbrojtjen e autoriteteve.

Gjykata vërejti me shqetësim të madh se autoritetet rumune kishin arritur në përfundimin se znj. Bălșan kishte provokuar dhunën në familje kundër saj, si edhe se si këto akte nuk ishin cilësuar si mjaftueshmërisht serioz për t'u përfshirë në fushëveprimin e ligjit penal. Kjo qasje, ku dhuna në familje nuk kontestohet si e tillë, cenon efikasitetin dhe qëllimin e kuadrit ligjor kombëtar. Natyrisht qasja në fjalë vjen në kundërshtim me standardet ndërkombëtare mbi dhunën kundër grave në përgjithësi dhe dhunën në familje në veçanti.

Për më tepër, përkundër faktit se znj. Bălșan kishte vazhduar të ankohej për abuzime të mëtejshme gjatë kohës së proceseve gjyqësore autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për ta mbrojtur atë. I vetmi sanksion i vendosur ishin gjobat administrative, të cilat ishin një masë jo efektive kundër abuzimit të mëtejshëm.

Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se mënyra në të cilën autoritetet kishin trajtuar ankesat e znj. Bălșan nuk i kishte siguruar asaj mbrojtjen e duhur kundër dhunës së N.C.-së, duke shkelur kështu garancitë e nenit 3 të Konventës.

Neni 14 marrë së bashku me nenin 3

Gjykata mori në shqyrtim statistikën zyrtare, që tregonin se si u tolerohej dhuna në familje në Rumani dhe se si perceptohej si normale nga shumica e popullsisë. Për më tepër, qytetarët mund të mos jetë mjaft i vetëdijshëm për kuadrin e gjerë ligjor dhe politik në Rumani për eliminimin e diskriminimit ndaj grave. Vetë gratë mund

të mos jenë të vetëdijshme për të drejtat e tyre. Për më tepër, autoritetet nuk e kuptojnë plotësisht seriozitetin dhe shtrirjen e dhunës në familje në Rumani, siç është faktuar në rastin aktual nga mos zbatimi i dispozitave përkatëse ligjore. Pasiviteti i tyre pasqyron një qëndrim diskriminues ndaj znj. Bălșan si një grua.

Gjykata vlerësoi se dhuna ndaj të cilës ishte nënshtruar znj. Bălșan ishte një dhunë me baza gjinore, e cila është një formë e diskriminimit ndaj grave. Pavarësisht faktit se qeveria kishte miratuar një ligj dhe strategji kombëtare për parandalimin dhe luftimin e një abuzimi të tillë, mungesa e një reagimi të duhur nga sistemi gjyqësor dhe mosndëshkimi i agresorëve, si në rastin objekt gjykimi treguan se nuk kishte angazhim të mjaftueshëm për të adresuar problemin e dhunës në familje në Rumani.

Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 14, të lexuar së bashku me nenin 3.

Neni 41

Gjykata kërkoi që shteti Rumun t'i paguante shumën prej 9,800 eurosh, znj. Bălșan në lidhje me dëmin jomaterial.

Mungesa e hetimeve efektive mbi një rast keqtrajtimi e ndjekur nga një sherr ku u përfshinë të rritur dhe të mitur përbën shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BEGANOVIĆ k. KROACISË

(Kërkesa nr. 46423/06)

25 qershor 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Darko Beganović, ishte një shtetas kroat me origjinë rome që jetonte në Luka (Kroaci). Më 23 prill 2000, ai ishte 23 e vjeç dhe hyri në një grindje me një grup prej shtatë miqsh (dy prej të cilëve ishin të mitur) për një incident të dhunshëm që dyshohet se kishte ndodhur mes disa prej tyre më 8 dhjetor 1999. Në mbrëmjen e 23 prillit 2000, grupi i miqve iu afrua kërkuesit, i cili ishte në shoqëri me njerëz të tjerë, për t'u përballur me atë për incidentin e 8 dhjetorit 1999. Kërkuesi nisi të fyente një nga sulmuesit për shkak të origjinës së tij serbe dhe për këtë shkak nisi një sherr. Në prill dhe qershor 2000 policia mori në pyetje grupin e miqve. Ata deklaruan se kishin rënë dakord për të sulmuar kërkuesin si hakmarrje për ngjarjen e ndodhur në dhjetor të vitit 1999. Policia mori në pyetje edhe kërkuesin, i cili në atë kohë nuk dha asnjë indikacion se donjë nga sulmuesit e tij e kishte ofenduar për shkak të prejardhjes së tij rome.

Më 12 qershor 2000 kërkuesi, përfaqësuar nga këshilli ligjor, paraqiti në prokurori një kallzim penal kundër gjashtë individëve të identifikuar dhe një të pa identifikuar. Ai pretendoi se e kishin rrahur më 23 prill 2000 duke i shkakuar lëndime të rënda trupore, si dhe B.B. (shtatëmbëdhjetë vjeç) e kishte goditur në kokë me një dërrasë druri, duke bërë që ai të humbiste vetëdijen. Një raport mjekësor iu dorëzua gjithashtu policisë nga një spital në Zagreb, duke deklaruar se kërkuesi ishte ekzaminuar pas incidentit dhe se ai kishte pësuar dëmtime të shumta në kokë dhe trup, si dhe një tronditje.

Në bazë të ankesës së kërkuesit, policia dorëzoi në prokurori një kallzim penal në lidhje me sulmuesit. Në korrik 2001 dhe shtator 2002, zyra e prokurorit vendosi të mos fillojë hetim kundër sulmuesve për shkak se konstatoi se lëndimet e kërkuesit nuk ishin mjaft të rënda dhe se çështja mund të ndiqej vetëm nga i dëmtuari akuzues. Bazuar në këto informacione, kërkuesi paraqiti një padi ndaj njërit prej sulmuesve B.B. Ky rast u rrëzua nga prokurori i çështjes i cili evidentoi se kish ndodhur një gabim procedural dhe B.B. duhet të ndiqej kryesisht nga organi i akuzës.

Procedimi penal ndaj B.B. pu shqyrtua nga një gjykatë për të mitur në shkurt të vitit 2002 vdehe u pushua në dhjetor të vitit 2005 për shkak se ishte parashkuar,

pavarësisht përpjekjeve të shumta të kërkuesit për të shpejtuar procedurat. Kërkuesi ka ndjekur penalisht edhe sulmuesit e tjerë. Këto procedura u ndërpre në maj të vitit 2006, pasi gjykata vërejti se akuzat ishin parashkruar pothuajse dy vjet më parë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi në kuadër të neneve 3 dhe 13, argumentonte se autoritetet nuk e mbrojtën atë nga një akt keqtrajtimi pasi ato nuk kishin hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive personat përgjegjës. Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 3, duke argumentuar se si sulmi ashtu edhe proceset pasuese treguan se ai ishte diskriminuar për shkak të origjinës së tij rome.

Neni 3

Keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie për t'u konsideruar brenda fushëveprimit të nenit 3. Vlerësimi i këtij niveli minimal është relativ dhe duhet të marrë parasysh rast pas rasti. Gjykata vërejti se kërkuesi pretendonte se shtatë individë ishin përballur me të dhe kishin sulmuar duke e goditur. Raporti mjekësor tregoi se kërkuesi kishte pësuar goditje të shumta dhe kishte plagë kontura dhe prerje në kokë e trup. Gjykata konsideroi se këto akte dhune përfshiheshin brenda objektit të nenit 3.

Pasi Gjykata konstatoi se niveli i ashpërsisë së dhunës përfshihet në mbrojtjen e nenit 3, ajo imponon një detyrim ndaj shtetit për të siguruar zbatimin e rregullave dhe praktikave ka qenë efektive, kjo veçanërisht në lidhje me veprimet procedural të autoriteteve vendase. Gjithashtu, neni 3 kërkon që shtetet të kenë parashikime ligjore efektive në fushën penale për të penguar kryerjen e veprave penale kundër integritetit të personit, të cilat mbështeten nga mekanizmat ndëshkuese të këtyre dispozitave. Kur nuk ekziston një mbrojtje e tillë e cila parandalon shkeljet e nenit 3, shteti mund të deklarohet përgjegjës.

Gjithashtu, neni 3 kërkon që autoritetet të hetojnë pretendimet për keqtrajtim kur ato janë të diskutueshme dhe ngrenë dyshime të arsyeshme edhe nëse trajtimi është kryer nga persona të tretë. Në këtë rast, Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit se kërkuesi u sulmua nga shtatë individë, në mbrëmje në një vend të izoluar, ku thirrjet e tij për ndihmë do të kishin qenë të kota. Sulmi ishte gjithashtu i paramenduar dhe ishte një sulm ndaj integritetit fizik të kërkuesit. Lëndimet e paraqitura nga kërkuesi nuk ishin thjesht të parëndësishme në natyrë. Gjykata vërejti se pretendimet e kërkuesit për keqtrajtim ishin të diskutueshme dhe ngrinin dyshime të arsyeshme në lidhje me nenin 3.

Në lidhje me detyrën për të hetuar duhet të arrihet një standard minimal ligjor. Përkatësisht kërkesa që hetimi të jetë i pavarur, i paanshëm dhe t'i nënshtrohet një shqyrtimi rigoroz. Gjithashtu, kërkohet që autoritetet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi. Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshme për të siguruar provat në lidhje me incidentin. Gjykata vërejti se policia menjëherë mori disa individë në pyetje. Megjithatë, hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga autoritetet e ndjekjes penale dhe gjykatat nuk mund të konsideroheshin se përmbushnin kriterin e efektivitetit për qëllime të nenit 3.

Në këtë rast Gjykata vërejti se autoritetet shtetërore paraqitën vetëm një padi kundër B.B., pavarësisht hetimeve që tregojnë qartë se gjashtë sulmues të tjerë ishin përfshirë në sulmin e ndodhur. Në qershor 2000, kërkuesi paraqiti një kallzim penal në prokurorinë e Zagrebit kundër gjashtë sulmuesve të identifikuar dhe një personi të panjohur. Prokuroria nuk ndërmori asnjë veprim aktiv për tetë muaj. Procesi penal kundër B.B. u trajtua në mënyrën e duhur pothuajse dy vjet pas incidentit. Kjo u pasua nga mosveprimi i mëtejshëm i autoriteteve derisa hetimi u parashkrua. Pavarësisht përpjekjeve të kërkuesit dhe procedimet e tjera u parashkruan. Si rezultat, faktet e rastit nuk u vërtetuan asnjëherë nga një gjykatë kompetente. Gjykata vlerësoi se elementet e mësipërme derivojnë shkelje të nenit 3 nga autoritetet përkatëse shtetërore. Në rastin aktual, praktika e ndjekur nga autoritetet nuk e mbrojtën në mënyrë të përshtatshme kërkuesin nga një akt dhune i rëndë.

Neni 14 in conjunction ëith Neni 3

Gjykata vërejti se autoritetet shtetërore kanë detyrim për të hetuar veprime të mundshme dhune me bazë raciste. Megjithatë, ky detyrim nuk është absolut, por autoritetet duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshme në kuadër të rrethanave të rastit.

Në rastin në fjalë, Gjykata vërejti se policia mori në pyetje të gjithë sulmuesit e supozuar si dhe kërkuesin për të vërtetuar faktet. Bazuar në të gjithë të pyeturit ishin pjesë e të njëjtit grup të miqve deri më 8 dhjetor 1999, kur kërkuesi sulmoi tre të mitur dhe dy persona të tjerë në grup. Sulmi ndaj kërkuesit ishte një hakmarrje kundër atij incidenti. Si rezultat, Gjykata vlerësoi se sulmi ndaj kërkuesit ishte një akt hakmarrës sesa me motive racore.

Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk përmendi se sulmuesit e tij kishin bërë referencë për origjinën e tij rromë gjatë marrjes në pyetje nga policia ose gjatë dhënies së dëshmisë para Gjykatës Komunale. Gjykata arriti në përfundimin se nuk provohej se sulmi ndaj kërkuesit ishte kryer për motive racore. Për rrjedhojë, Gjykata konkludoi se nuk kishte shkelje të nenit 14 të lexuar në lidhje me nenin 3.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 1,000 euro në lidhje me dëmin jo-material dhe 6,250 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm mjekësor ose mbikëqyrja arsimore e një të mituri në një qendër të përkohshme ndalimi, përbën shkelje të nenit 3 dhe 5, ndërsa marrja në pyetje dhe proceset përbëjnë shkelje të nenit 6

VENDIMI DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BLOKHIN k. RUSISË

(Kërkesa nr. 47152/06)

mars 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Ivan Blokhin, ishte një shtetas rus i lindur në vitin 1992 dhe banues në Novosibirsk (Rusi). Ai vuante nga çrregullimi hiperaktiv i deficitit të vëmendjes (ADHD) dhe urinimi i pavullnetshëm. Ai u diagnostikua në dhjetor 2004 dhe janar 2005, pasi u shqyrtua nga dy specialistë të cilët i caktonin ilaçe dhe konsulta të rregullta nga një neurolog dhe psikiatër.

Më 3 janar 2005 kërkuesi, i cili ishte 12 vjeç në atë kohë, u arrestua dhe u dërgua në një komisariat policor. Atij nuk ia thanë arsyet e arrestimit të tij dhe kërkuesi pretendoi se ishte vënë në një qeli që nuk kishte dritare dhe ku dritat ishin të fikura. Ai deklaroi se kaloi një orë në errësirë, pas së cilës u mor në pyetje nga një oficer policie. Polici i tha atij se S. (fqinji 9 vjeçar i kërkuesit) e kishte akuzuar atë për grabitje. Sipas kërkuesit, oficeri i policisë e detyroi të rrëfehej, duke thënë se nëse ai do të bënte këtë, do të lirohej, por nëse refuzonte, ai do të futej në burg. Kërkuesi nënshkroi një deklaratë rrëfimin e dhënë. Pasi kujdestari i kërkuesit, gjyshi i tij, u kontaktua dhe erdhi në komisariatën e policisë, ai tërhoqi rrëfimin e tij.

Duke u bazuar në rrëfimin e kërkuesit së bashku me deklaratat e fqinjtit 9 vjeçar dhe nënës së tij, prokuroria gjeti që veprimet e tij përmbanin elementë të veprës penale të zhvatjes. Megjithatë, meqenëse ai nuk kishte arritur moshën e përgjegjësisë penale, autoritetet refuzuan të hapnin proceset penale. Më 21 shkurt 2005, Gjykata e Rrethit urdhëroi vendosjen e tij për 30 ditë në një qendër të përkohshme të ndalimit për të mitur, për të mos lejuar kryerjen e veprimeve të mëtejshme kriminale; ai u vendos në qendrën e ndalimit në po të njëjtën ditë me dhënien e vendimit. Pas një apeli të bërë nga gjyshi i kërkuesit, duke deklaruar se ndalimi ishte i jashtëligjshëm dhe i papajtueshëm me shëndetin e nipit të tij dhe se ai ishte kërcënuar dhe marrë në pyetje në mungesë të kujdestarit të tij, gjykata e rrethit anuloi urdhrin e masës me burg në mars 2005. Në maj të vitit 2006 e njëjta gjykatë, pas rishqyrtimit të çështjes, konstatoi se urdhri i mëparshëm i burgimit ishte i ligjshëm.

Pasi u lirua nga qendra e ndalimit më 23 mars 2005, kërkuesi u dërgua në një spital ku mori trajtim për urinimin e pavullnetshëm dhe ADHD deri më 21 prill 2005. Sipas kërkuesit, ai nuk mori kujdesin e duhur mjekësor gjatë kohës së tij në qendrën e ndalimit. Ai pretendonte se aksesit në tualete ishte i kufizuar dhe se ai duhej të duronte dhimbjen e fshikëzës dhe poshtërimin, pasi vuante nga urinimi i pavullnetshëm. Kërkuesi gjithashtu pohoi se ai dhe të miturit e tjerë të ndaluar në qendër, kalonin gjithë ditën në një dhomë të madhe të zbrazët, e cila nuk kishte mobilje. Ata u lejuan të dilnin në oborr vetëm dy herë gjatë qëndrimit 30 ditor të kërkuesit dhe u jepnin mësimet vetëm dy herë në javë për rreth tre orë, ku rreth 20 fëmijë të të gjitha moshave të ndryshme mësonin së bashku në një klasë.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 3, kërkuesi u ankua se kushtet në qendrën e paraburgimit të përkohshëm ishin çnjerëzore dhe se ai nuk kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor. Ai gjithashtu u ankua se ndalimi i tij ishte në kundërshtim me nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri). Së fundmi, ai pohoi se procedurat lidhur me vendosjen e tij në qendrën e paraburgimit të përkohshëm ishin të padrejta dhe kishin shkelur nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt). Më 14 nëntor 2013, një Dhomë e Gjykatës dha një vendim, me të cilin në mënyrë unanime konstatoi shkelje të nenit 3, 5 dhe 6. Rasti u referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43, me kërkesë të Qeverisë.

Neni 3

Gjykata përsëriti se, në mënyrë që trajtimi të hyjë në juridiksionin e nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë. Gjykata vuri në dukje se neni 3 imponon një detyrim ndaj Shtetit për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, duke u ofruar atyre, ndër të tjera, kujdesin e kërkuar mjekësor. Megjithatë, vlerësimi nëse kujdesi mjekësor është i përshtatshëm është një nga elementët më të vështirë për të përcaktuar. Si rezultat, autoritetet duhet të sigurojnë që të mbahen shënime gjithëpërfshirëse lidhur me gjendjen shëndetësore të të ndaluarve dhe trajtimin e tyre gjatë kohës së paraburgimit. Shteti duhet të sigurojë që trajtimi mjekësor i ofruar në mjediset e burgut të jetë në një nivel të krahasueshëm me atë që Shteti i siguron publikut.

Në rastin e fëmijëve, shëndeti i të miturve të privuar nga liria duhet të ruhet sipas standardeve mjekësore të njohura për të miturit në komunitetin e gjerë. Autoritetet gjithmonë duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës dhe duhet të garantojnë mbrojtja dhe kujdesi i duhur i fëmijës. Kjo përfshin një vlerësim mjekësor të gjendjes shëndetësore të fëmijës për të përcaktuar nëse ai/ajo duhet të vendoset në

një qendër të paraburgimit për të mitur. Kur ngjarjet qëndrojnë në pjesën më të madhe brenda njohurive ekskluzive të autoriteteve, siç është rasti i personave nën kontrollin ose paraburgimin e tyre, do të lindin prezumime të forta të fakteve në lidhje me dëmtimet, lëndimet ose vdekjen, që kanë ndodhur gjatë paraburgimit. Barra e provës në raste të tilla qëndron tek autoritetet për të dhënë një shpjegim. Në mungesë të ndonjë shpjegimi të mjaftueshëm nga autoritetet, Gjykata mund të nxjerrë konkluzione jo të favorshme.

Në rastin në fjalë, Gjykata vuri në dukje në veçanti moshën e re të kërkuesit dhe gjendjen e tij shëndetësore si rrethana relevante në vlerësimin nëse, niveli minimal i ashpërsisë ishte arritur. Pavarësisht se Qeveria parashtroi dokumente për standardet e qendrës së paraburgimit, Gjykata vuri në dukje se të gjitha dokumentet datonin pas kohës kur kërkuesi ishte vendosur atje. Gjykata gjithashtu u shpreh se, raportet ose certifikatat e paraqitura nga Qeveria ruse kishin nuk kishin vlerë dëshmie pasi nuk i referoheshin dokumentacionit origjinal të mbajtur nga qendra e paraburgimit. Gjykata vuri në dukje se gjyshi i kërkuesit kishte dorëzuar certifikata mjekësore në seancën e leftësimit së paraburgimit për të treguar se nipi i tij vuante nga ADHD, për të siguruar që autoritetet do të ishin në dijeni të gjendjes së tij. Gjykata i konsideroi këto prova të mjaftueshme për të vërtetuar se autoritetet kishin dijeni për gjendjen shëndetësore të kërkuesit pas pranimit të tij në qendrën e ndalimit të përkohshëm. Për më tepër, fakti që ai duhej të shtrohej në spital pas lirimit për pothuajse tre javë, tregoi se ai nuk kishte marrë trajtimin e nevojshëm, në kohën kur ishte në qendër.

Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte arritur të tregonte se kërkuesi kishte marrë trajtim mjekësor të përshtatshëm për gjendjen e tij dhe konstatoi shkelje të nenit 3. Duke dalë në këtë konkluzion, Gjykata e konsideroi të panevojshme shqyrtimin e pjesës së mbetur të ankesave të kërkuesit sipas kësaj dispozite .

Neni 5

Gjykata konfirmoi se ndalimi i kërkuesit për tridhjetë ditë në qendrën e ndalimit të përkohshëm, përbënte një heqje lirie në kuptimi të nenit 5 (1). Gjykata konstatoi se paraburgimi i kërkuesit nuk i takon juridiksionit të nenit 5 (1) (a), (b), (c), (e) ose (f), por shqyrtoi nëse vendosja e tij në qendrën e përkohshme të ndalimit ishte në përputhje me nenin 5 (1) (d). Paraburgimi për mbikëqyrjen e arsimit, në rastin e të miturve, duhet të bëhet në një strukturë të përshtatshme, me burimet e nevojshme për të përbushur objektivat arsimore dhe kërkesat e sigurisë. Kjo nuk do të thotë që vendosja në një strukturë të tillë duhet të jetë e menjëhershme, vendosjet e përkohshme janë të lejuara në objekte që nuk i ofrojnë këto kushte, megjithatë,

periudha e kujdestarisë së përkohshme duhet të pasohet në një kohë të shkurtër nga transferimi në një qendër që ofron mbikëqyrje arsimore.

Në rastin konkret, kërkuesi u vendos në qendrën e paraburgimit me qëllim korrigjimin e sjelljes së tij dhe jo për tu mbajtur përkohësisht, përpara se të transferohej në një qendër tjetër. Gjykata konstatoi, në kundërshtim me pretendimet e Qeverisë, që vendosja e kërkuesit në qendrën e ndalimit të përkohshëm nuk mund të krahasohej me një vendosje në një institucion arsimor të mbyllur. Siç u diskutua më sipër, vendosja në një qendër të përkohshme të paraburgimit duhet të jetë një zgjidhje afatshkurtër dhe Gjykata nuk arriti të shohë se si do të mund të sigurohej mbikëqyrja e duhur arsimore, për të ndryshuar sjelljen e një të mituri, gjatë një periudhe maksimale prej tridhjetë ditësh. Gjykata pranoi se ofroheshin disa orë mësimi në qendër, megjithatë, qendra karakterizohej nga një regjim disiplinor. Për më tepër, asnjë nga gjykatat vendase nuk theksoi se vendosja e kërkuesit ishte për qëllime edukimi, por të gjitha ato iu referuan "korrigjimit të sjelljes" ose për të parandaluar atë nga kryerja e veprimeve të mëtejshme kriminale, asnjëra prej të cilave nuk ishin pjesë e juridiksionit të nenit 5 (1) (d).

Gjykata konstatoi se vendosja e kërkuesit në qendrën e ndalimit të përkohshëm nuk ishte bërë sipas parashikimeve të nenit 5 (1) (d), prandaj kemi të bëjmë me shkelje të nenit 5 (1).

Neni 6

Sa i përket të pandehurve të mitur, Gjykata u shpreh se proceset penale duhet të organizohen për të respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe se fëmija i akuzuar për një vepër penale trajtohet në një mënyrë të tillë, që merr parasysh moshën dhe nivelin e pjekurisë së tij dhe se janë ndërmarrë hapa për të promovuar aftësinë e tij për të kuptuar dhe marrë pjesë në proces. Fëmija nuk duhet të privohet nga masat mbrojtëse të rëndësishme procedurale, sepse procedimet mund të rezultojnë në heqjen e lirisë së tij. Edhe pse jo absolute, e drejta sipas nenit 6 (3) (c) parashikon që të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale të mbrohen në mënyrë efektive nga një avokat. Gjykata vuri në dukje se vulnerabiliteti i të akuzuarit në fazat fillestare të marrjes në pyetje nga policia mund balancohej vetëm me ndihmën e një avokati. Për një gjykim të drejtë, neni 6 (1) kërkon që caktimi i një avokati duhet të sigurohet sapo një i dyshuar të pyetet së pari nga policia, përveç rastit nëse ekziston një arsye bindëse e bazuar në rrethanat e rastit që kjo e drejtë duhet të kufizohet. Gjykata theksoi në veçanti rëndësinë themelore të ofrimit të një avokati, në rastin kur personi në paraburgim është i mitur, duke pasur parasysh vulnerabilitetin e tyre të veçantë.

Neni 6 (3) (d) ruan parimin se, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha provat kundër tij zakonisht duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë publike. Një të akuzuari duhet t'i jepet një mundësi e përshtatshme për të pyetur dhe për tu përballur me dëshmitarët kundër tij. Kur dënimi bazohet vetëm ose kryesisht në dëshminë e dëshmitarit të munguar, Gjykata duhet të vendosë nëse ka faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues për të lejuar ende një vlerësim të drejtë dhe të duhur të provave. Gjykata më tej vuri në dukje se duhet të ketë arsye të forta për mungesën e një dëshmitari në gjykim, veçanërisht kur dënimi bazohet vetëm në depozitimin e bërë nga një person, me të cilin i akuzuari nuk kishte mundësi të ballafaqohej. Të drejtat e mbrojtjes në këtë rast mund të konsiderohen aq të kufizuara, sa do të kishim të bënim me shkelje të nenit 6.

Në rastin konkret, kërkuesi ishte vetëm dymbëdhjetë vjeç dhe vuante nga ADHD kur policia e mori në pyetje në stacion. Ai ishte gjithashtu nën moshën e përgjegjësisë penale të përcaktuar nga Kodi Penal për veprën penale të zhatjes, për të cilën ai ishte akuzuar. Megjithatë, ai kishte nevojë për trajtim dhe mbrojtje të veçantë nga autoritetet dhe së paku duhet t'i ishin garantuar të njëjtat të drejta ligjore dhe masa mbrojtëse si për të rriturit. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asnjë të dhënë se kërkuesit i ishte thënë se kishte të drejtë të thërriste gjyshin e tij, mësuesin, avokatin ose ndonjë person tjetër të afërm, gjatë periudhës që ai ishte mbajtur në stacionin e policisë, për t'i ardhur në ndihmë gjatë marrjes në pyetje. Për më tepër, nuk u ndër-morën masa për të siguruar që atij t'i ishte ofruar ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje. Fakti që ligji i brendshëm nuk kishte ofruar asistencë ligjore për një të mitur nën moshën e përgjegjësisë penale, kur ishte intervistuar nga policia, nuk ishte një arsye e vlefshme për mosrespektimin e këtij detyrimi. Gjykata konstatoi se mungesa e ndihmës juridike gjatë marrjes në pyetje të kërkuesit nga ana e policisë, ndikoi në mbrojtjen e të drejtave të tij dhe dëmtoi procedurën në tërësi. Si rrjedhojë, gjykata konstatoi se kishim të bënim me shkelje të nenit 6 (1) dhe (3) (c).

Gjykata vuri në dukje se, Gjykatës së Rrethit iu siguruan rezultatet e hetimit paraprak, i cili përfshinte deklaratat e dëshmitarëve të bëra nga viktimat e supozuar dhe nëna e tij. As S., as nëna e tij, nuk ishin thirrur në seancë për të dhënë dëshmi dhe për t'i dhënë kërkuesit një mundësi për t'u përballur me ta, pavarësisht faktit se deklaratat e tyre kishin rëndësi thelbësore për konkluzionin që kishte dalë nga hetimi paraprak, se kërkuesi e kishte kryer aktin. Bazuar në këto fakte, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk iu siguroi e drejta për një proces të rregullt e si rrjedhojë, u konstatua shkelje e nenit 6 (1) dhe (3) (d).

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 7,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Gjithashtu, Gjykata i akordoi kërkuesit 1,910 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Përdorimi i forcës, përveç rasteve kur është domosdoshmërisht e nevojshme, dhe e përdorur nga autoritetet ndaj individëve që ndodhen nën kontrollin e tyre shkel nënin 3 dhe nëse ky veprim nuk deriuon dëmtime serioze fizike ose mendore

VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BOUYID k. BELGJIKËS

(Kërkesa nr. 23380/09)

28 shtator 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Said dhe Mohamed Bouyid, janë shtetas belg të lindur respektivisht në vitin 1986 dhe 1979, që jetojnë në Saint-Josse-Ten-Noode (një zonë që i përket Brukselit). Të dy vëllezërit banonin me prindërit, një vëlla dhe motër tjetër, pranë stacionit të policisë së Saint-Josse-ten-Noode. Ata pretendojnë se janë goditur me shpullë në fytyrë nga një oficer policie. Në 8 dhjetor 2003, kur Said po qëndronte përpara derës së shtëpisë së shokut të tij duke i rënë ziles që dikush ta hapte atë, duke qenë se kishte harruar çelsat, është pyetur nga një oficeri i policisë për kartën e identitetit.

Said i kishte kërkuar oficerit të policisë që ti tregonte kredencialet e tij përpara, por kjo e kishte nervozuar oficerin, i cili e kishte arrestuar atë dhe e kishte dërguar në rajon. Atje, sipas Said, ai ishte goditur më shpullë nga oficeri i policisë. Po atë ditë, një raport mjekësor konfirmoi se Said ishte në një gjendje shoku dhe se kishte eritema në faqen e tij të majtë. Said paditi oficerin e policisë përpara Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së Policisë dhe u mor në pyetje nga një anëtar i këtij komisioni, për ngjarjen e ndodhur.

I njëjti rast edhe për vëllain e tij Mohamed Bouid, më 23 shkurt 2004, gjatë kohës që po merrej në pyetje nga oficerët e policisë në Saint-Josse-ten-Noode, ai ishte goditur me shpullë në fytyrë. Ky fakt dëshmohej nga raporti mjekësor, që konfirmonte se Mohamed kishte pasur nxirje në faqen e tij të majtë. Mohamed paraqiti një ankesë për sjelljen e oficerit të policisë po atë ditë.

Oficeri i policisë që kishte marrë në pyetje Mohamed, u mor në pyetje nga drejtori i Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së Policisë dhe u shpreh se pavarsisht se Mohamed kishte qenë harbut dhe i pakontrollueshëm gjatë kohës së marrjes në pyetje, ai mohoi ta kish goditur.

Më 17 qershor 2004, të dy vëllezërit ngritën një padi civile kundër oficerave të policisë së rajonit të Saint-Josse-ten-Noode, duke pretenduar se ndaj tyre ishte ushtruar

dhunë për shkak të detyrës me qëllim plagosjen, dhe ishin shkelur liritë themelore kushtetuese.

Një raport i plotësuar nga departamenti i hetimit, doli në përfundimin se marrëdhëniet e familjes Bouyid me Policinë nuk ishin në raportet e tyre më të mira dhe në shumicën e rasteve, kishte sjellje provokuese dhe agresive ndaj oficerëve të policisë nga ana e pjesëtarëve të kësaj familje.

Ky raport iu dërgua Prokurorit të Kurorës dhe ky i fundit kërkoi pushimin e çështjes. Komisioni për Mbikëqyrjen e Punës së Policisë ndaloi hetimet. Më 9 prill 2008, Divizioni i Aktakuzave të Gjykatës së Apelit të Brukselit la në fuqi urdhërin e ndërprerjes së hetimeve. Më 29 tetor 2008, Gjykata e Kasacionit rrëzoi ankimin e vëllezërve Boyid.

2. Vendimi i Gjykatës

Në zbatim të nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar) kërkuesit pretenduan se kishin qenë viktimë të trajtimit degradues, duke qenë se u goditën në fytyrë gjatë kohës së marrjes në pyetje nga një oficer policie. Gjithashtu, ata u ankuan se hetimi i ankimit të tyre kishte qenë jo efektiv, i pa plotë, i njëanshëm, si edhe i tejzgatur në kohë.

Më 21 nëntor 2013, Dhoma e Gjykatës në vendimin e saj u shpreh se në këtë rast nuk kishte shkelje të nenit 3 të Konventës. Pas kërkesës së ankuesve çështja iu referua Dhomës së Madhe në zbatim të nenit 43 të Konventës.

Neni 3

Gjykata theksoi se neni 3 i Konventës garanton një nga vlerat më thelbësore të shoqërisë demokratike. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se neni 3 nuk ka hapësirë për përjashtime, madje edhe në situata emergjencash publike. Pretendimet për keqtrajtim në kundërshtim me nenin 3 të Konventës duhet të mbështeten me prova relevante, që do të thotë se duhet të vërtetohet "përtej një dyshimi të arsyeshëm". Kur ngjarjet e ndodhura kanë qenë brenda diskrecionit ekskluziv të autoriteteve, siç janë rastet kur individët janë në paraburgim, prezumime të forta do të derivojnë në lidhje me dëmtimet e ndodhura. Në këto raste barra e provës i takon qeverisë, për të prodhuar prova që hedhin dyshime në llogari të vetë viktimës.

Me qëllim që keqtrajtimi të përfshihet në fushëveprimin e nenit 3 të Konventës, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsise, që zakonisht përfshin lëndime trupore ose vuajtje intensive fizike ose mendore. Sidoqoftë, kur trajtimi poshtëron, përul, ose

cenon dinjitetin njerëzor të një individi, ai mund të karakterizohet si degradues dhe përfshihet në kuadër të ndalimit të përcaktuar në nenin 3 të Konventës. Kur një personi i është privuar liria ose përballet me oficerë të zbatimit të ligjit, çdo përdorim i forcës fizike, e cila nuk është e domosdoshme, cenon dinjitetin e tij njerëzor.

Në rastin objekt gjykimi qeveria argumentoi se certifikatat mjekësore të paraqitura nga kërkuesit nuk vërtetuan se lëndimet e tyre kishin rezultuar nga një shuplakë. Megjithatë, Gjykata vërejti se certifikatat, autenticiteti i të cilave nuk u kontestua, dokumentuan lëndime që ishin pasojat e mundshme të goditjeve në fytyrë. Certifikatat janë lëshuar në ditën e ngjarjeve, të cilat forcojnë vlerën e tyre dëshmuese. Gjithashtu, nuk është kontestuar që kërkuesit nuk kanë pasur ndonjë shenjë të tillë para se të hyjnë në stacionin policor. Bazuar në provat e paraqitura u arrit në përfundimin se mavijosjet e përshkruara në certifikatën mjekësore ndodhën ndërkohë që kërkuesit ishin nën kontrollin e policisë.

Gjykata u shpreh se kur një individi i privohet liria, qoftë edhe ushtrimi më i vogël i forcës fizike ndaj tij do të konsiderohet si shkelje e nenit 3 të Konventës. Në rastin konkret oficerët e policisë kishin ushtruar dhunë fizike ndaj të ndaluarve, pavarësisht se ky veprim ndalohet për çfarëdo lloj shkelje ligjore, që mund të ketë bërë i ndaluar.

Sipas Gjykatës, fakti që një individ ishte goditur në fytyrë, edhe pse ishte i ndaluar për të lëvizur, është një fakt i pamohueshëm se kemi të bëjmë me një sulm ndaj dinjitetit të njeriut. Një autoritet policor supozohet të mbrojë individin dhe jo ta kthejë atë në viktimë, dhe në rastin konkret ishte demonstruar një superioritet i tepruar nga oficerët e policisë, dhe kërkuesit gjendeshin në një pozicion inferioriteti përsa kohë ishin të ndaluar, tregon se dinjiteti i tyre është përdhosur. Gjykata shprehu shqetësimin e saj për ndikimin që do të kishte ky rast në një minoren 17 vjeçar si Said Bouyid.

Përsa i përket aspektit procedural, Gjykata theksoi se garancitë kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues do të ishin joefektive nëse nuk do të ekzistonte asnjë procedurë për hetimin e pretendimeve për keqtrajtim. Një hetim konsiderohet efektiv nëse është i aftë të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës për kryerjen e tij. Gjithashtu, duhet që hetimi të mos kryhet drejtpërdrejt nga individët e përfshirë në ngjarje. Një hetim efektiv duhet të jetë i shpejtë dhe i plotë. Në këtë rast Gjykata vuri në dukje se pas ankesave të parashtruara nga kërkuesit, autoritetet vendase nisën një hetim menjëherë. Gjyqtari i hetimeve paraprake kërkoi nga departamenti i hetimit të merrte parasysh ankimin e kërkuesve, si edhe t'i intervistonte ata. Gjithashtu, ai kërkoi të hartohet një raport mbi sjelljen e familjes Bouyid dhe të përpilohej një listë të të gjitha ankesave të parashtruara prej tyre.

Megjithatë, ai nuk arriti të intervistojë punonjësit e policisë, mjekët që kishin hartuar certifikatat mjekësore ose ndonjë dëshmitar okular. Prandaj, hetimi ishte i kufizuar në intervistat e punonjësve të policisë të përfshirë në incident nga oficerët e tjerë të policisë. Kohëzgjatja e hetimit ishte gjithashtu një çështje për t'u marrë në shqyrtim, duke pasur parasysh se ankimet u parashtruan në 2003 dhe 2004, megjithatë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit nuk dhanë vendim, duke mbyllur kështu procesin në vitin 2008, pothuajse pesë vjet pas ngjarje. Si rezultat, Gjykata vlerësoi se kërkuesit nuk kishin përfituar një hetim efektiv.

Bazuar në faktet e mësipërme, Gjykata arriti në përfundimin se shuplaka e dhënë për secilin nga kërkuesit ka cenuar dinjitetin e tyre. Si rezultat, Gjykata vlerësoi se në këtë rast kishte një shkelje të së drejtës garantuar nga neni 3 për të dy kërkuesit. Gjithashtu, ajo arriti në përfundimin se hetimi i incidenteve ishte i paefektshëm në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesve 5,000 euro secilit për dëm jomaterial dhe 10,000 euro të dyve së bashku për shpenzimet gjyqësore.

Mbipopullimi i qelive të burgut derivon një shkelje të nenit 3 dhe zgjatja e periudhës së ndalimit për 5 vjet 8 muaj dhe 15 ditë shkel nenin 5 (3) të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BULATOVIĆ k. MALIT TË ZI

(Kërkesa nr. 67320/10)

22 korrik 2014

1. Faktet kryesore

Më 8 maj 2001, kërkuesi, z. Željko Bulatović, vrau X dhe menjëherë u largua nga Mali i Zi. Më 6 mars 2002, ai u shpall fajtor për vrasje. Gjyqi u zhvillua në mungesë të tij. Pas arrestimit të tij në Spanjë dhe ekstradimit në Malin e Zi, procedimi penal u rihap më 3 shkurt 2004. Më 10 prill 2009 ai u shpall fajtor për vrasjen, por ky vendim u rrëzua nga Gjykata e Apelit, e cila e ktheu çështjen për rigjykim. Më 4 tetor 2010, kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua me katërmëdhjetë vjet burg. Ai u transferua në burg më 26 prill 2011.

Prej 20 prillit 2004, kërkuesi ishte mbajtur në paraburgim për shkak të frikës se mund të largohej nga vendi.

2. Vendimi i Gjykatës

Në referim të neneve 3 dhe 5 (3) të Konventës, kërkuesi u ankua rreth kushteve të cilave iu ishte nënshtruar gjatë kohës së paraburgimit. Gjithashtu, ai u ankua për mungesën e kujdesit mjekësor gjatë ndalimit, si dhe për kohëzgjatjen e masës së sigurisë ndaj tij. Në veçanti ai theksoi se qelia në të cilën ishte ndaluar ishte e mbi-populluar dhe se i mungonte uji i pijshëm dhe ushtrimi i përditshëm.

Pretendimet e kërkuesit në kuadër të nenit 6 dhe 14 dhe nenit 1 të Protokollit 12 të Konventës u shpallën haptazi të pabazuara.

Neni 3

Gjykata vërejti se mbipopullimi i burgjeve ngre në vetvete një çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës. Neni 3 kërkon që shteti të sigurojë që të burgosurit të mbahen në kushte të cilat janë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor. Mënyra e ekzekutimit të masës së sigurimit mund t'i vendosë individët e ndaluar në vështirësi ose stres të një intensiteti, që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim. Gjithashtu, shtetit i kërkohet, që duke pasur parasysh

kërkesat praktike të burgimit shëndeti dhe mirëqenia e të ndaluarve duhet të sigurohen në mënyrë të përshtatshme.

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vërejti se administrata e burgjeve kishte marrë një sërë masash, që synonin përmirësimin e kushteve në burg. Megjithatë, vërehet se këto masa janë marrë vetëm pas vitit 2008 dhe se përmirësimi më i rëndësishëm ishte zvogëlimi i numrit të të burgosurve, i cili gati u përgjysmua deri në mars 2013. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se paraburgimi i kërkuesit përfundoi më 4 tetor 2010 dhe ishte e vështirë të vlerësohej se si kishte ndikuar tek ai ulja e popullimit në qelitë e paraburgimit, në raport me kohën që ai qëndroi në këto qeli. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë drejtim.

Në lidhje me pretendimin e z. Bulatović për mos përfitim të kujdesit të nevojshëm shëndetësor, Gjykata konstatoi se, në bazë të provave të paraqitura përpara saj kërkuesi kishte marrë trajtim të përshtatshëm shëndetësor. Dështimi i autoriteteve për të siguruar një ekzaminim të mëtejshëm mjekësor në një rast të vetëm, nuk arrin nivelin e mjaftueshëm të ashpërsisë për të derivuar një shkelje të nenit 3 të Konventës, duke qenë se nuk kishte asnjë rekomandim i cili të provonte se ekzaminimi i kërkuar ishte urgjent, ose pa kryerjen e tij kërkuesi do t'i nënshtrohej një vuajtjeje të konsiderueshme.

Neni 5 (3)

Kërkuesi u ankua për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij.

Gjykata vërejti se periudha e paraburgimit të kërkuesit ishte 5 vite, 8 muaj dhe 15 ditë. Gjithashtu, ajo theksoi se në kohën kur ishte urdhëruar paraburgimi i z. Bulatović ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se ai kishte kryer vrasjen. Paraburgimi u urdhërua për shkak të frikës se ai mund të largohej nga vendi, ashtu sikurse kishte ikur më parë. Vendimet për zgjatje të periudhës së paraburgimit u morën duke pasur parasysh rëndësinë e veprës penale për të cilën akuzohej kërkuesi, dënimin që mund t'i jepej atij, si dhe rrethanat e tij personale. Gjykata konsideroi se arsyet e paraqitura nga autoritetet malazeze sigurisht, që ishin të rëndësishme. Megjithatë, në rrethanat specifike të rastit, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte nëse këto rrethana ishin të mjaftueshme ose nëse autoritetet vendase duhet të kishin marrë në konsideratë edhe masa të tjera alternative për të siguruar praninë e kërkuesit në gjykim. Procedimi penal në fjalë nuk u zhvillua brenda një afati të arsyeshëm, ashtu sikurse e pranojnë vetë gjykatat vendase, sikurse kërkohet nga garancitë e nenit 5 (3). Meqenëse në rastin objekt gjykimi nuk kishte asnjë rrethanë të veçantë, e cila

të justifikonte një zgjatje të tillë të procesit gjyqësor, Gjykata vletësoi se zgjatja e paraburgimit të kërkuesit kishte shkelur afatin e arsyeshem ligjor duke cenuar kështu të drejtën e garantuar nga neni 5 (3) i Konventës.

Neni 41

Kërkuesit nuk iu akordua shpërblim për dëmin jomaterial, pasi ai nuk kishte bërë një kërkesë të tillë.

Dështimi për të kryer një hetim efektiv dhe këshillimi i një të mituri pas abuzimit seksual përbënte shkelje të nenve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN C.A.S DHE C.S k. RUMANISË

(Kërkesa nr. 26692/05)

20 mars 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, C.S. dhe C.A.S, janë baba e bir shtetas rumun që jetojnë në Rumani.

Në janar 1998, C.A.S që ishte 7 vjeç në atë kohë, u ndoq nga shkolla deri në shtëpi nga një burrë P.E. P.E hyri me forcë në apartamentin e familjes, ku C.A.S ishte vetëm dhe e goditi djalin disa herë në stomak. P.E më pas e urdhëroi të zhvishet, ia mbylli gojën dhe ia lidhi këmbët dhe krahët. P.E e përdhanoi dhe e dëtyroi të kryente seks oral. Më pas, P.E i gjuajti sërish në stomak, kokë, në organet gjenitale dhe e kërcënoi më thikë se po t'i tregonte dikujt se ç'kishte ndodhur, do e vriste.

Ky abuzim vazhdoi për 3 muajt në vazhdim për disa herë në javë. C.A.S rrjedhimisht i tregoi të atit C.S se çfarë kishte ndodhur. I ati paraqiti një kërkesë në policinë lokale në fund të prillit – fillim maji 1998. Ky përkrahim i fakteve nuk u kontestua nga qeveria.

Tre javë pasi abuzimi u raportua në polici, filloi një investigim dhe u morën në pyetje shumë dëshmitarë. Edhe C.A.S u mor në pyetje disa herë nga qershori 1998 deri në mars 2003, periudhë gjatë së cilës ai përsëriti pretendimet për përdhunim, por dha deklarata kontradiktore në lidhje me faktin nëse i kishte treguar dikujt për abuzimin. Ai gjithashtu identifikoi P.E në një rreshtim të organizuar nga policia. P.E u intervistua në qershor 1998 dhe i mohoi akuzat. Gjatë një testi me dedektor gënjeshtresh, u pa se P.E kishte një sjellje të simuluar kur pyetej nëse kishte pasur marrëdhënie seksuale me C.A.S. Dëshmitarë të tjerë, përfshirë dhe fqinjët, pohuan se e kishin parë P.E të hynte në apartamentin ku banonte djali gjatë asaj periudhe. Djali adoleshent i njërit prej fqinjëve pohoi se kishte parë P.E të hynte në shtëpinë e djalit dhe e kishte dëgjuar këtë të fundit të bërtiste.

Hetuesit kërkuan edhe shtëpinë e kërkuesit edhe atë të P.E, por nuk gjetën asnjë provë që të mbështeste akuzat. Djali i'u nënshtrua dy ekzaminimeve mjekësore. I pari në 18 maj 1998, me të cilin u konstatuan lëndime në muskulin unazor anal dhe i dyti në shkurt 2000, i cili sollti në përfundimin që plagët mund të ishin shkaktuar vetëm nga një abuzim i vazhdueshëm seksual. Hetimi u ndal 3 herë deri në prill 2003,

kur prokuroria nxorri P.E në gjyq për përdhunim dhe hyrje me forcë në shtëpinë e viktimës.

Në maj të vitit 2004, Gjykata e Rrethit la të lirë P.E duke thënë se ai nuk i kishte kryer krimet për të cilat ishte akuzuar. Çështja u dërgua në Apel, por nuk u pranua. Gjykata e Rrethit tha se palët dhe dëshmitarët kishin dhënë deklarata kontradiktore. Gjithashtu, Gjykata ishte e shqetësuar për faktin se, pavarësisht se ishin në dijeni të një abuzimi të mundshëm (njolla gjaku në të mbathurat e djalit) dhe ndodhi të cuditshme në shtëpi (mobilje të zhvendosura, mungesë e ushqimeve dhe parave), prindërit kishin pritur kaq gjatë para se t'i drejtoheshin autoriteteve. Gjykata e Rrethit gjithashtu tha se C.A.S nuk kishte dhënë një përshkrim të saktë të fakteve dhe ishte e mundshme që të ishte duke fantazuar.

Babai i C.A.S bëri disa ankesa për tejzgjatjen e procedurave, por të gjitha u hodhën poshtë. C.A.S ndërroi shkollë pas abuzimit, megjithatë në tetor 2005 familja u zhvendos në lasi, me rekomandimin e këshilltarit të shkollës.

2. Vendimi i Gjykatës

C.A.S u ankua në bazë të nenit 3 abuzimi i dhunshëm seksual përbënte torturë dhe se procedurat ishin shtrembëruar, duke fajësuar atë dhe prindërit e tij për mosreagimin e mëhershëm. C.A.S dhe C.S u ankuan në bazë të nenit 8 se jeta e tyre familjare ishte shkatërruar dhe se ata ishin detyruar të largoheshin nga qyteti ku kishin jetuar, për të rindërtuar një jetë normale.

Nenet 3 dhe 8

Gjykata përseriti se, në bazë të nenit 1 të Konventës, Shtetet kanë detyrimin t'i sigurojnë kujtdo brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara nga Konventa. Kjo, në bashkëpunim me nenin 3, kërkon që shtetet të marrin masa për t'u siguruar që individët nuk janë subjekte të keqtrajtimin, edhe kur janë në dorë të individëve privatë. Neni 3 gjithashtu kërkon që, kur ka shkelje pretendime për keqtrajtim, autoritetet të zhvillojnë një hetim efektiv. Që një hetim të konsiderohet efektiv, në parim duhet të jetë në gjendje të çojë në vërtetimin e fakteve të çështjes dhe në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Gjykata gjithashtu tha se, detyrimet pozitive të Shtetit në bazë të nenit 8 janë të pandara në të drejtën për respektimin efektiv të jetës private. Shteti ka detyrimin të sigurojë përmbajtje efektive kundrejt akteve të tilla si përdhunimi, që kërkon dispozita efektive të së drejtës penale. Gjykata gjithashtu theksoi se, Komiteti i Kombeve të

Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, theksoi se duheshin marrë një sërë masash për t'i mbrojtur fëmijët nga të gjitha llojet e dhunës, masa të cilat përfshinin parandalimin, korrigjimin dhe dëmshpërblimin.

Në lidhje me faktet e çështjes, Gjykata theksoi se aktet e dhunës që pësoi kërkuesi i parë, takuan pragun e nenit 3. Prandaj, Shteti plotësoi detyrimin pozitiv për të nisur nje hetim për çështjen. Gjykata theksoi më tej se në këtë çështje, hetimi nuk filloi në mënyrën e duhur, pavarësisht rëndësisë së pretendimeve dhe vulnerabilitetit të viktimës. I'u deshën autoriteteve tre javë që nga data e ankimit, për të urdhëruar një ekzaminim mjekësor dhe pothuajse dy muaj për të marrë në pyetje të dyshuarin kryesor. Hetimi si i tërë zgjati për 5 vite, pavarësisht ankesave të vazhdueshme të kërkuesve.

Gjithashtu, Gjykata vëzhgoi se për gati 3 vite, asnjë hap i rëndësishëm nuk ishte marrë në lidhje me investigimin pas vendimit të parë të Prokurorit për të mos ndjekur penalisht, pavarësisht instruksioneve për të vazhduar investigimin. Personi i akuzuar u lirua në fund të procedurave penale, pra 7 vite pas akteve të pretenduara. Nuk ka asnje të dhënë se autoritetet u munduan të zbulonin nëse kishte një tjetër person përgjegjës për krimet. Kjo ngriti dyshime për efektivitetin e procedurave, veçanërisht në një çështje të tillë, që përfshinte abuzimin seksual të një të mituri.

Gjykata theksoi se Rumania kishte ratifikuar Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, c'ka detyronte Shtetin të mbronte fëmijët nga çdo formë abuzimi.

Në këtë rast Gjykata ishte veçanërisht e shqetësuar nga fakti se autoritetet nuk u munduan t'i zgjidhnin provat konfliktuale. Gjykata theksoi se investigimi duhet të jetë rigoroz dhe i ndjeshëm ndaj fëmijëve kur çështja përfshin dhunën ndaj një të mituri, siç ishte çështja në fjalë. Megjithatë, në këtë rast autoritetet mbajtën një qëndrim të dobët ndaj tejzgjatjes së procedurave dhe gjykatat vendase i dhanë tepër rëndësi faktit se familja nuk e raportoi që në fillim krimin në polici, dhe se viktima nuk reagoi më shpejt. Gjykata nuk pa asnjë arsye pse, neglizhenca e pretenduar e prindërve për të vënë re dhe për të raportuar abuzimin më herët në kohë, do të kishitë një ndikim të madh në gadishmërinë e policisë dhe përgjigjen e tyre ndaj fakteve të raportuara. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se, autoritetet nuk ishin të ndërgjegjshme për vulnerabilitetin e viktimës.

Në raste të tilla, Shteti krijon një detyrim sipas nenit 3 dhe 8 që kërkon që interesi më i mirë i fëmijës të respektohet. Kërkuesit të parë në këtë rast, asnjëherë nuk i ishte ofruar këshillim dhe nuk ishte shoqëruar nga një psikolog i kualifikuar gjatë

procedurave, ose pas tyre. Detyrimet pozitive që Shteti ka marrë në bazë të instrumenteve ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e fëmijës përfshijnë masat adekuate për shërim dhe riintegrim, të cilat nuk ishin të pranishme në këtë rast.

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në mungesën e efektivitetit në hetime, Gjykata vuri re se autoritetet kishin dështuar në sigurimin e detyrimeve pozitive në bazë të nenit 3 dhe 8. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 dhe 8.

Neni 41

Për shkak të vështirësive dhe vuajtjeve të pësuar nga kërkuesi i parë për shkak të hetimit joefektiv dhe ndërhyrjes në rrjedhën normale të jetës së tij private, Gjykata i akordoi kërkuesit 15,000 euro për dëmin jomaterial.

Dhuna e policëve kundër demonstruesve paqësor në vendqëndrimin e tyre dhe ligjet e papërshtatshme penale për të parandaluar në mënyrë efektive dhunën e ushtruar përbënin shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN CESTARO k. ITALISË

(Kërkesa nr. 6884/11)

7 prill 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Arnaldo Cestaro, ishte një shtetas italian që jetonte në Romë.

Më 19-21 Korrik 2001, u mbajt në Gjenova samiti i 27-të i G8. Një grup i quajtur “Forum Social i Gjenovës” (FSGJ), i krijuar nga një numër organizatash joqeveritare, ishte gjithashtu në Gjenova në të njëjtën kohë, me qëllim organizimin e një samiti alternative për antiglobalizimin. Si rrjedhojë, autoritetet italiane kishin marrë masa sigurie të larta. Në 20 dhe 21 korrik, në qytet pati incidente të tilla si përplasje me policinë. Disa qindra demonstrues dhe anëtarë të forcave të sigurisë u dëmtuan nga gazi lotsjellës.

Këshili i qytetit të Gjenovës vendosi që shkolla Diaz-Pertini të funksiononte si strehë natën për disa demonstrues. Në 20 dhe 21 korrik, banorët e zonës raportuan në polici se kishin parë të rinj të veshur me të zeza, duke hyrë në shkollë dhe duke marrë materiale nga vendndodhja e lidhur me punimet e vazhdueshme në shkollë. Pasi kontaktuan zyrtarin e FSGJ të cilit i ishte caktuar shkolla, policia vendosi të bëjë një kërkim të vendit për të siguruar prova dhe ndoshta të arrestonte të ashtuquajturit anëtarët e Black Bloc, që ishin përgjegjës për dëmtime të jashtëligjshme në qytet,

Z. Cestaro, në atë kohë 62 vjeç, ishte në katin e parë të shkollës. Kur policia arriti, ai ishte ulur, duke mbështetur kurrizin nga muri dhe me duart e ngritura lart. Ai ishte goditur disa herë, duke i shkakuar disa fraktura. Ai u operua në një spital në Gjenovë, ku ndejti për 4 ditë dhe më pas u operua sërish në një spital në Firence, disa vite pas ngjarjeve. Ai mbeti me një të metë të përhershme në krahun dhe këmbën e djathtë.

Pas 3 vitesh hetime nga Zyra e Prokurorit Publik në Gjenova, 28 individë nga forcat e sigurisë u paraqitën në gjyq. Në 13 nëntor 2009, Gjykata e Gjenovës dënoi 12 të pandehur me 2-4 vite burgim. Ata gjithashtu, bashkërisht ose veçmas me Ministrinë e Brendshme, u urdhëruan të paguanin kostot për dëmtimet dhe shpenzimet për palët, të cilave Gjykata i atribuoi shuma prej 2 500 – 50 000 eurosh. Z. Cestaro mori

një shpërblim provizor prej 35 000 eurosh. Të akuzuarit, Prokurori dhe Ministria e Brendshme, si dhe shumica e viktimave, apeluan vendimin. Gjykata e Apelit hodhi poshtë procedurat kundrejt disa prej të akuzuarve, pasi periudha e kufizimit për disa vepra kishte përfunduar. Shumica e dënimeve që përfshinin pagesa të dëmeve, kosto dhe shpenzime u miratuan. Më 2 tetor 2012, Gjykata e Kasacionit mbështeti pjesën kryesore të gjykimit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se gjatë sulmit të shkollës Diaz-Pertini, ai kishte pësuar akte dhune dhe keqtrajtimi, të cilat i konsideroi si torturë nga forcat e sigurimit, në shkellje të nenit 3. Ai gjithashtu u ankua se dënimi i dhënë ndaj atyre që ishin përgjegjës për aktet, ishte i papërshtatshëm, veçanërisht fakti se ndalimi i statutit gjatë procedurave kriminale ka rezultuar në uljen e dënimit të disa prej të dënuarve dhe në mungesë të sanksioneve disiplinore ndaj të tjerëve. Ai argumentoi se dështimi i Shtetit për të krijuar mbrojtje nga tortura dhe për të siguruar një dënim të përshtatshëm, do të thoshte se Shteti kishte dështuar në marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar dhunën dhe keqtrajtimin.

Neni 3

Në çështjen në fjalë, gjykatat vendase kanë konfirmuar tashmë se aktet dhe dhunës kanë ndodhur dhe nuk janë kontestuar. Gjykimet në shkallën e parë dhe në Apel vendosën se sapo oficerët e policisë kishin hyrë në shkollën Diaz-Pertini, ata kishin sulmuar të gjithë të pranishmit duke gjuajtur, goditur dhe kërcënuar. Kërkuesi, i cili ishte i moshuar në kohën e ngjarjes, ishte veçuar nga gjykatat e brendshme për të nxjerrë në pah mungesën absolute të proporcionalitetit midis dhunës së policisë dhe rezistencës së personave që pushtuan ambientin.

Gjykata tha se, në përcaktimin nëse një formë specifike e keqtrajtimin duhet të klasifikohet si torturë, një stigmë e veçantë duhet t'i bashkangjitet trajtimin çnjerëzor të qëllimshëm, që shkakton vuajtje serioze dhe mizore. Në çështjen në fjalë, Gjykata i dha rëndësi gjetjes së Gjykatës së Kasacionit se dhuna në shkollën Diaz-Pertini ishte kryer "për qëllime ndëshkuese, për ndëshkimin që synon të shkaktojë poshtërim dhe vuajtje fizike dhe mendore ndaj viktimës". Gjithashtu u konfirmua se kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë rezistencë dhe se keqtrajtimi i ishte shkaktuar në mënyrë të pajustificueshme dhe nuk mund të konsiderohej si proporcional. Kërkuesi ishte goditur me trungje, të cilat mund të ishin potencialisht vdekjeprurëse dhe rezultuan me pasojë të rënda fizike. Për më tepër, ndjenjat e frikës dhe ankthit të kërkuesit nuk duhet të nënvlerësohen, pasi ai u zgjua nga zhurma e shkaktuar nga policia që

sulmonte ndërtesën. Ai gjithashtu pa që protestuesit e tjerë u rrahën nga oficerët e policisë për asnjë arsye të dukshme, gjë që do të shkaktonte ndjenja të mëtejshme të frikës dhe ankthit.

Gjykata gjithashtu nuk mund të injoronte faktin se policia u mundua të fshihte ngjarjet në fjalë ose u mundua t'i justifikonte ato në bazat e deklaratave mashtruese. Në gjykimin e Apelit, u përmend se rezistenca e njerëzve që kishin pushtuar vendin, një sulm me thikë ndaj një oficeri dhe zbulimi i 2 koktejeve Molotov, ishin të gjitha të sajara. Këto fakte u paraqitën nga policia në mënyrë që të justifikoheshin sulmi ndaj shkollës dhe dhuna e përdorur ndaj pushtuesve.

Gjykata përsëriti se, kur një kërkesë e diskutueshme për keqtrajtim të paligjshëm nga policia ose ndonjë agjent tjetër i shtetit është ngritur, Shteti ka një detyrë të përgjithshme për të hetuar në mënyrë efektive ngjarjen. Kur procedurat fillojnë para gjykatave të brendshme, procedurat në tërësi duhet të jenë në përputhje me imperativin e ndalimit të përcaktuar në nenin 3. Kjo do të thotë se gjykatat kombëtare nuk duhet të lejojnë sulmet ndaj integritetit fizik dhe moral të individëve për të mos u ndëshkuar, në mënyrë që të ruajnë besimin e publikut. Gjykata deklaroi se, në rastet që kanë të bëjnë me torturën ose keqtrajtimin e shkaktuar nga agjentët shtetërorë, procedurat penale nuk duhet të ndërpriten për shkak të një periudhe kufizimi dhe amnistisë apo faljet nuk duhet të tolerohen.

Në çështjen në fjalë janë ngritur tri pika kryesore: dështimi për të identifikuar ata që janë përgjegjës për keqtrajtimin, ndalimin e statutit të disa prej veprave penale dhe heqjen e pjesësme të dënimeve, si dhe dyshimet për masat disiplinore të marra kundër atyre që janë përgjegjës për keqtrajtimin. Oficerët e policisë që sulmuan kërkuesin dhe e nënshtuan atë drejt torturës, nuk u identifikuan dhe mbetën pa u ndëshkuar. Disa zyrtarë të rangut të lartë dhe të mesëm u ndoqën dhe u përpoqën për vepra penale në lidhje me sulmin e shkollës Diaz-Pertini. Megjithatë, veprat penale të tilla si shpifje, shpërdorim të autoritetit publik, lëndime të thjeshta trupore dhe lëndime të rënda trupore, u parashtruan para vendimit të apelit dhe shumë të tjerë pranuan dërgesa të dënimeve të tyre. Prandaj, Gjykata konstatoi se legjislacioni penal italian i aplikuar në këtë rast ishte i papërshtatshëm përse i përket kërkesës për të ndëshkuar aktet e torturës dhe pa ndonjë efekt parandalues për të parandaluar shkeljet e ardhshme të nenit 3. Gjykata deklaroi se përgjigjja e autoriteteve nuk ishte e kënaqshme në rastin në fjalë dhe si rezultat, ishte e papajtueshme me obligimet e tyre procedurale sipas nenit 3. Për më tepër, ata që ishin përgjegjës për veprimet e torturës nuk u pezulluan nga detyrat e tyre gjatë procedurës penale.

Bazuar në faktet e ngjarjes, Gjykata deklaroi se masat e marra nga autoritetet vendase nuk plotësonin kriterin për një hetim të plotë dhe efektiv. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se shkelja e nenit 3 nuk mund të rregullohet vetëm duke kompensuar viktimën. Në çështjen në fjalë, Gjykata deklaroi se kishte shkelje të nenit 3, bazuar në torturën e ushtruar mbi kërkuesin.

Neni 41

Duke pasur parasysh kompensimin e marrë nga kërkuesi në nivel të brendshëm, Gjykata i akordoi kërkuesit 45,000 euro për dëmin jomaterial.

Dështimi në mbrojtjen e individëve nga dhuna me motive fetare dhe mungesa e hetimeve efektive përbën shkelje të neneve 3 dhe 9

VENDIMI I GJYKATËS PËR ÇËSHTJEN E ASAMBLESË GLDANI TË DËSHMITARËVE TË JEHOVAIT DHE TË TJERË kundër GJEORGJISË

(Kërkesa nr. 71156/01)

3 maj 2007

1. Faktet kryesore

Kërkesit ishin 97 anëtarë të Asamblesë Gldani të Dëshmitarëve të Jehovahit, së bashku me Z. Vladimer Kokosadze dhe tre të tjerë, që gjithashtu ishin anëtarë të Asamblesë dhe jetonin në Tbilisi. Z. Kokosadze ishte gjithashtu zëdhënësi i Asamblesë. Çështja lidhet me një sulm të 17 tetorit 1999 ndaj Asamblesë, nga një grup besimtarësh ortodoksë, të udhëhequr nga Basil Mkalavishvili, i njohur ndryshe si "At Basili".

At Basili ishte një prift i shkarkuar në Kishën Ortodokse të Gjeorgjisë. Më herët ishte akuzuar për akte të agresionit fizik ndaj anëtarëve të Kishës Ortodokse, për fyerje ndaj Patriarkut Katolik të Gjeorgjisë, si dhe mburrej në mediat gjeorgjiane se do të organizonte sulme kundër Dëshmitarëve të Jehovahit. Në 17 tetor 1999, dhjetëra individë të identifikuar nga kërkesit si një grup mbështetësish të At Basilit, rrethuan dhe hynë në teatrin ku po zhvillohej mbledhja e 120 anëtarëve të Asamblesë. Grupi i mbështetësve të At Basilit hyri në mbledhje duke bërë turrë dhe duke valëvitur shkopa dhe kryqe të mëdhenj prej hekuri. Sulmi ishte filmuar nga një prej mbështetësve të At Basilit. Disa anëtarë të Asamblesë mundën të arratiseshin, por rreth 60 prej tyre mbetën të bllokuar në korridor, përfshirë këtu gra dhe fëmijë. Më pas grupi vijoi t'i sulmonte anëtarët duke i gjuajtur me grushta dhe shqelma, si dhe duke i goditur me shkopat dhe kryqet. Disa prej grave u tërhoqën nga flokët dhe u shtrinë në dysheme ose u shtynë nga shkallët dhe u goditën me rrip. Prej sulmit, 16 persona u shtruan në spital.

Kur anëtarët e Asamblesë më në fund arritën të largoheshin nga korridori, ata u rrethuan nga një tjetër grup mbështetësish të At Basilit, të cilët i bënë kontroll dhe i hodhën simbolet e besimit të tyre në një zjarr të madh. Disa prej individëve që arritën t'i shpëtonin sulmit, u munduan të njoftonin policinë dhe disa të tjerë shkuan në stacionin e policisë. Oficerët e policisë regjistruan deklaratën e një prej kërkesve, por vendosën të mos ndërhyjnë; një tjetër kërkesi iu tha nga Drejtori i stacionit të policisë se "Po të ishte në vend të sulmuesve, do ti kishte bërë akoma më keq dëshmitarëve të Jehovahit". Megjithatë, policia më në fund shkoi në vendin e ngjarjes, por nuk mundi të arrestonte askënd.

Ditën tjetër, regjistrimet e sulmit nga grupi i At Basilit, ku anëtarët ishin lehtësisht të identifikueshëm, u nxorrën në kanalet televizive kombëtare. Një ditë pas sulmit, 42 kërkues depozituan kërkesat e tyre në autoritetet përkatëse. Nisën procedurat penale, por vetëm 11 kërkues u njohën si palë civile në çështje, 31 të tjerët nuk morën asnjëherë një përgjigje për kërkesat e ngritura. Çështja u transferua në departamente të ndryshme të Prokurorisë si dhe u pezullua në momente të ndryshme, me pretendimin se ishte e pamundur të identifikoheshin autorët e sulmit. Pas një parade identifikimi të organizuar nga hetuesi i policisë, u identifikuan 2 nga sulmuesit.

Rasti u transferua mes departamenteve të ndryshme të prokurorisë, si dhe u pezullua në disa raste, me pretendimin se ishte e pamundur të identifikoheshin autorët e sulmit. Pas një parade identifikimi, të organizuar nga hetuesi i policisë, u identifikuan dy sulmues. Kërkuesi në fjalë u vu më pas nën vëzhgim dhe nuk u ndërmor asnjë veprim për të vazhduar identifikimin e sulmuesve. Kërkuesi u dërgua në gjyq me dy mbështetës të At Basil, ku u dënua për kryerje të veprimeve që rrezikonin rendin publik, ndërsa akuza kundër dy mbështetësve të At Basilit u dërgua për hetime të mëtejshme, të cilat përfunduan kurrë. Rrjedhimisht, kërkuesi u la i lirë.

Nga tetori i vitit 1999 deri në nëntor 2002, u kryen 138 sulme të dhunshme kundër Dëshmitarëve të Jehovahit dhe 784 ankesa u paraqitën tek autoritetet gjeorgjiane. Në vitet 2000 dhe 2002, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komiteti i OKB kundër Torturës dhe disa OJQ u dënuan sulmet kundër pakicave fetare në Gjeorgji, veçanërisht kundër Dëshmitarëve të Jehovahit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan se ishin sulmuar nga një grup besimtarësh ortodoksë ekstremistë dhe se asnjë hetim efektiv nuk ishte kryer në këtë drejtim. Ata u mbështeten në nenin 3 (ndalimi i torturës), nenin 9 (e drejta për lirinë e mendimit, e ndërgjegjes dhe fesë), nenin 10 (liria e shprehjes), nenin 11 (liria e tubimit dhe organizimit), nenin 13 (e drejta për ankim efektiv), dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit).

Neni 3

Gjykata vuri në dukje se neni 3 i Konventës hyn në terma absolutë, që do të thotë se nuk mund të përjashtohet. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se për të zbatuar nenin 3, keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë që vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit. Neni 1 në lidhje me nenin 3 kërkon që Shtetet të marrin masa për të siguruar që asnjë individ në juridiksionin e tyre, nuk i nënshtrohen torturës ose trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtërues, madje edhe kur janë

në duart e individëve privatë. Kjo mbrojtje kërkon masa të arsyeshme dhe efektive, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me fëmijët dhe individë të tjerë vulnerabël. Neni 3 gjithashtu shkakton një detyrim pozitiv për të kryer një hetim zyrtar, të menjëherëshëm dhe efektiv, sapo të dorëzohet një ankesë zyrtare.

Në këtë rast Gjykata vuri në dukje se sulmi ishte drejtuar kundër të gjithë anëtarëve të Asamblesë që po mblidheshin në teatër për qëllime fetare. Gjykata më tej vuri në dukje se, prej kërkuesve të cilët u sulmuan, vetëm disa prej tyre paraqitën prova të përshtatshme për të provuar se kishin përjetuar trajtim të supozuar në kundërshtim me nenin 3. Qeveria asnjëherë nuk i kundërshtoi faktet e paraqitura nga këta kërkues me dëshmi të përshtatshme dhe duke pasur parasysh trajtimin që u shkaktua në 25 kërkues, Gjykata konsideroi se trajtimi arriti pragun e trajtimit çnjerëzor në kuptim të nenit 3. Për më tepër, Qeveria nuk e kundërshtoi faktin se qëllimi i sulmuesve ishte të poshtëronin publikisht kërkuesit, në mënyrë që të nxisnin ndjenjat e terrorit dhe inferioritetit që ata të mos mbanin më mbledhje fetare në përputhje me besimin e tyre. Gjykata gjithashtu i kushtoi rëndësi faktit se sulmi ishte filmuar nga një anëtar i grupit të sulmuesve, me qëllim që t'ia shfaqnin të tjerëve.

Gjykata vuri në dukje se dosja e çështjes përmbante dëshmi të qëndrueshme në lidhje me refuzimin nga ana e punonjësve të policisë, pasi u njoftuan për sulmin, për të ndërmarrë veprime menjëherë për t'i dhënë fund dhunës dhe për të mbrojtur viktimat. Ditën pas sulmit, 42 kërkues i paraqitën ankesat prokurorit në Tbilisi. Prokuroria filloi punën vetëm për 11 kërkues, ndërkohë që asnjë përgjigjë nuk iu dha 31 kërkuesve të tjerë, të cilët kishin paraqitur të gjitha detajet specifike të abuzimit fizik që kishin pësuar. Çështjet e 11 aplikantëve u transferuan disa herë ndërmjet departamenteve të ndryshme të prokurorisë, pa asnjë shpjegim. Edhe më tronditës ishte pohimi se ishte e pamundur të kryheshin hetimet për shkak të mosidentifikimit të autorëve, pavarësisht nga dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe videove të sulmit. Gjykata vuri në dukje se, policia kishte refuzuar të ndërhynte menjëherë, kërkuesit ishin përballur me indiferencën ndaj kërkesave të tyre, si dhe se autoritetet përkatëse kishin refuzuar të zbatonin ligjin, rastin e tyre.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet e mësipërme, Gjykata konstatoi se shteti gjeorgjian kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit të tij pozitiv për të mbrojtur 42 paditësit nga keqtrajtimi dhe për të hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim sipas nenit 3. Në të kundërt, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 3 në lidhje me 16 kërkuesit që u arratisën nga sulmi dhe 37 të tjerë të cilët nuk u ankuan tek autoritetet për trajtimin ndaj të cilit ishin nënshtruar.

Neni 9

Liria e besimit e mbrojtur nga neni 9, është një nga themelet e një shoqërie demokratike dhe pjesëmarrja në jetën e një bashkësie fetar bie nën juridiksionin e neni 9. Roli i shtetit është të mbrojë rendin publik dhe harmoninë fetare, si dhe të promovojë tolerancën në një shoqëri demokratike. Kur ushtron fuqinë e tij rregullatore, si dhe marrëdhëniet e tij me fetë dhe besimet, shteti ka për detyrë të mbetet neutral dhe i paanshëm. Në këtë rast autoritetet, për shkak se e shihnin aderimin e kërkuësve në një bashkësi fetar, si një kërcënim për ortodoksinë e krishterë, nuk morën masa lidhur me ankesat e tyre. Sulmi kundër kërkuësve përbënte veprimin e parë të agresionit në shkallë të gjerë kundër Dëshmitarëve të Jehovait dhe neglizhenca e autoriteteve hapi dyert për një përgjithësim të dhunës fetare nga i njëjti grup sulmuesish. Gjykata konstatoi se nëpërmjet pasivitetit të tyre, autoritetet relevante nuk kryen detyrën e tyre për t'i mundësuar bashkësisë fetare të kërkuësve ushtrimin lirisht të të drejtave të tyre për lirinë e besimit. Gjykata konstatoi shkelje të neni 9 në lidhje me 96 kërkuësit.

Neni 10 and 11

Gjykata gjeti që kërkesat sipas këtyre dispozitave ishin identike me ato të parashtruara sipas neni 3 dhe 9 kështu që nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin më vete.

Neni 13

Gjykata konstatoi se asnjë çështje e veçantë nuk ishte ngritur në bazë të neni 13.

Neni 14

Trajtimi i përshkruar në neni 14 është diskriminues nëse “mungon një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm”. Bazuar në të gjitha provat në këtë rast, Gjykata konstatoi se refuzimi nga ana e policisë për të ndërhyrë menjëherë në vendngjarje për të ndaluar dhunën, si dhe indiferenca e mëvonshme ndaj kërkuësve nga autoritetet përkatëse, ishte e lidhur me bindjet fetare të kërkuësve. Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë justifikim në lidhje me këtë trajtim diskriminues të kërkuësve. Si rezultat, Gjykata konstatoi se kërkuësit ishin viktimë të shkeljes së neni 14 në lidhje me neni 3 dhe 9.

Neni 41

Gjykata e pa të përshtatshme t'i jepte ankuesve dëmshpërblim jomaterial. Megjithatë, në varësi të kërkesës së secilit kërkuës, atyre iu dhanë shuma të ndryshme

duke filluar nga 120 deri në 700 euro. Përsa i përket shpenzimeve dhe kostove, Gjykata e pa të përshtatshme të jepte dëmshpërblime vetëm për kërkuesit që kanë pasur përfaqësues ligjor në çështjet e tyre.

Dështimi i Kroacisë në mbrojtjen e një personi me aftësi të kufizuara nga ngacmime të dhunshme të përsëritura cenon nenet 3 dhe 8 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ĐORĐEVIĆ K. KROACISË

(Kërkesa nr. 41526/10)

24 korrik 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi i parë, Dalibor Đorđević është shtetas kroat lindur në 1977 dhe kërkuesja e dytë Radmila Đorđević është mamaja e tij e lindur në 1956. Kërkuesi i parë vuante nga aftësi të kufizuara fizike dhe mendore dhe jetonte me nënën e tij në një banesë në katin e parë. Të dy kërkuesit u ankuan se mes korrikut 2008 dhe shkurtit 2011 ishin ngacmuar vazhdimisht nga nxënësit e një shkolle fillore aty pranë për shkak të aftësisë së tij të kufizuar dhe origjinës serbe, si edhe se autoritetet nuk i kishin mbrojtur siç duhet ata. Gjatë kësaj periudhe u regjistruan një sërë incidentesh, me fëmijët të cilët i binin ziles së derës familjes në çdo kohë, pështynin mbi kërkuesin e parë, duke e goditur dhe shtyrë sa andej këndeje, duke i djegur duart e tij me cigare, duke bërë vandalizma në ballkonin e kërkuesve dhe duke shfryrë sharje mbi ta.

Këto sulme e kishin shqetësuar së tepërmi kërkuesin e parë, duke i shkaktuar frikë dhe ankth. Në shumë raste ata u ankuan në autoritete të ndryshme, duke përfshirë si shërbimet sociale ashtu dhe Avokatin e Popullit për Personat me Aftësi të Kufizuar. Ata gjithashtu lajmëruan shumë herë policinë për të raportuar incidentet dhe për të kërkuar ndihmë. Por, pas çdo lajmërimi policia ndonjëherë mbërrinte shumë vonë në vendngjarje dhe herë të tjera vetëm për t'u thënë fëmijëve të shpërndaheshin apo të ndalonin së bëri zhurmë.

Ata gjithashtu intervistuan disa prej nxënësve dhe arritën në përfundimin se, edhe pse ata kishin pranuar se ka pasur sjellje të dhunshme ndaj kërkuesit të parë, ata ishin shumë të rinj për të mbajtur përgjegjësi penale.

Në tetor të vitit 2009 dhe maj 2010, avokatja e kërkuesve i shkroi zyrës së Prokurorisë së Rrethit, lidhur me ngacmimet e shumta dhe të vazhdueshme, duke u ankuar se nuk kishte mjet ligjor efektiv në ligjin kroat për mbrojtjen e personave nga veprimet e dhunshme të kryera nga fëmijët. Ajo gjithashtu u ankua tek Avokatja e Popullit dhe kërkoi këshilla, e cila u përgjigj se nuk kishte juridiksion në këtë çështje. Shërbimet sociale informuan nënën se do të duhej të ndërmerrej një padi civile. Policia u shpreh se një hetim i tillë nuk do të jepte rezultate. Prokuroria e deklaroi se nuk kishte juridiksion në këtë çështje.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan *inter alia* se shteti nuk iu tha atyre mbrojtjen e duhur ndaj ngacmimeve dhe për rrjedhojë u janë shkelur të drejtat e garantuara nga nenet 2, 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës.

Neni 3

Gjykata vendosi t'i konsiderojë incidentet si një situatë e vazhdueshme. Incidentet ishin të mirë regjistruara dhe ndikuan në shëndetin mendor dhe fizik të kërkuesit të parë, të përshkruar si një person paqësor i paaftë për të mbrojtur veten. Gjykata vlerësoi se efektet e një ngacmimi të vazhdueshëm verbal dhe fizik i cili ka ndodhur për një periudhë të gjatë kohe është një fakt i mjaftueshmërisht serioz për t'u kualifikuar në fushëveprimin e nenit 3 të Konventës.

Gjykata vërejti se aktet e dhunës kundër kërkuesit të parë, të cilat vijnë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, duhet normalisht të gjenin zgjidhje përmes zbatimit të dispozitave penale kundër atyre, që i kanë kryer. Megjithatë, në çështjen konkrete objekt gjykimi, pjesa më e madhe e autorëve të keq trajtimeve ishin fëmijë nën 14 vjeç të cilët në bazë të legjislacionit vendas ishte e pamundur të procedoheshin penalisht. Për më tepër, ka probabilitet, që asnjë nga veprat konkrete të ndërmarra prej tyre nuk përbënte veprë penale në vetvete, por pavarësisht kësaj në tërësinë e tyre incidentet dhe ngacmimet janë të pa pajtueshme me kërkesat e nenit 3 të Konventës.

Megjithatë, që nga korriku i vitit 2008, nëna e kërkuesit të parë kishte informuar policinë, Avokaten e Popullit dhe shërbimet sociale për këtë ngacmim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë, autoritetet kishin qenë të vetëdijshëm për situatën.

Ndërsa policia kishte marrë në pyetje disa fëmijë rreth incidenteve, ata nuk kishin bërë përpjekje serioze për të vlerësuar se çfarë po ndodhte në të vërtetë. Raportet e hartuara nuk ishin ndjekur nga ndonjë veprim konkret. Gjatë kësaj kohe nuk ishte marrë asnjë vendim për të miratuar ndonjë mekanizëm monitorues me qëllim për të njohur dhe parandaluar ngacmime të mëtejshme. Mungesa e ndonjë përfshirjeje të vërtetë të shërbimeve sociale dhe mungesa e këshillimit për kërkuesin e parë ishte veçanërisht e habitshme. Përveç përgjigjeve ndaj incidenteve specifike, asnjë autoritet nuk kishte ndërmarrë veprime relevante të natyrës së përgjithshme, pavarësisht dijenisë së tyre se kërkuesi i parë ishte vënë në shënjestër në mënyrë sistematike dhe se abuzimi i ardhshëm ka qenë mjaft i mundshëm. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me Dalibor.

Neni 8

Në kuadër të nenit 8, shtetet jo vetëm që duhet të mos cenojnë të drejtën e individëve, por kanë detyrë të marrin masa për t'i mbrojtur ata nga të tjerët. Jeta private dhe familjare e kërkuesses së dytë ishte ndikuar negativisht nga këto incidente. Në të njëjtën mënyrë që autoritetet kishin dështuar në marrjen e masave përkatëse për të parandaluar keqtrajtimin e mëtejshëm të djalit të saj, ata nuk kishin mbrojtur kërkuessen e dytë duke shkelur kështu garancitë e nenit 8 të Konventës.

Neni 14

Procese të brendshme mund të ishin nisur në referim të ligjit kroat për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili kishte dispozita specifike mbi origjinën etnike dhe aftësinë e kufizuar. Kjo mbrojtje garantohej gjithashtu nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane. Kështu këto mjete u konsideruan efektive. Meqenëse nuk ishin shteruar ankimi i kërkuesses në kuadër të nenit 14 u konsiderua i papranueshëm.

Gjykata vlerëson se një veprim, që parashikohet nga ligji kroat kundër diskriminimit përbën një mjet ankimi efektiv zbatimi në mënyrën e duhur i të cilit do të kishte vërejtur shkeljen e ndodhur dhe do të kishte caktuar një dëmshpërblim kërkuesses. Në rast se ankimi i kërkuesses nuk ishte i suksesshëm përpara gjykatave të zakonshme ata duhet të kishin pasur mundësi të bënin një ankim kushtetues, si edhe Gjykata Kushtetuese duhet të kishte shqyrtuar këtë ankim. Megjithatë, kërkuessit dështuan në përdorimin e mjeteve të ankimit që kishin në dispozicion.

Neni 13

Meqenëse kishte qenë e pamundur që kërkuessit të ankoheshin për keqtrajtimin, u konkludua se kjo e drejtë ishte shkelur në lidhje me nenet 3 dhe 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata iu akordoi kërkuesses 11,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial, si edhe 3,856 euro për shpenzimet gjyqësore.

Kushtet e papërshtatshme të ndalimit dhe trajtimi mjekësor i kërkuesit vinin në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN DYBEKU k. SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 41153/06)

18 dhjetor 2007

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Ilir Dybeku, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1971 dhe që në kohën e vendimit të Gjykatës vuante dënimin në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit. Prej vitit 1996 e në vazhdim kërkuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake dhe për shumë vite ai ka qenë i shtruar për kurim në disa spitale psikiatrike në Shqipëri.

Më 23 gusht 2002 si pasojë e një shpërthimi që ndodhi në apartamentin e motrës së kërkuesit, mbetën të vdekur tre persona, dy nga të cilët fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe disa persona të tjerë u plagosën. Më 24 gusht 2002, një ditë pas ngjarjes, ndaj kërkuesit u bë një kallëzim penal dhe po atë ditë ai u arrestua dhe u akuzua për veprën penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të lëndëve eksplozive. Ai u ndalua në dhomat e paraburgimit në Komisariatin e Policisë së Durrësit, në një qeli me disa të paraburgosur të tjerë.

Në 27 maj 2003 duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i Z. Dybeku ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Rrethit Durrës vendosi, që kërkuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Për rrjedhojë kjo gjykatë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Në shtator 2003 dhe mars 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. As Apeli as Gjykata e Lartë nuk e pranuan kërkesën e kërkuesit për një ekzaminim të ri mjekësor, duke konkluduar se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspertë të paanshëm në përputhje me garancitë procedurale.

Prej dhjetorit 2003 kërkuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij. Gjatë qëndrimit në këto burgje Z. Dybeku ndau qelinë me bashkë të burgosur të tjerë, të cilët gëzonin shëndet të plotë dhe u trajtua njësoj si ata. Në bazë të deklaratave të autoriteteve shqiptare, në pamundësi për t'i garantuar kërkuesit trajtimin mjekësor, që i nevojitej, atij i ishin dhënë barna të ngjashme me ato të parashikuara nga mjeku i tij. Z. Dybeku u shtrua në Spitalin e Burgut të Tiranës vetëm në dy raste kur shëndeti i tij ishte përkeqësuar ndjeshëm, nga 26 maji 2004 deri më

2 qershor 2004 dhe nga 1 dhjetori 2004 deri më 26 janar 2005. Ankesat e babait dhe avokatit të Z. Dybeku kundër administratës dhe stafit mjekësor të spitalit të burgut për pakujdesi dhe trajtim mjekësor jo të përshtatshëm, nuk u morën parasysh nga autoritetet.

Duke pasur parasysh gjendjen gjithnjë e më të shqetësuar të kërkuesit, më 7 janar 2005, avokati i tij nisi një procedurë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për të kërkuar lirim-in ose transferimin në një institucion mjekësor, me arsyetimin se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Bazuar në raportet e fundit mjekësore, avokati i kërkuesit kërkoi gjithashtu që të kryhen ekzaminime psikiatrike. Kjo kërkesë ashtu si dhe akimet në gjykatat më të larta u refuzuan.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua, në veçanti, se kushtet e paraburgimit dhe trajtimi mjekësor që ai kishte marrë në burg nuk ishin të përshtatshme duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore. Ai gjithashtu u ankua për prarregullsi procedurale lidhur me ankesat e tij.

Neni 3

Gjykata vërejti se gjendja psikologjike e kërkuesit e bënte atë më vulnerabël se të paraburgosurit e tjerë, duke i shkaktuar atij ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Fakti që autoritetet shqiptare pranuan se kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë me të burgosurit e tjerë pavarësisht gjendjes së tij të veçantë, tregoi se autoritetet shqiptare kanë dështuar në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta.

Sipas Gjykatës autoritetet shqiptare nuk ofruan informacion të detajuar mbi kushtet e burgimit të kërkuesit, dhe as provuan që gjendja e tij mendore ishte e përshtatshme për të qëndruar në të njëjtin ambient me gjithë të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se vizitat periodike të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të konsiderohen si zgjidhje efektive përderisa Z. Dybeku ishte duke kryer një dënim të përjetshëm. Gjykata vërejti se shumë nga mangësitë e vëna re mund të ishin rregulluar edhe në mungesë të mjeteve financiare të konsiderueshme. Sipas Gjykatës, mungesa e një trajtimi të tillë, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të Z. Dybeku nuk mund të justifikohet.

Gjykata, duke marrë në konsideratë efektet kumulative të kushteve krejtësisht të papërshtatshme të burgimit të cilave kërkuesi iu ishte nënshtruar, sidomos natyrën,

kohëzgjatjen dhe ashpërsinë e keqtrajtimit, të cilat në mënyrë të qartë kishin pasoja të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tij, duke iu referuar ra-portit të Komitetit të Parandalimit të Torturës në Këshillin e Evropës, si dhe jurisprudencës së saj të mëparshme, arriti në përfundimin se trajtimi i kërkuesit kishte qenë çnjerëzor dhe degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës.

Neni 6

Gjykata u shpreh se ankimet e kërkuesit në kuadër të nenit 6, lidhur me procedurat e ekzekutimit të dënimeve, ishin të papranueshme.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 5,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial.

Bashkëpunimi i autoriteteve maqedonase në rrëmbimin e kërkuarit - përbën shkelje të nenit 3 të Konventës

VENDIMI DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN EL-MASRI k. ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

(Kërkesa nr. 39630/09)

13 dhjetor 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuari, Khaled El-Masri, është shtetas gjerman i cili ka lindur më 1963, dhe jeton në Senden në Gjermani.

Në dhjetor 2003, kërkuari u nis për pushime me autobus drejt Shkupit. Në kufirin serbo-maqedonas, autoritetet kufitare patën dyshime për shkak se kërkuari kishte një pasaportë gjermane të sapo lëshuar. Autoritetet kontrolluan sendet e tij personale dhe kërkuari u mor në pyetje, për rreth shtatë orë, në lidhje me lidhjet e tij të mundshme me disa organizata islamike. Pas marrjes në pyetje ai u çua me makinë në hotelin që kishte prenotuar, i shoqëruar nga njerëz të armatosur në veshje civile. Pas mbërritjes në hotel, kërkuari u mbajt i ndaluar jo-zyrtarisht dhe u mor në mënyrë të përsëritur në pyetje në anglisht, gjuhë të cilën ai nuk e zotëronte. Kërkuari u informua se ai do të kthehej në Gjermani nëse ai nënshkruante një dëshmi si anëtar i Al-Kaedës. Pas u mbajt dhjetë ditë në këto kushte, kërkuari filloi një grevë urie, dhe u çua në aeroportin e Shkupit, i prangosur dhe me sy të lidhur.

Në aeroport, kërkuari u informua se do t'i nënshtrohej një "kontrolli mjekësor" dhe menjëherë pas kësaj iu tërhoqën dhe iu mbajtën krahët pas shpine dhe filluan ta rrihnin. Pas kësaj ai u përplas në dysheme dhe një çizme mbi shpinë e detyronte të rrinte ashtu. Kërkuarit i futën një objekt të fortë në anus. Atij i mbuluan kokën me një kapuç dhe e hipën në një avion, i cili në aeroport ruhej nga forcat e armatosura maqedonase. Në avion kërkuarin e mbajtën të prangosur dhe të lidhur me zinxhirë në paretet e avionit. Në pasaportën e tij u vu një vulë dalje nga Maqedonia. Kërkuarin e çuan në Afganistan pas një ndalese në Irak. Ai u mbajt në një qendër paraburgimi për terroristë me rrezik të lartë, dhe në mars 2004, ai filloi një grevë urie, për shkak se po mbahej i ndaluar pa asnjë akuzë.

Në prill 2004, disa persona të maskuar e ngritën me forcë nga shtrati, e lidhën në një karrige dhe e ushqyen me forcë me anë të një tubi. Më pas kërkuarit iu dhanë ushqime konservash dhe disa libra. Ushqyerja me forcë i shkaktoi probleme shëndetësore

kërkuesit, i cili mori edhe mjekim për këtë qëllim. Në maj 2004, kërkuesit iu lidhën përsëri sytë dhe iu vunë prangat, u urdhërua të vishte rrobat që kishte pasur kur kishte udhëtuar drejt Shkupit, dhe e hipën në një tjetër avion.

Kërkuesi u dërgua në Shqipëri, pa iu thënë fillimisht se ku ishte. Kur më në fund u lirua atij iu tha se ishte në Shqipëri dhe pasi i vendosën një vulë dalje nga Republika e Shqipërisë në Aeroportin Nënë Tereza, e hipën në një avion drejt Frankfurtit. Kur ai arriti në Gjermani ai peshonte 18 kg më pak nga pesha që kishte pasur kur u nis, vuante nga çrregullime mendore dhe u diagnostikua me çrregullime stresi post-traumatike, që mund të ishin shkaktuar nga torturat dhe keqtrajtimet që ai pretendonte se kishte pësuar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte përgjegjëse për keqtrajtimin e tij duke shkelur kështu të drejtat e garantuara nga nenet 3, 5, 8, 10 dhe 13 të KEDNJ-së.

Qeveria mohoi çdo përgjegjësi për keqtrajtimin e aplikantit dhe kontestoi vërtetësinë e raporteve të ekspertëve për shëndetin e tij mendor.

Qeveria më tej pretendoi se, megjithëse hetimi penal sipas pretendimeve të kërkeusit kishte qenë joefektiv, kjo situatë i atribuohet vonesës së kërkuesit në paraqitjen e ankesës dhe faktit se ai kishte ngritur akuzë ndaj një autori të pidentifikuar.

Pala e tretë argumentoi se e drejta për të vërtetën në rastet e zhdukjes me forcë janë përfshirë në Konventë si pjesë e neneve 2, 3 dhe 5 dhe më tej janë mishëruar në nenin 13. Më tej, u argumentua se taktikat e jashtëzakonshme të dorëzimit, për të cilat ankohej kërkuesi ishin një shkelje e parimit të *non-refoulement* sipas të drejtës ndërkombëtare.

Çështja i kaloi në juridiksion Dhomës së Madhe në zbatim të nenit 30 të Konventës.

Neni 3

Gjykata kujtoi se e drejta për të mos u torturuar, sipas nenit 3, është një nga të drejtat më themelore në një shoqëri demokratike. Për këtë arsye është absolutisht e detyrueshme për Shtetet që të hetojnë çdo akuzë për një trajtim në kundërshtim me nenin 3. Gjykata theksoi se ky detyrim pozitiv për të hetuar akuza të tilla lind nga një lexim i përbashkët i neneve 3 dhe 1 të Konventës. Gjykata theksoi se pa hetime

efektive, të afta për të identifikuar autorët e akteve të tilla, të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga neni 3 do të jenë të paefektshme në praktikë, dhe persona me autoritet shtetëror do të mundën që, pa u ndëshkuar, të shkelin të drejtat që neni 3 iu garanton personave në kontrollin e tyre. Për këtë arsye, hetimi duhet të jetë i menjëhershëm, i plotë dhe i pavarur nga ekzekutivi.

Kërkuesi kishte bërë një kallëzim penal në prokurori në tetor 2008 për bashkëpunim të agjentëve shtetërorë në dorëzimin dhe keqtrajtimin e tij. Pretendimet e tij mbështeteshin edhe nga prova plotësuese, të tilla si raporte të mediave të besueshme dhe hetime të tjera të huaja. Pas kallëzimit të kërkuesit, prokurori nuk bëri asgjë më shumë sesa një kontakt me Ministrinë e Brendshme dhe për këtë arsye nuk mund të justifikohet hedhja poshtë e pretendimit të kërkuesit për mungesë provash. Qeveria pranoi se hetimi në lidhje me ankesën e kërkuesit nuk ka qenë efektiv. Gjykata u shpreh se duhet luftuar pandëshkueshmëria e Shteteve të përfshira në abuzime të rënda të të drejtave të njeriut. Në këto kushte ajo vendosi se kërkuesi ishte privuar nga llogaridhënie e arsyeshme mbi çka i kishte ndodhur atij, dhe arsyet përkatëse.

Përveç kësaj, trajtimi i z. El-Masri nuk mund të justifikohet në bazë të sigurisë kombëtare, apo luftës ndaj terrorizmit. Gjykata theksoi se ndalimi i torturës ngelet një e drejtë absolute. Prandaj, Gjykata përsëriti se dështimi i autoriteteve për të marrë hapa të arsyeshëm për shmangien e rrezikut të keqtrajtimin për të cilin Shteti kishte dijeni, ose duhej të kishte dijeni, mund të fusë në veprim nenin 3. Edhe pse nuk i ishte nënshtruar dhunës fizike ndërsa mbahej në hotel në Shkup, Gjykata vërejti se neni 3 nuk i referohet ekskluzivisht vuajtjeve fizike. Izolimi i zgjatur i kërkuesit ishte i tillë sa i kishte shkaktuar atij shqetësime emocionale dhe ankth psikologjik. Kërkuesi ishte vendosur qëllimisht në një situatë ankthi të vazhdueshëm për shkak se autoritetet synonin që ai të rrëfehej. Autoritetet nuk kishin qenë në gjendje të jepnin ndonjë shpjegim për një trajtim të tillë. Kështu, Gjykata u shpreh se kushtet në hotel ishin aq të rënda sa të përbënin shkelje të nenit 3.

Gjykata vlerësoi se edhe keqtrajtimi i kërkuesit në aeroportin e Shkupit ishte gjithashtu nën përgjegjësinë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Veprimet që agjentët e huaj ndërmorën me dijeninë apo pranimin e autoriteteve maqedonase i ngarkohen Shtetit palë në këtë çështje. Ashpërsia e keqtrajtimin nuk mund të justifikohet, pasi agjentët ishin qartazi më të shumtë në numër sesa kërkuesi dhe ai nuk përbente asnjë rrezik për ta. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se zhveshja me forcë nga policia, e bërë në mënyrë krejt arbitrare synonte ta poshtëronte kërkuesin. Për më tepër transferimi i Z. El-Masri në duart e agjentëve të CIA-s nuk është bërë në kuadrin e një kërkese zyrtare dhe të ligjshme për ekstradim. Sipas të dhënave në dispozicion të Gjykatës, autoritetet maqedonase e njihnin destinacionin e avionit në

të cilin kërkuesi ishte detyruar të hipte. Gjykata shprehu shqetësime përse i përket trajtimit të të dyshuarve si terroristë nga autoritetet amerikane, veçanërisht në qendra të paraburgimit të profilit të lartë të tilla si Guantanamo Bay. Informacioni në lidhje me këto qendra ishte bërë ndërkohë publik në momentin që kërkuesi u ishte dorëzuar autoriteteve amerikane. Prandaj Gjykata besonte se autoritetet maqedonase ishin ose duhet të ishin në dijeni për rrezikun e torturës dhe keqtrajtimit të kërkuesit. Kështu, Gjykata vendosi se autoritetet maqedonase kishin shkelur nenin 3 të Konventës edhe në këtë aspekt.

Neni 5

Gjykata referoi jurisprudencën e saj sipas së cilës shtetet shkelin të drejtën për liri të garantuar nga neni 5 në qoftë se ata transferojnë individ drejt shteteve ku ata janë në rrezik të “shkeljeve flagrante” të nenit 5 të Konventës. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se mbajtja kërkuesit në hotel në Shkup, pastaj në aeroport, në vijim në Afganistan dhe më pas kthimi i tij nëpërmjet Shqipërisë ishin të gjitha veprime që iu ngarkohen autoriteteve maqedonase. Autoritetet maqedonase ishin bashkëpërgjegjëse për burgimin e kërkuesit në Afganistan, meqenëse në mënyrë të vullnetshme ia kishin dorëzuar atë autoriteteve amerikane.

Për më tepër Gjykata vërejti se praktikrat e dorëzimeve të jashtëzakonshme arrinin deri në zhdukje me forcë, e cila në vetvete përbën një burgim jashtë sistemit ligjor normal.

Neni 8

Gjykata u shpreh se të drejtat e kërkuesit jetë familjare dhe private, sipas nenit 8, ishin shkelur, pasi ndërhyrja ndaj këtyre të drejtave kishte qënë e asaj natyre sa nuk mund të konsiderohej “ në përputhje me ligjin”, pasi rrëmbimi i tij ishte bërë jashtë çdo baze ligjore.

Neni 13

Gjykata konstatoi gjithashtu se ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit për një mjet efektiv, sipas nenit 13 të Konventës. Sipas saj kërkuesi nuk ka pasur në dispozicion asnjë mjet efektiv dhe praktik për shkak të mungesës së një hetimi efektiv. Nuk kishte asnjë provë se vendimi për ta dorëzuar kërkuesin tek agjentët e CIA-s i ishte nënshtruar ndonjë forme shqyrtimi dhe praktikisht as mund t’i nënshtrohej në rrethanat konkrete. Prandaj Gjykata konstatoi shkelje të nenit 13, në lidhje me nenet 3, 5 dhe 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata u shpreh se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet t'i paguajë z. El-Masri 60,000 euro për dëmet jomateriale.

Përdorimi i teknikave të ndaluara nga neni 3 nga punonjësit e policisë

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN GÄFGEN k. GJERMANISË

(Kërkesa nr. 22978/05)

1 qershor 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Magnus Gäfgen, është shtetas gjerman i cili ka lindur në vitin 1975. Ai mbahet aktualisht në një burg në Gjermani.

Më 27 shtator 2002, kërkuesi e kishte gënijer J, që ishte djali 11 vjeçar i një familje bankierësh nga Frankfurti, të cilin ai e njihte nga e motra e tij. Kërkuesi e kishte ftuar J. në apartamentin e tij dhe e kishte mbytur duke i zënë frymën dhe pastaj kishte fshehur kufomën. Më pas, kërkuesi depozituar një kërkesë shpërblim në shtëpinë e prindërve të J., duke iu kërkuar që të paguanin një milion euro për ta parë përsëri fëmijën e tyre. Më 30 shtator 2002 Z. Gäfgen mori shpërblimin e kërkuar në një stacion tramvaji. Ai u vu nën mbikëqyrjen e policisë dhe u arrestua nga policia disa orë më vonë. Më 1 tetor 2002, një nga oficerët e policisë, përgjegjës për marrjen në pyetje të Z. Gäfgen, nën udhëzimet e Zëvendës Shefit të Policisë së Frankfurtit, e paralajmëroi kërkuesin se ai do të përballej me vuajtje të konsiderueshme në qoftë se këmbëngulte në refuzimin për të treguar vendndodhjen e fëmijës. Duke menduar se J. ishte ende gjallë, policia vlerësoi se kërcënimi ishte e nevojshëm përderisa jeta J. ishte në rrezik të madh nga mungesa e ushqimit dhe të ftohtit. Si rezultat i këtyre kërcënimeve, kërkuesi zbuloi ku e kishte fshehur trupin e J. Pas këtij rrëfimi, policia shkoi në vendin e treguar dhe siguroi prova të mëtjshme, sidomos kufomën dhe gjurmët e gomave të makinës së kërkuesit në baltë.

Në fillim të procesit penal kundër kërkuesit, gjykata rajonale e Frankfurtit në një procedurë paraprake vendosi që jo të gjitha rrëfimet e tij të bëra gjatë hetimeve mund të përdoret si provë në gjykim përderisa ishin marrë nën shtrëngim, në shkellje të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 3 të KEDNJ. Ajo madje vendosi se kërcënimet dhe presionet ndaj kërkuesit kishin shkelur nenin 136 a) të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 3 të KEDNJ. Megjithatë, gjykata rajonale lejoi përdorimin në procesin penal të provave materiale të marra si rezultat i deklaratave të nxjerra nga kërkuesit nën shtrëngim. Më 28 korrik 2003 kërkuesi u shpall fajtor për rrëmbimin dhe vrasjen e J. dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Gjykata gjermane vlerësoi se krimi i tij ishte i një ashpërsie të veçantë, dhe prandaj ai do të mund të lirohej me kusht vetëm pas

15 vitesh burg. Ajo u shpreh se, pavarësisht nga fakti se kërkuesi ishte informuar në fillim të gjyqit të tij për të drejtën e tij për të heshtur dhe se të gjitha deklaratat e tij të mëparshme nuk mund të përdoren si provë kundër tij, ai megjithatë përsëri pranoi se ai kishte rrëmbyer dhe vranë J. Konstatimet e gjykatës rajonale gjermane në lidhje me faktet, janë të bazuara kryesisht në këtë rrëfim. Gjykata u mbështet edhe në provat e siguruar si rezultat i rrëfimit të parë të kërkuesit, përkatësisht raportin e autopsisë dhe gjurmët e gomave në baltë dhe në prova të tjera të marra si rezultat i ndjekjes së kërkuesit pasi ai kishte marrë paratë, të zbuluara më vonë në banesën e tij ose të derdhura në llogaritë e tij.

Kërkuesi depozitoi një padi mbi pikat e ligjit në Gjykatën Federale të Drejtësisë e cila e hodhi poshtë atë. Ai më pas bëri një kërkesë në Gjykatën Federale Kushtetuese, e cila e konsideroi kërkesën të papranueshme. Gjykata Federale Kushtetuese konfirmoi vlerësimin e e gjykatës rajonale të Frankfurtit që kërcënimi i kërkuesit me ushtrim dhune në mënyrë që të tregonte përbënte një metodë të ndaluar të marrjes në pyetje në bazë të legjislacionit të brendshëm dhe ka shkëlur nenin 3 të Konventës. Megjithatë ajo arriti në përfundimin se ky konstatim i kishte dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit dhe një konstatim i tillë nuk nënkuptonte që procedura penale ndaj tij duhet të pushohej. Më 20 dhjetor 2004 dy policët e përfshirë në kërcënimin e kërkuesit u gjetën fajtorë për shtrëngim dhe nxitje të shtrëngimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe u dënuan me gjobë me kusht. Në dhjetor 2005, kërkuesi kërkoi ndihmë ligjore në mënyrë që të niste procedurat për shpërblim dëmi ndaj Landit të Hesen për shkak të traumave të pësuar nga metodat hetimore të policisë. Këto procedura ishin në vijim e sipër kur Gjykata e Strasburgut dha vendimin e mëposhtëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se ai i ishte nënshtruar torturës, kur u mor në pyetje nga policia, në shkelje të nenit 3. Duke u bazuar në nenin 6, ai pretendoi gjithashtu se e drejta e tij për gjykim të drejtë ishte shkelur në mënyrë të veçantë me përdorimin e provave të siguruar si rezultati i rrëfimeve të tij të marra nën shtrëngim. Në gjykimin e 30 qershorit 2008 një Dhomë e Seksionit V konstatoi se nuk ka pasur shkelje të neneve 3 dhe 6 të Konventës. Më 1 dhjetor 2008, çështja iu kalua Dhomës së Madhe, pas kërkesës së z. Gäfgen.

Neni 3

Gjykata vlerësoi se në rastin konkret kërcënimet ndaj kërkuesit me qëllim nxjerrjen e informacionit prej tij ishin mjaft serioze për t'u kualifikuar si trajtim çnjerëzor dhe përfshiheshin brenda sferës së veprimit të nenit 3. Gjykata ishte e kënaqur që

gjykatat gjermane, si në procedurën penale kundër kërkuesit edhe në atë kundër oficerëve të policisë, pranuan shprehimisht dhe në mënyrë të qartë se marrja në pyetje e kërkuesit kishte shkelur nenin 3. Ajo vuri re, megjithatë, që policët, pasi ishin gjetur fajtorë, respektivisht, për shtrëngim dhe nxitje të shtrëngimit gjatë ushtrimit të detyrës u dënuan me sanksione tepër modeste, me gjobë me kusht.

Për sa i përket kompensimit për të korigjuar shkeljen e Konventës, Gjykata vërejti se kërkesa e kërkuesit për ndihmë juridike për padi për shpërblim dëmi ndaj Landit të Hesse, është në shqyrtim prej më shumë se tre vjetësh dhe se nuk ishte marrë ende asnjë vendim mbi themelin e kësaj kerkese. Dështimi i gjykatave të brendshme për të vendosur mbi meritat e padisë ngre dyshime serioze për efikasitetin e procedurës për shpërblim dëmi ndaj autoritetit publik. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet gjermane nuk i kishin ofruar kërkuesit një shpërblim të mjaftueshëm për trajtimin e pësuar dhe prandaj Gjermania kishte shkelur nenin 3 të Konventës.

Neni 6

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se përdorimi i provave të marra nga metoda që janë në shkelje të nenit 3 ngre çështje serioze në lidhje me drejtësinë e procesit penal. Në këtë kuadër, ajo duhet të përcaktonte nëse procedurat kundër kërkuesit, në tërësinë e tyre, kanë qenë të padrejtë për shkak të përdorimit të provave të tilla në procesin kundër tij. Në rastin në fjalë, ishte rrefimi i ri i kërkuesit gjatë seancave gjyqësore - pasi ishte informuar se të gjitha deklaratat e tij të mëparshme nuk mund të përdoreshin si prova kundër tij - që kishte përbërë bazën për gjetjen fajtor dhe dënimin e tij.

Gjykata konstatoi se dëshmitë e tij të mëparshme nuk kishin qenë pra të nevojshme për të gjetur atë fajtor dhe për të caktuar dënimin e tij. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e veçanta të rastit, dështimi i gjykatave vendase për të përjashtuar provat e kundërshtuara, të siguruara pas një deklaratë të nxjerrë me anë të trajtimit çnjerëzor, nuk ka pasur një ndikim në gjetjen fajtor dhe dënimin e kërkuesit. Të drejtat e mbrojtjes e kërkuesit ishin respektuar, dhe procesi ndaj tij, në tërësi, duhet konsideruar se ka qenë i drejtë. Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

Neni 41

Kërkuesi nuk pretendoi asnjë shpërblim për dëmin pasuror ose jopasuror, por theksoi se qëllimi i kërkesës së tij në Strasburg ishte që të rifitonte një rigjykim të çështjes në Gjermani. Përderisa nuk gjeti shkelje të nenit 6, Gjykata konsideroi se nuk kishte arsye që të sugjerohej rigjykimi ose rihapja e çështjes së kërkuesit para gjykatave të brendshme.

Individëve me aftësi të kufizuara fizike të mbajtur në paraburgim, duhet t'u plotësohen nevojat e tyre të veçanta në mënyrë adekuate me qëllim që Shteti të veprojë në përputhje me nenin 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRIMAILOVS k. LETONISË

(Kërkesa nr. 6087/03)

25 qershor 2013

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Artemijs Grimaïlovs, ishte një 'banor i përhershëm jo-rezident' i Republikës së Letonisë dhe jetonte në Jelgava (Letoni). Në qershor të vitit 2000, kërkuesi iu nënshtrua një operacioni i cili konsistonte në futjen e një implanti metalik në shpinë pasi e kishte thyer. Kërkuesi u kategorizua si invalid i Kategorisë 2.

Më 10 shtator 2001 në Riga, dy policë trafiku, E.Š. dhe O.Ž., u përpoqën të ndalonin kërkuesin, pasi kishte tejkaluar limitin e shpejtësisë dhe sipas gjasave, po ngiste makinën nën ndikimin e alkoolit. Kërkesi nuk ndaloi sipas udhëzimit të policëve. Këta të fundit, e ndoqën jashtë qytetit në autostradë deri sa arritën ta nxirrnin në anë të rrugës.

Sipas qeverisë, të dy oficerët e policisë panë një armë zjarri në xhepin e xhakëtës së kërkuesit dhe vazhduan ta shtynin atë në tokë dhe më pas e lidhën me pranga. Pastaj, ata thirrën policinë lokale në vendin e ngjarjes për të mbledhur provat. Kërkuesi pretendoi se policët e kishin gjuajtur në shpinë disa herë pas arrestimit duke e plagosur rëndë. Pasi u tha oficerëve të policisë se ai ishte invalid, kërkuesi pretendoi se u kishte paraqitur policëve dokumentet që verifikonin invaliditetin tij. Ai pretendoi se pasi policët zbuluan invaliditetin e tij, kishin vendosur një armë zjarri mbi të në një përpjekje për të shmangur përgjegjësinë penale për sulm ndaj një personi me aftësi të kufizuara.

Më 11 shtator 2011, kërkuesi u dërgua në një spital publik ku i'u nënshtrua një ekzaminimi me rreze X në shpinë. Rezultatet e ekzaminimit konstatuan se vida që mbante implantin e metalit në shpinë, ishte thyer. Ai kishte gjithashtu dhimbje të forta shpine. Në të njëjtën ditë kërkuesi u vizitua nga një specialist. Kërkuesi i tregoi specialistit për arrestimin dhe se ai ishte tërhequr nga makina, e shtyrë në tokë nga policët. Ai u ankua për dhimbjen e shpinës dhe tha se nuk ishte në gjendje të lëvizte këmbën e djathtë si rezultat i dhimbjes.

Specialisti vizitoi kërkuesin dhe më pas e diagnostikoi atë me dëmtime dhe fraktura të pjesës së poshtme të shpinës. Katër vida ishin thyer dhe implanti metalik ishte

shkëputur. Më 12 shtator 2001 kërkuesi u largua nga spitali dhe iu tha të vazhdonte të merrte ilaçe. Po atë ditë ai u transferua në Burgun Qendror të Rigës. Ai u ekzaminua nga një mjek tjetër i cili e përshkroi shëndetin e përgjithshëm të kërkuesit si të mirë. Ditët më pas, kërkuesi filloi të ankohej për dhimbjen e shpinës dhe nuk ishte në gjendje të lëvzte këmbët. Më 28 shtator 2001 ai iu nënshtrua një ndërhyrjeje kirurgjikale për të lehtësuar dhimbjen. Më 10 tetor u largua nga Spitali i Burgut dhe shëndeti i tij i përgjithshëm u përshkrua si i mirë dhe ai mund të ecë përsëri.

Në ditën e arrestimit të kërkuesit, të dy oficerët u morën në pyetje nga një inspektor policie në lidhje me akuzën për armëmbajtje pa leje. Të dy oficerët deklaruan se kishin parë armën e zjarrit në xhaketën e kërkuesit dhe kishin shtyrë kërkuesin në tokë. Kërkuesi u pyet nga inspektori më 11 shtator 2001. Ai pohoi se ishte keqtrajtuar pas arrestimit të tij, por më 27 nëntor 2001 prokurori vendosi të refuzojë fillimin e procedimeve penale pas marrjes së një raporti të ekzaminimit mjekësor ku thuhej se dëmtimet e kërkuesit nuk u shkaktuan nga arrestimi.

Nga 24 maji deri më 4 qershor 2001 u zhvillua një gjyq i cili e shpalli kërkuesin fajtor si për armëmbajtje pa leje, ashtu edhe për një akuzë tjetër lidhur me lëndimet trupore dhe dhunën fizike, e cila kishte ndodhur më 9 shtator 2001. Gjyqtari nuk pranoi kërkesat e z.Grimailovs se ishte keqtrajtuar nga punonjësit e policisë bazuar në ekzaminimin mjeko-ligjor sipas të cilit kërkuesi nuk kishte lëndime trupore. Gjykatësi e dënoi z.Grimailovs me pesë vjet e gjashtë muaj burgim. Më 21 tetor 2002, Gjykata e Apelit mbështeti vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Edhe Gjykata Supreme mbajti të njëjtin qëndrim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi para Gjykatës se ishte keqtrajtuar nga policët më 10 shtator 2001. Ai gjithashtu u ankua se hetimi në këto ngjarje nuk ishte efektiv dhe invokoi nenin 3 për mungesën e ndihmës adekuate mjekësore në burg. Gjykata deklaroi se kërkesa për ndihmë mjekësore ishte e papranueshme, por vazhdoi të shqyrtonte kushtet e paraburgimit.

Neni 3

Ngjarjet e 10 shtatorit 2001

Gjykata deklaroi se kur një person është plagosur gjatë kohës së paraburgimit ose nën kontrollin e policisë, çdo dëmtim do të sjellë një prezumim të fortë se personi ishte i nënshtruar keqtrajtimit. Përdorimi i forcës gjatë arrestimit mund të bjeri

jashtë fushëveprimet të nenit 3, edhe nëse rezulton me se ushtrimi i dhunës ka qënë i domosdoshmëm si pasojë e së kërkuesit. Megjithatë, nëse një individ bën një pohim të besueshëm se ai ka pësuar një trajtim që ka shkelur nenin 3 në duart e policisë ose agjentëve të tjerë shtetërorë të ngjashëm, Konventa kërkon që të ketë një hetim efektiv. Hetimet mbi akuzat për keqtrajtim duhet të merren seriozisht nga autoritetet dhe ata duhet të bëjnë një përpjekje të plotë për të gjetur se çfarë ka ndodhur. Që një hetim të jetë efektiv, duhet që personat që kryejnë hetimin për të qenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në rast.

Në rastin në fjalë, të dyja palët ishin dakord se forca u përdor për të arrestuar kërkuesin pasi ai nuk kishte ndaluar makinën sipas udhëzimeve të oficerëve. Qeveria deklaroi se shpina e kërkuesit ishte shtrembëruar pas kësaj ngjarjeje, por theksoi se kërkuesi kishte një dëmtim të mëparshëm të shtyllës kurrizore dhe se forca e përdorur ndaj tij ishte proporcionale ndaj sjelljes së tij. Kërkuesi, nga ana tjetër, vlerësoi se forca e përdorur ishte joproporcionale. Eksperti i mjekësisë ligjore në këtë rast nuk dha një përgjigje nëse lëndimet e pretenduara nga kërkuesi mund të ishin shkaktuar nga punonjësit e policisë ose jo. Gjykata e kishte të pamundur të përcaktojë, bazuar në faktet, nga se ishte shkaktuar plagosja e kërkuesit.

Gjykata theksoi se autoritetet vendase kishin kryer një hetim mbi pretendimet e kërkuesit, megjithatë nuk ishte e bindur se hetimi ishte mjaftueshëmrisht i plotë dhe efektiv. Gjykata vuri në dukje se policia i dërgoi prokurorit materialet e çështjes tetë ditë pas ngjarjes dhe se nuk ishin ndërmarrë hapa proceduriale pas shqyrtimit të materialeve nga prokuroria. Gjithashtu, dëshmitë e policëve ishin kontradiktore dhe nuk ishte vëzhguar vendi i ngjarjes. Për me tepër, në në raportet e mjekësisë ligjore kishte mospërputhje si dhe nuk ishin pyetur dëshmitarët okularë. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte mangësi në zhvillimin e hetimeve.

Bazuar në faktet e lartpërmendura, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase nuk kishin kryer një hetim efektiv ndaj pretendimeve për keqtrajtimin e kërkuesit dhe se ishte shkelur të neni 3.

Kushtet e ndalimit

Gjykata deklaroi se neni 3 nuk përcakton një detyrim të përgjithshëm për lirimin e një të paraburgosuri për arsye shëndetësore ose për ta transferuar atë në një spital publik. Megjithatë, ky nen kërkon që shteti të sigurojë që të burgosurit të mbahen në kushte të cilat respektojnë dinjitetin njerëzor dhe shëndetin. Në rastet kur autoritetet vlerësojnë të vendosin një person me aftësi të kufizuara në paraburgim, ata duhet të tregojnë kujdes të veçantë në garantimin e plotësisht të kushteve të nevojshme për

nevojat e veçanta të atij personi. Gjykata vuri në dukje se kur një person me aftësi të kufizuara mbahet në paraburgim në një burg ku ai / ajo nuk mund të lëvizë i vetëm në qëli, kjo do të përbënte trajtim degradues.

Në këtë rast pretendimet e kërkuesit lidhen me kushtet materiale të paraburgimit të tij, për shkak të paaftësisë së tij fizike dhe mungesës së ndihmës. Gjatë dhënies së dënimit në burg, kërkuesi ishte paraplegjik dhe lëvizte përmes një karrigeje me rrota. Gjendja shëndetësore e kërkuesit pas lirimit nuk u konsiderua si fakt relevant për çështjen nga Gjykata në bazë të nenit 3. Gjithashtu Gjykata vlerësoi se objektet sanitare përmes të cilave ishte asistuar kërkuesi ngrejnjë një shqetësim të veçantë në bazë të nenit 3. Kërkuesi dhe Qeveria ishin dakort me faktin se aftësia e kufizuar fizike e kërkuesit e kishte penguar në kryerjen e nevojave personale pa ndihmën e të tjerëve. Gjykata u shpreh se kushtet e paraburgimit të kërkuesit në dritën e aftësisë së kufizuar fizike përbënin trajtim degradues në kundërshtim me nenin 3.

Neni 41

Gjykata I akordoi kërkuesit 6,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial.

Trajtim i papërshtatshëm mjekësor në shkellje të nenit 3 të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRORI k. SHQIPËRIË

(Kërkesa nr. 25336/04)

7 korrik 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Arben Grori, është një shtetas shqiptar i cili ka lindur në 1971. Në kohën e dhënies së vendimit ai mbahej në një burg të sigurisë së lartë në Shqipëri dhe vuante një dënim prej 15 vjet burg për trafik ndërkombëtar droge dhe një dënim me burgim të përjetshëm për vrasje me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit, vepra penale të kryera në territorin italian.

Më 2 shkurt 2001, Gjykata e Apelit e Milanos e dënoi kërkuesin në mungesë me burgim të përjetshëm për vrasje dhe me pesë vjet për posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Megjithatë, ata nuk mund të kërkonin zbatimin e dënimit në Shqipëri, pasi në atë kohë asnjëri prej dy vendeve nuk ishte palë e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare përkatëse.

Z. Grori u ndalua në Shqipëri, më 30 prill 2001 mbi bazën e një urdhër-arresti të lëshuar në Itali më 16 shkurt 2001, për një akuzë tjetër, në lidhje me përfshirjen e tij të dyshuar në trafikun e drogës. Në të njëjtën ditë, Interpol Roma i kërkoi autoriteteve shqiptare të fillonin procedurën penale kundër kërkuesit për veprat penale të kryera në territorin italian. Në korrik 2002 Prokuroria shqiptare e akuzoi z. Grori me veprën penale të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe në 29 dhjetor 2003 gjykata e rrethit Tiranë e shpalli atë fajtor, fajësi që mbeti në fuqi dhe në qershor 2006, Gjykata e Lartë e dënoi me 15 vjet burg.

Gjatë paraburgimit, në pritje të procedurës penale në Shqipëri për trafikimin e drogës në Itali, më 15 maj 2002 ndaj z. Grori u dha një vendim nga gjykatat shqiptare që urdhëronte arrestimin e tij në pritje të procedurës për vlefshmërinë e dënimit të dhënë në Itali për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit.

Z. Grori u ankua para gjykatave shqiptare se nuk kishte kërkesë për vlefshmërinë e dënimit në mungesë të dhënë në Itali bërë nga autoritetet italiane ndaj Ministrit shqiptar të Drejtësisë. Ai gjithashtu pohoi se nuk kishte pasur asnjë marrëveshje ndërkombëtare në fuqi midis dy vendeve në atë kohë për vlefshmërinë e një dënimi të tillë. Ai u mbështet edhe në faktin se ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për vlefshmërinë siç kërkohet dhe nga Kodi i Procedurës Penale. Gjykatat shqiptare vendosën kundër tij,

duke konkluduar se sipas rregullave e së drejtës penale ndërkombëtare, bashkëpunimi midis vendeve mund të ndodhë edhe në mungesë të traktateve dypalëshe, në bazë të vullnetit të mirë, rregullave të njohura përgjithësisht dhe parimit të reciprocitetit.

Më 23 prill 2002, Qeveria italiane dhe ajo shqiptare nënshkruan një marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, e cila u ratifikua nga parlamentet e tyre përkatësisht në vitin 2003 dhe 2004.

Gjatë periudhës shtator 2003 dhe shkurt 2004, Z. Grori kërkoi një ekzaminim mjekësor të përshtatshëm për shkak të përkeqësimit të shëndetit të tij. Në gusht 2004 ai u diagnostikua me sklerozë të shumëfishtë, mjekët raportuan se sëmundja e tij mund shkaktonte gjendje shoku, dëmtim organesh, paaftësi të përhershme ose vdekje. Në 2005, ai nisi disa procedura penale kundër prokurorisë dhe Drejtorit të Spitalit të Burgut Tiranë duke u ankuar për neglizhencën në sigurimin e kujdesit mjekësor të tij, duke qenë se ai kishte qenë i vonuar dhe se ishte trajtuar kryesisht me mjekime për trajtimin e reumatizmit.

Më 10 janar 2008, me kërkesën e tij, Gjykata Evropiane e urdhëroi Qeverinë shqiptare me një masë të përkohshme në bazë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës që kërkuesi të transferohej menjëherë në një spital civil për ekzaminimin dhe trajtimin e duhur mjekësor. Më 28 janar 2008, Qeveria e transferoi atë në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës, ku ai kaloi një ekzaminim të specializuar mjekësor. Prej 17 qershorit 2008, z. Grori ka marrë rregullisht trajtimin e duhur mjekësor për sëmundjen e tij.

2. Vendimi i Gjykatës

Z. Grori u ankua se ka marrë trajtim mjekësor të papërshtatshëm dhe se burgimi i tij ka qenë i paligjshëm për shkak të pavlefshmërisë dhe zbatimit në Shqipëri të dënimit me burgim të përjetshëm të vendosura nga gjykatat italiane në mungesë të tij. Ai u mbështet në nenet 3, 5 § 1, 6 § 1 dhe 7 të Konventës dhe të nenit 2 të Protokollit 7. Ai u ankua gjithashtu se transferimi i tij në një spital civil në janar 2008, siç u kërkua nga Gjykata në bazë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës së, ishte shtyrë, në shkelje të nenit 34.

Neni 3

Gjykata vërejti me shqetësim se nga prilli 2005 deri në 28 janar 2008 z. Grori ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtim mjekësor të përshtatshëm, pavarësisht se vuante nga një sëmundje e rëndë. Në mënyrë të veçantë, në raportin e fundit të mjekësor mbi gjendjen e tij shëndetësore ishte konfirmuar se avancimi i sëmundjes në vite kishte ndodhur për shkak të mungesës së kujdesit mjekësor. Qeveria nuk dha ndonjë

justifikim se pse ajo kishte refuzuar trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civile, duke pasur parasysh se kjo ishte falas për personat në spitalet publike në atë kohë. Qeveria nuk arriti të shpjegojë se si trajtimi me vitamina dhe me qetësues mund të konsiderohej i përshtatshëm në këto rrethana dhe pse shëndeti i kërkuesit ishte përkeqësuar në burg. Gjykata arriti në përfundimin se trajtimi i përshkruar më lart kishte krijuar një ndjenjë të tillë të fortë pasigurie të z. Grori që, e kombinuar me vuajtjet e tij fizike, kishte arritur në trajtim degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës.

Neni 5 § 1

Gjykata theksoi se periudha për tu marrë në shqyrtim për qëllimet e paraburgimit është ajo mes 15 majit 2002 dhe dhjetorit 2003. Ajo vuri në dukje se Gjykata e Lartë shqiptare ishte përpjekur të gjente një bazë ligjore për të justifikuar paraburgimin e kërkuesit, dhe kishte bërë një "importim" në dispozitat e legjisllacionit vendas të instrumenteve të drejtës ndërkombëtare që nuk kishin hyrë ende në fuqi në Shqipëri. Pra, sipas Gjykatës baza ligjore e gjetur nga Gjykata e Lartë zor se mund të thuhet se plotëson kërkesat për "ligjshmërinë" përse i përket paraburgimit të kërkuesit dhe konvertimit të dënimit të tij të vendosur nga gjykatat italiane. Gjykata arriti në përfundimin, pra, që, nga 15 maji 2002 deri më 29 dhjetor 2003, z. Grori nuk ishte ndaluar në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj, në shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

Neni 34

Gjykata theksoi se pavarësisht se autoritete shqiptare ishin njoftuar në mëngjesin e 11 janarit 2008 për transferimin e kërkuesit në një spital, Qeveria e kishte bërë transferimin e tij vetëm më 28 janar 2008. Urdhri i Gjykatës Evropiane nuk ishte zbatuar për 17 ditë dhe nuk duket të kishte pasur ndonjë pengesë objektive të autoriteteve shqiptare për ta bërë këtë. Kishte pra një shkelje të nenit 34.

Other complaints

Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme t'i shqyrtonte veçmas edhe në bazë të nenit 6 § 1 pretendimet e kërkuesit në lidhje me paligjshmërinë e procedurës për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit të dhënë në Itali. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë ankesat e tjera të kërkuesit.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 8,000 euro për dëmin jomaterial dhe 7,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

Një operacion i ashpër i policisë për të arrestuar një politikan ka deriuar shkelle të neneve 3, 5 (3), 5 (5), 6, 8 dhe 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GUTSANOVI V K. BULLGARISË

(Kërkesa nr. 34529/10)

15 tetor 2013

1. Faktet kryesore

Kërkuesit në këtë çështje janë z. Gutsanov (politikan i mirënjohur), bashkëshortja dhe dy vajzat e tij të vogla. Autoritetet dyshuan për përfshirjen e z. Gutsanov në një grup kriminal, i cili akuzohej për shpërdorim detyre dhe përvetësim të fondeve publike. Më 31 mars 2010, rreth orës 6.30 të mëngjesit një ekip i posaçëm, i cili përfshinte oficerë policie të armatosur dhe të maskuar, mbërriti në shtëpinë e kërkuesit. Një nga punonjësit e shërbimit lajmëroi policët për prezencën e bashkëshortes dhe fëmijëve të kërkuesit. Pasi z. Gutsanov nuk iu përgjigj urdhrin për të hapur derën, oficerët e policisë hynë me forcë në banesë. Ata kontrolluan banesën dhe morën prova të ndryshme. Z. Gutsanov u arrestua dhe shoqërua në orën 13:00 ndërkohë që gazetarët qëndronin jashtë banesës së tij dhe filmomin ngjarjen.

Prokurori i çështjes dha një konferencë për shtyp në të njëjtën ditë në të cilën njoftoi akuzat për personat e arrestuar përfshirë dhe kërkuesin.

Në orën 22:55 një prokuror akuzoi zyrtarisht z. Gutsanov për disa vepra penale dhe urdhëroi arrestimin e tij për shtatëdhjetë e dy orë derisa masa e sigurisë të vlerësohej nga gjykata.

Më 1 prill një gazetë publikoi fjalimin e prokurorit, së bashku me pjesë të një interviste dhënë nga Ministri i Brendshëm, ku ky i fundit përmendi afërsinë e z. Gutsanov me një nga të dyshuarit e tjerë dhe përfshirjen e tyre në të njëjtën ngjarje. Më 3 prill 2010, gjykata vlerësoi masën e sigurimit arrest me burg me argumentimin se kërkuesi nëse lihej i lirë mund të kryente vepra penale të tjera. Më 5 prill 2010 kryeministri i vendit dha një intervistë që u transmetua drejtpërdrejt për çështjen në fjalë, në fund të së cilës iu kërkua të komentonte mbi arrestimet e fundit. Kryeministri përmendi afërsinë e z. Gutsanov me një tjetër të dyshuar dhe "përfitime materiale". Më 13 prill 2010, gjykata vendase rrëzoi apelin e z. Gutsanov kundër vendimit për paraburgim. Ndërkohë, më 18 maj 2010 atij iu rrëzua dhe një kërkesë tjetër për lirim. Më 25 maj 2010, Gjykata e Apelit la kërkuesin në arrest shtëpie, duke argumentuar se rreziku i kryerjes së veprave të reja penale nuk ekzistonte më. Më 26 korrik 2010 gjykata vendosi ta lirojë atë me kusht.

2. Vendimi i Gjykatës

Në referim të nenit 3, kërkuesit u ankuan se kishin qenë subjekt i trajtimit poshtëruës si rezultat i operacionit policor në banesën e tyre. Gjithashtu, kërkuesi në referim të nenit 5 të Konventës, u ankua se rasti i tij nuk iu paraqit autoritetit gjyqësor kompetent në mënyrën e parashikuar nga ligji, si edhe ishte mbajtur në paraburgim për një kohë të gjatë në të cilën nuk ishin paraqitur argumente të mjaftueshme për ndalimin e tij.

Kërkuesi u ankua se deklaratat e bëra për të nga figura publike shkelën të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm në zbatim të neneve 6 dhe 13. Familja Gustanovi u ankua se kontrolli në banesën e tyre ishte një ndërhyrje e pajustificuar dhe cenoi të drejtën e tyre për t'u respektuar banesën dhe jetën familjare garantuar nga neni 8 i Konventës. Gjithashtu, ata u ankuan se ata nuk kishin pasur një mjet ligjor efektiv për tu ankuar mbi shkeljet e pretenduara në lidhje me nenin 3 të Konventës.

Neni 3

Gjykata vërejti se operacioni policor ishte ndërmarrë në zbatim të një qëllimi të ligjshëm për kryerjen e një hetimi penal, atë të kërkimit dhe gjetjes së provave. Megjithatë, planifikimi dhe ekzekutimi i tij nuk mori parasysh disa faktorë të rëndësishëm, siç ishin natyra e veprave penale për të cilat z. Gutsanov akuzohej, fakti që ai nuk ishte përfshirë në ndonjë histori dhune, si dhe prania e bashkëshortes dhe fëmijëve të tij në banesë.

Këta faktorë treguan se përfshirja e policëve të armatosur dhe të maskuar, si edhe kontrolli shumë herët në mëngjes i banesës së kërkuesit, ishin metoda të tepruara dhe jo të nevojshme për të ndaluar një të dyshuar dhe për të mbledhur prova. Gjykata vlerësoi se të katër kërkuesit i ishin nënshtruar një përvojë psikologjike, që krijoi tek ta ndjenjën e frikës, ankthit dhe të pafuqisë, duke e kualifikuar atë si trajtim poshtëruës të kryer në shkelje të nenit 3 të Konventës.

Neni 5

Neni 5 (3) - paraqitja përpara një gjyqtari të autorizuar me ligj

Kërkuesi u mbajt në arrest për tre ditë dhe gjashtë orë. Pas ditës së parë ai nuk mori pjesë në asnjë veprim hetimor. Ai nuk ishte i dyshuar për përfshirje në veprimtari të dhunshme dhe ishte në një gjendje të brishtë psikologjike gjatë fazave fillestare të paraburgimit pas trajtimit poshtëruës të pësuar gjatë operacionit policor, i cili u

pasua me cenim të imazhit të tij publik. Ai u arrestua në të njëjtin qytet ku ndodhej dhe gjykata që do të shqyrtonte çështjen dhe ndaj tij nuk ishte e nevojshme marrja e masave shtesë të sigurisë. Këto elemente derivuan shkelje të kërkesës së nenit 5(3) për të paraqitur menjëherë një të dyshuar përpara një gjyqtari të autorizuar me ligj.

Neni 5 (3) - kohëzgjatja e ndalimit

Z. Gutsanov u mbajt i ndaluar për një periudhë prej 118 ditësh (31 mars - 30 korrik 2010), dy muaj nga të cilët në arrest shtëpie. Vendimet e gjykatave vendase për ta mbajtur atë në paraburgim bazoheshin në argumentimin se ai të mund të kryente një vepër të re penale, veçanërisht të ndërhynte në prova. Megjithatë, më 25 maj 2010, Gjykata e Apelit vendosi që pas dorëheqjes së kërkuesit nga posti i tij zyrtar ky rrezik kishte kaluar. Në kundërshtim me detyrimet e saj sipas ligjit të brendshëm, e njëjta gjykatë e vendosi që kërkuesi duhet të qëndronte në arrest shtëpie pa ofruar ndonjë arsye të veçantë për të justifikuar këtë vendim. Në këto kushte, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase dështuan në përmbushjen e detyrimit të tyre për të siguruar një arsyetim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për arrestimin e kërkuesit pas 25 majit 2010. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se ndaj kërkuesit ishte shkelur e drejta e garantuar nga neni 5 (3) i Konventës.

Neni 5 (5)

Ligji mbi Përgjegjësinë Shtetërore nuk i ofroi kërkuesit një mjet ligjor efektiv për dëmshpërblim të dëmeve të pësuar gjatë paraburgimit. Meqenëse nuk ekzistonte ndonjë dispozitë tjetër ligjore për kompensim, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 5 (5).

Neni 6

Gjykata shqyrtoi pretendimet e kërkuesit se zyrtarë publik të ndryshëm kanë shkelur të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm.

Pasi nuk gjeti shkelje në lidhje me intervistën e kryeministrit dhe fjalimin prokurorit në konferencën e dhënë për shtyp, Gjykata mori në shqyrtim intervistën e Ministrit të Brendshëm, gjatë së cilës ai deklaroi se "[Gutsanov dhe një i dyshuar tjetër] kishin bërë veprime përfaqësimi dhe zhvilluar një komplot për një periudhë disa vjeçare". Gjykata veçoi natyrën e kësaj interviste, që kishte të bënte ekskluzivisht me operacionin, nga fjalët spontane të kryeministrit disa ditë më vonë. Përveç kësaj, fakti që ky fjalim u botua një ditë pas arrestimeve nga një zyrtar i lartë i qeverisë (dhe përpara paraqitjes së z. Gutsanov para një gjykatë), i cili në këto rrethana duhet të kishte marrë masa paraprake për të shmangur konfuzionin, ishte i rëndësishëm. Fjalët ishin

më shumë se një komunikim i thjeshtë i informacionit dhe incendonin fajësinë e z. Gutsanov duke shkelur këtu të drejtën e tij sipas nenit 6 (2).

Së fundi, Gjykata vërejti se gjyqtari i cili rrëzoi kërkesën për lirim më 18 maj 2010, deklaroi se gjykata “mbetej e mendimit se një vepër penale ishte kryer dhe se i akuzuari ishte përfshirë në të”. Sipas Gjykatës, fraza ishte më shumë se një përshkrim i thjeshtë i dyshimit dhe më tepër një deklaratë e fajit para se të ishte marrë ndonjë vendim mbi themelin e çështjes duke shkelur kështu nenin 6 (2) të Konventës.

Neni 8

Kontrolli në banesën e kërkuësve ishte kryer pa një urdhër gjyqësor. Një kontroll i tillë do të cilësohej i ligjshëm nëse një gjykatë vendase do të kishte bërë një shqyrtim retrospektiv të tij për të siguruar që ai plotësonte disa kushte materiale dhe procedurale. Në këtë rast, gjyqtari në fjalë nuk dha ndonjë arsye për miratimin e kontrollit dhe si rezultat, Gjykata konsideroi se ai nuk kontrolloi efektivitetin, ligjshmërinë dhe domosdoshmërinë e kontrollit të banesës. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se ndërhyrja në të drejtën e kërkuësve për respektimit e banesës nuk ishte “e përcaktuar me ligj” duke shkelur kështu nenin 8 të Konventës.

Neni 13 marrë së bashku me nenet 3 dhe 8

Në të drejtën e brendshme nuk ekzistonte asnjë mjet juridik efektiv me anë të të cilit kërkuësit mund të rivendikonin të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar trajtimin në kundërshtim me nenin 3 dhe për respektimin e banesës sipas nenit 8 të Konventës. Prandaj, u konstatua shkelja e nenit 13 marrë së bashku me nenet 3 dhe 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuësve 40,000 euro në kuadër të dëmit jomaterial dhe 4,281 euro për shpenzimet gjyqësore.

Keqtrajtimi nga policia gjatë arrestit

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN HAJNAL K. SERBISË

(Kërkesa nr. 36937/06)

19 qershor 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi është një shtetas serb i lindur në vitin 1985 dhe jeton në Suboticë, Serbi.

Më 8 gusht 2005, ai u arrestua nga policia e Suboticës dhe u dërgua në komisariat për shkak se dyshohej të kish kryer një vjedhje. Sipas procesverbalit të marrjes së tij në pyetje, kërkuesi pranoi akuzën për vjedhje të mbetur në tentative dhe pastaj nënshkroi dokumentin duke përdorur pseudonimin e tij, pavarësisht se gjatë marrjes në pyetje kishte deklaruar se ai ishte “analfabet”, fakt i cili ishte shënuar në procesverbal.

Më 17 dhe 18 gusht 2005, kërkuesi u shoqërua përsëri në komisariatin e policisë për t'u marrë në pyetje rreth vjedhjeve pa marrë më parë një njoftim për paraqitje. Kërkuesi pretendoi se gjatë këtyre shoqërimeve ai ishte abuzuar fizikisht nga policia, ku kjo e fundit kishte tentuar të merrte pohimin se ai kishte kryer këtë vepër penale. Në rastin e parë ai kishte qenë në gjendje ta shihte shkurtimisht avokatin e tij, por në rastin e dytë policia nuk e kish marrë në konsideratë kërkesën e tij. Kërkuesit iu siguria një avokat kryesisht, i cili, u shfaq vetëm një herë për të nënshkruar procesverbalin e marrjes në pyetje dhe u largua menjëherë pas kësaj. Procesverballi në fjalë përmbante: (i) akuzat e shumta për vjedhje të bëra në llogari të kërkuesit; (ii) rrëfimin e hollësishëm të mënyrës së kryerjes së këtyre veprave penale; (iii) deklaratën e tij se ai nuk dëshironte të mbante avokatin e tij si përfaqësues ligjor; dhe (iv) konfirmimin e tij se ai gjatë dhënies së dëshmisë nuk kishte qenë në kushtet e “ndonjë shtrëngimi fizik ose mendor”.

Më 24 gusht 2005, kërkuesi u arrestua përsëri dhe u ndalua për 48 orë. Avokati i caktuar prej tij (avokati i parë) paraqiti një ankesë pranë Gjykatës së Rrethit. Gjykata rrëzoi ankimin duke deklaruar se kërkuesi ishte dënuar për krime në të kaluarën dhe më pas kishte “vazhduar kryerjen e krimeve”, duke vënë në dukje se ndaj kërkuesit ishin ngritur gjashtë akuza. Gjithashtu, gjykata deklaroi se ai kishte kryer disa krime të lidhura me disa prona në një periudhë të shkurtër kohore.

Një hetim paraprak u ndërmor kundër kërkuesit dhe periudha e paraburgimit të tij u zgjat nga gjyqtari i hetimeve paraprake që argumentoi se nëse kërkuesi do të lihej i lirë mund të rikryej vepra penale, të arratiset ose të ndikojë tek dëshmitarët.

Kërkuesi nuk pranoi të jepte një deklaratë kur u ftua dhe në vend të saj u ankua për keqtrajtimin e pësuar nga ana e policisë, si edhe parregullsi procedurale të çështjes së tij. Zgjatja e periudhës së paraburgimit të tij u konfirmua më 30 gusht 2005. Në javët në vijim gjyqtari i hetimeve paraprake mori dëshminë e disa dëshmitarëve, dy prej të cilëve deklaruan se ishin kërcënuar apo dhunuar fizikisht nga policia për të dhënë deklaratat e tyre.

Më 16 shtator 2005, kërkuesi u padit. Avokati i tij paraqiti një kundërshtim formal kundër padisë, por kjo u refuzua. Avokati i tij më pas njoftoi Gjykatën e Rrethit se kërkuesi ishte fotografuar gjatë kohës së paraburgimit dhe se gjatë disa prej takimeve që avokati kish pasur me z. Hajnal, stafi i burgut kishte qëndruar mjaft afër tyre për të dëgjuar dhe parë gjithçka.

Gjatë seancave që pasuan, kërkuesi e përshkroi abuzimin që kishte pësuar gjatë kohës së ndalimit në polici dhe deklaroi se ishte detyruar të nënshkruante një deklaratë të përgatitur nga policia pa prezencën e tij. Individë të tjerë gjithashtu iu referuan abuzimit që kishin vuajtur në duart e policisë.

Më 13 prill 2006, Gjykata e Rrethit vendosi se kërkuesi ishte fajtor për njëmbëdhjetë vjedhje me dhunë dhe e dënoi me një vit e gjysmë burgim. Dëshmitë e disa dëshmitarëve, që deklarorin se ishin keqtrajtuar nga policia me qëllim që të inkriminonin kërkuesin, nuk u morën parasysh. Apeli i tij u rrëzua.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua në kuadër të nenit 3 lidhur me keqtrajtimin e pësuar më 17 dhe 18 gusht 2005, si dhe dështimin e shtetit të paditur për të kryer ndonjë hetim mbi këto incidente. Gjithashtu, kërkuesi u ankua në referim të nenit 6 se procesi penal ndaj tij nuk kish qenë i drejtë dhe dënimi i tij ishte bazuar mbi vetinkriminimin e tij, marrë me detyrim më 18 gusht 2005.

Neni 3

Duke përsëritur statusin e nenit 3 si një nga dispozitat më themelore të Konventës, Gjykata theksoi se mbrojtja e garantuar nga ky nen parashikohej në terma absolutë, duke mos iu nënshtruar asnjë përjashtimi ose kushti. Sa i përket faktit nëse rasti objekt gjykimi përfshihet ose jo në fushëveprimin e nenit 3 duhet të shqyrtohen të gjitha rrethanat e rastit.

Gjykata vërejti se kërkuesi kishte vendosur të pranonte kryerjen e vjedhjeve më 18 gusht 2005, vetëm një ditë pasi ai kishte refuzuar t'i jepte një deklaratë policisë. Më

tej, Gjykata vlerësoi të rëndësishme të theksonte se megjithëse kërkuesi nuk ishte në gjendje të merrte një certifikatë mjekësore, avokati i tij dhe një dëshmitar tjetër kishin vërejtur lëndimet e tij. Ndërkohë, disa dëshmitarë kishin dëshmuar se ata vetë i ishin nënshtruar keqtrajtimit nga policia. Përveç kësaj, Gjykata u mbështet në një raport të publikuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës të cilët gjatë vizitës së tyre në ambientet e shtetit të paditur kishin gjetur shkopinj bejsbolli dhe objekte të ngjashme në dhomat e marrjes në pyetje në thuajse çdo komisariat policie në Beograd. Së fundi, Gjykata vuri në dukje mungesën e të dhënave zyrtare në lidhje me kohën kur kërkuesi u shoqërua në paraburgim dhe për sa kohë ai qëndroi atje.

Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi i ishte nënshtruar dhunës fizike më 17 gusht 2005 dhe së paku, ishte detyruar të jepte rrëfimin e tij të nesërmen e asaj date. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 3. Në lidhje me dështimin e autoriteteve për të nisur dhe kryer një hetim të plotë mbi pretendimin e kërkuesit se kishte qenë subjekt keqtrajtimi Gjykata gjeti shkelje të aspektit procedural të nenit 3.

Neni 6 (1)

Për të vlerësuar nëse ndaj kërkuesit ishte shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, Gjykata theksoi se kjo varej nga fakti nëse procesi i marrë si një i tërë, duke përfshirë mënyrën në të cilën u siguruan provat, ishte i drejtë. Gjykata mori në konsideratë gjetjet e vërejtura në shkelje të nenit 3 dhe qëndrimin e jurisprudencës së saj të mëparshme, e cila theksonte se marrja e dëshmimeve si rezultat i keqtrajtimit bën që procesi të cilësohet si tërësisht i padrejtë.

Duke qenë se Gjykata kishte vlerësuar tashmë shkelje të nenit 3 në lidhje me procesin e marrjes në pyetje të kërkuesit, procesi si një i tërë u konsiderua i padrejtë. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

Neni 6 (2)

Kërkuesi argumentoi se e drejta e tij për t'u prezumuar i pafajshëm ishte shkelur nga Gjykata e rrethit në deklarinimin e saj se ndaj kërkuesit prisnin për t'u shqyrtuar edhe gjashtë akuza penale, duke e cilësuar këtë si rrethanë rënduese.

Gjykata vërejti se vetëm një dënim për kryerjen e një krimi të mëparshëm mund të merret si një rrethanë rënduese në dënimet e ardhshme. Pranimi i rëndësisë së proceseve gjyqësore të pa përfunduara në mënyrë të pashmangshme nënkupton

fajësinë e kërkuesit në lidhje me procesin në fjalë. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 6 (2) të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 12,000 euro dëmshpërblim në lidhje me dëmin jomaterial dhe 9,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

KJO ÇËSHTJE I ËSHTË REFERUAR DHOMËS SË MADHE NË ZBATIM TË NENIT 43 TË KONVENTËS. SEANCA DËGJIMORE PËR TË DO TË ZHVILLOHET MË 18 PRILL 2018

Mbajtja de facto për 23 ditë në zonën e tranzitit të azilkërkuesve ishte e paligjshme dhe largimi i tyre nga Hungaria në Serbi i ekspozoi ata para një rreziku real chain-refoulement

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ILIAS DHE AHMED K. HUNGARISË

(Kërkesa nr. 47287/15)

14 mars 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, z. Md Ilias and z. Ali Ahmed, janë dy shtetas nga Bangladeshi të cilët kanë lindur respektivisht në 1 janar 1983 dhe 3 korrik 1980.

Duke u larguar nga vendi i tyre, ata udhëtuan përmes Pakistanit, Iranit dhe Turqisë dhe hynë në territorin e Bashkimit Evropian në Greqi. Prej atje, ata kaluan nga Maqedonia në Serbi, ku kaluan respektivisht 20 orë dhe dy ditë. Më 15 shtator 2015 ata arritën në zonën e tranzitit Röscke në kufirin midis Hungarisë dhe Serbisë. Në të njëjtën ditë, ata paraqitën kërkesat për azil.

Prej këtij momenti, kërkuesit qëndruan brenda zonës së tranzitit, prej së cilës nuk mund të largoheshin në drejtim të Hungarisë. Zona e tranzitit, sipas kërkuesve, ishte e papërshtatshme për një qëndrim më të gjatë se një ditë, veçanërisht në kushtet e gjendjes së tyre të rënduar psikologjike. Efektivisht ata ishin mbyllur në një zonë të rrethuar me gardh dhe të ruajtur nga oficerët. Ata pohuan se nuk kishin pasur akses në ndihmë ligjore, sociale apo mjekësore.

Kërkuesit ishin të dy analfabetë. Ata u intervistuan nga Autoriteti i Shtetësisë dhe Imigracionit ("autoriteti i azilit"). Ndërkohë, gjuha e tyre kombëtare ishte urdu. Gënimisht, kërkuesi i parë u intervistua me ndihmën e një përkthyesi në Dari, gjuhë të cilën ai nuk e fliste. Një përkthyes Urdu ishte i pranishëm për intervistën e kërkuesit të dytë. Sipas procesverbaleve të intervistave, Hungaria ishte vendi i parë ku të dy kërkuesit kërkuan azil.

Me një vendim të datës 15 shtator 2015, autoriteti i azilit refuzoi kërkesat për azil të kërkuesve, duke i gjetur ato të papranueshme me arsyetimin se Serbia do të konsiderohej "vend i tretë i sigurt" në zbatim të Dekretit të Qeverisë nr. 191/2015. Kërkuesit

ankimuan vendimin pranë Gjykatës Administrative dhe të Punës në Szeged, e cila rrëzoi vendimin e autoritetit të azilit me arsyetimin se ky i fundit duhet të kishte analizuar më mirë situatën aktuale në Serbi lidhur me procedurat e azilit dhe e ktheu rastin përsëri për rishqyrtim.

Më 23 shtator 2015, të dy kërkuesit u diagnostikuan me çrregullime të stresit post-traumatik ("PTSD"). Raportet përkatëse mjekësore nuk përmbanin ndonjë tregues të trajtimit urgjent mjekësor ose psikologjik. Megjithatë, psikiatri ishte i mendimit se gjendja mendore e kërkuesve do të përkeqësohej për shkak të izolimit.

Më 30 shtator 2015, autoriteti i azilit refuzoi përsëri kërkesat për azil dhe urdhëroi dëbimin e tyre nga Hungaria. Gjykata Administrative dhe e Punës e Szeged mbajti të njëjtin qëndrim me autoritetin edhe pas ankimit të kërkuesve. Vendimi iu dorëzua kërkuesve më 8 tetor 2015. Më pas ata u shoqëruan në kufirin serb, duke lënë zonën e tranzitit të Serbisë pa kufizime fizik.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit ankuan që izolimi i tyre në zonën e tranzitit ishte i paligjshëm dhe nuk kish pasur shqyrtimin e duhur gjyqësor, duke shkelur nenin 5 (1) dhe (4) të Konventës. Ata gjithashtu u ankuan se izolimi i tyre i zgjatur në zonën e tranzitit, duke pasur parasysh statusin e tyre vulnerabël dhe kushtet e përgjithshme, përbënte trajtim çnjerëzor në kundërshtim me nenin 3. Për më tepër, ata pretendonin se nuk kishte asnjë mjet efektiv në dispozicion të tyre për t'u ankuar për kushtet e zonës së tranzitit, duke shkelur nenin 13 marrë sebashku me nenin 3 të Konventës. Së fundmi, ata pretendonin se dëbimi i tyre drejt Serbisë i kishte ekspozuar ndaj një rreziku real i *refoulement*⁸³, që përbënin trajtim çnjerëzor dhe degradues duke shkelur nenin 3.

Neni 5 (1)

Gjykata vërejti se kërkuesit u mbajtën për 23 ditë në një ambient të ruajtur, i cili ishte nën kontrollin efektiv të shtetit dhe nuk mund të aksesohet nga persona të tretë, madje as nga avokati i kërkuesve. Aplikantët nuk kishin mundësi të hynin në territorin hungarez përtej zonës së tranzitit. Për më tepër, ata nuk mund të kishin lënë zonën e tranzitit në drejtim të Serbisë pa humbur kërkesën e tyre për azil dhe duke rrezikuar refuzimin. Prandaj, nuk mund të konsiderohej se atyre nuk iu ishte privuar liria dhe mbajtja e tyre në zonën e tranzitit përbën *de facto* kufizimin e lirisë së tyre.

83 Term i përdorur në të drejtën e azilit si kthim i detyrueshëm i refugjatëve ose azil kërkuesve në një vend ku ata rrezikohen t'i nënshtrohen persekutimit.

Gjykata nuk ishte e bindur se dispozitat e brendshme të pretenduara nga qeveria si bazë ligjore për paraburgimin e kërkuesve, përmbanin saktësi dhe parashikueshmëri të mjaftueshme të faktit se azilkërkuesit legjitimohej të mbaheshin në zonën e tranzitit. Dispozitat në fjalë thjesht theksonin se azilkërkuesit që i nënshtrohen procedurës së kufirit nuk kishin të drejtën të qëndronin në territorin e Hungarisë ose të kërkonin strehim në një strukturë të caktuar.

Në këto kushte, paraburgimi i kërkuesve ka ndodhur *de facto*, për shkaqe të zgjidhjeve praktike, e cila nuk ishte shoqëruar me një vendim zyrtar të arsyetuar. Për rrjedhojë, ndalimi i kërkuesve nuk mund të konsiderohej “i ligjshëm” për qëllimet e nenit 5 (1). Gjykata gjeti shkelje të kësaj dispozite.

Neni 5 (4)

Duke mbajtur parasysh se paraburgimi i ankuesve përbënte një masë *de facto*, ankuesit nuk mund të kishin ndjekur ndonjë rishikim gjyqësor të procesit të dërgimit të tyre në zonën e tranzitit, i cili në vetvete nuk ishte urdhëruar në asnjë procedurë formale ose të kishte marrë formën e një vendimi. Gjykata vërejti se proceset e ndjekura kishin të bënin me aplikimet për azil të kërkuesve. Në anën tjetër, kërkuesit nuk kishin mundësi të ndërmerrnin asnjë procedurë të shpejt në të cilën të shqyrtohej ligjshmëria e paraburgimit të tyre. Kjo situatë përbënte shkelje të nenit 5 (4).

Neni 3

Kërkuesit ishin mbyllur në një hapësirë të mbyllur prej 110 m² për 23 ditë, ku iu la një dhomë në një nga kontejnerët e dedikuar, sipërfaqja e së cilës ishte 13 m² sipas KPT-së. Dhoma e kërkuesve përmbante shtretër për pesë persona, por dukej se në kohën kur ata qëndruan aty ishin të vetmit banorë. Kushtet sanitare ishin siguruar në kontejnerë të veçantë. Për më tepër, ata kishin pasur mundësinë të vizitonin një psikiatër. Ndërkohë, KPT-ja kishte shprehur një përshtypje përgjithësisht të favorshme për institucionet shëndetësore. Nuk kishte asnjë indicie se kushtet materiale ishin të këqija, veçanërisht se kishte mungesë të hapësirës personale, privatësisë, ventilimit, dritës natyrore ose qëndrimit në natyrë.

Gjykata mori në konsideratë mendimin e psikiatrit, i cili konstatoi se kërkuesit vuanin nga PTSD, fakt i cili duhet të ishte përfshirë në dosjet e tyre gjatë kohës që iu nënshtroan procedurës së kufirit. Raporti mjekësor pranonte se azilkërkuesit ishin veçanërisht të pambrojtur, por konkludonte se ata në rastin aktual nuk ishin më shumë të preکشëm se çdo azilkërkues tjetër i rritur i ndaluar në atë kohë.

Duke pasur parasysh kushtet materiale të kënaqshme dhe kohën relativisht të shkurtër të qëndrimit, trajtimi i kërkuesve nuk arrinte nivelin minimal të ashpërsisë së nevojshme për të derivuar trajtim çnjerëzor në kuptim të nenit 3. Për rrjedhojë, Gjykata nuk gjeti shkelje.

Neni 13 marrë së bashku me nenin 3

Ankimet e kërkuesve për kushtet në të cilat ata ishin mbajtur ishin “të diskutueshme” për qëllime të nenit 13. Megjithatë, qeveria nuk kishte paraqitur ekzistencën e ndonjë mjeti juridik me anë të të cilit kërkuesit mund të kishin adresuar ankimet e tyre në nivel të brendshëm. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 13 të marrë së bashku me nenin 3.

Neni 3 (në lidhje me rrezikun për t`ju nënshtruar trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës)

Gjykata vërejti se kërkuesit u larguan nga Hungaria në zbatim të Dekretit të Qeverisë 191/2015, i cili paraqiti një ndryshim të papritur në qëndrimin e shtetit hungarez ndaj Serbisë në lidhje me perspektivën e procedurave të azilit, duke renditur këtë të fundit si një vend të tretë të sigurt dhe duke krijuar një prezumim në këtë drejtim, pavarësisht raporteve të UNHCR-së dhe organizatave ndërkombëtare, që tregojnë mungesën e procedurave të drejta dhe efikase të azilit në Serbi.

Në lidhje me procedurën së cilës i ishin nënshtruar kërkuesit, Gjykata vërejti se ajo nuk u gjet e përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e nevojshme kundër një rreziku real të trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Autoritetet hungareze u mbështetën në një referencë skematike në listën e qeverisë për vendet e treta të sigurta, duke mos marrë parasysh raportet për vendin dhe prova të tjera të paraqitura nga kërkuesit. Kështu, autoritetet u vendosën kërkuesve një barrë prove të padrejtë dhe të tepërt.

Më tej Gjykata vërejti se për shkak të një gabimi, kërkuesi i parë u intervistua dhe u pajis me një fletëpalosje informuese mbi procedurat e azilit në një gjuhë që nuk fliste. Për më tepër, të gjitha informatat që kërkuesit pranuan ishin të përfshira në një fletushkë, pavarësisht faktit se ata ishin të dy analfabetë. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në procedurën e azilit ka qenë jashtëzakonisht e kufizuar.

Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkuesit nuk kanë përfituar nga garancitë efektive të cilat do t`i kishin mbrojtur ata nga ekspozimi ndaj një rreziku real për t`u nënshtruar trajtimin çnjerëzor ose degradues në kundërshtim me nenin 3.

Neni 41

Gjykata i akordoi secilit kërkues 10,000 euro në kuadër të dëmit jo-material dhe 8,705 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Të drejtat e mbrojtura nga neni 3 janë absolute dhe nuk mund të derogohen për shkak të emergjencave publike

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN IRLANDA K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 5310/71)

18 janar 1978

1. Faktet kryesore

Kjo çështje lindi nga kriza tragjike dhe e vazhdueshme që përjetoi Irlanda e Veriut. Në muajin mars 1975, trazirat e viteve të fundit në Ulster kishin shkaktuar më shumë se 1 100 të vdekur dhe 11 500 të plagosur, si dhe shkatërrime pasurish që arrinin shumën mbi 140 milionë livra. Ato merrnin formën herë si prishje rendi, herë si akte terrorizmi, që do të thotë dhunë e organizuar për qëllime politike.

Më 9 gusht 1971, qeveria e Irlandës së Veriut përdor kompetencat e saj speciale që përfshijnë arrestimin, paraburgimin dhe internimin e disa personave pa gjykim. Këto kompetenca "jogjyqësore" vazhduan të ushtroheshin edhe pas 30 marsit 1972, datë në të cilën funksionet e qeverisë dhe të parlamentit të gjashtë konteve iu akorduan autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar. Sipas një burimi zyrtar, ato kishin në shënjestër Ushtrinë Republikane Irlandeze (IRA), organizatë klandestine paramilitare; pas 5 shkurtit 1973, ato u përdorën edhe kundër personave të dyshuar si terroristë "besnikë". Legjislacioni që i akordoi këto kompetenca dhe niveli i përdorimit të tyre kanë evoluuar gjatë zhvillimit të çështjes. Të interesuarit i ishin nënshtruar një ose disa masave që merrnin formën e një arrestimi fillimisht për t'i marrë në pyetje, të një paraburgimi të zgjatur për një shqyrtim plotësues dhe të një paraburgimi parandalues për një kohë të papërcaktuar me ligj. E drejta penale qëndroi në fuqi gjatë zbatimit të kompetencave speciale.

Më 16 dhjetor 1971, qeveria Irlandeze iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut me një kërkesë duke pretenduar se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur nene të ndryshme të Konventës në Irlandën e Veriut, kryesisht nenet 3, 5, 6, 14 dhe 15. Ajo pohoi në thelb se shumë persona të privuar nga liria e tyre me anë të kompetencave speciale janë keqtrajtuar, se këto kompetenca nuk janë të pajtueshme me Konventën dhe mënyra e zbatimit të tyre është një diskriminim i bazuar mbi opinione politike. Pra, Gjykata thirrej për t'u shprehur mbi ekzistencën e praktikave dhe jo mbi rastet individuale.

2. Vendimi i Gjykatës

Qeveria e Republikës së Irlandës e paraqiti kërkesën para Komisionit duke pohuar se praktikat e ndryshme të marrjes në pyetje të përdorura nga britanikët - në veçanti të ashtuquajturat 'pesë teknikat' - dhe praktikat e tjera ndaj të cilëve u nënshtruan të dyshuarit përbënin torturë dhe trajtim çnjerëzor ose degradues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

Neni 3

Përpara Gjykatës, qeveria Britanike nuk e kundërshtoi opinionin e Komisionit mbi këto dy pika: gjithashtu ajo merrte zotimin pa kusht se "pesë teknikat" nuk do të përdreshin më në asnjë rrethanë si ndihmëse në seancat e pyetjeve. Për më tepër, ajo mbështeste mendimin se një vendim i Gjykatës mbi këto çështje nuk do të sillte ndonjë dobi, duke pasur parasysh zotimin dhe masat e marra nga Mbretëria e Bashkuar. Gjykata pranoi zotimin e Mbretërisë së Bashkuar; por pavarësisht nga mungesa e kundërshtimit të disa shkeljeve të nenit 3, ajo njëzëri u shpreh se duhej marrë një vendim lidhur me to. Ajo analizoi situatën në qendra të ndryshme pyetjesh ose paraburgimi.

Rasti i parë: qendra ose qendrat e paignifikuar. Në gusht dhe tetor 1971, katërm-bëdhjetë persona të paraburgosur në një ose disa qendra i nënshtrohen një lloji seance pyetjesh "të tepruar". Kjo përfshin zbatimin e pesë teknikave që konsistojnë në qëndrimin pas murit për disa orë me radhë, vënien e një kapuçi të zi ose të errët në kokën e të dënuarve, nënshtrimin e vazhdueshëm ndaj zhurmave të forta dhe irrituese, privimin nga gjumi dhe privimin nga ushqimi dhe uji.

Dëshmi të detajuara nga dy të paraburgosur treguan se këto teknika, të quajtura ndonjëherë teknika "çorientimi" ose "privimi shqisash", zbatoheshin tek ata gjatë katër ose pesë ditësh me disa pushime ndërmjetëse, kohëzgjatja e të cilave nuk mundi të përcaktohej. Gjykata theksoi se këto teknika ishin përdorur të gjitha së bashku, me paramendim, gjatë disa orëve dhe i kanë shkaktuar personave në mos dëmtime konkrete, të paktën vuajtje të forta fizike dhe morale dhe kanë shkaktuar tronditje të rënda psikike gjatë seancave të pyetjeve. Për më tepër, ato ngjallnin tek viktimat ndjenjë frike, ankthi, inferioriteti deri në poshtërim dhe thyenin rezistencën e tyre fizike ose psikike. Nga njëra anë, Gjykata konkludoi se përdorimi i pesë teknikave analizohet si një trajtim çnjerëzor dhe degradues. Nga ana tjetër, ajo vlerësoi se zbatimi i teknikave nuk mund të cilësohej si torturë, sepse këto teknika nuk kishin shkaktuar vuajtje të një intensiteti të tillë dhe egërsie të veçantë që përmban fjala torture.

Rasti i dytë: Palace Barracks. Në vjeshtë të vitit 1971, anëtarët e Royal Ulster Constabulary⁸⁴ keqtrajtojnë shumë të paraburgosur në këtë kamp ushtarak (për shembull me shqelma dhe grushte), gjë që i shkaktoi atyre vuajtje të mëdha dhe dëme trupore ndonjëherë të konsiderueshme. Gjykata njëzëri konstatoi ekzistencën e një praktike trajtimitesh çnjerëzore, por gjykoj se nuk bëhej fjalë për një praktikë torture sepse intensiteti i vuajtjeve të provokuara nga veprimet e denoncuar nuk e arrinte nivelin e veçantë që implikonte nocioni i torturës. Për më tepër, ajo nuk e mori parasysh si fakt atë që praktika në fjalë të ketë vazhduar përtej vjeshtës së vitit 1971.

Rasti i tretë: Vendet e tjera. Gjykata e cilësoi trajtimin e të paraburgosurve në kampin ushtarak të Ballykinler (qarku i Down-it) në gushtin e vitit 1971, që përmbante kryerjen e detyruar të ushtrimeve të rënda, si praktikë poshtëruese dhe përçmuese; por ajo vendosi që kjo praktikë nuk ishte në kundërshtim me nenin 3.

Së fundi, Gjykata çmoi se nuk mund ta këshillonte Mbretërinë e Bashkuar ashtu si e kërkonte qeveria Irlandeze, për të angazhuar ndjekje penale ose disiplinore kundër atyre që kishin kryer, mbuluar ose toleruar shkeljet e nenit 3 të konstatuara nga Gjykata.

Neni 3 ndalon torturën dhe trajtimin ose dënimin degradues. Qeveria irlandeze pretendoi se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur këtë nen.

Gjykata përsëriti deklaratën e Komisionit në mënyrë që keqtrajtimi të përfshihet në objektin e nenit 3 duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ dhe varet nga tërësia e rrethanave të rastit, si p.sh., kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës etj.

Gjykata theksoi se Konventa ndalon, në terma absolutë, torturën dhe dënimin çnjerëzor ose degradues, pavarësisht nga sjellja e viktimës. Prandaj, ndryshe nga shumica e dispozitave të Konventës, neni 3 nuk parashikon përjashtime dhe, sipas nenit 15 (2), nuk mund të ketë shmangie, madje edhe në rastet e një emergjence publike që kërcënon jetën e shtetit.

Gjykata formuloi të njëjtin mendim si Komisioni në lidhje me “pesë teknikat”. Ajo konstatoi se këto ishin zbatuar me paramendim dhe për orë të tëra, duke shkaktuar të paktën vuajtje intensive fizike dhe mendore ndaj personave të nënshtuar ndaj “teknikave” dhe gjithashtu çoi në çrregullime akute psikike gjatë marrjes në pyetje.

84 Policia Mbretërore e Ulsterit.

Prandaj, këto praktika binin në kategorinë e trajtimit çnjerëzor në kuptim të nenit 3. Teknikat ishin po ashtu degraduese pasi ato ngjallin në viktimat e tyre ndjenja të frikës, ankthit, inferioritetit, poshtërimit dhe madje duke u shkaktuar ulje të rezistencës fizike ose morale.

Për të përcaktuar nëse “pesë teknikat” duhet të cilësohen si torturë, Gjykata duhet të ketë parasysh dallimin midis torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues, të parashikuara në nenin 3. Sipas Gjykatës, dallimi rrjedh kryesisht nga një ndryshim në intensitetin e vuajtjeve të shkaktuara. “Tortura” sjell pasoja të posaçme të cilat rrënjosen thellë tek personi ndaj të cilit janë ushtuar në raport me me trajtimin çnjerëzor të qëllimshëm, duke shkaktuar vuajtje shumë serioze dhe mizore.

Megjithëse “pesë teknikat” përbënin trajtim çnjerëzor dhe degradues, dhe megjithëse objekti i tyre ishte nxjerrja e rrëfimeve, dhënia e emrave dhe / ose informacione të tjera, dhe megjithëse ato zbatoheshin në mënyrë sistematike, ato nuk passillnin vuajtje të një intensiteti dhe mizorie të veçantë për tu konsideruar si torturë.

Gjykata i përcaktoi teknikat e zbatuara nga qeveria si të papajtueshme me Konventën pasi ato konsistonin në një ‘një tërësi shkeljesh identike ose analoge të cilat janë të shumta dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, jo vetëm ndaj incidenteve apo përjashtimeve të izoluara, por ndaj një modeli apo sistemi’. Në një situatë të tillë, Gjykata theksoi se do të ishte e pakonceptueshme që autoritetet më të larta të një Shteti t’u mos ishin në dijeni të praktikave të tilla. Për më tepër, Gjykata bëri të qartë se, sipas Konventës, këto autoritete janë rreptësisht përgjegjëse për sjelljen e vartësve të tyre dhe vartësit duhet të zbatojnë detyrat dhe udhëzimet e dhëna prej autoriteteve më të larta.

Gjykata arriti në përfundimin se përdorimi i “pesë teknikave” përbënte një praktikë të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues dhe se kjo praktikë përbënte shkelje të nenit 3.

Marrja e provave me forcë përbën shkelje të të drejtave të kërkuesit në kuadër të ndalimit e trajtimit çnjerëzor e poshtërues dhe procesit të rregullt

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN JALLOH k. GJERMANSË

(Kërkesa nr. 54810/00)

11 korrik 2006

1. Faktet kryesore

Çështja ka të bëjë me një kërkesë të paraqitur nga Abu Bakah Jalloh, një shtetas nga Sierra Leone, i cili ka lindur në 1965 dhe ka jetuar në Gjermani.

Më 29 tetor 1993, disa policë të veshur si civilë pikasën që kërkuesi po nxirrte dy qese të vogla plastike nga goja e tij duke i dorëzuar ato duke marrë para në këmbim. Duke marrë parasysh që qeset përmbanin drogë, oficerët e policisë shkuan për të arrestuar kërkuesin, i cili gjatë arrestimit gëlltiti një tjetër qese të vogël që e kishte ende në gojë. Meqë nuk ju gjet asnjë drogë, prokurori publik kompetent për çështjen urdhëroi që kërkuesit t'i jepej një ilaç që provokonte vjelljen me qëllim që ai të nxirrte qesën e gëlltitur.

Kërkuesi u dërgua në spital ku u vizitua nga mjeku. Pasi refuzoi të merrte ilaçin që nxiste vjelljen, katër oficerë të policisë e shtrinë përtokë dhe nga ana tjetër mjeku i futi kërkuesit një sondë përmes hundës duke i provokuar vjelljen me forcë. Gjithashtu, mjeku i injektoi atij një lloj tjetër ilaçi provokues për vjelljen. Si rezultat, kërkuesi vulli një qese të vogël që përmbante 0.2182 g kokainë. Pak më vonë ai u ekzaminua nga një mjek, i cili konfirmoi se gjendja e tij shëndetsore nuk përbënte shkak për të mos shkuar në paraburgim. Rreth dy orë pas dhënies së ilaçit që nxiste vjelljen, kërkuesi, i cili u kuptua që nuk fliste gjermanisht, pasi po fliste një anglishte të çalë tha se ishte shumë i lodhur për të bërë një deklaratë në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.

Më 30 tetor 1993, kërkuesi u akuzua për trafik droge dhe u la në paraburgim. Avokati i tij i ngriti pretendimet mbi tre argumente kryesore në mbrojtjen e tij: së pari, provat kundër tij ishin marrë në mënyrë të paligjshme dhe për rrjedhojë nuk mund të përdoshin gjatë procesit penal; së dyti, punonjësit e policisë dhe mjeku që kishin marrë pjesë në proces ishin fajtorë për shkaktimin e lëndimeve trupore gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare; së treti, përdorimi i substancave toksike ishte i ndaluar nga Kodi i Procedurës Penale të Gjermanisë dhe gjithashtu masa e marrë ishte joproporcionale sipas këtij Kodi, pasi rezultati do të kishte qenë i njëjtë duke pritur derisa qesja të dilte jashtë në mënyrë natyrale.

Më 23 mars 1994, Gjykata e Rrethit Gjyqësor e dënoi kërkuesin me një vit burg për veprën penale të trafikut të drogës. Pas ankimit të vendimit, dënimi i tij u ul në 6 muaj, por ai rrëzua më vonë. Gjithashtu, një ankimim i mëtejshëm u hodh sërisht poshtë.

Gjykata Kushtetuese Federale e cilësoi kërkesën kushtetuese të kërkuesit si të pa-pranueshme, duke konkluduar se ai nuk kishte shteruar të gjitha mjetet në dispozicion para gjykatave penale gjermane. Gjykata, gjithashtu vërejti se masa në fjalë nuk përbënte asnjë kundërshtim kushtetues në lidhje me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor ose të drejtën e heshtjes (mosinkrimimit të vetes), siç garantohet nga Kushtetuta Gjermane.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi paraqiti një kërkesë më Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 30 janar të vitit 2000. Më 1 shkurt 2005 Dhoma të cilës ju caktua rasti, ja kaloi në juridik-sion Dhomës së Madhe, sipas nenit 30 të Konventës.

Kërkuesi u ankua se atij i ishte dhënë më forcë një një ilaç që provokonte vjelljen dhe se provat e marra në këtë formë - sipas tij, në mënyrë të paligjshme - ishin përdorur kundër tij gjatë procesit gjyqësor. Ai më tej u ankua se i ishte shkelur e drejta për të mos dhënë dëshmi kundër vetes së tij. Për këtë ai e mbështeste kërkesën e tij në nenet 3, 6 dhe 8 të Konventës.

Neni 3

Gjykata theksoi se Konventa në parim, nuk e ndalonte rekursin e një ndërhyrje mjekësore me dhunë cila do të ndihmonte hetimin e një veprë penale. Megjithatë, çdo ndërhyrje në integritetin fizik të një personi e kryer me qëllim marrjene provave duhej të ishte subjekt i një shqyrtimi rigoroz.

Gjykata kishte në vëmendje problemin me të cilin përballeshin Shtetet lidhur me përpjekjet e tyre për të luftuar dëmin që iu shkaktonte shoqërive të tyre nga trafiku i drogës. Megjithatë, në rastin në fjalë, ishte e qartë se masa e ndërmarrë kundër trafikantit të rrugës që kishte mbajtur drogën në gojën, nuk përbënte rrëzikshmëri të lartë duke qenë se sasia e shitjes së drogës ishte e një shkalle jo të madhe. Kjo gjithashtu ishte reflektuar dhe në dënimin e tij. Gjykata nuk ishte e bindur se dhënia me forcë e ilaçit që provokonte vjelljen ishte e domosdoshme për marrjen e provave. Autoritetet e akuzës thjesht mund të kishin pritur që droga të kishte dalë në mënyrë natyrale nga organizmi i kërkuesit, pasi kjo ka qenë metoda e përdorur nga shumë

shtete të tjera anëtare të Këshillit të Evropës lidhur me hetimet mbi veprat penale të narkotikëve.

Gjykata vuri në dukje se as palët dhe as ekspertët nuk mund të binin dakord nëse përdorimi i ilaçeve që provokojnë vjelljen ishte i rrezikshëm. Ai vuri në dukje se në shumicën e shteteve gjermane dhe të paktën në një shumicë të madhe të shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës, autoritetet shmangin përdorimin e ilaçeve që provokojnë vjelljen me forcë, fakt që priret të sugjerojë se masa konsiderohet se përbën rrezik shëndetësor.

Përsa i përket mënyrës së përdorimit të ilaçeve që provokojnë vjelljen, Gjykata vuri në dukje se, pas përdorimit të forcës brutale, kërkuesit iu fut një tub përmes hundës në stomakun tij me qëllim për ta dëmtuar atë fizikisht dhe psikologjikisht. Kjo duhet t'i ketë shkaktuar atij dhimbje dhe ankth. Më pas sërish kundër vullnetit të tij kërkuesit ju injektua një ilaçi tjetër që provokonte vjelljen. Gjithashtu, Gjykata vërejti se duhej të merrej në konsideratë fakti që kërkuesit i ishte shkaktuar vuajtje psikologjike, ndërkohë që priste që ilaçi që provokonte vjelljen të jepte efektin e tij dhe se gjatë asaj kohe atij i ishte kufizuar lëvizja dhe mbahej nën vëzhgim. Duke qenë i detyruar të villte në kushte të tilla duhet të ketë qenë mjaft poshtëruese për të, krahasuar me faktin që mund të prisnin që droga të dilte jashtë në mënyrë natyrale.

Në përfundim, Gjykata vërejti se autoritetet gjermane e kishin cenuar rëndë integritetin fizik dhe psikologjik të kërkuesit, kundër vullnetit të tij. Megjithëse nuk kishte qenë ky qëllimi, masa e marrë kishte shkaktuar tek kërkuesi si dhimbje fizike ashtu edhe vuajtje psikologjike. Për rrjedhojë, ai ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, veprime që janë në shkelje të nenit 3.

Neni 8

Gjykata vërejti se asnjë çështje e veçantë nuk u pretendua në bazë të nenit 8 të Konventës.

Neni 6

Gjykata vuri në dukje se, edhe nëse qëllimi i autoriteteve nuk kishte qenë shkaktimi i dhimbjes dhe vuajtjes ndaj kërkuesit, përveçse marrja e provave, ky rezultat erdhi nga një masë që përbënte shkelje të një prej të drejtave themelore të garantuara nga Konventa. Për më tepër, droga e marrë në këtë mënyrë përbënte elementin vendimtar në bindjen së kërkuesi ishte fajtor. Së fundi, interesi publik në dënimin e kërkuesit nuk mund të justifikonte marrjen e provave në mënyrë të tillë me qëllim që

të përdorshin gjatë gjykimit. Për rrjedhojë, përdorimi i provave të drogës së përfiturar nga marrja me dhunë përmes injektimit të ilaçeve që provokojnë vjelljen në rastin konkret kërkuesit, përbënin shkelje të procesit të rregullt në tërësi.

Pavarësisht këtij konstatimi, Gjykata e konsideronte të përshtatshme për të trajtuar gjithashtu kërkesën e kërkuesit se mënyra ishin marrë dhe përdorur provat, kishin shkelur të drejtën e kërkuesit për të mos u shprehur dhe dëshmuar kundër vetes së tij.

Gjykata përsëriti se përdorimi i ilaçeve që provokonin vjelljen përbënte një trajtim çnjerëzor dhe poshtërues. Më tej, edhe pse ligji gjerman ndërmorri masa mbrojtëse kundër përdorimit arbitrar ose të papërshtatshëm të masës së përdorur, kërkuesi, duke u mbështetur në të drejtën e tij për të heshtur, kishte refuzuar të kryente një ekzaminim paraprak mjekësor dhe i ishte nënshtruar procedurës pa një ekzaminim të plotë të tij lidhur me aftësinë fizike nëse e përballonte ose jo këtë lloj mase. Së fundmi, barnat e marra në këtë mënyrë ishin prova vendimtare në bindjen se ai ishte fajtor. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se administrimi i provave të fituara nga injektimin me forcë i ilaçeve që provokonin vjelljen shkelnin të drejtën e tij për të mos e akuzuar veten duke derivuar në një proces të parregullt në tërësi.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit shumën prej 10,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 5,868.88 euro për shpenzimet gjyqësore.

Mungesa e një hetimi efektiv mbi pretendimet për nënshtrimin ndaj torturës të një personi me origjinë etnike rome

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN JASAR k. “ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË”

(Kërkesa nr. 69908/01)

15 shkurt 2007

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Pejrusan Jasar, është shtetas maqedonas me origjinë etnike rome, i lindur në vitin 1965 dhe jeton në Štip (“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”).

Më 16 prill 1998, kërkuesi ishte në radhë në një lokal, nga ku filloi një sherr. Disa oficerë policie shkuan tek lokali për të vendosur rendin dhe qetësinë, ku gjatë operacionit kërkuesi u plagos.

Qeveria dhe z. Jasar dhanë dëshmi të ndryshme lidhur me faktin sesi u plagos kërkuesi.

Kërkuesi deklaroi se policët e kapën atë për flokësh dhe e detyruan të hipte në furgonin e policisë. Ai u çua në komisariat, ku deklaroi se u godit në kokë dhe u rrah me një shkop nga një polic. Raporti mjekësor i paraqitur një ditë më pas konstatonte se kërkuesi kishte pësuar “lëndime të lehta trupore” në komisariatin e policisë, në formën e plagëve të shumta në kokë, duar dhe në kurriz.

Sipas autoriteteve të paditura, kërkuesi ishte duke pritur në rradhën që mbahej tek lokali dhe më vonë u dërgua në komisariatin e policisë pasi kishte penguar policët në kryerjen e detyrës. Sipas autoriteteve, ndaj kërkuesit nuk është përdorur dhunë në komisariatin e policisë dhe as nuk është ngritur ndonjë akuzë kundër tij.

Në maj 1998, kërkuesi paraqiti një kallzim penal pranë prokurorit publik kundër një punonjësi të paidentifikuar të policisë. Pas dy kërkesave, prokurori publik deklaroi se në nëntor të vitit 1999, ai i kishte kërkuar zyrtarisht Ministrinë e Punëve të Brendshme që të kryente hetime shtesë. Por lidhur me këtë kërkesë nuk ka pasur asnjë tregues se janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm hetimi.

Kërkuesi gjithashtu paraqiti dhe një kërkesëpadi civile ndaj Shtetit, duke u ankuar se ai ishte viktimë e brutalitetit të policisë. Në mars të vitit 1999 ankesa e tij për dëmtime ju hodh poshtë. Gjykatat vendase, në bazë të provave me dëshmitarë dhe një

eksperti mjekësor, konstatuan se kërkuesi mund të ishte plagosur në lokal, qoftë si rezultat i sherrit që ndodhi atje ose duke i rezistuar forcave të policisë në momentin e arrestimit, pasi pas arrestimit policët nuk kishin përdorur forcë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankuar se ai ishte keqtrajtuar nga policia dhe se për këtë nuk u krye asnjë hetim efektiv. Ai e mbështeste kërkesën e tij në nenin 3 dhe 13 të Konventës.

-

Neni 3

Lidhur me keqtrajtimin e pretenduar

Gjykata vërejtë se nuk kishte marrë asnjë provë që mund të vinte në pikëpyetje vendimet e gjykatave vendase dhe mbështeste pretendimet e kërkuesit. Tetë vjet pas ngjarjeve në fjalë - kryesisht për shkak të mosveprimit të autoriteteve kombëtare dhe hezitimit për të kryer një hetim efektiv lidhur me pretendimet e kërkuesit - Gjykata nuk ishte në gjendje të përcaktonte se cili version i ngjarjeve ishte më i besueshëm.

Në përfundim, duke qenë se dëshmitë e paraqitura para Gjykatës nuk i mundësonin asaj të konstatonte përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit fizik dhe psikologjik gjatë kohës së arrestimit nga policia, Gjykata konkludoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 3 për shkak të keqtrajtimin të pretenduar.

Lidhur me mungesën e një hetimi efektiv

Gjykata vuri në dukje se avokati i kërkuesit paraqiti një kallzim penal lidhur me pretendimin për dhunë nga ana e policisë marrë së bashku me raportin mjekësor, për sa kohë që çështja u soll në vëmendjen e autoriteteve vendase përkatëse. Gjykata kishte bindjen se ajo ngriti të paktën një dyshim të arsyeshëm lidhur me faktin se dëmtimet e kërkuesit mund të ishin shkaktuar nga trajtimi që ai kishte pësuar gjatë kohës së arrestimit nga policia. Si i tillë, prokurori publik kishte për detyrë të hetonte nëse ishim përpara faktit të kryerjes së një vepre penale. Megjithatë, e vetmja masë hetimore e ndërmarrë nga prokurori ishte kërkesa e tij për informacione shtesë të paraqitura në Ministri, të cilat ishin bërë pas më shumë se një vit e gjysmë nga kryerja e kallzimit penal.

Për më tepër, mosveprimi i prokurorit publik e pengoi kërkuesin që të kryente vetë kërkesa të mëtejshme dhe i mohoi atij qasjen në seancat pasuese para gjykatës

kompetente. Kërkuesi ishte i ndaluar të vijonte personalisht në paraqitjen e kërkesave pasi prokurori publik nuk kishte marrë ende një vendim për rrëzimin e kallzimit penal.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh mungesën e një hetimi nisur nga pretendimet e ngritura nga ana e kërkuesit se ai ishte keqtrajtuar nga policia gjatë kohës së mbajtjes në paraburgim, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 3.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit shumën prej 3,000 euro për dëmin jomaterial dhe shumën prej 9,148 euro për shpenzimet gjyqësore.

Mungesa e mbikqyrjes ose e kujdesit të specializuar për një person më aftësi të kufizuar mendore që kreu veturasje në burg – përbën shkelje të nenit 3 dhe 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KEENAN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 27229/95)

3 prill 2001

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Susan Keenan, është shtetase britanike, e lindur më 1935 dhe e ëma e Mark Keenan, i cili vdiq në burgun e Exeter në Angli në moshën 28 vjeçare nga asfiksia pasi u vetëvar.

Mark Keenan ishte trajtuar me mjekim kundër skizofrenisë që në moshën 21 vjeçare dhe se dosjen e tij mjekësore konstatoheshin simptoma të paranojës, të sulmeve ndaj të tjerëve, të dhunës dhe të shaktimit të vuajtjeve të qëllimta ndaj vetes.

Më 1 prill 1993, ai u dërgua në burgun e Exeter, ku fillimisht u mbajt në qendrën mjekësore të tij, si i dënuar me katër vjet burg për shkak se kishte sulmuar të dashurën e vet. Përpjekje të shumta për ta transferuar në burgun e sigurisë së ulët ishin të pasuksesshme për shkak se gjendja e tij përkeqësohej sapo ai transferohej. Më 1 maj 1993, pasi u pyet në lidhje me mundësinë e transferimit të tij në burgun e sigurisë së ulët, z. Keenan sulmoi dy oficerë të spitalit, njërin nga të cilët e plagosi rëndë. Menjëherë pas kësaj ai u vendos në një izolim në dhomën e dënimeve. Më 14 maj, ai u shpall fajtor për sulmin e kryer dhe dënimi i tij me burg u shtua edhe 28 ditë të tjera, përfshi edhe 7 ditë në izolim, duke e shtyrë pra lirimin e tij nga 23 maji 1993 më 20 qershor. Në orën 18:35, të 15 majit 1993, dy policë të burgut e gjetën kërkuesin të varur me çarçaf në hekurat e dritares së qelisë së tij. Në orën 19:05 të të njëjtës ditë ai u shpall i vdekur.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendonte se i biri ishte vetëvararë në burg për shkak të mosmarrjes së masave për mbrojtjen e jetës së tij nga ana e autoriteteve të burgut, ku ai kishte vuajtur trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës për shkak të kushteve të izolimit në të cilat ishte detyruar të rrinte dhe se ajo nuk kishte pasur mjet efektiv në lidhje me pretendimet e saj. Ajo bazohej në nenet 2, 3 dhe 13 të Konventës.

Neni 2

Për të vendosur nëse ka pasur shkelje të nenit 2, Gjykata analizoi nëse autoritetet e dinin ose ishin në gjendje ta dinin se kishte një rrezik imediat që Mark Keenan të kryente vetëvrasje dhe nëse autoritetet kishin bërë gjithçka që, në mënyrë të arsyeshme pritej të bënin, duke pasur parasysh natyrën e rrezikut.

Gjykata vuri në dukje se personat me skizofreni vuanin nga një gjendje në të cilën rreziku i kryerjes së vetëvrasjes ishte i ditur dhe madje i lartë. Megjithatë, ndërsa ishte fakt i ditur se Mark Keenan ishte person me aftësi në kufizuara në aspektin mendor, Gjykatës nuk ju paraqit nga një mjek psikiatër asnjë raport i diagnostikimit me sëmundjen e skizofrenisë. Pra nuk mund të arrihej në përfundimin se kishte një rrezik imediat gjatë periudhës së burgut, megjithëse ndryshueshmëria e kushteve të Mark Keenan kërkonte që ai të mbikëqyrej me kujdes.

Për të vendosur nëse autoritetet e burgut bënë detyrën e tyre si duhet, Gjykata konstatoi së pari që, në tërësi, autoritetet iu përgjigjën në mënyrë të arsyeshme qëndrimit të tij, duke e vendosur nën kujdesin mjekësor brenda burgut dhe nën mbikëqyrje kur ai jepte shenja për tentativë vetëvrasjeje. Ai i nënshtrohej një kontrolli të përditshëm mjekësor nga mjekët e burgut, të cilët në dy herë rresht ishin këshilluar me dy ekspertë të jashtëm që ishin marrë me sëmundjen e Mark Keenan. Mjekët e burgut, të cilët mund të kishin kërkuar që ai të mos mbahej në izolim nuk e bënë këtë gjë, sepse iu duk masa më e përshtatshme që mund të merrej ndaj tij. Pra nuk kishte arsye për autoritetet që të alarmoheshin që më 15 maj 1993 Mark Keenan ishte aq i shqetësuar nga ana psikologjike sa të shkonte deri në vetëvrasje.

Pra, nuk ishte e qartë që autoritetet nuk kishin marrë ndonjë masë që duhet ishte marrë në rastin në fjalë dhe për këtë arsye Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 2.

Neni 3

Për të vendosur nëse z. Keenan i ishte nënshtruar trajtimeve ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese në kuptimin e nenit 3, Gjykata nuk un vu në dijeni për shkak të mungesës së të dhënave mjekësore në lidhje me Mark Keenan, i cili ishte nën një rrezik të parashikueshëm vetëvrasjeje dhe me shqetësime të tjera që mund të mendoheshin për shkak të veçimit dhe të ndëshkimit të tij disiplinor të mëvonshëm. Nga 5 maji deri më 15 maj 1993 nuk kishte pasur shënime në dosjen e tij mjekësore. Duke pasur parasysh faktin që e kishin vizituar disa mjekë të burgut, kjo mungesë shënimesh tregonte një preokupim të pamjaftueshëm për të pasur të dhëna të plota dhe të detajuara në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore gjë që cenonte efektivitetin e çdo procesi kujdesi ose mbikëqyrjeje.

Në vijim, ndërsa mjeku i kategorisë më të lartë në burg u këshillua me mjekun e z. Keenan për pranimin e kryerjes së vizitave të psikiatrit që e kishte vizituar atë edhe më parë, ky i fundit ishte thirrur që ta vizitonte atë më 29 prill 1993. Pas kësaj date Gjykata nuk gjeti asnjë referencë tjetër për vizita nga ana e këtij psikiatri. Edhe pse Dr. Rowe kishte paralajmëruar më 29 prill 1993, që Mark Keenan duhet të ishte mbajtur larg njerëzve derisa ndjenjat e tij paranojake të ishin pakësuar ose shkuar, çështja e kthimit të tij në pjesën qendrore të burgut ishte diskutuar me të që të nesërmen. Ndërsa gjendja e tij vazhdonte të përkeqësohej, një mjek i burgut, jo i specializuar në psikiatri, i riktheu Mark Keenan trajtimin me mjekimin e mëparshëm, pa u këshilluar me mjekun psikiatër që kishte rekomanduar fillimisht ndryshimin e terapisë. Pas kësaj erdhi sulmi ndaj dy policëve të burgut. Megjithëse, Mark Keenan i kërkoi mjekut të burgut që të vinte në djeni drejtorin e burgut që do vendoste për pasojat e sulmit, pasi ky sulm erdhi si pasojë e ndryshimit të terapisë së tij, dhe asnjë psikiatër nuk u pyet në lidhje me trajtimin e tij të mëtejshëm ose përsa i përket mundësisë së tij për t'iu përshtatur dënimit dhe ndëshkimit vijues.

Pra, Gjykata konstatoi mungesë të mbikëqyrjes dhe kujdesit ndaj gjendjes së Mark Keenan dhe se mungesa e këshillave të specializuara psikiatrike në lidhje me gjendjen dhe trajtimin e tij nxirrte në pah mangësi domethënëse përsa i përket trajtimit mjekësor që u duhet ofruar personave me sëmundje mendore që mendohet se mund të kryejnë vetëvrasje. Dënimi i rëndë disiplinor i tij, në këto rrethana, me shtatë ditë izolim në godinën e ndëshkimit dhe me 28 ditë më tepër burg, i vendosur dy javë pas ngjarjes dhe vetëm nëntë ditë përpara lirimit të tij, mund ta ketë cenuar së tepërmi qëndrueshmërinë e tij fizike dhe morale. Si i tillë ai nuk ishte në përputhje me standartet e trajtimit të kërkuar ndaj personave me të aftësi të kufizuara mendore.

Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

Neni 13

Gjykata vuri në dukje se në kuadrin e nenit 13 dilnin në pah dy çështje: së pari nëse vetë Mark Keenan kishte pasur mundësi të shfrytëzonte ndonjë mjet ankimor ndaj dënimit që i ishte dhënë dhe, së dyti, nëse, pas vetëvrasjes së tij, kërkuesja kishte pasur mundësi të përdorte një mjet efektiv, qoftë në emrin e saj, qoftë si përfaqësuese e të birit.

Në lidhje me Mark Keenan, Gjykata vuri në dukje se dënimi për zgjatjen e burgimit dhe për izolimin e tij ishte dhënë më 14 maj 1993 dhe se ai kishte kryer vetëvrasje më 15 maj 1993. Ashtu siç e kishte konstatuar edhe Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut, Qeveria nuk mund të ishte përgjegjëse për faktin se atij nuk i kishte ofruar një mjet ankimor që ti ishte vënë në dispozicion brenda 24 orëve.

Megjithatë asnjë mjet ankimor efektiv nuk kishte qenë i mundur të përdorej nga Mark Keenan që të ishte në gjendje t'i ofronte atij mundësinë e shfuqizimit të dënimit të dhënë brenda periudhës së izolimit prej shtatë ditësh ose edhe brenda periudhës së zgjatjes së afatit të burgimit prej 28 ditësh. Edhe në qoftë se prezumohet se do t'i ishte ofruar një rishikim gjyqësor për të ndryshuar vendimin e Drejtorit, nuk do të kishte qenë e mundur për Mark Keenan të kishte ndihmë dhe përfaqësim ligjor dhe të mund të paraqiste një ankim brenda një periudhe kaq të shkurtër. Nga ana tjetër, procedurat e ngjashme në një rast tjetër në të cilin kundërshtohej një vendim i Drejtorisë së Burgut zgjatën rreth gjashtë javë.

Në qoftë se, siç u pretendua, Mark Keenan nuk ishte në një gjendje të tillë shëndetësore mendore sa të përdorte çdo mjet ankimi të mundshëm, atëherë kjo do të thotë se ishte nevoja për një rishikim automatik, pa kërkesën e tij lidhur me vendimin e dënimit. Për më tepër, Gjykata nuk u bind që një ankim efektiv kundër dënimit do të kishte ndikuar në ndryshimin e rrjedhës së ngjarjeve. Mark Keenan ishte dënuar në rrethana që, sipas saj, ngrinin dyshime për një shkelje të nenit 3 dhe për këtë arsye ai, në bazë të nenit 13, kishte të drejtën për një mjet ankimor që do të shfuqizonte dënimin e tij përpara se ai të ishte ekzekutuar ose të kishte pasur një rrjedhë të tillë.

Duke iu rikthyer mjeteve të mundshme efektive për ankim pas vdekjes së Mark Keenan, Gjykata vuri në dukje se hetimi nuk përbënte një mjet efektiv për të përcaktuar përgjegjësinë e autoriteteve për ndonjë keqtrajtim të pretenduar ose që të mund të ofronte shpërblim të drejtë. Kërkuësja duhet të kishte pasur mundësi që të kërkonte shpërblim të drejtë për dëmin jomaterial dhe për atë që i biri kishte vuajtur përpara vdekjes. Për më tepër nuk pati asnjë mjet efektiv ankimor në dispozicion të kërkuësës për të përcaktuar nëse kishte vend për gjetjen e përgjegjësve lidhur me vdekjen e djalit të saj. Sipas opinionit të Gjykatës, ky ishte një element thelbësor i mjetit efektiv të parashikuar nga neni 13 për një prind që ka humbur fëmijën.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuësës shumën prej 10,000 £ lidhur me dëmin material dhe shumën prej 21,000 për shpenzimet gjyqësore.

Moskryerja e një hetimi efektiv nga ana e agjentëve shtetërorë gjatë arrestimit dhe ndalimit në komisariatën e policisë dhe në paraburgim përbënte shkelje të nenit 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KRSMANOVIĆ K. SERBISË

(Kërkesa nr. 19796/14)

19 dhjetor 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Đorđe Krsmanović, është shtetas Serb dhe jeton në Zemun (Serbi). Në 2003, kërkuesi u arrestua dhe u ndalua si pjesë e një operacioni në shkallë të gjerë të policisë i urdhëruar pas vrasjes së Kryeministrit Serb në vitin 2003. Pas ndodhisë së vrasjes, qeveria serbe shpalli gjendjen e jashtëzakonshme.

Z. Krsmanović ishte anëtar i grupit kriminal të lidhur me Klanin Zemun, i cili ishte përgjegjës për vrasjen e Kryeministrit. Gjatë hetimeve të policisë për këtë vrasje rreth 10,000 persona u arrestuan dhe u futën në burgim, përfshi këtu të gjithë anëtarët e Klanit Zemun dhe grupet e lidhura me të, pjesë e të cilëve ishte dhe z. Krsmanović. Kërkuesi u arrestua më 1 prill 2003, kur Njësia e Posaçme Anti-Terroriste hyri në banesën ku ai dhe pesë miqtë tij ishin duke u fshehur. Kërkuesi pretendoi se pas ardhjes së Njesisë Speciale Anti-Terroriste ai i ishte nënshtruar abuzimit fizik dhe verbal. Ai pretendonte se ishte goditur dhe rrahur pa dallim dhe se Njësia Speciale i kishte vënë jastëk në kokë dhe e kishte kërcënuar për familjen e tij. Sipas një regjistrimi gjatë arrestimit të tij, i cili u transmetua në televizionin kombëtar në fillim të prillit 2003, ai kishte plagë të dukshme në fytyrë. Me mbërritjen në komisariatën e policisë ai deklaroi se ishte keqtrajtuar gjatë 11 ditëve në vijim, periudhë në të cilën ishte mbajtur në izolim në komisariatën e policisë. Ai pretendonte se ishte nxjerrë jashtë qelisë së tij në mënyrë të vazhdueshme për t'u marrë në pyetje dhe se ishte rrahur, goditur dhe policët i kishin futur shkopin e policisë disa herë në anusin e tij. Më 12 prill 2003, ai u transferua në Burgun e Rrethit të Beogradit, ku nga ekzaminimi i kryer nga mjeku i burgut, kërkuesi kishte plagë në shpatat e këmbëve, në pëllëmbët e duarve, në fytyrë në shpatulla dhe në të ndenjura. Gjatë gjashtë ditëve të para të ndalimit të tij në Burgun e Rrethit të Beogradit ai u vendos në një qeli më vete dhe kishte kontakt vetëm me mjekët që e kishin ekzaminuar atë. Përfundimisht, ai u akuzua, ndër të tjera, për vepra penale të trafikut të drogës dhe u dënua me katër vjet e dhjetë muaj burgim. Në qershor 2004 ai u lirua në pritje të vendimit të gjykitimit në apel.

Pretendimet për keqtrajtim të z. Krsmanović u hetuan nga tre autoritete të ndryshme - Shërbimi i Inspektorit të Përgjithshëm, pas një ankese të paraqitur nga nëna e tij

në vitin 2004; zyra e prokurorisë pas një kallëzimi të parashtruar nga z. Krsmanović, në vitin 2007; dhe një gjyqtar i hetimeve paraprake ku z. Krsmanović mori përsipër vijimin e procesit penal si i dwmtuar akuzues, në vitin 2008. Zyra e prokurorit hapi një hetim zyrtar në vitin 2007, duke marrë në pyetje kërkuesin si dhe tre policët që e kishin arrestuar dhe marrë në pyetje kërkuesin. Të tre hetimet e nisura u ndërprejnë për shkak të mungesës së provave lidhur me keqtrajtimin ose gjetjen e fajtorit. Pavarësisht marrjes në pyetje të oficerëve të policisë të përfshirë në arrestimin dhe ndalimin e tij, nuk u identifikua kurrë asnjë zyrtar i akuzuar për abuzim apo dëshmitarë okularë.

Z. Krsmanović paraqiti një ankim për shkaqe të ligjit në zyrën e prokurorit dhe një kërkesë kushtetuese. Të dyja u hodhën poshtë respektivisht në vitin 2010 dhe 2013.

2. Venimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se autoritetet kishin dështuar të kryerjen e një hetimi efektiv lidhur me pretendimet e tij për keqtrajtim, çka përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës.

Pranueshmëria

Qeveria argumentoi se Gjykata nuk kishte juridiksion në rastet kur ngjarja kishte ndodhur para 3 marsit të vitit 2004, periudhë në të cilën Konventa hyri në fuqi për Serbinë. Megjithatë, Gjykata deklaroi se ka konsideruar vazhdimisht se aspekti procedural për të marrjen në shqyrtim të nenit 2 dhe 3 të Konventës ka fushëveprimin e vet të veçantë të aplikimit dhe vepron në mënyrë të pavarur nga aspekti thelbësor i nenit 2 dhe 3. Kur ngjarjet kishin ndodhur para ratifikimit, vetëm aktet procedurale dhe/ose përjashtimet që kanë ndodhur pas datës së ratifikimit mund të shqyrtohen nga Gjykata në zbatim të *rationae temporis*. Gjithashtu, duhet të ketë një lidhje të reale midis vdekjes ose keqtrajtimet dhe hyrjes në fuqi të Konventës që detyrimet procedurale të kenë fuqi. Në rastin në fjalë Gjykata vuri në dukje se mes keqtrajtimet të pretenduar dhe ratifikimit të Konventës nuk kishte kaluar një kohë e mjaftueshme dhe se të gjitha hapat paraprake hetimore u zhvilluan pas hyrjes në fuqi të Konventës, që do të thotë se ka qenë brenda shqyrtimit të Gjykatës në zbatim të *rationae temporis*.

Qeveria gjithashtu argumentoi se kërkesa ishte parashtruar jashtë afatit. Gjykata vuri në dukje se periudha gjashtë mujore fillon nga data e vendimit përfundimtar në procesin e shterimit të mjeteve juridike të brendshme, që është kërkesa kushtetuese. Në rastin në fjalë, kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion lidhur me ankimimin e vendimeve të organeve gjyqësore. Si rezultat, Gjykata konstatoi se kërkuesi ka paraqitur kërkesën e tij brenda afatit gjashtë mujor nga 11 shtatori 2013,

që është dhe data e marrjes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, kërkesa është parashtruar brenda afatit gjashtë mujor.

Neni 3

Kur një kërkesë individuale paraqitet mbi bazën e një pretendimi të arsyeshëm se një person është keqtrajtuar nga policia ose agjentët e shtetit në kundërshtim me nenin 3, kjo dispozitë marrë së bashku me nenin 1 të Konventës, kërkon kryerjen e një hetimi efektiv. Autoritetet duhet të veprojnë sa më shpejt nga momenti i paraqitjes së një kërkesë. Detyrimi për të hetuar nuk nënkupton detyrimin e pasojës, por të mjeteve ligjore. Një hetim efektiv duhet të jetë i përshtatshëm dhe ata që janë përgjegjës për kryerjen e hetimeve duhet të jenë gjithashtu të pavarur nga ata që janë të përfshirë në ngjarje. Hetimi duhet të jetë i plotë dhe i detyrueshëm, dhe të ndërmerren veprime të menjëhershme pasi të jetë paraqitur kërkesa. Së fundi, një hetim efektiv duhet të përmbajë elementë të mjaftueshëm të shqyrtimit publik me qëllim garantimin e llogaridhënies.

Në këtë rast, Gjykata mbajti parasysh se keqtrajtimi i pretenduar i kërkuesit ndodhi gjatë një gjendje të jashtëzakonshme, pra pas vrasjes së Kryeministrit Serb në vitin 2003. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se ata ishin të vetëdijshëm se kërkuesi u arrestua dhe u ndalua si pjesë e Operacionit Sabre, kur një numër i madh njerëzish u arrestuan dhe u ndaluan. Si kërkuesi ashtu edhe nëna e tij kishin parashtruar ankesa pranë autoriteteve vendase përkatëse që denonconin keqtrajtimin e tyre dhe Gjykata konkludoi që këto ankesa të ishin mjaft të detajuara, duke përfshirë të dhënatë sakta, vendndodhjet, si dhe autorët e mundshëm. Kishte gjithashtu një raport mjekësor që dokumentonte lëndimet e kërkuesit si dhe transmetimin e videos ku tregohet kërkuesi me plagë të dukshme në fytyrë. Të gjitha provat së bashku me ankesat e parashtruara përbënin një "kërkesë bindëse" brenda kuptimit të nenit 3, se kërkuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit. Si përfundim, autoritetet serbe kishin detyrimin për kryerjen e një hetimi efektiv.

Gjykata vuri në dukje se, hetimet kryesisht ishin fokusuar në marrjen në pyetje të disa prej policëve të përfshirë në incident. Kërkuesi dhe nëna e tij nuk u lejuan të marrin pjesë në mënyrë efektive gjatë hetimeve dhe shumë pak vëmendje iu kushtua pretendimeve të kërkuesit pavarësisht dëshmive të paraqitura prej tij. Nuk u identifikua asnjë dëshmitar okular për keqtrajtimin e kërkuesit, çka përbënte mangësi të konsiderueshme në koordinimin mes tri hetimeve. Fakti që hetimet nga autoritetet shtetërore nuk kishin identifikuar as agjentët shtetërorë që keqtrajtuan kërkuesin, e përforconin dyshimin e Gjykatës për efektivitetin e hetimeve.

Këto përfundime ishin të mjaftueshme për Gjykatën për të konkluduar se ndaj kërkuesit nuk ishte garantuar një hetim efektiv dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 3.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 4,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Gjithashtu, Gjykata i akordoi kërkuesit 4,200 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Kohëzgjatja e tepërt e procesve të kujdestarisë dhe dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve përbën shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE M. K. KROACISË

(Kërkesa nr. 10161/13)

3 shtator 2015

1. Faktet kryesore

Kërkueset, znj. M. dhe M., respektivisht nëna dhe vajza e saj e mitur, ishin shtetase korate, të cilat kanë lindur në vitin 1976 dhe 2001, dhe kanë jetuar në Zadar, Koraci.

Znj. M. u martua me z. I.M. më 23 qershor 2001, dhe vajza e tyre lindi më 4 shtator të vitit 2001. Marrëdhëniet e çiftit filluan të përkeqësohet dhe ata nisën procesin për divorc. Më 24 gusht 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Zadarit dha vendimin e divorcit. Sipas vendimit të gjykatës vendase, vajza u la në kujdestari të babait dhe nënës ju dha e drejta për të mbajtur kontakte me vajzën si dhe ju caktua pagesa për mjetet e jetesës që duhej të jepte për të.

Sipas deklaratës së dhënë në polici nga ana e M., më 1 shkurt të vitit 2011, kishte ndodhur një ngjarje e rëndë e abuzimit në familje: babai i saj e goditi në fytyrë, e kapi për fyti dhe abuzoi psikologjikisht me të. Okulisti e diagnostikoi vajzën me mavijosje dhe dëmtim të indit të syrit të majtë duke treguar se lëndimi ishte shkaktuar nga një goditje me grusht. M. kishte raportuar edhe raste të tjera të dhunës fizike dhe psikologjike nga babai i saj të cilat kishin ndodhur tre vitet e fundit duke pranuar se ajo bkishte frikë nga ai, duke qenë se ishte një njeri i dhunshëm.

Si rrjedhojë, e situatës problematike në familje, një sërë seancash të ndërlihdura me njëra tjetrën nisën përpara gjykatave penale të Kroacisë (për të vendosur mbi pretendimin lidhur me abuzimin e fëmijës), gjykatat civile (për të vendosur mbi kujdestarinë dhe divorcin) dhe autoritetet e mirëqenies sociale.

Pas incidentit të 1 shkurtit, më 30 mars 2011, z. I.M., u akuzua nga Prokurori i Shtetit për kryerjen e veprës penale të lëndimeve trupore. Në tetor 2014, procesi nuk kishte nisur ende pasi gjykata në Zadar priste të merrte një pajisje video-link përmes së cilës M. do të regjistrohej gjatë seancës dëgjimore.

Më 27 prill 2011, znj. M., depozitoi një kallzim penale ndaj z. I.M., për abuzim të vajzës së tij, duke cituar incidentin e 1 shkurtit 2001, si dhe pretendimet nga vajza e tyre se

ky nuk kishte qenë rasti i vetem. Kallzimi penal u hodh poshtë në janar 2012, pasi që nuk ishin gjetur elemente të mjaftueshme për të vërtetuar abuzimin.

Paralelisht, më 30 mars 2011, znj. M. paraqiti një kërkesëpadi civile për të anuluar urdhrin e kujdestarisë të 24 gushtit 2007, duke kërkuar që të marrë kujdestarinë e përkohshme të vajzës së saj. Megjithatë, kërkesa për kujdestarinë e përkohshme u refuzua dy muaj më vonë për shkak të mungesës së dëshmisë se abuzimi i pretenduar kishte ndodhur vërtet. Proceset lidhur me kujdestarinë ishin ende në pritje në shkallën e parë të gjykimit në kohën që çështja kishte shkuar për gjykim në GJEDNJ.

Në procesin para autoriteteve të mirëqenies sociale të përfshira në rastin e M., me vendim të datës 7 nëntor 2006, u urdhërua një masë mbrojtëse e fëmijëve për mbikëqyrjen e ushtrimit të autoritetit prindëror me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes. Masa zgjati deri në gusht të 2008. E njëjta masë u vendos më pas nga shtatori 2011 deri në mars 2014 pasi situata familjare nuk kishte pasur ndonjë përmirësim të dukshëm të rastit në fjalë.

Gjatë të gjitha proceseve të mësipërme, M. ishte ekzaminuar nga disa psikiatër dhe psikologë, të cilët kishin konstatuar se fëmija ishte traumatizuar emocionalisht nga ndarja e prindërve dhe nga lidhja e tyre konfliktuale dhe se ajo vazhdimisht kishte shprehur dëshirën për të jetuar me nënën e saj. Megjithatë, nuk ishte vërejtuar asnjë rrezik nëse fëmija do të vazhdonte të jetonte me babain e saj, pasi deklaratat e M. se ishte abuzuar nga babai i saj nuk ishin mjaftueshëm bindëse për të justifikuar heqjen e kujdestarisë nga i ati dhe largimin e saj të menjëhershëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueset pretendonin se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive sipas Konventës pasi autoritetet nuk ndoqën penalisht z. I.M., për veprën penale të abuzimit të fëmijëve të kryer kundër vajzës së tij, e as për mbrojtjen e saj ndaj veprimeve të tjera të dhunshme duke vijuar me qëndrimin e saj në shtëpinë e tij dhe duke mos i hequr kujdestarinë përbënint shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Nenet 3 dhe 8

Duke pasur parasysh se M. kishte paraqitur një dëshmi për abuzim, ishte e mitur dhe viktimë e dhunës në familje, Gjykata vlerësoi se rasti në fjalë përbëntë detyrim pozitiv për shtetin sipas nenit 3 të Konventës për të hetuar rastet e pretenduara të

abuzimit dhe për mbrojtjen e saj nga abuzimi që mund të ndodhte në të ardhmen. Gjatë shqyrtimit të shkeljes së pretenduar sipas nenit 8, Gjykata i shqyrtoi kërkesat e M. duke i marrë në shqyrtim së bashku me nenin 3.

Autoritetet kroate kishin nisur hetime penale vetëm në lidhje me incidentin e 1 shkurtit të 2011, duke mos marrë parasysh të gjitha rastet e mëparshme të abuzimeve të pretenduara që M.-së i ishte dashur të duronte, duke mos e akuzuar z. I.M. lidhur me veprën penale të abuzimit me të mitur dhe në këtë mënyrë duke mbuluar të gjitha rastet e keqtrajtimeve të vazhdueshme që ishin bërë më parë. Për rrjedhojë, autoritetet kishin dështuar në marrjen në shqyrtim të çështjes si një e tërë. Për më tepër, kohëzgjatja e proceseve penale ka qenë tepër e gjatë për të pasur në një hetim efektiv, e cila përbën shkelje të kërkesës për marrjen e masave të menjëhershme dhe brenda një afati të arsyeshëm parë në kontekstin e nenit 3. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të këtij neni.

Përsa i përket pretendimeve mbi shkeljen e detyrimeve pozitive të autoriteteve për të parandaluar keqtrajtimin e mundshëm në të ardhmen duke marrë të gjitha masat e nevojshme të arsyeshme, Gjykata vërtetëse autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë të gjitha hapat e mundshme dhe të nevojshme për të vlerësuar dhe matur rrezikun e keqtrajtimeve të mundshme, si dhe parandalimin e tyre duke marrë parasysh një sërë opinionesh dhe rekomandimeshtë të ndryshme kontradiktore të lëshuara nga autoritete të ndryshme sociale dhe duke shqyrtuar me kujdes të gjitha materialet relevante. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje në këtë pikë të nenit 3.

Neni 8

Kërkueset u ankuan se autoritetet vendase nuk kishin marrë parasysh dëshirën e M.-së për të jetuar me nënën e saj dhe se ajo nuk ishte dëgjuar gjatë proceseve për kujdestarinë, të cilat kishin qenë në pritje pezull për më shumë se katër vjet. Pas tre vjet e gjysmë, M., kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese, të cilën ajo e kishte përshkruar si një reagim ndaj frustrimit që kishte ardhur si rezultat që asaj nuk i ishte lejuar të zgjidhte se me kë dëshironte të jetonte, i ishte mohuar liria e veprimit dhe në këtë mënyrë i ishte kufizuar liria e saj personale. Në bazë të këtyre rethanave kërkueseve ju lindte e drejta të ngrinin pretendime për respektimin e jetës private dhe familjare të ndryshme nga ato të analizuar në kontekstin e nenit 3 dhe, për rrjedhojë Gjykata konstatoi se për këtë kërkohej një shqyrtim i marrë më vete.

Sipas Gjykatës, rasti i në fjalë bënte thirrje për kujdes më të madh nga gjykatat dhe autoritetet kombëtare për sa i përket një të miture të traumatizuar, e cila kishte

pësuar një ankth të madh psikologjik që kishte kulmuar në sjellje që çojnë në lëndim të vetes. Megjithatë, gjykatat vendase nuk kishin kuptuar seriozitetin dhe urgjencën e situatës së M. Ajo që ishte më flagrante për Gjykatën ishte se nuk u mor asnjë hap për të përshpejtuar procedurat edhe pasi M. kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese.

Ekspertët mjeko-ligjorë të psikologjisë dhe psikiatrisë të përfshirë në rastin në fjalë kishin konstatuar se të dy prindërit ishin po aq të papërshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën e tyre, qëndrim ky i mbajtur dhe nga qendra lokale e mirëqenies sociale. Ata gjithashtu kishin konstatuar se M. për disa herë më radhë kishte shprehur dëshirën e madhe për të jetuar me nënën e saj. Siç parashikohet në nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët që janë të aftë të kenë pikëpamjet e tyre dhe të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje për çdo çështje që ka të bëjë me ta, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tyre, në çdo proces që ka të bëjë me ta. M., ishte nëntë vjeç e gjysmë në kohën e fillimit të proceseve dhe trembëdhjetë e gjysmë në kohën e vendimit të Gjykatës. Prandaj, do të kishte qenë e vështirë të argumentohej se, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e saj, ajo nuk kishte qenë e aftë të kishte pikëpamjet e veta dhe t'i shprehte ato lirisht.

Gjykata konstatoi se mos respektimi i dëshirave të M., lidhur me çështjen se me cilin prind do të jetonte përbënte shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës private dhe familjare në kundërshtim me nenin 8 të Konventës. Konkluzionet në lidhje me procedurat e tejkzgjatura mbi kujdestarinë gjenin të njëjtin zbatim edhe në rastin e znj. M., në lidhje me të drejtën e saj për respektimin e jetës private dhe familjare.

Neni 41

Gjykata i ngarkoi shtetit Kroat ti paguante vajzës dhe nënës së saj respektivisht shumën prej 19,500 euro dhe 2,500 euro lidhur me dëmin jomaterial dhe 3,600 euro, bashkarisht për shpenzimet gjyqësore.

Kjo çështje kishte të bënte me detyrimin pozitiv të shteteve për të ngritur dhe zbatuar me efektivitet një sistem penal që ndëshkon të gjitha format e përdhunimit

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M.C. k. BULLGARISË

(Kërkesa nr. 39272/98)

4 dhjetor 2003

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, M.C., është shtetase bullgare e lindur më 1980 dhe pretendonte se kur kishte qenë 14 vjeç, që është edhe moshja e lejuar për kryerjen e marrëdhënieve seksuale të vullnetshme në Bullgari, ishte përdhunuar nga dy djem, A. dhe P., përkatësisht 20 dhe 21 vjeç.

M.C. pretendonte se më 31 korrik 1995, ajo shkoi në një disko me dy djem dhe një shoqe të saj. Në vijim, ajo pranoi që të shkonin së bashku në një disko tjetër. Në kthim, A. sugjeroi që të ndalonin për të notuar në një rezervuar. M.C. qëndroi në makinë. P. u kthye përpara të tjerëve, dhe sipas pretendimeve të kërkueses e detyroi atë që të kryenin marrëdhënie seksuale. M.C. deklaroi se ishte në një gjendje shumë të shqetësuar. Në orët e para të mëngjesit, kërkuesja u çua në një shtëpi, ku sipas pretendimeve të saj, A. e detyroi që të kryenin marrëdhënie seksuale ndërsa ajo vazhdonte të qante gjatë dhe pas përdhunimit. Më vonë ajo u gjet nga e ëma dhe u çua në spital ku analizat mjekësore vërtetuan se membrana e saj vagjinale ishte çarë. A. edhe P. e mohuan faktin që ta kishin përdhunuar M.C.

Lidhur me ndjekjen penale e nisur për shkak të kësaj ngjarje nuk u gjetën prova të mjaftueshme që M.C. ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale me A. dhe P. Hetimi u mbyll në 17 mars 1997 nga Prokurori i Rrethit, i cili arriti në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për përdorimin e forcës ose për kërcënime për kryerjen e marrëdhënieve të tilla. Në mënyrë të veçantë, nuk u vërtetua që kërkuesja të kishte rezistuar ose të kishte bërë përpjekje për të kërkuar ndihmë nga persona të tjerë. Kërkuesja apeloj ndaj këtij vendimi, por pa sukses.

Raportet me shkrim të ekspertëve, të paraqitura përpara Gjykatës së Strasburgut nga M.C., e diagnostikonin atë me sindromën traumatike psikologjike infantile të "frikës së ngrirë", e cila konsiderohet si pasoja më normale e përdhunimit, kur viktimat e terrorizuara nënshtrihen në mënyrë pasive ose përpiqen t'i largohen psikologjikisht konceptit të përdhunimit. Nga 25 raste përdhunimi të analizuar në Bullgari në lidhje me vajza të moshës nga 14 deri 20 vjeç, 24 prej viktimave i ishin përgjigjur përdhunuesve të tyre në këtë mënyrë.

2. Vendimi i Gjykatës

M.C. ankohej se e drejta dhe praktika bullgare nuk ofronin mbrojtje efektive ndaj përdhunimit dhe abuzimit seksual, përderisa hetohen vetëm rastet kur viktimat rezistojnë në mënyrë aktive. Ajo ankohej gjithashtu se autoritetet nuk i kishin kryer një hetim efektiv lidhur me ngjarjet në fjalë. Për pretendimin e saj ajo mbështetej në nenin 3, 8, 13 dhe në nenin 14 të Konventës.

Nenet 3 dhe 8 të Konventës

Gjykata vuri në dukje se, në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës, shtetet anëtare kanë një detyrim pozitiv të dyfishtë. Nga njëra anë ato duhet të kenë një legjislacion penal që të ndëshkojë në mënyrë efektive përdhunimin dhe nga ana tjetër duhet ta zbatojnë me efikasitet këtë legjislacion me hetim dhe ndjekje penale.

Në vijim Gjykata vuri në dukje se, historikisht, në bazë të së drejtës dhe praktikës juridike të shteteve të ndryshme, kërkohet prova e përdorimit të forcës fizike nga përdhunuesi dhe i rezistencës fizike nga ana e viktimës. Megjithatë, duke se kjo nuk ishte më një praktikë e kërkuar në vendet Evropiane. Në vendet e *common-law*, ashtu si edhe në Evropën kontinentale, por edhe më gjerë legjislacioni dhe praktika nuk kërkonin më ekzistencën e një prove në lidhje me përdorimin e forcës fizike. Madje, megjithëse në shumë prej vendeve evropiane të ndikuara nga sistemi kontinental i *civil-law* përkufizimi i përdhunimit kërkonte prova në përdorimin e dhunës ose të kërcënimit për dhunë nga shkaktoesi i saj, sipas jurisprudencës mungesa e pëlqimit dhe mospërdorimi i forcës, përbëjnë elementet thelbësor në përkufizimin e përdhunimit.

Gjithashtu, Gjykata vërejt se shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë rënë dakord se penalizimi i akteve seksuale pa vullnet e viktimës, pavarësisht nëse viktimja ka rezistuar apo jo, ishte i nevojshëm për mbrojtjen e grave ndaj dhunës dhe ka derivuar në vënien në jetë të reformave të mëtejshme në këtë drejtim. Nga ana tjetër, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ka arritur së fundmi në përfundimin se, në të drejtën ndërkombëtare penale, çdo penetrim seksual pa vullnetin e viktimës përbën përdhunim, duke pasqyruar kështu një tendencë universale që e sheh mungesën e pëlqimit si një element thelbësor të përdhunimit dhe të abuzimit seksual. Në përgjithësi, ligji dhe praktika ligjore në lidhje me përdhunimin janë në zhvillim e sipër për të pasqyruar qëndrimet sociale në ndryshim, të cilat kërkojnë respektim të autonomisë seksuale të individit dhe barazi. Duke pasur parasysh standardet dhe tendencat aktuale, detyrimi pozitiv i shteteve anëtare në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës kërkon penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual të pavullnetshëm, edhe kur viktimja nuk ka rezistuar fizikisht.

Kërkuesja pretendonte se qëndrimi i autoriteteve në rastin e saj justifikohet nga mangësitë në legjislacion dhe pasqyronte një praktikë për ndjekjen e përdhunuesve vetëm kur kishte prova se kishte pasur rezistencë fizike të fortë nga ana e viktimës. Qeveria Bullgare nuk ishte në gjendje të ofronte kopje të vendimeve gjyqësore ose opinionin juridik, që të hidhnin poshtë pretendimet e kërkueses për një përjasje të ngushtë në konceptimin dhe penalizimin e përdhunimit. Pra, pretendimi i saj bazohet në argumente të logjikshme të cilat nuk u hodhën poshtë.

Ofrimi i dy versioneve të papajtueshme në lidhje me faktet, natyrisht që kërkonte vlerësim të kujdesshëm të kontekstit në lidhje me besueshmërinë e deklaratave të bëra si dhe verifikim të të gjitha rrethanave. Megjithatë, ishte bërë shumë pak për vlerësimin e besueshmërisë së versionit të ngjarjeve të ofruar nga P. dhe A., apo për të provuar besueshmërinë e dëshmitarëve të thirrur nga të akuzuarit ose përcaktimin e kohës së saktë të ngjarjeve. As kërkuesja dhe as përfaqësuesit e saj nuk kishin qenë në gjendje t'u bënin pyetje dëshmitarëve, të cilët kërkuesja i kishte akuzuar për dëshmi të rreme. Në vijim të këtyre fakteve, autoritetet nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim për qartësimin e të gjitha rrethanave dhe nuk kishin vlerësuar si duhej besueshmërinë e deklaratave që ishin bërë e që ishin të papajtueshme me njëra-tjetrën. Arsyeja e këtij mosveprimi ishte për shkak të faktit se hetuesi dhe prokurori vlerësonin se ishin përpara një "marrëdhënie seksuale të detyruar mes personave që njihen" dhe, në mungesë të një prove "të drejt-përdrejtë" përdhunimi të tilla si, gjurmë dhune dhe rezistence ose thirrje për ndihmë, ata nuk mund të deduktonin një provë për një mungesë pëlqimi dhe, për këtë arsye, një përdhunim duke u nisur vetëm nga vlerësimi i të gjitha rrethanave të ngjarjes.

Pa shprehur ndonjë opinion në lidhje me fajësinë ose jo të P. dhe A., Gjykata konstatoi se efektiviteti i hetimit të çështjes së kërkuesit dhe, në veçanti, qëndrimi i mbajtur nga hetuesi dhe prokurorët, nuk respektonte detyrimet pozitive të Bullgarisë në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Nën dritën e standardeve të zbatueshme të së drejtës moderne ndërkombëtare dhe të krahasuar, këto detyrime kërkojnë ngritjen dhe funksionimin efektiv të një sistemi ligjor penal që dënon të gjitha format e përdhunimit dhe abuzimit seksual.

Nenet 13 dhe 14 të Konventës

Gjykata vuri në dukje se në bazë të nenit 13 nuk u ngrit asnjë çështje e veçantë dhe për rrjedhojë nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kërkesa sipas nenit 14.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 8,000 euro për dëmin jomaterial dhe 4,110 euro për shpenzimet gjyqësore.

Mungesa e hetimeve efektive ndaj sulmeve të motivuara për shkak të urrejtjes fetare

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MILANOVIĆ K. SERBISË

(Kërkesa nr. 44614/07)

14 dhjetor 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Života Milanović, është shtetas serb, i cili ka lindur në 1961 dhe jeton në Belica, të Serbisë.

Që nga viti 1984, ai ka qenë kryetar i komunitetit të Hare Krishna Hindu në Serbi. Në vitin 2000, ai filloi të merrte telefonata kërcënuese dhe në 2001 denoncoi në polici për shqetësimin e tij, duke deklaruar se ata ishin anëtarë të një dege lokale të një organizate të ekstremist të djathtë të quajtur *Obraz*.

Ai u sulmua fizikisht disa herë nga njerëz të paidentifikuar që e çanë ose e plagosën me thikë, për herë të parë në vitin 2001, dhe pastaj sërish në verën e vitit 2005, 2006 dhe 2007, gjithnjë në mbremje ose gjatë natës në afërsi të banesës së të afërmeve të tij në qytetin e Jagodinës. Në secilin rast, z. Milanović dhe spitali ku ai ishte dërguar me urgjencë raportuan incidentin në polici. Gjithashtu, Z. Milanović informoi policinë se sulmuesit me gjasa i përkisnin degës lokale të organizatës së ekstremist të djathtë. Policia e pyeti atë dhe një sërë dëshmitarësh potencialë dhe ndërmori disa hetime, por nuk arriti të identifikonte autorët. Ata njoftuan Ministrinë e Punëve të Brendshme se nuk kishin gjetur prova që organizatat në fjalë kishin ekzistuar ndonjëherë në komunën e Jagodinës.

Dy muaj pas incidentit në vitin 2005, policia depozitoi një akuzë kundër autorëve të paidentifikuar. Nga viti 2006, z. Milanović u mbështet nga një organizatë për të drejtat e njeriut me të cilën ai bashkërisht paraqiti kallëzimin penal lidhur me incidentin e vitit 2005 dhe ato të mëvonshme, duke pretenduar se ai ishte viktimë e një krimi me motive të urrejtjes fetare. Duke kërkuar në mënyrë të përsëritur nëse kishte pasur ecuri lidhur me kallëzimin penal, z. Milanović u informua nga zyra e Prokurorit Publik se policia kishte dështuar në sigurimin e ndonjë informacioni në lidhje me akuzat e tij. Në vitin 2008, z. Milanović vuri në dijeni gjyqtarin e hetimeve paraprake se kishte bindjen që kishte parë një nga sulmuesit në rrugë, duke veshur një këmishë me logon e një organizatë tjetër të ekstremist të djathtë.

Në shtator të 2009, Kryeprokurori Publik i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të ndalojë me ligj organizatat e dyshimta, veçanërisht për shkak të nxitjes së urrejtjes racore dhe fetare në të gjithë Serbinë.

Në dokumentet e saj, policia vërejti se në disa raste z. Milanović ishte anëtar i një “sekti fetar” dhe kishte një “pamje të çuditshme”. Në një raport të prillit 2010, policia theksoi se shumica e sulmeve kishin ndodhur gjatë pushimeve të një feste fetare të madhe ortodokse dhe se z. Milanović më pas kishte publikuar këto incidente në media dhe përmes këtyre daljeve kishte “theksuar” dhe përkatësinë e tij fetare.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenet 2, 3 dhe 13, z. Milanović u ankua për dështimin e autoriteteve në parandalimin e sulmeve të përsëritura ndaj tij dhe për hetimin e përshtatshëm lidhur me rastin e tij. Sipas nenit 14 të marrë së bashku me nenin 3, ai pretendoi më tej se ky dështim vinte për shkak të përkatësisë së tij fetare.

Gjykata kishte juridiksion të shqyrtonte kërkesat vetëm për sa i përket rasteve që kishin ndodhur nga 3 marsi i 2004, kur Serbia kishte ratifikuar Konventën. Për arsye të kontekstit dhe për të shqyrtuar kërkesën e marrë si një e tërë, Gjykata vendosi të marrë parasysh të gjitha ngjarjet relevante para asaj date.

Neni 3

Gjykata konstatoi se lëndimet e pësuar nga z. Milanović, kryesisht prerje të shumta, të kombinuara me ndjenjat e tij të frikës dhe ankthit, ishin mjaft serioze për tu trajtuar si keqtrajtim në bazë të nenit 3. Shumë vite pas sulmeve, kur disa persona ishin marrë në pyetje si dëshmitarë dhe/ose si të dyshuar nga policia, askush nuk u identifikua apo u vu para drejtësisë dhe për këtë z. Milanović haptazi nuk ishte informuar rregullisht për rrjedhën e hetimeve ose ti ishte dhënë mundësia që të identifikonte sulmuesit e tij.

Ka pasur mangësi në bashkëpunimin midis policisë dhe prokurorit publik dhe hetimi dukej se ishte përqendruar në Jagodina pavarësisht faktit se organizatat e dyshuara për të djathtën ekstreme ishin të njohura se vepronin në të gjithë vendin. Ankesa e z. Milanović se një nga sulmuesit, të cilin ai e identifikoi në rrugë, mund të ketë qenë anëtar i një organizate tjetër të veçantë, nuk u mor për bazë. Që nga sulmi i dytë, ka qenë e qartë për policinë se z. Milanović, duke qenë anëtar i një pakice të pambrojtur fetare, ishte vënë në shënjestër në mënyrë të vazhdueshme dhe se në të ardhmen do të ndodhnin sulme të tjera të ngjashme. Megjithatë, asgjë nuk ishte bërë për të parandaluar sulme të tilla.

Ndërsa autoritetet kishin ndërmarrë një sërë hetimesh dhe kishin hasur vështirësi të mëdha, siç ishte mungesa e qartë e dëshmitarëve okularë, Gjykata konsideroi se nuk ishin marrë të gjitha masat e arsyeshme për të kryer një hetim të rregullt ligjor dhe nuk kishin ndërmarrë hapa efektive për të parandaluar keqtrajtimin e përsëritur ndaj z. Milanović. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 3.

Neni 14 marrë së bashku me nenin 3

Gjykata konstatoi se trajtimi i rasteve të dhunës me motive fetare në mënyrë të barabartë me rastet që nuk kishin asnjë ton të tillë nënkuptonte “mbylljen e njërit sy” ndaj natyrës specifike të akteve që janë veçanërisht shkatërruese për të drejtat themelore. Ishte e papranueshme që autoritetet, duke qenë të vetëdijshëm se sulmuesit e z. Milanović mund ti takonin një ose disa organizatave të ekstremit të djathtë, kishin lejuar hetimin të zgjasë për shumë vite pa ndërmarrë veprime sipas ligjit për të identifikuar apo ndjekur penalisht autorët. Deklaratat e bëra nga policia në raportet e tyre, duke iu referuar bindjeve të z. Milanović, pamjes së tij dhe faktit që ai kishte publikuar incidentet në media, nënkuptonin se kishin dyshime se ai ishte një viktimë e vërtetë për shkak të fesë së tij. Për rrjedhojë, megjithëse autoritetet kishin hetuar në disa drejtime sipas dëshmive të z. Milanović lidhur me motivimin e sulmuesve të tij, këto hapa ishin pak më shumë se një hetim *pro forma*.

Në këtë mënyrë Gjykata theksoi se ka pasur shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 3.

Nenet e tjera

Duke pasur parasysh konstatimet e tij sipas nenit 3, Gjykata vërejti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin më vete kërkesat e njëjta të ngritura sipas nenit 2 dhe 13.

Neni 41

Gjykata i ngarkoi shtetit Serb se duhej ti paguante kërkuarit shumë prej 10,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 1,200 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Ndalimi për 27 ditë rresht në një hapësirë në më pak se 3 m² përbën trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN MURŠIĆ k. KROACISË

(Kërkesa nr. 7334/13)

20 tetor 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Kristijan Muršić, ishte shtetas kroat i lindur në 1987 dhe jetonte në Kuršanec (Kroaci).

Në shkurt 2009, z. Muršić u dënua me dy vjet burg për grabitje me armë, dhe në korrik të 2010 u dënua me një vit tjetër burg për veprën penale të vjedhjes. Në gusht të vitit 2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Čakovec bashkoi të dyja veprat penale dhe e dënoi atë në total me dy vjet e njëmbëdhjetë muaj burg. Më 16 tetor 2009, kërkuesi u transferua nga burgu i sigurisë të zakonshme të Turopoljes në Burgun e Qarkut të Bjelovar, ku qëndroi deri më 16 mars 2011.

Z. Muršić parashtroi se gjatë qëndrimit në burgun e Bjelovarut ai ishte caktuar të qëndronte në qeli të mbipopulluara. Në veçanti, ai parashtroi se për një periudhë prej pesëdhjetë ditësh në total ai kishte në dispozicion një hapësirë personale në më pak se 3m², përfshi këtu edhe qëndrimin për njëzet e shtatë ditë rresht. Ai gjithashtu pretendonte se në periudha të ndryshme ishte ndarë hapësirën personale mes 3 dhe 4 m². Për më tepër, ai pohoi se qelitë në të cilat kishte qëndruar ishin me lagështi, të ndotura, të pamirmbajtura dhe pa pajisje të mjaftueshme. Për më tepër, atij nuk i ishte dhënë asnjë mundësi për t'u angazhuar me punë në burg dhe nuk i ishte siguruar qasje e mjaftueshme në aktivitete argëtuese dhe edukative.

Në mars të vitit 2010, kërkuesi kërkoi që të transferohej në Burgun e Varaždinit për arsyë personale dhe familjare, një kërkesë të cilën e përsëriti dhe në maj 2010. Në gusht të vitit 2010 kërkuesi ngriti një padi pranë një gjyqtari-ekzekutues lidhur me kushtet në burg. Gjyqtari pasi mori një raport nga burgu në lidhje me kushtet e ndalimit dhe pasi dëgjoi personalisht kërkuesin, e hodhi poshtë padinë e këtij të fundit si të pabazuar. Në tetor 2010 kërkuesi e apeloj këtë vendim. Megjithatë, apelimi i tij u hodh poshtë nga një trup gjykues i përbërë prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut në Bjelovar si i pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e gjyqtarit të rrethit gjyqësor. Në nëntor të vitit 2010, kërkuesi u ankua në Gjykatën e Apelit të Bjelovarit për vendimin

e turpit gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë dhe paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke u ankuar për mungesën e hapësirës personale dhe mundësive të punësimit në Burgun e Bjelovar. Në qershor 2012, Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën e kërkuesit si të papranueshme dhe haptazi të pabazuar.

2. Vendimi i Gjykatës

Më 12 mars 2015, Dhoma konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës. Me kërkesën e kërkuesit, rasti iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43.

Kërkuesi ankohej për kushtet e këqija të burgut të Bjelovar, përkatësisht mungesën e hapësirës personale, kushtet e këqija sanitare, higjienike dhe ushqimit, mungesa e mundësive për të punuar dhe aksesit i ulët në aktivitetet rekreative dhe arsimore, të cilat përbënin trajtime çnjerëzore ose poshtëruese sipas nenit 3 të Konventës.

Neni 3

Dhoma e Madhe konfirmoi vendimin e Dhomës se parashtruesi kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore në dispozicion, duke hedhur poshtë kërkesat para-prake të Qeverisë.

Gjykata ritheksoi se pavarësisht shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të nenit 3 nuk mund të bazohej vetëm në një llogaritje numerike të metrave katrorë të caktuar për një të burgosur, ku kërkesa e sipërfaqes prej 3 m² për një të burgosur në një vend që ndahej mes shumë personash në bazë të jurisprudencës përbënte standard minimal për një vlerësim të tillë. Kur ndarja e hapësirës për një të ndaluar ishte më pak se 3 m², mungesa e hapësirës personale ishte mjaft e madhe sa mbi këtë u ngrit një prezumim i fortë për shkelje të nenit 3. Qeveria e paditur mund të kundërshtonte këtë prezumim duke provuar se ka alternativa të tjera për të kompensuar në mënyrën e duhur mungesën e hapësirës. Kjo normalisht do të ishte e mundur nëse faktorët e mëposhtëm do të plotësoheshin të marrë së bashku si: reduktimet në hapësirën minimale të kërkuar prej 3 m² të ishin të shkurtra, rastësore dhe minimale, ti mundësohej liria e mjaftueshme dhe e përshtatshme për lëvizjen dhe aktivitetet jashtë qelisë, dhe lehtësirat e ndalimit të ishin përgjithësisht të përshtatshme.

Në rastin në fjalë, sipas dokumentacionit të paraqitura nga Qeveria e paditur, të cilin kërkuesi nuk e kundërshtoi, z. Muršić qëndroi në Burgun e Bjelovarit për një vit e pesë muaj, periudhë gjatë së cilës ai qëndroi në katër qeli, në një hapësirë personale ndërmjet 3 dhe 6,76 m². Ai pati vetëm një herë për një ditë një hapësirë personale prej 2.62 m², një herë për dy ditë dhe tri herë për tri ditë; dhe 2.55 m² për tetë ditë dhe një

herë për tri ditë; së fundmi, ai kishte pasur një hapësirë personale prej 2.62 m² për një periudhë të pandërprerë për 27 ditë me radhë.

Duke marrë parasysh testin e sipërpërmendur të “dyshimit të fortë”, Gjykata vijoi të shqyrtojë kërkesat e kërkuesit marrë më vete në lidhje me periudhën në të cilën ai dispononte më pak se 3 m² hapësirë personale dhe periudhën në të cilën ai kishte ndarë hapësirën personale mes 3 dhe 4 m² në burgun e Bjelovar.

Gjykata konstatoi se në periudhën prej 27 ditëve me radhë në të cilën z. Muršić kishte qëndruar në një hapësirë personale në më pak se 3 m², ai i ishte nënshtruar kushteve të burgut, të cilat i kishin shkaktuar në mënyrë të dukshme vështirësi duke shkuar përtej nivelit të pashmangshëm të vuajtjeve të qenësishme dhe për sa i përket periudhave të tjera, të cilat kanë qenë të një kohëzgjatje të shkurtër, Gjykata pati në vëmendje faktorët e tjerë relevantë dhe për këtë ishte Qeveria ajo që kishte barrën për të provuar nëse kishte të tillë faktorë.

Gjykata vërejti se parashtrimet e Qeverisë lidhur me kushtet e burgut ishin shumë të detajuara dhe nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar në vërtetësinë, objektivitetin dhe relevancën e dokumenteve që kishin paraqitur. Nga ana tjetër, në mungesë të informacioneve të hollësishme nga z. Muršić lidhur me rutinën e tij të përditshme në Burgun e Bjelovar, Gjykata nuk ishte në gjendje të pranonte parashtrimet e kërkuesit si të bazuara ose të besueshme. Ajo theksoi më tej se kërkuesi asnjëherë nuk ngriti pretendime në nivel vendor lidhur me aspekte të caktuara të izolimit të tij, siç është mungesa e pretenduar e ajrimit ose koha e pamjaftueshme për lëvizjen e lirë brenda ambienteve të burgut.

Gjykata vuri në dukje se sipas dëshmive të paraqitura në regjimin e zakonshëm të përditshëm, z. Muršić i ishte lejuar mundësia prej dy orësh për të dalë jashtë në ajrim, e cila ishte një standard sipas ligjit përkatës vendas dhe e bazuar në standardet minimale të KPT-së (Komiteti Evropian për Parandalimi i Torturës dhe Trajtimi ose Ndëshkimi Çnjerëzor ose Poshtëruës). Gjithashtu, ishte e padiskutueshme se kërkuesit i ishte lejuar tre orë në ditë lëvizja e lirë jashtë qelisë brenda ambienteve të burgut. Ndonëse Z. Muršić nuk kishte një punë në burg, mundësia e lëvizjes së lirë jashtë qelisë dhe mjeteve në dispozicion të tij mund të konsideroheshin dukshëm si faktorë lehtësues në lidhje me shpërndarjen e pamjaftueshme të hapësirës personale. Për më tepër, sipas materialit në dispozicion të tij, kushtet e burgut të kërkuesit ishin përgjithësisht të përshtatshme.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se Qeveria kishte hedhur poshtë dyshimin e fortë për shkelje të nenit 3 në lidhje me periudhat e tjera, gjatë të

cilave kërkuesi kishte pasur më pak se 3m² hapësirë personale. Ato ishin periudha të ndara që mund të konsideroheshin si reduktime të shkurtra dhe minimale në hapësirën personale, gjatë të cilave liria e mjaftueshme e lëvizjes dhe veprimtaria jashtë qelisë përbënin për kërkuesin një strukturë të përshtatshme të burgut në përgjithësi. Kushtet e ndalimit të z. Muršić, megjithëse jo plotësisht të përshtatshme për sa i përket hapësirës personale, nuk kishin arritur shkallën e ashpërsisë të kërkuar për t'u konsideruar trajtim çnjerëzor ose poshtëruës brenda kuptimit të nenit 3.

Duke marrë parasysh gjithë elementet e sipërpërmendura, Gjykata konkludoi se kushtet e ndalimit të tij në periudhën që ndante hapësirën personale në 3 dhe 4 m², nuk përbënin trajtim çnjerëzor ose poshtëruës në bazë të nenit 3.

Për këtë, Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me periudhën e qëndrimit për 27 ditë rresht duke pasur një hapësirë personale në më pak se 3 m², ndërkohë që për periudhat e tjera të qëndrimit me shkëputje nuk ka pasur shkelje referuar këtij neni.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 1,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 3,091.50 euro për shpenzimet gjyqësore.

Autoritetet belge nuk duhet të kishin kthyer mbrapsht azilkërkuesin në shtetin grek

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN M.S.S. k. BELGJIKËS DHE GREQISË

(Kërkesa nr. 30696/09)

21 janar 2011

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, M.S.S., ishte shtetas Afgan, i larguar nga Kabuli në fillim të vitit 2008, i cili kishte udhëtuar nëpërmjet Iranit dhe Turqisë, dhe kishte hyrë në Bashkimin Evropian përmes Greqisë.

Më 10 shkurt 2009, kërkuesi mbërriti në Belgjikë, ku aplikoi për azil. Në bazë të rregullores së Dublin II, Zyra për të Huajt i paraqiti një kërkesë autoriteteve greke për të marrë përgjegjësinë e kërkesës për azil. Më 2 prill 2009, UNHCR-ja i dërgoi një letër Ministrit belg për Politikën e Migracionit dhe Azilit, ku kritikonte mangësitë në procedurën e azilit dhe kushtet e pranimit të azilkërkuesve në Greqi dhe rekomandonte pezullimin e transferimeve në Greqi. Një kopje iu dërgua Zyres për të Huajt. Më 19 maj 2009, Zyra për të Huajt vendosi refuzimin e qëndrimit për kërkuesin dhe lëshoi urdhrin për largimin e tij nga vendi. Zyra për të Huajt i paraqiti një kërkesë autoriteteve greke për të marrë përgjegjësinë e kërkesës për azil. Autoritetet greke nuk u përgjigjen brenda periudhës dy mujore të parashikuar sipas Rregullores, dhe kështu Zyra për të Huajt e konsideroi këtë një pranim të heshtur të kërkesës për të marrë përgjegjësinë e kërkesës. Arsyet e dhëna ishin se, në bazë të Rregullores së Dublinit, Belgjika nuk ishte përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës për azil; Greqia ishte përgjegjëse dhe nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar se autoritetet greke do të dështonin në përmbushjen e detyrimeve të tyre në çështjet e azilit.

Kërkuesi paraqiti një ankesë pranë Bordit të Apelit për të Huajt ku arsyet e dhëna, bazoheshin në veçanti në nenin 3 të Konventës, duke ju referuar një rreziku të ndalimit arbitrar në Greqi në kushte të mjerueshme, dhe rrezikut të keqtrajtimit. Kërkuesi u mbështet edhe në mangësitë në procedurën e azilit në Greqi, mungesën e aksesit efektiv në procedurat gjyqësore dhe frikën e tij se mund të kthehej në Afganistan, pa një shqyrtimin të arsyeve që ai kishte pasur për t'u larguar nga vendi, ku ai pretendonte se i kishte ikur një tentative vrasjeje nga talebanët si ndëshkim për punën e tij si përkthyes për trupat e forcave ajrore të lokalizuara në Kabul.

Kërkesa e tij për shtyrjen e ekzekutimit të largimit nga Belgjika u rrëzua dhe ai u

transferua në Greqi në 15 qershor 2009. Me të mbërritur në aeroportin ndërkombëtar të Athinës kërkuesi ishte ndaluar menjëherë dhe ishte vendosur në një ndërtesë afër aeroportit, i kyçur në një hapësirë të vogël me 20 të ndaluar të tjerë, mund të shkonte në tualet vetëm sipas diskrecionit të rojeve, nuk ishte lejuar të dilte në ajrim, i ishte dhënë shumë pak për të ngrënë dhe kishte fjetur në një dyshek të pistë, ose në dysHEME.

Kur u la i lirë më 18 qershor 2009, atij iu dha karta e azilkërkuesit dhe pas kësaj ai jetoi në rrugë pa pasur asnjë mjet jetese.

Në një përpjekje për t'u larguar nga Greqia, kërkuesi u arrestua në aeroport ku përmes një karte të rreme identiteti bullgare donte të largohej nga Greqia. Ai u ndalua për shtatë ditë në të njëjtën ndërtesë afër aeroportit, ku ishte rrahur nga oficerët e policisë të qendrës. Pas lirimit të tij ai vijoi të jetonte në rrugë duke marrë ndihmë rastësore nga banorët rezidentë dhe nga kisha. Pas rinovimit të kartës së tij rozë në dhjetor të 2009, u ndërmorrën disa hapa për akomodimin e tij, nisur nga ankesat e tij se asnjëherë nuk i ishte ofruar një vend për t'u akomoduar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se kushtet e ndalimit të tij në aeroportin ndërkombëtar të Athinës përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtërues sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës, dhe se ai nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv në bazë të ligjit grek në lidhje me pretendimet e tij në bazë të nenit 2 (e drejta për jetën) dhe 3, si dhe të nenit 13. Kërkuesi më tej pretendoi se për shkak të kushteve të ndalimit dhe jetesës në të cilat gjendeshin azilkërkuesit në Greqi, duke e kthyer atë në atë vend, në zbatim të Rregullores së Dublinit, autoritetet belge e kishin ekspozuar ndaj trajtimit të ndaluar sipas nenit 3 të Konventës.

Ai më tej pretendoi se nuk kishte pasur asnjë mjet juridik efektiv sipas ligjit belg në lidhje me kërkesat e tij, për shkelje të nenit 13. Kërkesa u parashtrua në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 11 qershor 2009. Më 12 qershor 2009, kërkesa e kërkuesit për një vendim të ndërmjetëm sipas Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës për ta pezulluar transferimin e tij në Greqi u refuzua. Më 2 korrik 2009 u vendos që të zbatohet Rregulli 39 kundër Greqisë, me qëllim që ai të mos deportohet në Afganistan, në pritje të vendimit të procedurave para Gjykatës.

Më 16 mars 2010, Dhoma në të cilën ishte paraqitur kërkesa hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, dhe në 1 shtator 2010 u mbajt seanca e parë dëgjimore. Qeveritë e Holandës dhe Mbretërisë së Bashkuar Komisioneri i Këshillit të Evropës

për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara, u autorizuan për të ndërhyrë gjatë seancave dëgjimore si palë të treta. Vëzhgime me shkrim u paraqitën gjithashtu nga Qeveritë e Holandës dhe Mbretërisë së Bashkuar si dhe nga Qendra për Këshillimin mbi të Drejtat Individuale në Evropë ("Qendra Aire") dhe Monitoruesi i Helsinkit Grek.

Neni 3: Kushtet e ndalimit në Greqi

Gjykata nuk nënvlerësoi barrën dhe presionin e kësaj situatë në Shtetet që formojnë kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian të cilët janë duke përjetuar vështirësi të konsiderueshme në përballimin e fluksit në rritje të emigrantëve dhe azilkërkuesve dhe vështirësive në pritjen e tyre në aeroportet kryesore ndërkombëtare dhe të numrit disproporcional të azilkërkuesve krahasuar me kapacitetet e disa prej këtyre shteteve. Megjithatë, duke pasur parasysh karakterin absolut të nenit 3, Shtetet nuk mund t'i shpëtojnë detyrimeve sipas kësaj dispozite.

Kur kërkuesi mbërriti në Athinë nga Belgjika, autoritetet greke ishin të vetëdijshëm për identitetin e tij dhe për faktin se ai ishte një azilkërkues potencial. Përkundër kësaj, ai u vendos menjëherë në paraburgim, pa iu dhënë ndonjë shpjegim. Gjykata vuri në dukje se raporte të ndryshme nga organet ndërkombëtare dhe organizatat jofitimprurëse të viteve të fundit konfirmuan që vendosja e vazhdueshme e azilkërkuesve në paraburgim pa i informuar për këtë ndalim ishte një praktikë e përhapur e autoriteteve greke. Pretendimet e kërkuesit se ai ishte rrahur brutalisht nga policia gjatë periudhës së dytë të paraburgimit ishin ishin po aq të vërteta nisur dhe nga raportimet e shumta të mbledhura nga monitoruesit e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT). Gjetjet e KPT-së dhe të UNHCR-it konfirmonin gjithashtu pretendimet e kërkuesit për kushtet johigjienike dhe mbipopullimin të qendrës së ndalimit pranë aeroportit ndërkombëtar të Athinës.

Përkundrejt faktit se ai ishte mbajtur në paraburgim për një periudhë relativisht të shkurtër, Gjykata vlerësoi se kushtet e paraburgimit, të përjetuara nga kërkuesi në qendrën e ndalimit ishin të papranueshme. Ai zbuloi se, të marra së bashku, ndjenja e arbitraritetit, inferioritetit dhe ankthi shpesh i lidhur me të, si dhe efekti i rëndë që kushtet të tilla të ndalimit padyshim kanë tek dinjiteti i personit, përbënin trajtim poshtëruar në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Përveç kësaj, ndjenja e ankthit të kërkuesit ishin intensifikuar nga vetë pozita e tij vulnerabël si azilkërkues. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3.

Neni 3: Kushtet e jetesës në Greqi

Neni 3 nuk mund të interpretohet si detyrim i përgjithshëm ndaj Palëve të Larta Kontraktuese për t'u dhënë refugjatëve ndihmë financiare në mënyrë që ata të ruajnë një standard të caktuar jetese. Ajo vërejtë se situata në të cilën kërkuesi ishte gjendur ishte veçanërisht serioze.

Pavarësisht detyrimeve që autoritetet Greke kishin sipas legjislacionit të tyre dhe Direktivës së Pranimet të BE, kërkuesi kaloi muaj të tërë duke jetuar në një gjendje të varfërisë më ekstreme, në pamundësi për të përmbushur nevojat e tij më elementare: ushqim, higjienë dhe një vend për të jetuar dhe për më tepër kësaj shtoheshin edhe ndjenja e frikës nga sulmet dhe grabitjet. Vërtetësia e akuzave të ngritura nga kërkuesi mbështetej dhe nga vëzhgimet e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe UNHCR-së, si dhe raportet e organizatave jo-fitimprurëse ku situata e përshkruar nga kërkuesi është një fenomen shumë i përhapur edhe ndaj një numri të madh të azilkërkuesve të tjerë.

Autoritetet nuk e kishin njoftuar rregullisht kërkuesin për mundësinë e akomodimit. Palët nuk bien dakord mbi faktin nëse kërkuesit i ishte dhënë një broshurë informative për azilkërkuesit. Gjykata nuk e vlerësoi të rëndësishme këtë fakt për sa kohë që broshura nuk tregonte se azilkërkuesit mund të deklaroheshin tek organet policore se janë të pastrehë dhe as nuk përmbante ndonjë informacion në lidhje me strehimin. Qeveria vetë pranonte se ishin më pak se 1000 vende në qendrat e pritjes për të akomoduar dhjetëra mijëra azilkërkues. Gjykata vërejtë se këto të dhëna binin në kundërshtim me argumentet e Qeverisë se situata në të cilën gjendej kërkuesi kishte ardhur si pasojë e mosveprimit të tij.

Gjendja për të cilën ankohej kërkuesi kishte zgjatuar që nga transferimi i tij në Greqi në qershor 2009 dhe lidhej me statusin e tij si azilkërkues. Sikur autoritetet të kishin marrë menjëherë në shqyrtim kërkesën e tij për azil, ato mund të kishin zbutur ndjeshëm vuajtjet e tij. Ajo vijon më tej se, për fajin e autoriteteve, kërkuesi e ka gjetur veten në një situatë të papajtueshme me nenin 3 të Konventës. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

Neni 13 marrë se bashku me nenin 2 dhe 3 (Greqia)

Midis palëve ishte e padiskutueshme se situata në Afganistan kishte paraqitur dhe vazhdonte të paraqiste pasiguri. U takonte autoriteteve greke, në radhë të parë, të cilat kishin përgjegjësinë për të shqyrtuar kërkesën e azilkërkuesit dhe dokumentet e paraqitura prej tij dhe të vlerësonin rreziqet ndaj të cilave ai do të ekspozohej në

Afganistan. Shqetësimi kryesor i Gjykatës ishte nëse ekzistojnë garanci efektive në rastin konkret, për të mbrojtur kërkuesin kundër kthimit arbitrar të drejtpërdrejtë ose jo, në vendin e tij të origjinës.

Ndërsa legjislacioni grek përmbante një sërë garancish, prej disa vitesh UNHCR-ja dhe Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, si dhe shumë organizata ndërkombëtare jo-fitimprurëse, kanë raportuar në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme se legjislacioni grek nuk zbatohet në praktikë dhe se procedura e azilit paraqiste mangësi të mëdha strukturore. Kjo përfshin: azilkërkuesit kanë shumë pak shanse që kërkesat e tyre dhe ankimet sipas Konventës, të shqyrtohen në mënyrë serioze nga autoritetet greke, dhe se në mungesë të një mjeti efektiv, në fund të ditës ata nuk janë të mbrojtur kundër largimit arbitrar dhe kthimit në vendet e tyre të origjinës. Për rrjedhojë, azilkërkuesit kanë shumë pak shanse në marrjen në shqyrtim të kërkesave të tyre në mënyrë serioze. Për më tepër, nga një raport i UNHCR 2008 tregohet se vendimet e shkallës së parë kishin një shkallë rritje në më pak se 0.1%, krahasuar me normën mesatare të suksesit prej 36.2% në pesë nga gjashtë vendet e BE-së të cilat, së bashku me Greqinë, kishin numrin më të madh të aplikimeve. Organizatat që ndërhyjnë si palë të treta kishin denoncuar rregullisht kthimin e detyruar të azilkërkuesve nga Greqia në vendet me rrezikshmëri të lartë.

Gjykata nuk ishte e bindur nga argumenti i Qeverisë Greke se kërkuesi ishte përgjegjës për mosveprimin e autoriteteve, sepse ai nuk kishte raportuar në qendrën e policisë brenda afatit prej tre ditësh siç përshkruhet në një dokument që ai kishte marrë. Gjithashtu, kërkuesi nuk ishte i vetmi që e kishte keqinterpretuar njoftimin dhe se shumë azilkërkues nuk shkonin në qendrën policore, sepse ata nuk kishin asnjë adresë për të deklaruar.

Përsa i përket, një kërkesë në Gjykatën e Lartë Administrative greke për shqyrtim gjyqësor të një refuzimi të mundshëm të kërkesës për azil, Gjykata vlerësoi se dështimi i autoriteteve për të garantuar komunikimin me të dhe vështirësi të kontaktit me një person pa një adresë të njohur është shumë e paqartë nëse ai do të mësonte rezultatet e aplikimit të tij për azil dhe do të kishte mundësinë të reagoonte brenda afatit të caktuar. Përveç kësaj, edhe pse kërkuesi qartazi nuk kishte mundësi financiare për të përballuar një avokat, ai nuk kishte marrë asnjë informacion për organizata të cilat ofronin këshilla dhe udhëzime ligjore. Për t'i shtuar kësaj situatë edhe mungesën e avokatëve në listën e hartuar për sistemin e ndihmës juridike, çka e bënte sistemin joefektiv në praktikë. Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se informacioni i dhënë nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, që Qeveria nuk e kundërshtoi, ishte dëshmi se një ankim në Gjykatën e Lartë Administrative nuk kompensoonte mungesën e garancive lidhur me shqyrtimin në themel të kërkesave për azil.

Për sa më sipër, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës të marrë shqyrtim në lidhje me nenin 3. Duke pasur parasysh konstatimin e mësipërm dhe rrethanat e çështjes, Gjykata çmoi se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi i kërkesës të paraqitur sipas nenit 13 të marrë në lidhje me nenin 2.

Neni 2 dhe 3

Vendimi i autoriteteve belge për të ekspozuar kërkuesin për procedurën e azilit në Greqi

Gjykata vlerësoi se mangësitë e procedurës së azilit në Greqi duhet të ishin të njohura dhe nga e autoriteteve belge kur ata nxorrën urdhrin e dëbimit kundër kërkuesit, dhe për rrjedhojë kërkuesi nuk mund të mbante të gjithë barrën e provës në lidhje me rreziqet me të cilat do ballafaqohej duke u ekspozuar ndaj këtij procesi. UNHCR kishte njoftuar qeverinë belge për situatën, ndërkohë që çështja e kërkuesit ishte në pritje. Ndërsa Gjykata në vitin 2008 kishte konstatuar në një rast tjetër që dëbimi i një azilkërkuesi nga Greqia sipas Rregullores së Dublinit II, nuk përbënte shkelje të Konventës, dhe që nga ajo kohë 3 raporte dhe materiale të shumta ishin përpiluar nga organizmat dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat përputheshin lidhur me vështirësitë praktike të përfshira në aplikimin e sistemit të Dublinit në Greqi. Belgjika fillimisht kishte lëshuar urdhrin e dëbimit vetëm në bazë të një marrëveshjeje të heshtur nga autoritetet greke dhe kishte vazhduar ta zbatonte këtë urdhrë pa ndonjë garanci individuale të dhënë nga ana e autoriteteve në një fazë të mëvonshme, ndonëse sipas Rregullores, Belgjika mund të kishte bërë një përjashtim dhe refuzuar transferimin e kërkuesit.

Si përfundim, autoritetet belge, të përballura me situatën e përshkruar më sipër, nuk duhet thjesht të kishin supozuar se kërkuesi do të trajtohej në përputhje me standardet e Konventës, por, përkundrazi, më parë duhet të kishin verifikuar se si autoritetet greke zbatonin legjislacionin e tyre mbi azilin në praktikë. Për sa më sipër, Gjykata konstatoi se transferimi i kërkuesit nga Belgjika në Greqi përbënte shkelje të nenit 3. Duke pasur parasysh këtë përfundim dhe rrethanat e çështjes, Gjykata konstatoi se, nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi i kërkesës sipas nenit 2.

Neni 3

Vendimi i autoriteteve belge për ekspozimin e kërkuesit ndaj kushteve të ndalimit dhe kushteve të jetesës në Greqi

Gjykata vendosi se, kushtet e ndalimit të kërkuesit dhe ato të jetesës në Greqi ishin poshtëruese. Ajo vërejti se këto fakte ishin të njohura edhe para transferimit të

kërkuesit dhe gjendeshin në një numër të gjerë burimesh. Gjykata çmoi se duke transferuar kërkuesin në Greqi autoritetet belge me vetëdije e kishin ekspozuar atë ndaj kushteve të ndalimit dhe jetesës që përbënin një trajtim poshtërues, në shkelje kjo të nenit 3 të Konventës.

Neni 13 marrë së bashku me nenin 2 dhe 3 (Belgjika)

Përsa i përket kërkesës se kërkuesi nuk kishte pasur në dispozicion asnjë mjet juridik efektiv sipas ligjit belge me të cilin ai mund të ishte ankuar kundër urdhrin të dëbimit, qeveria belge kishte argumentuar se para Bordit të Apelit për të Huajt mund të paraqitej një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të urdhrin e njohur si “procedura urgjente”.

Kjo procedurë e pezulloi ekzekutimin e masës së dëbimit për një maksimum prej 72 orësh derisa Bordi të merrte një vendim. Megjithatë, Gjykata konstatoi se procedura nuk përmbushte kërkesat e jurisprudencës së Gjykatës që çdo ankesë lidhur me dëbimin në një vend tjetër do ta ekspozonte një individ ndaj trajtimit të ndaluar nga neni 3, duhej të shqyrtohej nga afër dhe me rigorozitet dhe se organi kompetent duhet të shqyrtonte përmbajtjen e ankesës dhe për të rivendosur në vend të drejtën.

Duke pasur parasysh shqyrtimin e çështjeve nga Bordi i Apelit për të Huajt, organ që e kufizonte shqyrtimin e saj në verifikim nëse ishin dhënë dëshmi konkrete për pasojën që mund të vinte nga shkelja potenciale e pretenduar sipas nenit 3, dhe nisur nga kjo kërkuesi nuk kishte asnjë shans për sukses.

Gjykata konstatoi se, ka pasur shkelje të nenit 13 marrë së bashku me nenin 3. Duke pasur parasysh këtë përfundim dhe rrethanat e çështjes, Gjykata konstatoi se, nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi i kërkesës sipas nenit 13 marrë së bashku me nenin 2.

Neni 46

Në rastin konkret Gjykata e konsideroi të nevojshme për të treguar disa masa të veçanta që kërkohen për ekzekutimin e vendimit aktual në lidhje me kërkuesin, pa paragjykuar masat e përgjithshme që kërkohen për të parandaluar shkelje të tjera të ngjashme, në të ardhmen. Duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit dhe nevojës urgjente për t'i ndaluar shkelje të Konventës, Gjykata e konsideroi të detyrueshme për Greqinë që të vazhdonte me shqyrtimin në themel të kërkesës për azil të kërkuesit pa vonesë dhe në përputhje me kërkesat e Konventës dhe gjithashtu, mos dëbimin e tij deri në përfundim të shqyrtimit.

Neni 41

Sipas nenit 41 të Konventës, Gjykata konkludoi se Greqia duhej ti paguante kërkuarit 1,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 4,725 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore. Më tej ajo vijoi se Belgjika duhej ti paguante kërkuarit 24,900 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 7,350 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Struktura e arsimit fillor në Irlandë në vitet 1970, dështoi në mbrojtjen e një nxënëseje nga abuzimi seksual nga mësuesi i saj duke derivuar në shkelle të neneve 3 dhe 13

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN O'KEEFFE k. IRLANDËS

(Kërkesa nr. 35810/09)

28 janar 2014

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, znj. Louise O'Keeffe, ishte shtetase irlandeze, e lindur në vitin 1964 dhe me banim në Cork të Irlandës. Që nga viti 1968 ajo frekuentonte Shkollën Kombëtare të Dunderrow, e cila ishte në pronësi, të Peshkopit katolik i Dioqezës së Corkut. Një nga mësuesit ("LH") e shkollës ishte laik, i martuar dhe drejtori i saj. Akuzat e para ndaj LH lidhur me abuzimin seksual me fëmijë nisën në vitin 1971, por asnjëherë nuk u vërtetuan. Më pas, nga janari deri në mesin e vitit 1973, kërkuesja ishte subjekt i abuzimit seksual të vazhdueshëm nga LH gjatë orës së muzikës në klasën e tij. Po atë vit, por në një periudhë më të vonë prindërit e kërkueses u vunë në dijeni për akuzat të ngjashme edhe nga prindërit e tjerë në lidhje me LH. Si përfundim, LH dha dorëheqjen nga posti i tij, por lidhur me akuzat në fjalë nuk u mor asnjë masë e mëtejshme nga asnjë autoritet shtetëror. Në vitin 1974, LH rifilloi mësimdhënien në një tjetër shkollë kombëtare ku vazhdoi të jepte mësim deri në daljen në pension në vitin 1975.

Kërkuesja dha një deklaratë në polici në janar 1997 si pjesë e një hetimi të policisë lidhur me një akuzë të ngritur nga një ish nxënës i Shkollës Kombëtare të Dunderroë kundër LH. Më pas, një numër i madh nxënësish të tjerë dhanë dëshmitë e tyre gjatë hetimeve dhe si rezultat LH u akuzua për 386 vepra penale të abuzimit seksual. Pasi ai u shpall fajtor, u dënua me burg dhe licenca e tij për mësimdhënie ju hoq.

Në vitin 1998, kërkuesja paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Kompensimit të Dëmtimeve Penale dhe asaj iu akordua shuma prej 54,000 euro. Më pas, kërkuesja paraqiti një kërkesëpadi kundër LH dhe shtetit irlandez, duke pretenduar shpërblimin e drejtë lidhur me lëndimet personale të shkaktuara nga kërcënimet dhe kontakti fizik përfshi këtu dhe abuzimin seksual të LH. LH nuk u mbrojt lidhur me pretendimet e parashtruara dhe u urdhërua të paguajë dëmin në shumën prej 305,000 euro, megjithatë për shkak të mjeteve të tij të pamjaftueshme, kërkuesi në kohën e këtij vendimi siguroi me përafërsi 30,000 euro. Nga ana tjetër, kërkesat kundër shtetit u hodhën poshtë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja e bazoi kërkesën e saj nënenet 3, 8, 13 dhe 14 dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1, se Shteti nuk e kishte mbrojtur atë nga abuzimi seksual që i ishte bërë nga një mësues në Shkollën e saj Kombëtare dhe se ajo nuk kishte një mjet efektiv kundër shtetit në këtë drejtim.

Neni 3

Në lidhje me aspektin thelbësor të nenit 3, Gjykata e konsideroi të nevojshme të vlerësonte çështjen e përgjegjësisë së Shtetit në kontekstin e fakteve dhe standardeve në vitin 1973. Gjykata vërejti se autoritetet kanë një detyrim i pandarë për të mbrojtjen e të miturve nga keqtrajtimi, sidomos në arsimin fillor, dhe ky detyrim gjithashtu përfshinte dhe implikimin e tij në vitin 1973. Prandaj, Gjykata vijoi të vlerësonte nëse shteti kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive në këtë drejtim. Ajo pranoi se keqtrajtimi ishte brenda qëllimit të nenit 3 dhe se kishte pak mosmarrëveshje midis palëve mbi këtë çështje, si dhe në strukturën e sistemit irlandez të shkollave fillore. Edhe sikur Shkollat Kombëtare të ishin institucione arsimore të administruara nga aktorë jo shtetërorë, shteti duhej të ishte i vetëdijshëm për nivelin e krimeve seksuale ndaj të miturve në shkolla përmes zbatimit të legjislacionit penal mbi këtë çështje. Shteti duhet të ketë qenë në dijeni të rreziqeve të mundshme për sigurinë e fëmijëve në atë kontekst dhe se nuk kishte kuadër të përshtatshëm në garantimin e mbrojtjes së tyre. Meqenëse mekanizmat në të cilat ishte mbështetur Shteti nuk ishin efektive, gjykata konkludoi se shteti kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive për mbrojtjen e kërkueses nga abuzimi seksual dhe për rrjedhojë kjo përbënte shkelje të nenit 3.

Në lidhje me aspektin procedural të nenit 3, Gjykata konkludoi se në momentin që u ngrit një akuzë për abuzimin seksual nga LH nga Shkolla Kombëtare në fjalë në vitin 1995, dhe për këtë u hap një hetim ku kërkuesja kishte pasur mundësinë të jepte dëshminë e saj. Për këtë, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në këtë drejtim.

Neni 13

Për sa kohë që kërkuesja nuk kishte asnjë mjet efektiv juridik në dispozicion të saj lidhur me kërkesat e pretenduara sipas nenit 3, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 marrë së bashku me nenin 3.

Kërkesat e tjera

Gjykata nuk e konsideronte të nevojshme marrjen në shqyrtim të kërkesave të tjera të kërkuases sipas Konventës.

Neni 41

Gjykata i ngarkoi Irlandës për t'i paguar kërkuases shumën prej 30,000 euro për dëmin jomaterial dhe 85,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

Një vendim i rëndësishëm mbi dështimin e autoriteteve për mbrojtjen ndaj dhunës në familje përbënte shkelle të neneve 2, 3 dhe 14

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN E DHOMËS OPUZ K. TURQISË

(Kërkesa nr. 33401/02)

9 qershor 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Nahide Opuz, ishte shtetase turke e lindur në vitin 1972 dhe jetonte në Turqi. Në vitin 1990, zonja Opuz filloi të jetonte me H.O., djalin e bashkëshortit të nënës së saj. Znj. Opuz dhe H.O. u martuan në nëntor 1995 dhe patën tre fëmijë në vitet 1993, 1994 dhe 1996. Çifti kishte probleme serioze që në fillim të marrëdhënies së tyre dhe dhe më pas ata u divorcuan.

Në periudhën mes prillit 1995 dhe marsit 1998, ka pasur katër incidente për shkak të sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese të H.O. kundrejt kërkueses dhe nënës së saj, incidente që u denoncuan edhe para autoriteteve. Këto incidente përfshinin rrahje, një grindje të ashpër, gjatë së cilës H.O. nxorri edhe thikën, si dhe një incident tjetër ku H.O. përplasi me makinën e tij dy gratë. Pas kësaj dhune të përsëritur, gratë u ekzaminuan nga doktorët të cilët përgatitën raporte sipas të cilëve dy gratë kishin dëmtime të ndryshme, përfshirë këtu gjakosje, mavijosje, gunga dhe gërvishtje. Sipas mjekut të dyja gratë kishin marrë dëmtime që u vinin në rrezik jetën; dhe veçanërisht kërkuesja nga një rrahje e dhunshme dhe mamaja e saj pasi ishte përplasur nga makina e tij.

Ndaj, H.O. nisi procedimi penal për tre prej këtyre rasteve për kërcënimin e jetës, dëmtime të rënda e të përsëritura në trup dhe tentativë për vrasje. Për sa i përket incidentit me thikë, u vendos që të mos hetohej për mungesë provash. H.O. u arrestua dy herë dhe në të dyja rastet u hetua në gjendje të lirë.

Megjithatë, kur kërkuesja dhe mamaja e saj tërhoqën denoncimet e tyre, gjykatat e brendshme i pushuan çështjet, për arsye se procedimi nuk mund të vazhdohej kryesisht sipas Kodit Penal nëse tërhiqeshin paditë. Megjithatë, procesi në lidhje me incidentin me makinë ndaj nënës të kërkueses vijoi më tej, nisur nga dëmtimet e rënda që ajo kishte pësuar dhe për këtë H.O. u dënua me tre muaj burg, dënim që më vonë iu konvertua në gjobë.

Më 29 tetor 2001, kërkuesja u godit shtatë herë me thikë nga H.O., dhe u dërgua në spital. H.O. u arrestua për sulm me thikë dhe mori një tjetër gjobë prej thujse 840

mijë lirash turke (rreth 385 euro), shumë të cilën mund ta paguante me tetë këste. Pas këtij incidenti, mamaja e kërkueses bëri një kërkesë që H.O. të mbahej në gjendje arresti, duke kujtuar se në disa raste të mëparshme ajo dhe vajza e saj ishin detyruar të tërhiqnin kallëzimet kundër tij për shkak të presionit të pareshtur dhe kërcënimeve për jetën e tyre.

Si përfundim, më 11 mars 2002, mamaja e kërkueses, pasi kishte vendosur të shpërngulej në Izmir me vajzën e saj, po udhëtonte në furgonin e mbushur me orënditë e shtëpisë, kur H.O. e detyroi automjetin të hapte krahun, dhe pasi H.O. hapi dorën e pasagjerit vrau nënën e kërkueses me armë zjarri, e cila vdiq në vend.

Më mars 2008, H.O. u dënua për vrasje dhe armëmbajtje pa leje. Ai u dënua me burgim të përjetshëm, por më pas u lirua gjatë procesit në apel. Në prill 2008, kërkuesja paraqiti një tjetër kallëzim penal pranë prokurorisë, duke i kërkuar që të merrnin masa për ta mbrojtur atë, meqenëse pas lirimit ish-bashkëshorti i saj kishte filluar ta kërcënonte sërisht. Në maj dhe nëntor 2008, përfaqësuesi i kërkueses informoi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut se nuk ishte marrë ende asnjë prej masave të kërkuara dhe Gjykata kërkoi shpjegimet përkatëse. Pas kësaj, autoritetet turke morën masa specifike për ta mbrojtur kërkuesen, të tilla si: shpërndarja e fotografisë së ish-burrit të saj dhe gjurmët e tij të gishtërinjve në të gjitha stacionet e policisë me urdhrin për ta arrestuar, në rast se do të afrohej pranë vendit të banimit të kërkueses.

Në janar 1998, në Turqi hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes, që parashikonte masa specifike për mbrojtjen kundër dhunës në familje.

2. Vendimi i Gjykatës

9. Kërkuesja pretendoi se autoritetet turke kishin dështuar në mbrojtjen e së drejtës së jetës së nënës së saj dhe se ato ishin treguar neglizhentë përballë dhunës së përsëritur, kërcënimeve për vdekje dhe dëmtimeve, të cilat i kishte pësuar dhe ajo vetë. Kërkuesja u mbështet në nenet 2, 3, 6 dhe 13. Ajo u ankua gjithashtu, për mangësitë e legjislacionit turk për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje, gjë që sipas saj binte ndesh me nenin 14.

Neni 2

Gjykata vlerësoi se dhuna e përshkallëzuar, në rastin e kërkueses, si, tentativa për vrasje, jo vetëm që ishte e mundur, por edhe e parashikueshëm, duke parë historinë e sjelljes së dhunshme të H.O., precedentëve të tij penalë ndaj së shoqes dhe nënës së saj, si edhe kërcënimin e vazhdueshëm nga ana e tij për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Sipas praktikës së përbashkët juridike në shtetet anëtare, sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më e rëndësishme është që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht për në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre. Megjithatë, duke vendosur vazhdimisht për t'i pushuar proceset penale kundër H.O., autoritetet i referoheshin ekskluzivisht nevojës për t'iu shmangur ndërhyrjes në atë, që ato e perceptonin si një "çështje familjare". Me sa duket, autoritetet nuk i kishin marrë në konsideratë arsyet që qëndronin pas tërheqjes së kallëzimeve, megjithë deklaratat e nënës së kërkueses se ajo dhe vajza e saj kishin qenë të detyruara ta bënin këtë për shkak të kërcënimeve për vdekje dhe presionit të H.O. Gjykata e Strasburgut u shpreh se, pavarësisht nga tërheqja e kallëzimeve nga ana e viktimave, kuadri ligjor duhej t'i kishte dhënë mundësi organeve të akuzës që të vazhdonin procesin penal kundër H.O., për shkak se sjellja e tij e dhunshme kishte qenë aq serioze sa të përligjte hetimet dhe se kishte pasur një kërcënim konstant për integritetin fizik të kërkueses.

Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kombëtare nuk kishin treguar kujdesin e duhur për të parandaluar dhunën ndaj kërkueses dhe nënës së saj, në veçanti duke marrë masa parandaluese penale apo të ndonjë lloji tjetër kundër H.O. Gjykata kujtoi se në bazë të nenit 2 të Konventës autoritetet kanë për detyrë që të kryejnë një hetim efektiv për të zbuluar shkaqet e humbjes së jetës së një personi dhe për të vënë para drejtësisë përgjegjësit. Ajo theksoi se një detyrim i tillë përfshin edhe nevojën për procedura të menjëhershme dhe efektive. Në rrethanat e çështjes konkrete ajo konstatoi se proceset penale në ngarkim të H.O. për vrasje, të cilën për më tepër e kishte pranuar vetë, kishin zgjatur ndërkaq për më shumë se gjashtë vjet dhe ishin ende përpara Gjykatës së Lartë. Në këto kushte këto procedura nuk mund të konsideroheshin si efektive. Për më tepër, sistemi ligjor penal nuk kishte pasur asnjë efekt parandalues në këtë rast. Për këto arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 2 edhe në këtë aspekt.

Neni 3

Gjykata vlerësoi se reagimi i autoriteteve ndaj sjelljes së H.O. kishte qenë qartazi i papërshtatshëm, duke parë seriozitetin e kërcënimeve të tij. Vendimet gjyqësore, të cilat nuk kishin ofruar asnjë masë ndaluese ose ndonjë efekt parandalues ndaj H.O., kishin qenë të paefektshme dhe madje shfaqnin njëfarë tolerance kundrejt veprimeve të tij. Veçanërisht, pas incidentit me makinë, H.O. kishte ndenjur vetëm 25 ditë në burg dhe ishte ndëshkuar vetëm me gjobë për dëmtimet e rënda që i kishte shkaktuar nënës së kërkueses. Edhe më e habitshme ishte se si ndëshkim për goditjen shtatë herë me thikë të kërkueses, ai mori vetëm një gjobë minimale, të cilën mund ta paguante me këste.

Gjykata konstatoi se deri në janar 1998, kohë kur edhe hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes, legjislati turk nuk ofronte masa specifike administrative dhe policore për të mbrojtur personat e vulnerabël nga dhuna në familje. Madje edhe pas kësaj date, autoritetet turke nuk i kishin zbatuar me efektivitet masat dhe sanksionet në mbrojtje të kërkueses.

Në përfundim, Gjykata vërejti se dhuna e pësuar nga kërkuesja nuk kishte marrë fund dhe se autoritetet vazhdonin të tregoheshin pasive. Megjithë kërkesën e kërkueses në prill 2008, asgjë nuk u bë deri kur Gjykata i kërkoi Qeverisë që t'i paraqiste informacion mbi masat që autoritetet kishin marrë në mbrojtje të kërkueses.

Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse në ndalimin efektiv të cenimeve serioze të integritetit personal të kërkueses nga ana e ish-bashkëshortit të saj.

Neni 14

Sipas raporteve të depozituara nga kërkuesja, të cilat u përpiluan nga dy organizata të rëndësishme të shoqërisë civile dhe që nuk u kundërshtuan nga Qeveria, numri më i lartë i viktimave të dhunës në familje ishte pikërisht në Diarbakir, ku kishte jetuar edhe kërkuesja në kohën kur ndodhën ngjarjet. Të gjitha viktimat ishin gra, shumica e të cilave me origjinë kurde, analfabete ose me një nivel të ulët arsimimi dhe në përgjithësi pa ndonjë burim të pavarur të ardhurash. Në fakt, raportet shpjegonin se dhuna në familje tolerohej nga ana e autoriteteve dhe se mjetet ankimore në dispozicion nuk funksiononin në mënyrë efektive.

Për rrjedhojë, Gjykata vërejti se kërkuesja kishte qenë në gjendje të vërtetonte se dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti diskriminues dhe i përgjithshëm nga gjykatat turke kishte krijuar një klimë që favorizonte dhunën në familje. Duke pasur parasysh këtë, dhuna ndaj kërkueses dhe mamasë së saj mund të konsiderohej si dhunë me bazë gjinore, që përbente një formë të diskriminimit kundër grave. Megjithatë, reformat e ndërmarra nga Qeveria turike vitet e fundit, mungesa e përgjithshme e reagimit nga ana e sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi i dhunuesve, siç u vërtetua në rastin e kërkueses, tregonin se marrja e masave të duhura për të zgjidhur problemin e dhunës në familje ishte e pamjaftueshme. Për rrjedhojë, Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 14, marrë së bashku me nenin 2 dhe 3.

Nenet e tjera

Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme, Gjykata nuk e pa të nevojshme shqyrtimin e të njëjtve fakte në kontekstin e neneve 6 dhe 13.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 30,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 6,500 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Dështimi i autoriteve për të marrë në konsideratë shëndetin e kërkuarit gjatë procesit të deportimit të tij, përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues në shkellje të nenit 3

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN PAPOSHVILI k. BELGJIKËS

(Kërkesa nr. 41738/10)

13 dhjetor 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuari, Georgie Paposhvili, ishte shtetas gjeorgjian i lindur në vitin 1958 dhe jetonte në Bruksel. Ai ndërroi jetë më 7 qershor 2016. Më 20 qershor 2016, gruaja e kërkuarit dhe tre fëmijët e tyre shprehën dëshirën për të vazhduar gjykimet para Gjykatës.

Z. Paposhvili mbërriti në Belgjikë më 25 nëntor 1998, i shoqëruar nga gruaja e tij dhe fëmija i tyre gjashtë vjeçar. Çifti më pas pati edhe dy fëmijë të tjerë. Mes viteve 1998 dhe 2007, z. Paposhvili u shpall fajtor për një sërë veprash penale, përfshirë grabitje me dhunë dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Ndërkohë që vuante dënimet me burgim, z. Paposhvili u diagnostikua me disa sëmundje, përfshi leukeminë limfotike kronike dhe tuberkulozin, për të cilat mori trajtim mjekësor. Duke u mbështetur në nenet 3 dhe 8 të Konventës, ai paraqiti disa kërkesa por pa sukses për rregullimin e statusit të tij të qëndrimit në Belgjikë për arsye të jashtëzakonshme dhe mjekësore, me pretendimin se nëse kthehej në Gjeorgji nuk do mund të merrte trajtimin e nevojshëm.

Në gusht të vitit 2007, Ministri i Brendshëm lëshoi një urdhër për dëbimin e kërkuarit dhe ndalimin për t'u rifutur në Belgjikë për dhjetë vjet pasi përbënte rrezik për rendin publik. Urdhri do të bëhej i zbatueshëm pasi z. Paposhvili të përfundonte dënimin e tij, por në fakt nuk u zbatua, pasi ai ishte duke u mjekuar. Më 7 korrik 2010, Zyra e të Huajve lëshoi një urdhër për largimin e tij nga vendi, së bashku me një urdhër ndalimi. Kërkuari u transferua në një vendqendrim për emigrantët e paligjshëm me qëllim kthimin e tij në Gjeorgji dhe u pajis me dokumentet e udhëtimit.

Më 23 korrik 2010, z. Paposhvili bëri kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e një masë të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores me qëllim pezullimin e dëbimit të tij nga Belgjika. Gjykata vendosi pezullimin e dëbimit të tij. Më pas kërkuari u lirua. Afati për zbatimin e urdhrin për të lënë territorin belg u shty disa herë. Në nëntor të vitit 2009, gruaja e kërkuarit dhe tre fëmijët e tij u lejuan të qëndronin në Belgjikë. Midis viteve 2012 dhe 2015, z. Paposhvili u arrestua disa herë për vjedhjen e një dyqani.

Kërkuesi, duke u mbështetur në të drejtën e jetës sipas nenit 2 dhe ndalimin e trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës sipas nenit 3, pretendonte se kishte arsye të konsiderueshme për të besuar se nëse dëbohej në Gjeorgji, do të përballej me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës apo vdekjes së parakohshme. Ai gjithashtu pretendoi, sipas nenit 8, se nëse dëbohej nuk do mund të qëndronte me familjen e tij, e cila ishte mbështetja e vetme morale për të.

2. Vendimi i Gjykatës

Më 17 prill 2014, Dhoma e Gjykatës vendosi se nuk ka pasur shkelje të neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës. Më 20 prill 2015, Dhoma e Madhe pranoi kërkesën në emër të kërkuesit për kalimin në juridiksion të Dhomës së Madhe sipas nenit 43 të Konventës. Gjykata konstatoi se duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe rolin e sistemit të Konventës, fakti që kërkuesi kishte ndërruar jetë nuk përbënte pengesë për vazhdimin e gjykimit të çështjes.

Nenet 2 dhe 3

Gjykata ripohoi të drejtën e të gjitha Shteteve Kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë, nëse ekzistonte besimi i bazuar se personi në fjalë, pas dëbimit, do të përballej me një rrezik real për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, neni 3 i detyronte shtetet të mos e dëbonin atë. Çfarë konsiderohej keqtrajtim varej nga rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe psikologjike, dhe në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Vuajtjet e shkaktuara për shkak të një sëmundje mund të përfshihen në fushëveprimin e nenit 3, nëse ato përkeqësohen për shkak të trajtimit nga ana e autoriteteve shtetërore.

Gjykata pasi analizoi jurisprudencën e saj, arriti në përfundimin se zbatimi i deritani-shëm i nenit 3 nuk ofronte mbrojtjen e nevojshme për të huajt të cilët ishin të sëmurë rëndë (në ndryshim nga ata që ishin në prag të vdekjes). Gjykata vlerësoi se “rastet e tjera më të jashtëzakonshme”, në kuptimin e vendimit në çështjen *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*⁸⁵ të cilat mund të ngrenë një çështje sipas nenit 3, i referohen situatave që kanë të bëjnë me dëbimin e një personi të sëmurë rëndë, kur ka arsye thelbësore për të besuar se ai do të përballej me rrezikun real, për shkak të mungesës së trajtimit të përshtatshëm në vendin pritës ose mungesës së aksesit ndaj një trajtimi të tillë, të përkeqësimit serioz, të shpejtë dhe të pakthyeshëm të gjendjes së tij shëndetësore, çka do të çonte në vuajtje të shtuara ose në një reduktim të ndjeshëm të jetëgjatësisë.

85 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim[DHM] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përsëritur në këtë seksion.

Shteti ka detyrimin të vlerësojë rreziqet me të cilat kërkuesi mund të përballlet nëse do të dëbohet në vendin pritës, në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij negativ për të mos ekspozuar individët ndaj rrezikut të keqtrajtimi. Shteti duhet të verifikojë nëse trajtimi shëndetësor në shtetin pritës është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së kërkuesit dhe nëse personi në fjalë ka faktikisht mundësi për ta marrë një trajtim të tillë. Nëse ekzistojnë dyshime serioze në lidhje me ndikimin e dëbimit, Shteti kthyes duhet të marrë garanci individuale dhe të mjaftueshme nga Shteti pritës që personit do ti ofrohet trajtimi i përshtatshëm. Në rastin në fjalë, kërkuesi, kishte parashtruar informacione të hollësishme mjekësore, se si trajtimi në Belgjikë kishte bërë që gjendja e tij shëndetësore të ishte e qëndrueshme dhe se nëse trajtimi ndërpritej, nuk do ti mbeteshin më shumë se gjashtë muaj jetë. Gjithashtu kërkuesi kishte pohuar se në Gjeorgji mungonte qoftë trajtimi i përshtatshëm, qoftë dhe transplantimi i organeve të dhuruara.

Pavarësisht fakteve të mësipërme, kërkesat e z. Paposhvili për t'u pajisur me letra të rregullta qëndrimi për arsye mjekësore u refuzua nga Zyra e të Huajve. Bordi i Ankesave për të Huajt konstatoi se, kur autoriteti administrativ parashtronte arsyet për përjashtim, nuk ishte e nevojshme që ai të shqyrtonte provat mjekësore të paraqitura. Lidhur me ankesat e bazuara në nenin 3 të Konventës, Bordi i Apelimeve për të Huajt, vuri në dukje se vendimi që refuzonte lejen për të qëndruar nuk ishte shoqëruar me një masë largimi, kështu që rreziku i ndërprerjes së trajtimit mjekësor të kërkuesit në rast se kthehej në Gjeorgji ishte thjesht hipotetik. Këshilli i Shtetit, në të cilin kërkuesi apeloj për çështje të ligjit, mbështeti arsyetimin e Bordit të Apelimit për të Huajt.

Duke qenë se raportet mjekësore të kërkuesit nuk ishin marrë parasysh nga Zyra për të Huajt apo Bordi i Apelimeve për të Huajt në prespektivën e nenit 3 gjatë proceseve për lejimin ose jo të qëndrimit të kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se nëse kërkuesi kthehej në Gjeorgji, do ishim para shkeljes së nenit 3 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata e konsideroi të panevojshme shqyrtimin e pretendimeve sipas nenit 2 të Konventës.

Neni 8

Bordi i Apelimeve për të Huajt e hodhi poshtë kërkesën e z. Paposhvili sipas nenit 8, me arsyetimin se vendimi që refuzonte lejen e qëndrimit nuk ishte i shoqëruar me një masë largimi. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se autoritetet kombëtare duhet të bënin një vlerësim të ndikimit që do të kishte dëbimi i z. Paposhvili në jetën familjare të tij nisur nga gjendja e tij shëndetësore; kjo përbënte një detyrim procedural për autoritetet në mënyrë që të garantonin efektivitetin e së drejtës për respektimin e

jetës familjare. Shteti duhet të kishte shqyrtuar nëse familja e kërkuesit do të mund ta ndiqte atë në Gjeorgji nëse dëbohej dhe nëse nuk do mundej, a kërkonte respektimi i të drejtës së z. Paposhvili për respektimin e jetës së tij familjare, që atij ti jepej leja e qëndrimit në Belgjikë, për kohën që i kishte mbetur për të jetuar. Kështu, Gjykata vendosi që nëse z. Paposhvili do të ishte dëbuar në Gjeorgji pa vlerësuar këto faktorë, do të kishte pasur gjithashtu një shkelje të nenit 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes së neneve 3 dhe 8 të Konventës përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë në lidhje me çdo lloj dëmi jomaterial që z. Paposhvili mund të kishte pësuar. Gjithashtu ajo vendosi që Belgjika t'i paguante familjes së z. Paposhvilit 5,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Dështimi i autoriteteve, për të përmbushur detyrimet pozitive në mbrojtje të kërkuesve nga persekutimi nga të burgosurit e tjerë, përbënte shkelje të nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RODIĆ DHE 3 TË TJERËT k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

(Kërkesa nr. 22893/05)

27 maj 2008

1. Faktet kryesore

Të katërt kërkuesit ishin shtetas të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe një prej tyre ishte kroat. Ata kishin lindur mes viteve 1946 dhe 1972, dhe në kohën e këtij vendimi ishin të burgosur në burgun e Mostarit në Bosnje dhe Hercegovinë. Të gjithë u dënuan për krime lufte kundër civilëve boshnjakë (boshnjakë muslimanë) gjatë luftës së viteve 1992-1995 në Bosnje dhe Hercegovinë.

Mes gushtit 2004 dhe majit 2005, kërkuesit u dërguan në burgun e Zenicës, burgu i vetëm i sigurisë të lartë në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Rreth 90% e të burgosurve ishin Boshnjakë.

Në maj të vitit 2005, u evidentuan disa grafito ofenduese në mencën e burgut që i drejtoheshin kërkuesve. Ata që ishin përgjegjës nuk u identifikuan asnjëherë. Më 4 qershor 2005, pas transmetimit të një videoje që tregonte një vrasje të vitit 1995 të boshnjakëve në Srebrenicë, një i burgosur e tërhoqi një nga kërkuesit në qelinë e tij dhe e goditi me grusht në sy. Më 7 qershor 2005, ai u dërgua në spital. Sipas një raporti zyrtar, sulmi ishte kryer për motive etnike, ku sulmuesi kishte pasur një copë qelqi në dorë dhe pasojat mund të kishin qenë të rënda nëse nuk do kishte ndërhyrë një i burgosur tjetër.

Më 5 qershor 2005, një tjetër i burgosur sulmoi kërkuesin e dytë në mencën e burgut. Rojet e burgut ndërhyrën pasi ai kishte marrë disa goditje në kokë. Ai u dërgua në spital.

Më 8 qershor 2005, kërkuesit shpallën një grevë urie për të tërhequr vëmendjen e publikut për gjendjen e tyre dhe menjëherë u akomoduan në një vend të veçantë në njësinë e spitalit të burgut. Po të njëjtën ditë, të burgosurit që ishin përgjegjës për sulmet u dënuan me 20 ditë në izolim dhe po ashtu për këtë u hap një hetim nga një komision *ad hoc* lidhur me sulmet.

Më 15 qershor 2005, Ministria e Drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës urdhëroi transferimin e kërkuësve në një burg në Republikën Serbe, për arsye sigurie. Më 19 qershor 2005, Komisioni nxorri raportin përfundimtar duke kritikuar autoritetet e burgut për dështimin në mbrojtjen e kërkuësve. Në mbrojtjen e tyre, autoritetet përmendën mungesën e stafit të burgjeve, hapësirës apo ekzistencën e ndonjë burgu tjetër të sigurisë lartë në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe faktit se transferimet e të burgosurve të entiteteve të ndryshme nuk ishin parashikuar. Më 21 qershor 2005, Ministria e Federatës urdhëroi që kërkuësit të qëndronin në burgun e Zenicës, në njësinë e spitalit të burgut, deri në një njoftim të mëtejshëm.

Më 1 korrik 2005, kërkuësit ndërprejnë grevën e tyre të urisë në përgjigje të kërkesës së Gjykatës Evropiane.

Kërkuësit paraqitën një kërkesë para Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës për moszbatim të vendimit të 15 qershorit 2005, që urdhëronte transferimin e tyre në një burg tjetër dhe rreth kushteve të paraburgimit të tyre në Burgun e Zenicës, por kjo kërkesë u rrëzua.

Në nëntor të vitit 2005, një nga kërkuësit u transferua në burgun e Mostarit, një tjetër burg në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës. Nga data 28 nëntor 2005 deri më 9 dhjetor 2005, tre kërkuësit që ishin ende në burgun e Zenicës hynë në një grevë të re urie duke protestuar kundër kushteve të burgut të tyre në njësinë spitalore. Në dhjetor 2005 dhe tetor 2006 edhe ata u transferuan në burgun e Mostarit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 22 qershor 2005. Më 24 dhe 29 qershor 2005, sipas Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës (vendimet e ndërmjetme), Gjykata kërkoi që kërkuësit të mbyllnin grevën e urisë. Në shtator të vitit 2005 çështjes ju dha prioritet sipas Rregullit 41 të Rregullores së Gjykatës.

Kërkuësit deklaruan se ata ishin të persekutuar nga të burgosurit e tjerë që nga koha e vendosjes së tyre në burgun e Zenicës, derisa u siguruan strehim të veçantë në njësinë e spitalit të burgut. Ata pretendonin se incidentet e ndryshme varionin që nga pështyrja në ushqim, derdhja e ujit në shtretërit e tyre deri në rrahjet dhe kërcënimet me vdekje. Ata më tej u ankuan për kushtet e tyre të burgut në njësinë spitalore. Ata i mbështetën pretendimet e tyre në nenet 3 dhe 13.

Neni 3

Ndalimi me të burgosurit e tjerë në burgun e Zenicës

Gjykata nuk vërejti ndonjë politikë të qeverisë për integrimin e atyre që janë dënuar për krime lufte në sistemin e burgjeve të zakonshme për të qenë në mënyrë të natyrshme çnjerëzore ose poshtëruese. Megjithatë, nuk përjashtoi faktin që zbatimi i kësaj politike mund të ngrejë çështje sipas nenit 3.

Gjykata rikujtoi se për shkak të të gjitha mizorive të kryera gjatë luftës, marrëdhëniet ndër-etnike vazhdonin të ishin ende të tensionuara dhe ngjarjet e dhunës me motive etnike vazhdonin të ishin relativisht të shpeshta gjatë periudhës respektive në Bosnje. Incidentet serioze të dhunës me motive etnike të drejtuara kundër të burgosurve me origjinë serbe dhe kroate ishin raportuar në Burgun e Zenicës. Duke marrë parasysh numrin e boshnjakëve në burg dhe natyrën e veprave të kërkuesve, ishte e qartë se ndalimi i tyre atje përbënte një rrezik serioz për mirëqenien e tyre fizike.

Përkundër kësaj, kërkuesit u vendosën në qeli të zakonshme, ku u duhej të ndanin një qeli me deri në 20 të burgosur të tjerë dhe të ndajnë pajisje të përbashkëta me një numër edhe më të madh të burgosurish. Për më tepër, burgu i Zenicës po përjetonte një mungesë serioze të stafit gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, mangësitë strukturore nuk e ndryshonin detyrimin e shtetit për të siguruar në mënyrë të përshtatshme mirëqenien e të burgosurve.

Ishte e rëndësishme që, pavarësisht nga ekzistenca e një rreziku serioz për mirëqenien fizike të kërkuesve, në Burgun e Zenicës nuk u ndërmorr asnjë masë specifike sigurie për muaj me radhë. Kërkuesit u akomoduan më vete në spitalin e burgut vetëm pas sulmeve të 4 dhe 5 qershorit 2005, edhe shpallja e grevës së urisë dhe vëmendja e vazhdueshme e medias, ndodhi thujse dhjetë muaj pas kërkuesi i parë kishte ardhur në burg. Administrata e burgjeve ishte gjithashtu e vetëdijshme për seriozitetin e situatës së kërkuesve gjatë kësaj periudhe.

Gjykata arriti në përfundimin se mirëqenia fizike e kërkuesve nuk u siguroa në mënyrë të përshtatshme nga koha e ardhjes së tyre në burgun e Zenicës derisa u siguruan një strehim të veçantë në spital (një periudhë që zgjati midis një dhe dhjetë muaj në varësi të kërkuesit). Prandaj, Gjykata konsideroi se vështirësitë që ju desh të duronin kërkuesit, në veçanti ankthi i vazhdueshëm psikologjik në lidhje me kërcënimin e dhunës fizike, ishte në kundërshtim me detyrimet pozitive të Shtetit sipas nenit 3 të Konventës.

Kushtet e ndalimit në Spitalin e Burgut të Zenicës

Pasi shqyrtoi provat në lidhje me mjetet në dispozicion të kërkuesve në spitalin e burgut, Gjykata konstatoi se kushtet e ndalimit të kërkuesve në njësinë e spitalit të burgut në Zenicë nuk përbënin shkelje sipas nenit 3.

Neni 13 marrë së bashku me nenin 3

Gjykata konstatoi se kërkuesit nuk kishin në dispozicion asnjë mjet juridik efektiv të brendshëm për kërkesat e tyre sipas nenit 3. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 13.

Neni 41

Në lidhje me dëmin jomaterial, Gjykata i akordoi secilit prej kërkuesve shumat midis 2,000 dhe 4,000 euro.

Mos respektimi i masës së ndërmjetme bazuar në Rregullin 39, për të mos lejuar ekstradimin në SHBA përbënte shkelje të nenit 34

VENDIM PËR ÇËSHTJEN RRAPO k. SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 58555/10)

25 shtator 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte z. Almir Rrapo, ishte shtetas shqiptar dhe amerikan.

Më 2 korrik 2010, kërkuesi bëri kërkesë zyrtare pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për rinovim të Pasaportës Amerikane, por ai u arrestua nga Policia Shqiptare me kërkesë të kësaj ambasade.

Një notë diplomatike (nr. 55), ju dërgua autoriteteve shqiptare për arrestimin paraprak të kërkuesit, pasi në 28 maj 2010 ishte lëshuar një urdhër arresti për të, nga një gjykatë amerikane.

Më 4 korrik 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë autorizoi ndalimin e ankuesit për një periudhë prej dyzetë ditësh. Z. Rrapo rezultonte të ishte në kërkim sipas Interpolit. Ankuesi dhe prokurori apeluan kundër vendimit. Vlefshmëria e ndalimit të ankuesit u miratua nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila e zgjati periudhën e ndalimit në gjashtëdhjetë ditë. Ankuesi apeloj në Gjykatën e Lartë, e cila e kundërshtoi apelimin. Midis gushtit dhe nëntorit të vitit 2010 kërkuesi bëri kërkesë dhe tre herë të tjera për ndalimin e tij, dhe çdo herë gjykatat vendase i rrëzuan kërkesat e tij dhe e zgjatën ndalimin e tij sipas Kodit të Procedurës Penale deri në 2 nëntor 2010.

Në gusht 2010, Ambasada e SHBA-së i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme një tjetër notë diplomatike (nr. 071), duke i kërkuar ekstradimin e kërkuesit. Sipas kësaj note kërkuesi së bashku me disa të pandehur të tjerë ishte akuzuar për pjesëmarrje në një organizatë kriminale shantazhi të përfshirë në vrasje, rrëmbime, shpërndarje droge, zjarrvënie, grabitje, transportim të mallrave të vjedhura dhe shtatë akuzat të tjera të ngjashme, ku pesë prej tyre përmbanin dënimin maksimal me burgim të përjetshëm; dy akuzat mbanin një dënim maksimal me dyzet vjet burg; një akuzë mbante dënim maksimal me njëzet vjet burg; dhe një tjetër akuzë mbante një dënim me vdekje ose me burgim të përjetshëm.

Gjykata e Rrethit miratoi kërkesën e prokurorit për ekstradimin e kërkuesit drejt SHBA-së më 30 shtator 2010, dhe hodhi poshtë kundërshtimin e ankuesit i cili pretendonte se autoritetet amerikane nuk kishin parashtruar ndonjë siguri kundër dënimit me vdekje, me arsyetimin se kjo siguri nuk kërkohet me ligj. Në nëntor 2010, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi në favor të ekstradimit të kërkuesit. Gjykata u shpreh se nuk ekzistonte asnjë detyrim ligjor që të kërkonte sigurinë nga autoritetet e amerikane kundër ushtrimit të dënimit me vdekje.

Më 12 tetor 2010, ndërsa procedurat e apelit nuk kishin përfunduar ende përpara Gjykatës së Apelit, Presidenti i Seksionit të Katërt të GJEDNJ në bazë të masave të ndërmjetme sipas Rregullit 39 i komunikoi qeverisë së Shqipërisë, se kërkuesi nuk duhej të ekstradohej në SHBA. Kjo masë do të ishte e vlefshme për dhjetë ditë.

Kërkuesi apeloj kundër ekstradimit të tij në Gjykatën e Apelit të Tiranës, ankesë e cila u hodh poshtë, me arsyetimin se nuk kishte asnjë detyrim ligjor për të kërkuar garanci nga autoritetet amerikane kundër dhënies së dënimit me vdekje. Në 16 nëntor 2010 Ministri i Drejtësisë urdhëroi ekstradimin e kërkuesit dhe njëherësh i dërgoi Ambasadës së SHBA një shënim verbal ku i kërkonte të dinte nëse kërkuesi do t'i nënshtrohej dënimit kapital për aktet kriminale për të cilat ai ishte akuzuar. Ambasada i ktheu përgjigje Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme me shënimin diplomatik ku saktësohej se kundër kërkuesit nuk do të kërkohet dhe as zbatohet dënimi me vdekje.

Më 9 nëntor 2010, kërkuesi bëri rekurs në Gjykatën e Lartë duke argumentuar se autoritetet e Shteteve të Bashkuara nuk i ofronin asnjë garanci ligjore për mos zbatimin e dënimit me vdekje, duke shkelur në këtë mënyrë nënin 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kërkuesi bëri edhe një kërkesë tjetër në Gjykatën e Lartë, në të cilën kërkonte pezullimin e ekstradimit të tij, duke ju referuar vendimit sipas Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës së Strasburgut.

Ndërkohë, Ministri i Drejtësisë e shtyu ekstradimin në 1 dhjetor 2010, në ekstremin e limitit kohor gjatë së cilit do mund të realizohej ekstradimi.

Më 24 nëntor 2010, kërkuesi u ekstradua në SHBA. Dy ditë më vonë Gjykata e Lartë, i shfuqizoi të dyja vendimet e gjykatave më të ulta dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, duke përdorur si arsyetim se gjykatat e ulta nuk duhet të kishin urdhëruar ekstradimin e kërkuesit, pasi ato nuk kishin marrë asnjë garanci nga autoritetet e amerikane se dënimi kapital nuk do të ushtrohej mbi kërkuesin dhe këto vendime binin ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë.

Më 26 korrik 2012, kërkuesi u shpall fajtor nga gjykata amerikane, dhe u dënua me 80 muaj burg dhe mbikëqyrje për 3 vjet pas liritimit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se ekstradimi në SHBA dhe rreziku i dënimit me vdekje përbënin shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës-së, dhe nenit 1 i Protokollit nr. 13. Kërkuesi gjithashtu u ankua se ekstradimi në SHBA ishte në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Strasburgut sipas Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës, duke ardhur për rrjedhojë në shkelje të nenit 34 të Konventës.

Nenet 2 dhe 3 të Konventës dhe neni 1 i Protokollit nr. 13

Gjykata vendosi të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për nenet 2 dhe 3 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit 13 të saj nën dritën e parimeve të përgjithshme vendosur më herët në vendimet e GJEDNJ86. Sipas, Gjykatës neni 3, ndalon kategorikisht torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor e poshtërues të personave, duke respektuar vlerat themelore të shoqërive demokratike. Parashikimet e këtij neni nuk mund të anashkalohej për asnjë rast, duke përfshirë këtu edhe kushtet e emergjencës.

Në rastin konkret Gjykata vërejti se kërkuesi u arrestua me synimin për t'u ekstraduar në SHBA, në bazë të kërkesës së autoriteteve amerikane në gusht 2010 për ekstradimin e tij *inter alia* bazuar në një akuzë kapitale. Sipas GJEDNJ-së është për të ardhur keq se Gjykata e Rrethit dhe e Apelit ranë dakord që të lejonin ekstradimin e kërkuesit pa ekzaminuar mundësinë e rrezikut të pretenduar nga ai. Përbën fakt shokues, që gjykatat më të ulta nuk kërkuan kurrë siguri nga qeveria shqiptare se dënimi me vdekje nuk do të jepej nëse kërkuesi shpallej fajtor. Gjykat nënvizoi se Protokollit nr. 13, i cili në Shqipëri hyri në fuqi më 1 qershor 2007, së bashku me detyrimet e Shtetit përgjegjës bazuar në nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës, pohonte se, për çfarëdo arsye, ai nuk do t'i ndalonte individët me synimin për t'i ekstraduar ata dhe më pas të gjykohej me akuzë kapitale. Gjithshtu, Shteti përgjegjës nuk duhet t'i bënte në asnjë mënyrë individët subjekt të një rreziku real për t'u dënuar me dënim me vdekje nëse nuk ofrohet siguri e mjaftueshme nga shteti që bën kërkesën e ekstradimit.

Megjithatë, Gjykata theksoi se në çështjet e ekstradimit, shënimet diplomatike janë mjete standarde për Shtetin që bën kërkesën për të dhënë çdo siguri, të cilën, Shteti të cilit i është paraqitur kërkesa, e konsideron të nevojshme për të dhënë miratimin e tij për ekstradim. Në këto raste merret në konsideratë dhe sjellja e shtetit, që kërkon

ekstradimin në raste të ngjashme⁸⁷. Gjykata në rastin konkret nuk gjeti asnjë fakt, që mund të ngrinte dyshime se mbi kërkuesin do të kërkohet apo ushtrohet dënimi kapital. Siguria e dhënë nga SHBA ishte specifike dhe e qartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se ekstradimi i kërkuesit nuk përbënte shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 13 të saj, në lidhje me rrezikun e ushtrimit ndaj z. Rrapo të dënimit me vdekje.

Neni 34

Gjykata theksoi se masat e përkohshme të parashikuara nga Rregulli 39 i Rregullores së Gjykatës së Strasburgut përdoren vetëm në raste të kufizuara, të cilat zakonisht kanë të bëjnë me të drejtën e jetës, të drejtën për të mos u bërë objekt i trajtimit çnjerëzor dhe të drejtën për respektimin e jetës private. Këto masa luajnë një rol thelbësor në shmangien e situatave të pakthyeshme. Në rastin konkret Gjykata e Strasburgut duhet të vlerësonte nëse kishte pengesa objektive, të cilat i detyruan autoritetet shqiptare të mos zbatonin masën e përkohshme, që i'u komunikua nga Kryetari i Seksionit IV të Gjykatës.

Prandaj, shteti kishte dështuar në përmbushjen efektive të të drejtës së kërkesës individuale të garantuar me nenin 34 të Konventës. Ky nen shkelet kur shteti nuk merr të gjitha masat që duhet të merren për të përmbushur një vendim të ndërmjetëm. Gjykata nuk do të rishqyronte nëse vendimi për zbatimin e masës së përkohshme ishte i saktë. Shteti duhet t'i provojë Gjykatës se është respektuar, ose në raste të jashtëzakonshme ka pasur një pengesë objektive që ka penguar mos zbatimin e kësaj mase dhe se janë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për heqjen e saj këtë dhe Gjykata duhet të ishte mbajtur e informuar.

Së pari, Gjykata hodhi poshtë argumentin e autoriteteve shqiptare se duke ekstraduar kërkuesin ata përmbushën një vendim përfundimtar të Gjykatës së Apelit të 1 nëntorit, duke arsyetuar se vendimi i asaj gjykate nuk ishte përfundimtar, përderisa GJL e shfuqizoi. Së dyti, sipas GJEDNJ argumenti i qeverisë shqiptare se përmes ekstradimit të Z. Rrapo u përmbush një detyrim ndërkombëtar i shtetit shqiptar, ishte i pabazuar – ku Gjykata iu referua çështjes Al-Saadoon dhe Mufdhi duke theksuar se një shtet mban përgjegjësi para GJEDNJ-së lidhur me detyrimet që rrjedhin nga traktati qoftë kjo para ose pas hyrjes në fuqi të Konventës. Një shtet kontraktues nuk mund të hyjë në marrëveshje me një shtet tjetër, duke rënë në kundërshtim me detyrimet e Konventës për shtetin kontraktues. Megjithëse, dëmi që synon të parandalojë masa e përkohshme nuk ndodh nuk është fakt i mjaftueshëm për të

87 Shih çështjet *Babar Ahmad dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* nr. 24027/07, 11949/08 dhe 36742/08, 6 korrik 2010.

vlerësuar nëse detyrimet e përcaktuara nga neni 34 i Konventës janë përmbushur nga shteti palë. Në përfundim, Gjykata kundërshtoi qeverinë shqiptare se ekstradimi ishte i pashmangshëm.

Mos zbatimi i masës së përkohshme dhënë nga Gjykata në mungesë të një justifikimi objektiv ka derivuar shkelje të nenit 34 të Konventës.

Neni 41

Pavarësisht, kërkesave të kërkuarit Gjykata vlerësoi se shteti shqiptar duhet t'i paguante atij vetëm shumën 1,500 euro për shpenzimet gjyqësore. Nga ana tjetër, Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me dëmin jomaterial.

Mos kryerja e hetimeve në mënyrë efektive lidhur me lëndimet e pësuar nga kërkuesi, mbarte në vetvete një nivel minimal së ashpërsie për t'u konsideruar keqtrajtim sipas nenit 3

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SINIŠTAJ DHE TË TJERËT K. MALIT TË ZI

(Kërkesat nr. 1451/10, 7260/10 dhe 7382/10)

24 nëntor 2015

1. Faktet kryesore

Z. Anton Siništaj dhe z. Viktor Siništaj (shtetas shqiptarë), z. Pjetar Dedvukaj, z. Djon Dedvuković dhe z. Nikola Ljekočević (shtetas malazez) dhe z. Kola Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj (shtetas amerikanë me origjinë shqiptare), të lindur mes viteve 1946 dhe 1980, u arrestuan më 9 shtator 2006 nga një njësi speciale anti-terroriste të dyshuar për bashkëpunimin me qëllim ndërmarrjen e veprimeve anti-kushtetuese, organizmin e akteve kundër rendit kushtetues ndaj sigurisë së Malit të Zi dhe posedimin e paligjshëm të armëve dhe eksplozivëve.

Më 11 dhe 12 shtator 2006, kur u pyetën nga gjyqtari i hetimeve paraprake i Gjykatës së Lartë, kërkuesit deklaruan se nga momenti i arrestimit të tyre dhe në vazhdim në periudhën e ndalimit si dhe në momentin që do të dilnin para gjyqtarit i hetimeve paraprake ata ishin keqtrajtuar dhe dhunuar me qëllim marrjen e deklaratave. Në veçanti, ata pretendonin se ishin rrahur, iu ishte privuar ushqimi, ishin fyer me fjalë, përfshi këtu edhe për origjinën e tyre etnike dhe se ishin kërcënuar nga policët. Gjyqtari i hetimeve paraprake i paraqiti këto pretendime në procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe një sërë lëndimesh të tjera të disa prej kërkuesve, të tilla si prerje, gërvishtje dhe hematoma. Gjithashtu, lëndimet e z. Pjetar Dedvukaj u vërtetuan edhe përmes raportit mjekësor të përgatitur nga mjeku i burgut.

Më 14 shtator 2006, pesë kërkuesit paraqitën një akuzë pranë gjyqtarit hetues kundër policëve të paidentifikuar për marrjen e deklaratave me dhunë, torturës dhe keqtrajtimet. Më 17 nëntor 2006, një raport i lëshuar nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm të Drejtorisë së Policisë konstatonte se përfshirja e zyrtarëve të akuzuar në keqtrajtimin e pretenduar nuk mund të provohej. Megjithatë, u vendos që të gjitha dokumentet relevante duhet të dorëzoheshin pranë Prokurorit të Shtetit për shqyrtim të mëtejshëm. Asnjë nga akuzat e lartpërmendura penale ose shtesat e tyre të mëvonshme nuk ishin marrë në shqyrtim nga autoritetet në kohën e gjykimit të çështjes pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me përjashtim të akuzës nga Prokurori i Shtetit në maj 2008 ndaj pesë policëve për veprën penale të torturës

dhe abuzimit të babait të kërkuesit të parë dhe të dytë në ditën e arrestimit të tyre. Megjithatë, në tetor 2010 të pandehurit u liruan.

Më 5 gusht 2008, Gjykata e Lartë i deklaroi fajtorë pesë prej kërkuesve për bashkëpunim për qëllime të akteve anti-kushtetuese dhe organizimin e akteve kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Malit të Zi, dhe dy prej tyre fajtorë për posedim të paligjshëm të armëve dhe eksplozivëve. Z. Kolja Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj u dënuan në bazë të dëshmisë së z. Anton Siništaj në komisariatit dhe policisë si dhe nga përmbajtja e ditarit të tij e gjetur gjatë kontrollit të banesës. Gjykata e Lartë gjithashtu vendosi që kontrolli i banesës së z. A. Siništaj ishte kryer në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe se të drejtat e tij nuk ishin shkelur gjatë procedurës paraprake. Apeli i kërkuesve nuk u pranua nga Gjykata e Apelit më 18 qershor 2009.

Më 25 dhjetor 2009, Gjykata e Lartë rrëzoi rekuursin e kërkuesve. Pas kësaj katër prej kërkuesve depozituan kërkesa kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, të cilat u rrëzuan më 23 korrik 2014.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor ose poshtëruar), kërkuesit u ankuan se ishin torturuar dhe keqtrajtuar nga policët midis periudhës 9 dhe 15 shtator 2006 dhe se marrja në shqyrtim e ankesave të tyre kishte qenë e paefektshme. Përveç kësaj, z. Kola Dedvukaj u ankua po në bazë të nenit 3 për mungesën e kujdesit të duhur mjekësor në kohën e ndalimit. Më tej, duke u mbështetur në nenin 6 (1) (të drejtën për proces të rregullt) dhe nenin 3, z. Kola Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj u ankuan që ishin dënuar me prova të marra me dhunë dhe duke u bazuar në ditarin e z. Anton Siništaj i cili ishte marrë gjatë një kontrolli të paligjshëm, përkthimi i të cilit nuk ishte i saktë.

Neni 3

Përsa i takon pranueshmërisë së kërkesave lidhur me keqtrajtimin e pretenduar në harkun kohor ndërmjet 9 dhe 15 shtatorit 2006 të paraqitur nga të gjithë kërkuesit, Gjykata hodhi poshtë të gjitha kërkesat përveç njëjës, si të papranueshme. Kërkuesi i parë, i dytë, i pestë, i gjashtë dhe i shtatë nuk i parashtuan kërkesat e tyre pranë Gjykatës brenda afatit prej gjashtë muajsh të parashikuar me nenin 35 dhe për rrjedhojë kërkesat e tyre u hodhën poshtë bazuar në rrethanat e çështjes. Në shqyrtimin e kërkesës së z. Djon Dedvuković, Gjykata vërejti se para saj ishte paraqitur një raport mjekësor i lëshuar në vitin 2010, i cili konstatonte se kishte disa fraktura të vjetra, por në dosjen e çështjes nuk kishte asgjë që të vërtetonte se ai kishte paraqitur të njëjtën

provë para ndonjë autoriteti vendas. Në fakt para gjyqtarit të hetimeve paraprake ai kishte deklaruar se nuk kishte pasur lëndime. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata hodhi poshtë kërkesën e z. Djon Dedvuković si haptazi të pabazuar.

Përsa i përket kërkesës së kërkuesit të tretë, Gjykata e deklaroi të pranueshme dhe vijoi me shqyrtimin e themelit të saj. Pas arrestimit të kërkuesit të tretë, si gjyqtari i hetimeve paraprake ashtu edhe mjeku i burgut vërejtën se ai kishte një fashë në kokën e tij nën të cilën kishte dhe një prerje të dukshme, si dhe një plagë në pjesën e sipërme të faqes së tij të majtë. Pas paraqitjes së një akuze në këtë drejtim në tetor të vitit 2006, veprimi i vetëm i ndërmarrë ishte një hetim nga ana e Kontrollit të Policisë së Brendshme, i cili doli me një raport dhe dukshëm në identifikimin dhe përfshirjen e policieëve. Sidoqoftë, ky raport nuk i referohej aspak kërkuesit të tretë ose lëndimeve të tij të vërejtura nga ana gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe mjeku i burgut dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohej i pavarur, duke qenë se raporti kishte dalë nga vetë policia, duke pasur parasysh dhe faktin se ankesat e kërkuesit dhe lëndimet ndaj tij nuk ishin marrë fare parasysh. Për më tepër, në dosjen në fjalë nuk kishte asgjë që do të dëshmonte se çdo veprim tjetër ishte ndërmarrë për të shpjeguar origjinën e lëndimeve të kërkuesit të tretë dhe për identifikimin e personave përgjegjës.

Prandaj, Gjykata konstatoi se niveli minimal i shkallës së ashpërisë së nenit 3 është mbartur dhe për rrjedhojë konsiderohet se ka pasur shkelje të të dyja elementeve substanciale dhe procedurale të nenit 3 në lidhje me kërkuesin e tretë.

Lidhur me pretendimet mbi mungesën e kujdesit të përshtatshëm mjekësor gjatë ndalimit të z. Kola Dedvukaj, Gjykata përsëriti interpretimin e kërkesës për sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të ndaluarve si një detyrim ndaj Shtetit për t'u siguruar atyre ndihmë të përshtatshme mjekësore si p.sh., duke përcaktuar diagnozën e saktë dhe duke treguar kujdes të menjëhershëm, si dhe kur kërkohet nga natyra e gjendjes shëndetësore, mbikëqyrje e rregullt dhe sistematike, duke marrë parasysh në të njëjtën kohë dhe kërkesat praktike të burgimit. Në kohën që u arrestua, z. Kola Dedvukaj kishte kolesterol të lartë, për të cilin ai edhe kishte marrë trajtim. Ky trajtim vazhdoi të kontrollohej rregullisht gjatë gjithë periudhës së ndalimit nëpërmjet kryerjes së analizave të ndryshme laboratorike dhe trajtimit përkatës. Më tej, nga dosja e tij mjekësore, midis 12 shtatorit 2006 dhe 24 dhjetorit 2008, ai u vizitua 36 herë në total nga specialistë të ndryshëm dhe për këtë mori rregullisht trajtimet dhe kontrollet e nevojshme. Për rrjedhojë, nuk kishte asnjë provë që në ndonjë rast kërkuesit i ishte mohuar ndihma mjekësore. Në këto rrethana, Gjykata hodhi poshtë ankesën e kërkuesit të gjashtë si haptazi të pabazuar.

Neni 6

Të gjitha kërkesat e paraqitura nga z. Kola Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj në bazë të nenit 6 u hodhën poshtë si haptazi të pabazuara.

Përsa i përket kërkesës së parë, sipas së cilës ata ishin dënuar në bazë të një deklaratë të marrë me dhunë nga z. Anton Siništaj, Gjykata vuri në dukje se asnjëri prej kërkuesve nuk paraqiti ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve të tyre dhe gjyqtari i hetimeve preparake nuk vërejti ndonjë dëmtim në lidhje me kërkuesin e parë. Më tej, dënimet e z. Kola Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj u bazuan në të gjitha dëshmitë e disponueshme (dhe jo vetëm mbi dëshmitë e marra me dhunë) ku procesi duke u marrë si njëi tërë mund të konsiderohej i drejtë.

Lidhur me objektin e kërkesës së tyre të dytë - provave (d.m.th. ditari) të marrë në bazë të një kontrolli të paligjshëm të banesës së z. Anton Siništaj - Gjykata theksoi se kërkuesit u ankuan për mungesën e pranisë së dy dëshmitarëve, parashikuar kjo sipas dispozitave përkatëse penale gjatë kontrollit të shtëpisë së z. Anton Siništaj. Duke qenë se nuk ishte e mundur të sigurohej prania e dëshmitarëve në kohën kur u krye kontrolli dhe ekzistonte rreziku që kontrolli duhet të shtyhej, kontrolli u krye sipas ligjit vendas dhe për rrjedhojë ishte i ligjshëm.

Gjykata vuri në dukje se z. Kola Dedvukaj dhe z. Rok Dedvukaj u gjyquan në të njëjtin proces me të akuzuarit e tjerë, duke përfshirë edhe ata të akuzuar për vepra penale të dënueshme deri në pesëmbëdhjetë vjet burg, gjykimii të cilave sipas legjisllacionit të brendshëm parashikonte një trup gjykues prej pesë gjyqtarësh. Megjithatë, meqenëse dy kërkuesit u akuzuan për vepra penale të dënueshme me burg më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe për këtë arsye legjisllacioni i brendshëm parashikonte një trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, sërisht Gjykata konkludoi se trupi gjykues që gjykoi kërkuesit ishte në përputhje me ligjin malazez.

Neni 41

Gjykata konstatoi se Mali i Zi duhej ti paguante kërkuesit të tretë z. Pjetar Dedvukaj, shumë prej 3,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Po këtij kërkuesi ju akordua dhe shuma prej 3,500 euro për shpenzimet gjyqësore.

Dështimi i autoriteteve kroate për hetimin e dhunës mbi motive racore ndaj viktimeve, përbëjnë shkelje të Konventës

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠKORJANEC k. KROACISË

(Kërkesa nr. 25536/14)

28 mars 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Znj. Maja Škorjanec, ishte shtetase kroate, e cila kishte lindur në 1988 dhe jetonte në Zagreb.

Më 9 qershor 2013, kërkuesja dhe partneri i saj, Š.Š., ishin në një treg gjërash të lira ku disa kalimtarë i sulmuan verbalisht dhe fizikisht, duke ju drejtuar shprehje fyese anti-rome gjatë sulmit fizik duke u shkaktuar edhe lëndime trupore. Më 29 korrik 2013, kërkuesja dhe partneri i saj, të përfaqësuar nga i njëjti avokat, paraqitën një kallzim penal në Zyrën e Prokurorisë të Rrethit të Zagrebit kundër dy të dyshuarve të pidentifikuar në lidhje me incidentin e 9 qershorit 2013.

Në kallzimin penal u pretendua se njëri nga të dyshuarit fillimisht kishte shtyrë kërkuesen duke i thënë asaj se ajo ishte një "kurvë" që kishte një marrëdhënie me një rom dhe për këtë do ta rrihnin. Ata e kishin kapur nga bluza dhe e kishin hedhur në tokë ku ajo kishte goditur dhe kokën. Më pas sulmuesit kishin vazhduar të rrihnin Š.Š., duke kërcënuar se do të vrisnin atë dhe kërkuesen. Sipas hetimit të kryer, kërkuesja u cilësua si dëshmitare.

Të dy sulmuesit u ndoqën penalisht dhe u dënuan për kërcënime serioze kundër Š.Š., duke i shkaktuar atij lëndime trupore, të lidhura me elementet e krimit të urrejtjes. Megjithatë, kallzimi penal i kërkueses u rrëzua me arsyetimin se vepra penale e pretenduar nuk ishte e motivuar nga urrejtja ndaj romëve, pasi kërkuesja nuk kishte origjinë rome.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive efektivisht në lidhje me dhunën e motivuar me baza racore kundër saj thjesht, sepse ajo nuk ishte origjinë rome, duke shkelur kështu nenet 3, 8 dhe 14. Ajo gjithashtu u ankua se duke mos iu përgjigjur kallzimit penal të saj, autoritetet vendase e kishin penguar atë në marrjen e të dhënave personale

të sulmuesve, pa të cilat ishte e pamundur që ajo të paraqiste një kërkesëpadi për dëmet e shkaktuara në kuadër të shkeljes së nenit 6.

Neni 3 marrë së bashku me nenin 14

Gjykata konstatoi se në lidhje me pretendimet mbi lëndimin dhe prezumimin për dhunën e motivuar në baza racore kërkesa e kërkueses duhej të shqyrtohej sipas nenit 3 marrë së bashku me nenin 14, në vend të nenit 8.

Gjykata theksoi se kur hetohen incidentet e dhunshme të shkaktuara nga sjellje të dyshimta raciste, autoriteteve shtetërore u është kërkuar të ndërmarrin të gjitha veprimet e arsyeshme për të përcaktuar nëse ka pasur motive raciste dhe për të vendosur nëse ndjenjat e urrejtjes ose paragjykimet e bazuara në origjinën etnike të një personi kanë luajtur rol në ngjarjet respektive. Një detyrim i tillë ka të bëjë jo vetëm me aktet e dhunës të bazuara në statusin ose karakteristikat personale të tanishme ose të perceptuara të viktimës, por edhe aktet e dhunës të bazuara në shoqëritë e sotme ose të prezumuara të viktimës ose në lidhje me një person tjetër, i cili në të vërtetë ose në dukje posedon një status të veçantë ose karakteristikë të mbrojtur.

Sistemi ligjor kroat siguroi mekanizma të përshtatshëm ligjorë që garantonin një nivel të pranueshëm mbrojtjeje për kërkuesen në rrethanat e çështjes, përkatësisht Kodi Penal parashikonte një dispozitë të posaçme për krimin e urrejtjes si një formë shtrënguese për veprën penale të shkakimit të lëndimeve trupore. Më tej, Gjykata vuri në dukje se sipas kësaj dispozite ishte e mjaftueshme që një krim urrejtjeje të konsiderohej si i tillë, edhe pa u evidentuar karakteristika të dukshme. Më pas, Gjykata vijoi shqyrtimin nëse mënyra mbi të cilën ishin zbatuar mekanizmat penale në rastin në fjalë kishte mangësi që përbënin shkelje të detyrimeve të shtetit të paditur sipas Konventës.

Pas raportit për sulmin ndaj kërkueses dhe partnerit të saj, policia u përgjigj menjëherë duke shkuar në vendin e ngjarjes dhe duke kryer një hetim paraprak mbi bazën dyshimit për kryerjen e një sulmi ndaj çiftit të motivuar nga urrejtja ndaj personave me origjinë rome. Gjatë hetimeve policia mori në pyetje kërkesen, partnerin e saj dhe dy sulmuesit. Ndërsa të dy sulmuesit mohuan çdo akuzë raciale për konfliktin e ndodhur, kërkuesi dhe partneri i saj dëshmuan për të kundërtën. Partneri i kërkueses kishte shpjeguar se si dy burrat, pas dyshimit të tij se ishin të dehur, i ishin kthyer atij dhe kishin filluar ta fyenin lidhur me origjinën e tij rome, dhe pas kësaj e kishin sulmuar atë. Ai gjithashtu, shpjegoi se kërkuësja ishte sulmuar kur ajo i kishte ardhur atij në ndihmë. Nga ana e saj, kërkuësja kishte konfirmuar versionin e ngjarjeve të Š.Š. Në këtë mënyrë deklaratat e tyre çonin në përfundimin se kërkuësja

ishite viktimë e një sulmi me motive racore për shkak të faktit se ajo kishte qenë në shoqërinë e Š.Š.

Pavarësisht dëshmive të mësipërme, autoritetet përkatëse e kufizuan hetimin dhe shqyrtimin e tyre në elementin e krimit të urrejtjes dhe sulmit me dhunë kundër Š.Š., duke mos kryer një vlerësim të plotë të faktorëve relevantë të situatës dhe marrëdhënies së kërkuases me Š.Š. dhe sulmit për motive racore ndaj tyre. Në fakt, policia paraqiti një kallzim penal vetëm në lidhje me sulmin ndaj Š.Š., duke e trajtuar kërkuesen thjesht si dëshmitare, megjithëse edhe ajo kishte pësuar lëndime gjatë të njëjtit sulm ndërsa ishte e shoqëruar me partnerin e saj.

Më tej, Gjykata theksoi pretendimet **specifike** të kërkuases lidhur me dhunën për motive racore drejtuar kundër saj në kallzimin penal të 29 korrikut 2013. Çështja ishte ngritur në mënyrë të ngjashme në rrjedhën e procesit penal kundër dy sulmuesve, ku informacione të mëtejshme sugjeronin se kërkuesi kishte qenë viktimë e dhunës me motive racore. Megjithatë, në vlerësimin e saj, Prokuroria theksoi faktin se vetë kërkuësja nuk ishte me origjinë rome dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohej viktimë e krimit të urrejtjes.

Gjykata ritheksoi qëndrimin e saj subsidiar, në lidhje me përcaktimin e fakteve që kanë bërë autoritetet kombëtare. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos vinte në dukje se këmbëngulja e autoriteteve të akuzës për faktin se kërkuësja nuk kishte origjinë rome, dhe dështimi i tyre në identifikimin nëse ajo ishte perceptuar nga ana e sulmuesve si rome, apo marrjen parasysh dhe përcaktimin e lidhjes ndërmjet motivit racist për sulmin dhe shoqërimit të kërkuases me Š.Š., kishte rezultuar në një vlerësim të metë të rrethanave të rastit. Kjo solli moskryerjen e përshtatshme të hetimit nga ana e autoriteteve vendase lidhur me pretendimet e kërkuases për një akt të dhunshëm me motive racore kundër saj deri në një masë të papajtueshme me detyrimin e Shtetit për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të zbuluar çdo motiv racist të mundshëm pas incidentit.

Rrjedhimisht, u konstatua se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës, kur ata rrëzuan kallzimin penal të kërkuases pa kryer një hetim të mëtejshëm para marrjes së vendimit të tyre, gjë që rezultoi me shkelje të nenit 3 lidhur me aspektin procedural marrë së bashku me nenin 14.

Neni 6

Gjykata vërejti se gjatë procesit kundër partnerit të saj, i cili gjithashtu ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat, kërkuases i ishte garantuar informacion i mjaftueshëm për të

dhënat personale të dy sulmuesve për ti mundësuar asaj ngritjen e një kërkesëpadie për dëmet e shkaktuara ndaj tyre. Për rrjedhojë, kërkesa e saj në bazë të nenit 6 u rrëzua si haptazi e pabazuar.

Neni 41

Kërkueses ju akordua vlera prej 12,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 2,200 euro për shpenzimet gjyqësore.

Sterilizimi i gruas rome në një spital publik, pa vullnetin e saj të plotë përbënte shkelje të drejtave të njeriut sipas neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN V.C. k. SLOVAKISË

(Kërkesa nr. 18968/07)

8 nëntor 2011

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, V.C, ishte shtetase sllovae me origjinë etnike rome, e lindur në vitin 1980 dhe jetonte në Jarovnicës të Sllovakisë.

Në gusht të vitit 2000, gjatë lindjes së fëmijës së saj të dytë ajo u sterilizua në Qendrën Spitalore dhe Shëndetësore në Prešov të Sllovakisë, e cila ishte në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Kërkuesja pretendonte se, në përfundim të procesit të sterilizimit ajo u pyet nëse donte të kishte më shumë fëmijë, por për këtë ju tha që nëse po, ajo ose fëmija i saj do të vdisnin. Për shkak të frikës dhe dhimbjes ajo e nënshkroi formularin e sterilizimit, por nuk e kuptoi natyrën dhe pasojat e këtij procesi, veçanërisht pakthyeshmërinë e tij. Kërkuesja nuk ishte informuar për ndonjë metodë alternative. Nënshkrimi i formularit u krye pa vullnetin e saj të plotë. Ajo gjithashtu deklaroi se përkatësia e saj rome - e shprehur qartë në të dhënat e saj mjekësore - luajti një rol vendimtar në procesin e sterilizimit të saj.

Administrata e spitalit të Prešov, deklaroi se procesi i sterilizimi të kërkueses u krye për shkaqe mjekësore dhe se kërkuesja kishte dhënë pëlqimin e saj pasi ishte informuar lidhur me rrezikun që i kanosej nga në rast se nuk do e hiqte mitrën.

Në janar të 2003, Qendra për të Drejtat e Riprodhimit dhe Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Civile botoi një raport "Trupi dhe Shpirti: Sterilizimi i detyruar dhe shtrëngues dhe sulme të tjera për Lirinë Riprodhuese të Romëve në Sllovaki" ("Raporti i Trupit dhe Shpirtit"). Për këtë u kryen një sërë porcesesh: një hetim i përgjithshëm penal për sterilizimin e dyshuar si të paligjshëm të grave të ndryshme rome, ku si përfundim u ndërpre me arsyetimin se nuk ishte kryer asnjë vepër penale; si dhe, proceset civile dhe kushtetuese të iniciuara nga kërkuesja me pretendimet se spitali e kishte mashtruar atë me qëllim sterilizimin. Si përfundim, kërkesëpadia u hodh poshtë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Preshevës, në maj të vitit 2006, me arsyetimin se sterilizimi ishte i domosdoshëm nga ana mjekësore dhe ishte kryer në

përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe me pëlqimin e kërkuesses. Më pas u rrëzua edhe kërkesa kushtetuese.

Kërkuësja ju referua disa botimeve që tregonin histori të sterilizimit të detyruar të grave rome, të cilat filluan gjatë regjimin komunist në Çekosllovakia në fillim të viteve 1970. Në veçanti, ajo paraqiti se 60% e sterilizimeve të kryera nga viti 1986 deri në 1987 në rrethin e Prešovit ishin bërë ndaj grave rome.

Qeveria parashtroi se kujdesi shëndetësor në Sllovakia iu ofrua të gjitha grave në mënyrë të barabartë dhe se të gjitha proceset e sterilizimit ishin kryer për shkaqe mjekësore.

Sterilizimi i kërkuesses kishte pasoja të rënda mjekësore dhe psikologjike. Veçanërisht në 2007/2008, ajo përjetoj një shtatzëni psikologjike. Që nga 2008 ajo u trajtua nga një psikiatër dhe vazhdoi të vuante faktin e të qenit e sterilizuar, përfshi këtu dhe përjashtimin nga komuniteti rom dhe divorcimin nga bashkëshorti i saj.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësja u ankua se ishte sterilizuar pa vullnetin e saj të plotë dhe se hetimi që u krye nga autoritetet nuk ishte i plotë, i drejtë apo efektiv. Ajo më tej pretendoi se etnia e saj luajti një rol vendimtar në sterilizimin e saj, duke parashtruar në këtë mënyrë orientimin drejt parjes në një kontekst më të gjerë të procesit të sterilizimit të grave rome dhe qëndrimet e vazhdueshme armiqësore ndaj romëve. Ajo mbështetej në nenet 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 12 (e drejta për t'u martuar), 13 (e drejta për një zgjidhje efektive) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit).

Neni 3

Keqtrajtimi

Gjykata vuri në dukje se sterilizimi përbente një ndërhyrje të rëndësishme në statusin e shëndetit riprodhues të një personi, duke përfshirë dhe aspekte të shumta të integritetit personal (mirëqenia fizike dhe psikologjike, si dhe emocionale, shpirtërore dhe jeta familjare), kërkonte vullnetin e plotë të një pacienti të rritur me arsyetim racional. Për më tepër, vullneti i plotë është përcaktuar si një parakusht për procesin e sterilizimit në një sërë dokumentash ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësisë, e cila ishte në fuqi në Sllovakia në periudhën e sterilizimit të kërkuesses.

Megjithatë, nga dokumentet e paraqitura, kërkuesja - një paciente me shëndet të plotë mendor nuk ishte informuar plotësisht për gjendjen e shëndetit të saj, sterilizimin e propozuar dhe/ose alternativat e tij. Në vend të kësaj, asaj iu kërkua të nënshkruante një formular ndërkohë që ajo ishte ende gjatë dhimbjeve të lindjes. Për më tepër, ajo u shty të nënshkruante dokumentin pasi ju tha nga stafi mjekësor se nëse do të kishte një fëmijë më shumë, ajo ose fëmija do të vdisnin. Ndërhyrja, pra, nuk ishte një domosdoshmëri e menjëhershme mjekësore pasi çdo kërcënim për shëndetin e saj konsiderohej si i mundshëm në rast të një shtatëzanie në të ardhmen. Në fakt, sterilizimi në përgjithësi nuk konsiderohet si ndërhyrje për shpëtimin e jetës. Gjykata konstatoi se mënyra në të cilën veproi stafi i spitalit ishte imponuese pasi në praktikë ajo nuk kishte zgjedhje tjetër veçse të pajtohej me kryerjen e procesit të sterilizimit, pa pasur kohë të reflektonte mbi pasojat e saj ose ta diskutonte me bashkëshortin e saj.

Sterilizimi i kërkueses, si dhe mënyra në të cilën i ishte kërkuar asaj të binte dakord, duhet ti kenë shkaktuar asaj ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit. Për rrjedhojë, kjo solli pasoja të shtrira në kohë dhe serioze lidhur me gjendjen shëndetsore fizike dhe psikologjike, si dhe në marrëdhëniet e saj me bashkëshortin dhe me komunitetin rom. Megjithëse nuk kishte asnjë provë se personeli mjekësor kishte pasur për qëllim keqtrajtimin e kërkueses, sërisht ata kishin nënvlerësuar të drejtën e saj për të bërë zgjedhjen e lirë si paciente. Për rrjedhojë, sterilizimi i kërkueses përbënte shkelje të nenit 3.

Hetimet lidhur me keqtrajtimin

Gjykata vuri në dukje se kërkuesja kishte një mundësi që veprimet e ndërmarra nga ana e personelit spitalor të shqyrtoheshin nga autoritetet vendore nëpërmjet procesve civile dhe kushtetuese. Gjykatat u morën me çështjen e saj civile për një periudhë prej dy vitesh e një muaji dhe çështjen e saj kushtetuese brenda 13 muajve, një periudhë kohore që nuk lë hapësirë për kritika. Ajo nuk kishte kërkuar dëmshpërblim duke iniciuar një hetim penal, edhe pse kjo mundësi kishte qenë e hapur për të. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në lidhje me pretendimin e kërkueses se hetimi për sterilizimin e saj kishte qenë jo i plotë.

Neni 8

Duke pasur parasysh konstatimin e saj të mëparshëm lidhur me shkelje të nenit 3, Gjykata e konsideroi të panevojshme marrjen në shqyrtim me vete të nenit 8, për të konstatuar nëse procesi i sterilizimit të kërkueses përbënte shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

Gjykata konstatoi se Sllovakia dështoi në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga neni 8, duke mos garantuar vëmendjen e veçantë që i duhej kushtuar shëndetit riprodhues të kërkueses si rome.

Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës kishin identifikuar të meta serioze në legjislacionin dhe praktikën lidhur me sterilizimet në përgjithësi në Sllovakë duke dalë në deklarata se komuniteti rom ishte ai që kishte pasur më shumë gjasa të prekej nga këto të meta. Po kështu, një raport i ekspertëve të qeverisë sllovaqe të majit 2003 kishte identifikuar të meta në kujdesin shëndetësor dhe pajtueshmërinë me rregullat mbi sterilizimin, duke bërë rekomandime rreth trajnimit të stafit mjekësor në lidhje me romët. Në veçanti, lidhur me kërkuesen, Gjykata konstatoi se thjesht duke iu referuar origjinës së saj etnike në dosjen e saj mjekësore dhe pa një informacion më të plotë, stafi mjekësor krijoi bindjen për mënyrën sesi duhej të trajtohej kërkuesja, pra si anëtare e komunitetit rom. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 8 në lidhje me mungesën e masave mbrojtëse ligjore në periudhën e sterilizimit të kërkueses, duke i kushtuar vëmendje të veçantë shëndetit të saj riprodhues si anëtare e komunitetit rom.

Neni 13

Çështja e kërkueses u shqyrtua nga Gjykatat civile në dy nivele juridiksioni dhe më pas nga Gjykata Kushtetuese. Ajo gjithashtu duhet të kishte iniciuar një proces penal. Përveç kësaj, neni 13 nuk mund të interpretohej si kërkesë e një mjeti ligjor të përgjithshëm kundër legjislacionit vendas, deri në masën që - siç deklarohet nga kërkuesja - mungesa e masave mbrojtëse të përshtatshme sipas legjislacionit vendas kishte qenë në shkaku i sterilizimit të saj dhe në vijim rrëzimin e kërkesës së saj. Për rrjedhojë, nuk kishte pasur shkelje të nenit 13.

Neni 12

Duke pasur parasysh konstatimin e Gjykatës se sterilizimi i kërkueses kishte pasoja serioze në jetën e saj private dhe familjare, Gjykata e konsideroi të panevojshme marrjen në shqyrtim më vete lidhur me faktin nëse kishte pasur shkelje të së drejtës së saj për t'u martuar dhe për të krijuar një familje sipas nenit 12.

Neni 14

Gjykata gjithashtu konsideroi se ishte e panevojshme të shqyrtohej më vete kërkesa e kërkueses sipas nenit 14. Provat objektive nuk ishin të mjaftueshme për të provuar se mjekët kishin vepruar në keqbesim kur sterilizuan kërkuesen dhe se sjellja e tyre

ishte motivuar në bazë të qëllimeve racore ose se sterilizimi i saj ishte pjesë e një politike të organizuar. Megjithatë, Gjykata më tej vuri në dukje se organet ndërkom-bëtare dhe ekspertët vendas kishin vënë në dukje të meta serioze në legjislacionin dhe praktikën vendase në lidhje me sterilizimet, të cilat ishin veçanërisht të orien-tuara ndaj anëtarëve të komunitetit rom dhe për rrjedhojë kishin konstatuar se Sll-ovakia nuk kishte përmbushur detyrimet e saj pozitive sipas nenit 8 për të mbrojtur mjaftueshmërisht kërkuesen.

Neni 41

Gjykata vendosi që Sllovakia duhet ti paguante kërkueses shumën prej 31,000 euro lidhur me dëmin jomaterial dhe 12,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

Dështimi i autoriteteve për dhënien e trajtimit me terapinë e përshtatshme gjatë periudhës së ndalimit për një person të varur nga droga, përbënte një shkelje të nenit 3

VENDMI PËR ÇËSHTJEN WENNER K. GJERMANISË

(Kërkesa nr. 62303/13)

1 shtator 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Wolfgang Adam Wenner, ishte shtetas gjerman. Ai kishte krijuar varësi nga heroína që nga viti 1973, kur ishte 17 vjeç dhe kishte virusin HIV pozitiv që nga viti 1988. Ai gjithashtu, ishte konstatuar plotësisht si person me aftësi të kufizuara që nga viti 2001.

Z. Wenner kishte provuar të shkëputej nga varësia e krijuar nga droga përmes rehabilitimeve të ndryshme, por pa sukses. Duke nisur nga viti 1991 deri në vitin 2008, varësia e tij ndaj drogës u trajtua përmes terapisë së zëvendësimit të drogës të këshilluar dhe mbikëqyrur nga ana mjekësore.

Në 2008, z. Wenner u arrestua si i dyshuar për trafik droge dhe u ndalua në Bavari, ku terapia e zëvendësimit të drogës i ishte ndërprerë kundër vullnetit të tij. Në qershor 2009 ai u dënua për trafik droge me gjashtë vjet burg. Gjykata urdhëroi që ai të dërgohej në një qendër rehabilitimi për personat që ishin të varur nga droga, por kjo ndodhi gjashtë muaj pas ndalimit të tij. Në dhjetor të vitit 2009 ai u transferua në qendrën e rehabilitimit të drogës në Bavari ku i'u nënshtrua trajtimit për varësi nga droga, pa trajtim të zëvendësimit shtesë. Në prill të vitit 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Memmingenit e ndërpreu qëndrimin e tij në qendrën e rehabilitimit, pasi mjekët që ishin marrë me trajtimin e tij konstatuan se kërkuesi nuk mund të vazhdonte të kurohej pasi me gjasa ai nuk mund të shërohej nga varësia që kishte ndaj drogës dhe për rrjedhojë u transferua përsëri në burg. Z. Wenner e apeloj këtë vendimi, pavarësisht se dhe ankimimi i tij ju rrëzua nga Gjykata e Apelit të Mynihut, e cila doli në konkluzionin se nuk duhej të mund të pritej për një periudhë të konsiderueshme kohore që ai të shërohej dhe rehabilitohej nga varësia që kishte krijuar ndaj drogës duke shmangur për rrjedhojë një kohë të konsiderueshme nga dënimi i dhënë me burg ndaj tij.

Në qershor të 2011 z. Wenner paraqiti një kërkesë para autoriteteve të burgjeve për të trajtuar varësinë e tij të drogës me një zëvendësues të heroinës. Ai gjithashtu, kërkoi që kërkesa e tij të merrej në shqyrtim nga një specialist i drogës për të vërtetuar nevojën e terapisë së zëvendësimit të drogës për kërkuesin. Ai më tej pretendoi se

dhimbja e tij serioze nervore mund të lehtësohej në një masë të konsiderueshme nga terapia e zëvendësimit të drogës, siç ishte diagnostikuar nga mjeku i jashtëm që e kishte marrë në shqyrtim rasin e tij sipas kërkesës së autoriteteve të burgut në tetor të 2010. Autoritetet e burgut e hodhën poshtë kërkesën e tij duke deklaruar se terapia e zëvendësimit nuk është e nevojshme dhe as e përshtatshme për rehabilitimin e tij. Ata argumentuan se ai ishte trajtuar tashmë në qendrën e rehabilitimit të drogës, ku nuk iu aplikua terapia e zëvendësimit të drogës dhe se pas tre vitesh burgim ai nuk vuante më nga simptomat e varësisë nga droga.

Z. Wenner e apeloj vendimin, duke argumentuar se autoritetet e burgut nuk arritën të shqyrtonin, sipas kritereve të përcaktuara me ligj, nëse terapia zëvendësuese e drogës ishte e nevojshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor e hodhi poshtë kërkesëpadinë e tij në mars 2012, duke i qëndruar arsytimit të parashtruar nga autoritetet e burgjeve. Vendimi u mbështet edhe nga Gjykata e Apelit të Mynihut dhe më 10 prill 2013, Gjykata Kushtetuese Federale nuk e mori në shqyrtim kërkesën kushtetuese.

Më 17 nëntor 2014, autoritetet e burgut e rrëzuan kërkesën e radhës së kërkuesit për t'u trajtuar me terapinë e zëvendësimit në periudhën që po përgatitej për t'u liruar nga burgju. Këshilltari ligjor i tij u këshillua gjithashtu nga autoritetet e burgut për ta dërguar kërkuesin në një qendër për rehabilitimin e drogës në momentin e lirimit nga burgju me qëllim që të parandalonin atë në marrjen e ndonjë mbidoze heroine sapo ti krijohet mundësia. Në dhjetor të vitit 2014, pas lirimit të z. Wenner nga burgju, ai u ekzaminua nga një mjek, i cili i këshilloi terapinë e zëvendësimit të drogës.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 3, nisur nga refuzimi i autoriteteve për ta trajtuar atë me terapinë e zëvendësimit të drogës në burg, duke i shkaktuar atij vuajtje dhe dhimbje të konsiderueshme dhe në këtë mënyrë duke i dëmtuar shëndetin. Ai gjithashtu, argumentoi se refuzimi për t'u trajtuar domosdoshmërisht me terapinë e zëvendësimit të drogës, i ekzaminuar nga një mjek i jashtëm, përbënte trajtim çnjerëzor.

Neni 3

Gjykata ritheksoi se në mënyrë që llojet e keqtrajtimin të merren në shqyrtim sipas qëllimit të nenit 3 duhet që keqtrajtimi të mbartë në vetvete një nivel minimal të shkallës së ashpërsisë. Vlerësimi i këtij niveli minimal është relativ, në varësi nga të gjitha rrethanat e rastit. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se neni 3 përcakton detyrime ndaj Shtetit për të garantuar që çdo person i ndaluar të mbahet në kushte që

janë në përputhje me respektin e dinjitetin njerëzor, i cili përfshin, ndër të tjera, edhe qasjen për trajtimin mjekësor të përshtatshëm. Kjo do të thotë se trajtimi mjekësor i ofruar duhet të jetë në një nivel proporcional me trajtimin që shteti i siguron qytetarëve të tij në tërësi - megjithatë kjo nuk do të thotë se ajo duhet të jetë ekuivalente me nivelin e institucioneve më të mira shëndetësore jashtë burgut. Një i burgosur që vuan nga një sëmundje serioze duhet t'i nënshtrohet një diagnostikimi të gjendjes së tij shëndetësore nga një mjek specialist dhe duhet ti garantohet kurim i përshtatshëm. Gjithashtu, Gjykata në vlerësimin e saj do të shqyrtojë respektimin e nenit 3 nga ana e Shtetit, nisur nga fakti nëse të burgosurit që vuante nga një gjendje e rëndë shëndetësore iu mohua ndihma mjekësore sipas kërkesës së tij. Gjykata vuri në dukje se nuk ishte kompetenca e saj për të vendosur mbi çështje që ishin ekskluzivisht në fushën e ekspertizës mjekësore ose për të vendosur se çfarë përbën trajtim të përshtatshëm për përmushjen e nevojave të kërkuarit. Megjithatë, barra e provës binte mbi Qeverinë për të paraqitur dëshmi të besueshme dhe bindëse që tregonin se kërkuari kishte marrë trajtim mjekësor gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm gjatë periudhës së ndalimit.

Në rastin konkret ndërmjet palëve ka pasur kontestime nëse trajtimi me terapi zëvendësuese të drogës konsiderohej si trajtim i domosdoshëm mjekësor që duhej t'i ofrohej kërkuarit në mënyrë që Shteti të përmbushte detyrimin e tij sipas nenit 3. Gjykata vuri në dukje se megjithëse trajtimi me terapinë e zëvendësimit të drogës ishte bërë gjithnjë e më i përhapur në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës gjatë viteve të fundit, ky lloj trajtimi ishte ende subjekt i polemikave se cilat ishin masat që duhet të merreshin për të trajtuar varësinë nga droga. Në këtë rast Gjykata vuri në dukje se nuk ishte e nevojshme të përcaktonte kërkesën e kërkuarit mbi trajtimin me terapi zëvendësuese të drogës, por në vend të kësaj, duhej të përcaktonte nëse shteti kishte paraqitur dëshmi të besueshme dhe bindëse që vërtetonin se gjendja shëndetësore dhe trajtimi i kërkuarit ishte vlerësuar në mënyrë të përshtatshme dhe se ai realisht kishte marrë trajtim mjekësor të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës.

Midis palëve nuk kishte kundërshtime lidhur me faktin se kërkuari ishte i varur nga droga prej një kohe të gjatë dhe në kohën e ndalimit kishte më shumë se dyzet vjet me këtë varësi. Të gjitha përpjekjet e tij për të të mos qenë i varur, që përfshinin dhe terapitë e shumta të rehabilitimit, kishin dështuar. Gjithashtu, gjendemi para faktit të pakundërshtueshëm se kërkuari vuante nga dhimbje kronike për shkak të konsumit të tij afatgjatë të drogës si dhe polineuropatisë⁸⁸. Para ndalimit të tij, kërkuari u trajtua me terapi zëvendësuese të drogës për shtatëmbëdhjetë vjet. Gjykata vërejtë se trajtimi me terapi të zëvendësimit të drogës ishte e aplikueshme në burgjet Gjer-

88 Degradim i përgjithshëm i nervave periferik që përhapet drejt qendrës së trupit, shënim i përkthyesit.

mane dhe jo vetëm që mjekët këshilluan trajtimin me terapinë e zëvendësimit të drogës sipas nevojës për të trajtuar kërkuesin përpara ndalimit të tij, por një mjek i jashtëm i caktuar nga autoritetet e burgut kishte dalë në të njëjtin konkluzion. Fakti që kërkuesit iu këshillua trajtimi me terapi zëvendësuese të drogës pas lirimit nga burgu, përbënte një tregues të fortë që mund të konsiderohej një trajtim i përshtatshëm për kërkuesin. Për më tepër, pasi u transferua nga qendra e rehabilitimit të drogës, shëndeti i kërkuesit gjatë periudhës së ndalimit u karakterizua nga dhimbje kronike, të cilat vinin si pasojë e simptomave të mëparshme të varësisë nga droga. Sipas mjekëve të qendrës së rehabilitimit të drogës në të cilën ishte kuruar kërkuesi, terapia e orientuar përmes zëvendësimit të drogës kishte dështuar, dhe për rrjedhojë para gjykatave vendase ishte krijuar bindja mbi këtë rezultat. Për këtë, autoritetet u thirrën për të vlerësuar nëse për kërkuesin do të ishte e përshtatshme një lloj tjetër terapie.

Autoritetet kishin elemente të forta që dëshmonin se terapia e zëvendësimit të drogës mund të ishte një trajtim i përshtatshëm për gjendjen shëndetësore të kërkuesit. Nuk kishte dëshmi se autoritetet vendase, me ndihmën e këshillave të ekspertëve mjekësorë, shqyrtuan nëse terapia e zëvendësimit të drogës ishte ende një trajtim i përshtatshëm për kërkuesin, pavarësisht trajtimit të terapisë së zëvendësimit të drogës për rreth shtatëmbëdhjetë vjet. Gjithashtu, Gjykata deklaroi se dhimbja e kërkuesit u përkeqësua edhe nga fakti se ai ishte në dijeni të ekzistencës së një trajtimi që mund të lehtësonte dhimbjen e tij në mënyrë efektive, por ky trajtim ju mohua. Refuzimi për t'i dhënë kërkuesit trajtimin me terapinë e zëvendësimit të drogës, kundrejt varësisë së tij dhe trajtimit të mëparshëm me terapinë e zëvendësimit të drogës, i shkaktoi atij vuajtje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme psikologjike dhe fizike për një periudhë të gjatë kohore. Në bazë të provave, Gjykata kishte krijuar bindjen se varësia fizike dhe psikologjike që kërkuesi kishte pësuar për shkak të gjendjes së tij, mund të tejkalonte pragun minimal të ashpërisë së vuajtjes që ishte normale për shkak të ndalimit të tij dhe për rrjedhojë i takonte fushëveprimin të nenit 3. Autoritetet kishin për detyrë që të vlerësonin siç duhet aspektin shëndetësor të kërkuesit dhe të ofronin trajtim të përshtatshëm, megjithatë siç u vërejt dhe më sipër, ata nuk arritën të provojnë se kurimi i kërkuesit vetëm me qetësues ishte i mjaftueshëm në rrethanat konkrete dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 3.

Neni 41

Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me dëmin jomaterial, por nga ana tjetër i akordoi atij vlerën prej 1,801.05 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Mungesa e një hetimi efektiv lidhur me pretendimet për abuzimin seksual dhe mbrojtja e viktimës nga ballafaqimi me autorin e sulmit – ishte në shkelje të neneve 3 dhe 8

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Y. k. SLOLOVENISË

(Kërkesa nr. 41107/10)

28 maj 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesja znj. Y., ishte shtetase sllovene, 28 vjeç dhe kishte lindur në Ukrainë në vitin 1987.

Në 2002, e ëma e kërkueses paraqiti një kallëzim penal kundër z. X (një mik i familjes), i cili dyshohej se përdhunoi Y., atëherë 14-vjeç në peridhën midis korrikut dhe dhjetorit të vitit 2001.

Pas kësaj në vitin 2002, nisi një hetim nga ana e policisë dhe më pas në vitin 2003, u hap një hetim gjyqësor. Në vitin 2006, pas përfundimit të hetimeve z. X., u akuzua për veprën penale për marrëdhënie me dhunë me të mitur nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare.

Gjatë hetimit penal, u morën në pyetje znj. Y., z. X., dëshmitarët dhe ekspertët. Ndërsa një psikolog konstatoi se znj. Y., kishte simptoma që lidheshin me abuzimin seksual, ndërsa eksperti ortoped argumentoi se z. X., nuk mund të kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej për shkak të krahut të tij të sëmurë. Eksperti i gjinekologjisë ju kundërvu znj. Y., nisur nga rezultatet e raportit të ortopedisë dhe e pyeti se pse ajo nuk e kishte mbrojtur veten më shumë. Përveç kësaj, ka pasur dy raporte gjinekologjike, të cilat nuk ishin bindëse në lidhje me pretendimet e znj. Y.

Veçanërisht, kërkesa e znj. Y., në gjykatë për përjashtimin e përfaqësuesit ligjor të z. X., një i njohur i znj. Y., u rrëzua pasi nuk kishte asnjë bazë ligjore që mund të bazohej ky pretendim.

Gjyqi zgjati nga qershori 2007 deri në shtator 2009. Gjatë 12 seancave të njëpasnjëshme, proceset penale u shtynë në mënyrë të përsëritur. Në veçanti, znj Y., u përball publikisht me z. X., për rreth katër orë. Ai deklaronte se ishte fizikisht i pamundur për ta sulmuar atë dhe se akuzat e saj kundër tij ishin nxitur nga dëshira e nënës së saj për të zhvatur para prej tij; disa pyetje kishin formulim sugjestionues për të marrë një përgjigje të caktuar dhe ai pretendonte se ajo ishte në gjendje të qante me qëllim që njerëzit të besonin atë.

Në përfundim, gjykata vendase i rrëzoi të gjitha akuzat ndaj z. X., pasi shkelja e pretenduar nuk ishte vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja, duke ju referuar nenit 3, deklaroi se kishte qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës si rezultat i vonesave evidente në procesin penal dhe se autoritetet përgjegjëse kishin qenë të anshme ndaj saj për shkak të origjinës ukrainase. Përveç kësaj, kërkuesja deklaroi se integriteti i saj personal, i mbrojtur nga neni 8, ishte shkelur për shkak të ballafaqimit publik dhe ndërhyrjes intensive nga i akuzuari gjatë procesit penal, e cila kishte rezultuar në një përvojë të mëtejshme traumatike ndaj saj.

Neni 3

Gjykata përsëriti parimet e saj të vendosura në lidhje me një detyrim pozitiv të Shtetit sipas nenit 3, lidhur me hetimin efektiv dhe ndjekjen penale të keqtrajtimet, duke përfshirë abuzimin seksual. Veçanërisht, u theksua rëndësia e reagimit të shpejtë të autoriteteve ndaj çdo ankese lidhur me keqtrajtimin.

Në përfundim, Gjykata pranoi vështirësinë për autoritetet përgjegjëse për të vlerësuar dhe hetuar veçanërisht një çështje të ndjeshme si ajo e abuzimit seksual të ndodhur në një situatë kur dëshmitë nuk përputhen dhe mungojnë provat materiale të besueshme.

Megjithatë, hetimet dhe procesi i mëvonshëm kishin pasur disa vonesa dhe mosveprim nga ana e autoriteteve përgjegjëse. Periudha nga momenti i kryerjes së kallëzimit penal nga ana e kërkueses deri në vendimin e gjykatës ishte një hendek kohor prej 7 vitesh. Përderisa këto vonesa ishin të pamjaftueshme për të vendosur detyrat e autoriteteve përgjegjëse gjatë hetimit lidhur me kallzimin penal të kërkueses, Gjykata konstatoi mungesën e kërkesës procedurale për kërkesën lidhur me kryerjen e hetimeve të përshpejtuara gjatë periudhës së procesit penal.

Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të detyrimeve procedurale të Qeverisë sipas nenit 3 të Konventës.

Neni 8

Kërkesa në bazë të nenit 8 kishte të bënte me dështimin e qeverisë për të marrjen e masave efektive për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të keqtrajtimet gjatë procesit penal. Miratimi i masave të përshtatshme për të garantuar respektimin e jetës private të viktimës gjatë procesit penal bie në kundërshtim me detyrimet pozitive sipas nenit 8.

Për këtë qëllim, duhet të arrihet një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesit të mbrojtjes dhe interesit të dëshmitarëve dhe/ose viktimave të thirrura për të dëshmuar. Në rastin në fjalë, ajo që kërkohet të shqyrtohet është nëse mënyra në të cilën viktimat është marrë në pyetje a përbën një ekuilibër të drejtë midis integritetit të saj personal dhe të drejtës së mbrojtjes së të pandehurit.

Në bazë të nenit 6, një proces i rregullt kërkon që i akuzuari të ketë mundësinë të ballafaqohet me dëshmitarin dhe/ose viktimën. Megjithatë, kjo e drejtë, nuk është e pakufizuar. Gjykatat kombëtare duhet të vlerësojnë me kujdes masën në të cilën kontrolli dhe konfrontimi i drejtpërdrejtë midis të akuzuarit dhe viktimës duhet të jetë, pasi kjo mund të rezultojë në traumatizimin e mëtejshëm të viktimës.

Gjatë proceseve penale, znj. Y., ishte ballafaquar drejtpërdrejt me z. X., i cili kishte përdorur një teknikë kërcënuese dhe poshtëruese të marrjes në pyetje të dëshmitares. Gjykata vlerësoi se ishte përgjegjësia e kryetarit të turpit gjykues, se deri në çfarë mase përdorimi i kësaj teknike ishte në kundërshtim me integritetin personal të viktimës. Sidoqoftë, qasja e z. X., tejkalonte qartë kufijtë e kërkuar për një mbrojtje efektive. Për më tepër, gjykata vendase nuk kishte marrë parasysh ndikimin që mund të kishte pasur në psikologjinë e viktimës ballafaqimi me përfaqësuesin ligjor të z. X., që ishte një i njohur i znj. Y. Gjykata duhet të kishte vlerësuar dhe të kishte marrë në konsideratë faktin nëse përfaqësuesi ligjor duhet të përjashtohet. Në përfundim, eksperti gjinekolog e kishte tejkaluar në mënyrë të ngjashme fushëveprimin e detyrës së tij duke u ballafaquar drejtpërdrejt me znj. Y., lidhur me rezultatet e raportit të tij.

Pavarësisht disa masave mbrojtëse që ishin marrë nga autoritetet përgjegjëse, si dhënia e dëshmisë së viktimës në mënyrë private dhe shtyrja e disa seancave, Gjykata vendosi që marrëdhënia personale ndërmjet viktimës dhe të akuzuarit, ndjeshmërisë së çështjes dhe mosha e mitur e viktimës ishin faktorë të rëndësishëm që duheshin marrë parasysh në caktimin e masave mbrojtëse që duhej të ishin marrë gjatë procesit penal.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, nuk kishte pasur një ekuilibër të drejtë ndërmjet të drejtave të viktimës sipas nenit 8 dhe të drejtës së mbrojtjes së të akuzuarit sipas nenit 6. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 8.

Neni 41

Gjykata vendosi që shteti duhej të paguante 9,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 4,000 për shpenzimet gjyqësore.

Detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur fëmijët nga veprime të personave të tretë në kuadër të nenit 3 dhe mungesa e një mjeti efektiv ankimi në bazë të nenit 13

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Z. DHE TË TJERËT k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 29392/95)

10 maj 2001

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, katër vëllezër dhe motra nga njëri prind, janë respektivisht Z, një vajzë e lindur më 1982, A, një djalë i lindur më 1984, B, një djalë i lindur më 1986 dhe C, një vajzë e lindur më 1988. Të katër janë shtetas britanikë.

Në tetor 1987, familjes së kërkuesve iu rekomandua nga mjeku që t'i drejtoheshin shërbimeve sociale për shkak që shqetësimeve që paraqisnin fëmijët, përfshirë këtu edhe faktin se kishte të dhëna që Z. vidhte ushqim. Shërbimet shoqërore vijuan të mbikqyrnin familjen rreth edhe katër vjet e gjysmë më pas duke ju ofruar forma të ndryshme mbështetje prindërve të kësaj familje. Sidoqoftë, gjatë kësaj periudhe, problemet ende vazhdonin. Në tetor 1989, ndërkohë që po hetonin në një rast grabitje, policia konstatoi se dhomat e fëmijëve kishin një gjendje të mjerueshme dhe dyshekët ishin të lagur me urinë. Në mars 1990, u raportua se Z dhe A kërkonin ushqim në kazanët e mbeturinave në një shkollë. Në shtator 1990, u raportua se A dhe B kishin djegie në fytyrë. Në një sërë rastesh u bë e ditur se fëmijët mbylleshin në dhomat e tyre ku vinte erë e keqe. Së fundmi, më 10 qershor 1992, fëmijët u dërguan në një institucion kujdesi të përkohshëm me kërkesë të nënës së tyre e cila u shpreh se, në qoftë se ata do të vazhdonin të lireshin në kujdesin e saj ajo do t'i rrihte. Psikologjia që vizitoi fëmijët konstatoi se tre më të rriturit nxirrnin në pah shqetësime psikike serioze dhe vuri në dukje se ky kishte qenë rasti më i keq i abuzimit emocional dhe neglizhencës që ajo kishte parë në karrierën e saj.

Avokati, i caktuar kryesisht për kërkuesit, filloi proceset kundër autoriteteve vendore duke pretenduar për dëme si pasojë e neglizhencës së treguar nga autoritetet, të cilat kishin dështuar në ofrimin e kujdesit të përshtatshëm për këta fëmijë si dhe marrjen e masave për t'i mbrojtur ata. Në përfundim të proceseve në House of Lords⁸⁹, pretendimi i kërkuesve nuk u pranua. Në vendimin e dhënë më 29 qershor 1995, dhe që kishte të bënte me tre çështje, Lordi Browne-Wilkinson u shpreh, ndër të tjera, se

⁸⁹ *House of Lords* është autoriteti më i lartë gjyqësor në Mbretërinë e Bashkuar.

interesat e politikës publike ishin të tilla që autoritetet vendore nuk duhet të konsideroheshin përgjegjëse për neglizhencë në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre ligjore në mbrojtje të kujdesit për fëmijët.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se autoritetet vendore kishin dështuar në marrjen e masave të përshtatshme mbrojtëse duke u lënë krejtësisht jashtë vëmendjes dhe abuzimeve të cilave ata u nënshtroheshin, për shkak të keqtrajtimit nga prindërit e tyre. Gjithashtu, kërkuesit ankoheshin se nuk kishin pasur mundësi ligjore për t'iu drejtuar një gjykatë ose për një mjet tjetër ankimi efektiv në lidhje me vuajtjet që ju ishin shkaktuar. Lidhur me pretendimet e tyre ata i referoheshin neneve 3, 6, 8 dhe 13 të Konventës.

Neni 3

Neni 3 përbën një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, duke ndaluar në mënyrë absolute torturën ose trajtimet apo dënimet çnjerëzore dhe poshtëruese. Shtetet që kanë ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet, të marrin të gjitha masat që të garantojnë që individët brenda juridiksionit të tyre të mos i nënshtrohen trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, përfshirë këtu edhe rastet kur keqtrajtime të tilla bëhen nga individë në pozita private. Këto masa duhet të ofrojnë një mbrojtje efektive, në mënyrë të veçantë, fëmijëve dhe personave të tjerë në pozita vulnerabël, si dhe të përfshijnë edhe marrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimet për të cilat autoritetet kanë pasur mundësi të marrjes dijeni.

Nuk pati mosmarrëveshje në lidhje me faktin se neglizhenca dhe abuzimi që i'u ishin nënshtuar katër fëmijët-kërkues arrinin në nivelin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues. Qeveria nuk e kundërshtoi konstatimin e Komisionit, sipas së cilit trajtimi i vuajtur nga katër kërkuesit arrinte në pragun e ashpërsisë së ndaluar sipas nenit 3 dhe se shteti kishte dështuar në lidhje me detyrimin e tij pozitiv në kuadër të këtij neni për t'u ofruar kërkuesve mbrojtje të përshtatshme ndaj trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruese. Ky trajtim u ishte bërë i njohur autoriteteve vendore që në tetor 1987, dhe se ato kishin një detyrim ligjor të shkruar, që t'i mbronin fëmijët si dhe gëzonin një gamë të gjerë kompetencash në këtë drejtim, përfshirë atë të largimit të tyre nga shtëpia. Megjithatë, fëmijët u larguan prej andej dhe u vendosën nën kujdesin e një qendre të përkohshme vetëm me insistimin e nënës së tyre, më 20 prill 1992.

Për një periudhë prej 4 vite e gjysmë që u mor në shqyrtim, në shtëpinë e tyre kërkuesit i ishin nënshtruar, asaj që këshilltarja psikologe e fëmijëve e quajti “eksperiencë të tmerrshme”. Bordi për Kompensimin e Dëmeve Penale, konstatoi gjithashtu se fëmijët ishin lënë në një gjendje të tmerrshme për një periudhë të gjatë kohe dhe kishin vuajtur fizikisht dhe psikologjikisht si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga dhuna e ushtruar ndaj tyre. Gjykata e vlerësoi karakterin e vështirë dhe delikat të vendimeve që duhet të merrnin shërbimet shoqërore si dhe, nga ana tjetër, parimin e rëndësishëm të respektimit dhe ruajtjes së jetës familjare. Megjithatë, rasti në fjalë, nuk linte asnjë dyshimi në lidhje me dështimin e sistemit për mbrojtjen e kërkuesve nga neglizhenca dhe abuzimet serioze dhe afatgjata. Për këtë arsye, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3.

Neni 8

Nisur nga konstatimet e bëra lidhur me shkeljen e nenit 3, Gjykata vërejti se asnjë çështje e veçantë nuk u ngrit në bazë të nenit 8.

Neni 6

Në lidhje me zbatimin e nenit 6, Gjykata e vlerësoi të kënaqshëm faktin që, në përfundim të proceseve, kishte një mosmarrëveshje serioze dhe themelore në lidhje me ekzistencën e së drejtës të pretenduar nga kërkuesit në bazë të së drejtës së brendshme mbi neglizhencën dhe se mbi këtë fakt ata kishin të drejtë për një ankim sipas këtij neni. Për rrjedhojë, neni 6 ishte i zbatueshëm në lidhje me kërkesat e paraqitura nga kërkuesit përmes të cilave ata pretendonin neglizhencë nga ana e autoriteteve publike.

Në lidhje me pajtueshmërinë e nenit 6, Gjykata konstatoi se rezultati i proceseve të brendshme ishte se kërkuesit dhe çdo fëmijë me pretendime të ngjashme si ata, nuk mund të padisnin një autoritet vendor për qëndrim neglizhent dhe më tej duke pretenduar shpërblim të drejtë. Neglizhenca e autoriteteve vendase dhe sjellja e paarsyeshme e tyre kishte derivuar në shkaktimin e vuajtjeve të mëdha dhe evidente që kërkuesit kishin pësuar nga mosmarrja e masave për të parandaluar ose për ti dhënë fund këtyre vuajtjeve. Megjithatë, ky qëndrim nuk erdhi si rezultat i ndonjë pengese procedurale apo nga veprimi i ndonjë kriteri tjetër procedural që kufizonte mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës. Mospranimi i kërkuesve të kërkuesve vinte si pasojë e zbatimit të parimeve të së drejtës materiale nga ana e gjykatave britanike dhe për rrjedhojë nuk i përkiste Gjykatës së Strasburgut që të vendoste në lidhje me përmbajtjen e duhur të së drejtës së brendshme në këtë kuadër. Megjithatë, kërkuesit kishin të drejtë në deklaratat e tyre që mangësitë që ata kishin hasur në të drejtën e

brendshme ishin të tilla që preknin një çështje në kuadër të Konventës. Megjithatë, sipas vendimit të Gjykatës, kjo ishte një çështje që i përkiste nenit 13 dhe jo nenit 6 (1). Pra, duke vlerësuar se duhej shqyrtuar në kuadrin e së drejtës së kërkuesve për një ankim efektiv të mbrojtur nga ana e nenit 13, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6.

Neni 13

Duke vlerësuar nëse kishte pasur shkelje të nenit 13, Gjykata vuri në dukje se në rastet kur kishte pretendime për dështim të autoriteteve për t'ju ofruar mbrojtje individëve nga akte të kryera nga persona të tretë, në dispozicion të individit të dëmtuar ose të familjes së tij duhet të ketë një mekanizëm që të përcaktojë nëse ka pasur ndonjë përgjegjësi nga ana e funksionarëve ose organeve shtetërore për veprime ose mosveprime, që mund të përbëjnë shkelje të të drejtave të të dëmtuarve në bazë të Konventës. Për më tepër, në rastet e shkeljeve të neneve 2 dhe 3, të cilat konsiderohen edhe si dispozitat më themelore të Konventës, në parim duhet të jetë i mundshëm, si pjesë e efektivitetit të mjetit ankimor, edhe një kompensim për dëmet jomateriale që kanë ardhur si pasojë e shkeljes.

Kërkuesit argumentuan që, në rastin e tyre, një mjet efektiv ankimor mund të ofrohej vetëm nga proceset gjyqësore në të cilat të ishte i pranishëm edhe organi publik përgjegjës për shkeljen. Gjykata vuri në dukje se qeveria kishte pranuar që mjetet ankimore në dispozicion të kërkuesve nuk ishin efektive aq sa duhej dhe se, në të ardhmen, në bazë të Ligjit mbi të Drejtat e Njeriut të vitit 1998, të dëmtuarit që ju ishin shkelur të drejtat e njeriut do të kishin mundësi të fillonin procese gjyqësore pranë gjykatave që do të ishin kompetente për të akorduar edhe shpërblimin e drejtë.

Gjykata konstatoi se kërkuesit nuk kishin pasur në dispozicion mjete e duhura ligjore për t'u ankuar në lidhje me pretendimet e tyre për të cilat autoritetet vendore nuk kishin arritur t'i mbronin nga trajtimet çnjerëzore ose poshtëruese ose në lidhje me mundësinë e akordimit të një shpërblimi të drejtë lidhur me dëmet që ju ishin shkaktuar si pasojë e këtyre trajtimeve. Pra, atyre nuk u ishte ofruar një mjet efektiv në lidhje me përmbushjen e qëllimeve të nenit 3 dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 13.

Neni 41

Në kuadër të nenit 41 të Konventës, Gjykata i akordoi kërkuesit Z. 8,000 £, 100,000 £ për A., 80,000 £ për B., dhe 4,000 £ për C., në lidhje me dëmin material. Gjithashtu, Gjykata i akordoi 32,000 £ secilit prej kërkuesve lidhur me dëmin jomaterial dhe në total 39,000 £ lidhur me shpenzimet gjyqësore.



Foreign &
Commonwealth
Office

Përgatitja e këtij botimi është mbështetur nga Zyra e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Zyrës së Punëve të Jashtme dhe të Komonuelthit.



Regional Cooperation Council

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk mund të merren në asnjë mënyrë për të pasqyruar opinionin zyrtar të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal.

